

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 20 DHE 21 PRILL 2006

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 20. i 21. APRILA 2006

Prill – April 2006



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Implementimit të Standardeve për Kosovën,
2. Shqyrtimi i Procesit të privatizimit në Kosovë,
3. Shqyrtimi i Informatës për parandalimin e gripit të shpendëve.

DNEVNI RED

1. Razmatranje Implementacije standarda o Kosovu,
2. Razmatranje procesa privatizacije na Kosovu,
3. Razmatranje Informacije o sprečavanju ptičjeg gripa.

AGENDA

1. Review on the Standard Implementation for Kosovo,
2. Review on the privatization Process in Kosovo,
3. Review of the information for preventing the bird flu (pandemics).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS TË MBAJTUR MË 20 DHE 21 PRILL 2006

KRYETARI – Të nderuar deputetë, z. kryeministër, ministra ,ju dëshiroj mirëseardhje në seancën e sotme plenare, për të cilën propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i implementimit të standardeve për Kosovën,
2. Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë dhe
3. Shqyrtimi i Informatës për parandalimin e gripit të shpendve.

Rendin e ditës ,bashkë me materialin, e kemi marrë në kohë të caktuar dhe me qenë se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, konsideroj se janë plotësuar kushtet që t'ia fillojmë punës. Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri.

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Në pikën e tretë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimin e Informatës për parandalimin e gripit të shpendve. Diku shënohet informatë e diku raport, mirëpo propozuesi i kësaj pike të rendit të ditës edhe pse e ka parë rëndësinë e veçantë që sot të diskutohet, unë mendoj se kjo pikë nuk duhet të diskutohet sot se raporti nuk ka qenë komplet kur erdhi në këto tryeza të deputetëve.

Mendoj se përgatitja e këtij raporti është e njëanshme,është bërë vetëm nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe është avukuar, ndërsa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë fare nuk e kemi pasur raportin. Është qesharake , por po përsëriten këto shkelje protokollare se raporti i shëndetësisë është i datës 20. 4. do me thanë sot i kemi marrë, sot është hartuar,po nuk di kush e ka shkruar dhe kur erdhi. Prandaj është një lëshim që është bërë sot, se gripit i shpendve e dimë se është një sëmundje zoonozë që do me thënë shkaktari nuk është vetëm i shtazëve ,por është edhe tek njerëzit e që kjo sëmundje po të paraqitet, dhashtë zoti të mos paraqitet në Kosovë në këtë gjendje të rëndë, se do ta keqësonte shumë situatën dhe shëndetin e popullatës.

Dhe shkak i dytë nuk është bërë përgatitja nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë , nuk u është dhënë deputetëve që të njohohen, është edhe raporti financiar. Janë dhënë mjete alarmante për ndërtimin e këtyre laboratorëve,që është kënaqësi që i kemi parë në mjetet informative të revistës "Agimi" edhe janë bërë të gjitha ato shpenzime. Sipas zëvendësministrit ,thuhet se janë dhënë 200 mijë euro dhe 200 mijë të tjera pritjet të jepen. Këtu në raportin financiar nuk e kemi asnjë shënim, asnjë të dhënë edhe pse paraqitet buxheti i Kosovës, a jepen mjete a donacione , jep edhe Ministria e Bujqësisë, prandaj deputetët besoj se duhet ta kenë të qartë raportin financiar.

Së kendejmi propozoj të mos bëhet shkelje, të hartohet raporti financiar. Faleminderit!

KRYETARI – Ju faleminderit. Deputeti Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit për fjalë. I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar dhe të respektuar ministra, deputetë, kolegë dhe të pranishëm.

Mbështetur në shkallën e shqetësimeve dhe të paqartësive që ka paraqitë aprovimi i një projekti për krijimin e dy njësive komunale në Mitrovicë kërkoj ta kemi një informatë të plotë për procesin dhe rrjedhat e këtij projekti në një seancë të posaçme në Kuvend të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit Ramadan. Ramadan Musliu e ka fjalën.

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU – I nderuari z. kryetar. Unë nuk do të flas për rendin e ditës, por do ta paraqes një kërkesë të dy fshatrave të zonës kufitare Kosovë – Maqedoni. Me qenë se jam deputet i asaj zone kam për obligim ta paraqes këtë kërkesë.

Kohëve të fundit ekziston edhe një fushatë mediale rreth këtij problemi dhe rreth pakënaqësive që ekzistojnë për një 400 – 500 hektarë vetëm të komunës së Vitisë, që sipas kadastrit është zonë kadastrale e Vitisë. Megjithëse kjo pjesë ka 2500 hektarë, pakënaqësia e banorëve të fshatit Dobëllde dhe Mjak të komunës së Vitisë është në radhë të parë se kanë kaluar 7 vjet nga marrëveshja që është bërë midis Serbisë dhe Maqedonisë rreth vijës së demarkacionit. Janë këmbyer territore për zonat rreth pronës, që u zëvendësua me 2500 hektarë të territorit të Kosovës. Ka 7 vjet që banorët e Dubëlldes dhe të Mjakut nuk mund ta punojnë tokën e vet.

KRYETARI – Ju lutem kolegë a keni propozim.

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU – Po t'i lexoj së pari kërkesat e mandej propozimin.

Kërkesa numër 1 e këtyre dy fshatrave është të përcaktohet vija kufitare në mes të Kosovës dhe Maqedonisë pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës.

E dyta është të shqyrtohet seriozisht mundësia e kompensimit të dëmeve që janë shkaktuar gjatë këtyre 7 vjetve.

KRYETARI – Natyrisht se e keni kaluar kohën prej 2 minutash. Pra, të diskutohet për rendin e ditës e jo për çështje të tjera. Vazhdon diskutimi.

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU – Unë do të kisha diskutuar për çështjet e rendit të ditës, por jemi deputetë edhe në fushatën paraelektorale kemi dhënë shumë fjalë të mëdha, shumë premtime prej të cilave asnjë nuk i kemi realizuar. Së paku kam obligim moral që kërkesat e zonës prej së cilës jam t'i paraqes. Po flas për zonën time, nuk po flas se po i paraqes kërkesat e komunës së Vitisë.

Edhe e treta - thashë se është një ultimatum që nuk na obligon, se banorët e këtyre dy fshatrave thonë që nuk do ta pranojnë asnjë marrëveshje që mund të shkojë në dëm të

tyre. Problemi është se është një zonë shumë e ndjeshme ,e cila mund të shkaktoë telashe për shkak se është në kufi me Tanushën a dihet se konflikti në Maqedoni, pikërisht ka filluar nga ai fshat. E dyta po ndodh një shpërngulje masive, është boshatisur po ashtu Debelldeja . Me qenë se është Qeveria këtu e ka për obligim që së paku të marrë masa dhe ta parandalojë shpërnguljen e këtyre fshatrave . Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Deputeti Sabit Rrahmani. Ju lutem vetëm rreth rendit të ditës, i keni 2 minuta kohë.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. Kryeministër, të nderuar ministra të kabinetit Qeveritar, të nderuar deputetë.

Me qenë se Grupi Parlamentar për Integrim gjatë 5 muajve të fundit 3 herë ka bërë kërkesë në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës që të përfshihet ky grup parlamentar në komisionet funksionale të Kuvendit, deri te e Kryesia e Kuvendit kemi marrë përgjigje se do të shqyrtohen të gjitha mundësitë që edhe ne të përfshihemi në komisionet funksionale, kurse herën e tretë kemi marrë përgjigje se mund të marrim pjesë në komisione, por pa të drejtë vote apo të mërcmi vesh me Grupin Parlamentar 6+ për t'i ndarë këto vende në komisione. Unë mendoj që kjo është një shkelje e rëndë dhe në kundërshtim me nenin 9.1.19 te Komizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës.

Unë z. kryetar, në bazë të rregullës 23, pika 2 të kësaj rregulle, kërkoj që për emërimin në komisionet funksionale të Grupit Parlamentar për Integrim të deklarohet Kuvendi i Kosovës ,sepse kjo është e drejtë që ne këtë çështje ta ndriçojmë dhe të kërkojmë që në fund të seancës kjo të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës për emërimin e anëtarëve të Grupit Parlamentar për Integrim në komisionet funksionale. Ne kërkojmë deklarimin e Kuvendit. Herën e kaluar është thënë në Kuvendin e Kosovës që Grupi Parlamentar për Integrim i ka të gjithë anëtarët e vet nëpër komisionet e Kuvendit,por nuk është e vërtetë. Në Komisionin për Komunitete janë 4 anëtarë,që marrin pjesë në kuadër të komuniteteve dhe i përfaqësojnë komunitetet e tyre, kurse anëtari i 5-të i Grupit Parlamentar për Integrim asnjëherë nuk është votuar në Kuvendin e Kosovës dhe Grupi Parlamentar për Integrim në emër të grupit nuk ka asnjë anëtar në komisionet e Kuvendit. Prandaj kërkojmë deklarimin e Kuvendit dhe kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të jetë në fund të kësaj seance. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Ju e dini procedurën, mund të shkoni nëpërmjet Zyrës për Ankesa dhe Parashtrësa. Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi e ka fjalën.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar. Megjithëse edhe unë vij nga komuna e Vitisë edhe mua më është bërë e njëjta kërkesë nga përfaqësuesit e fshatit Debellde, por unë për dallim nga kolegu që vjen nga e njëjta komunë,propozoj që ky Kuvend ta miratojë një deklaratë me të cilën rikonfirmohet qëndrimi i këtij Kuvendi se çështja e kufirit me Maqedoninë mund të vendoset vetëm pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, vetëm pas bërjes së Kosovës shtet i pavarur.

Deklaratat e kryeministrit se këtë çështje do ta zgjidhë me kryeministrin e Maqedonisë i kanë shqetësuar qytetarët e Debelldes dhe të Vitisë. Prandaj unë mendoj se ky Kuvend sot duhet të dalë me një deklaratë që propozoj të hyjë në rend dite. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Çdo propozim i ri duhet të kalojë nëpërmjet Zyrës për Parashtrësia dhe Ankesa. Veproni ashtu. Ju faleminderit. Sabit Rrahmani për të dytën herë po e merrni fjalën.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Jo z. kryetar vetëm desha t'ju informoj se ne kemi reaguar në vendimin e Kryesisë dhe para dy jave kemi bërë kërkesën, vërtet ankesën edhe në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia, por nuk kemi marrë përgjigje ende. Ju faleminderit.

KRYETARI – Do t'i merrni. Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar unë desha të reagoja lidhur me propozimet e z. Rrahmani dhe në përgjigjen që iu dha.

Mendoj se ka shumëçka të bëhet lidhur me funksionimin e komisioneve në Kuvendin e Kosovës, pra, duhet të rishqyrtohet tërësisht mënyra e funksionimit dhe e përzgjedhjes së komisioneve konform Kornizës Kushtetuese dhe pastaj këtë formulë mendoj se administrata dhe Kryesia e legjislaturës së mëparshme e di mirë si ka funksionuar dhe si është zgjedhur, me qenë se grupi parlamentar mendon se Korniza Kushtetuese këtyre nuk ua ndalon pavarësisht se ndonjëri e ka vendin të rezervuar dhe nuk është i zgjedhur drejtpërsëdrejti ose nuk ka fituar numër të mjaftueshëm votash të domosdoshme, se shumica e partive politike dhe veçanërisht opozita janë të hendikepume, sepse nuk është zbatuar dhe nuk është respektuar formula përkatëse për funksionimin dhe për zgjedhjen dhe udhëheqjen e komisioneve të Kuvendit të Kosovës konform Kornizës Kushtetuese. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Mund të bisedohet kjo në një mbledhje të ardhshme. Deputeti Gani Koci e ka fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI – Z. kryetar dua t'jua përkujtoj rregullën 30 të Rregullores së Punës të Kuvendit lidhur me parashtrimin e mocioneve ose të mocionit kur ka të bëjë me bartjen e një pike të rendit të ditës në një seancë tjetër që ishte kërkesë e deputetes Teuta Hadri., që pika rreth raportit për masat parandaluese të gripit të shpendve të shtyhet për një seancë tjetër me qëllim të kompletimit të raportit. Sipas kësaj rregulle, pika 2 kjo kërkesë duhet të hidhet në votim, të shtyhet ose të mos shtyhet, do të thotë Kuvendi duhet ta miratojë me anë të votimit këtë kërkesë të deputetit në fjalë.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Ne me kohë, siç është paralajmëruar, në njërin prej seancave të radhës që sot do të diskutohen tri çështje rre rëndësi të posaçme për qytetarët e Kosovës, por ju përgëzoj për përgatitjen e seancës dhe dërgimin

e materialeve. Lidhur me propozimin që pika e tretë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës, ne si grup parlamentar lusim Kryesinë e Kuvendit dhe ju posaçërisht që të na mundësoni debat pasi që kemi marrë disa materiale nga Ministria për Bujqësi dhe disa materiale lidhur me këtë çështje nga Ministria e Shëndetësisë . Mendoj se janë pjekur të gjitha kushtet që debati të fillojë, nëse deputetët apo eventualisht një grup parlamentar mendojnë se nevojitet një kohë më e gjatë, ne mund ta vazhdojmë këtë debat edhe në një prej seancave të ardhshme.

Por ne kërkojmë që kjo të debatohet sot dhe nëse ka nevojë për informata shtesë ato mund të rregullohen sipas procedurave parlamentare, pyetje përgjigje nëpërmjet interpelancës, që kjo të hyjë por ne nuk e kundërshtojmë që kjo të vjen përsëri në rend të ditës një herë tjetër, por insistojmë që për këtë të debatohet sot. Ju faleminderit.

KRYETARI – Faleminderit profesor. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatçia.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryetar. Sa i përket pjesëmarrjes së Grupit Parlamentar për Integrim në komisione në parim edhe ne i përkrahim pasi si grup parlamentar janë trup i këtij Kuvendi dhe do të duhej ta jepnin kontributin e vet nëpër komisione. Zgjidhjen e kësaj nuk dëshiroj ta quaj problematike, por për zgjidhjen e saj do të duhej të ishte pikë e rendit të ditës në fund apo si një pikë tjetër e rendit të ditës, por gjithsesi që këta deputetë të përfshihen dhe të japin kontributin e vet. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Çdo propozim duhet ta ketë mbështetjen e grupit parlamentar. Urdhëroni z. Hadri.

DEPUTETJA TETUTA HADRI – Unë e kontestova atë se nuk ka rëndësi të veçantë, e tash që nga fjalët e para se kjo pikë ka qenë e një rëndësie të veçantë, mirëpo e them se deputetët sot nuk kanë qenë të përgatitur për raportin që i ka sjell Ministria e Shëndetësisë më 20.. d.m.th. sot e kemi marrë dhe besoj se të gjithë deputetët do ta përkrahin mendimin tim, prandaj propozoj të hedhet në votë.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e kërkon prapë shefi i Grupit Parlamentar Alush Gashi. Urdhëroni profesor.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Deputeti Ramadan Kelmendi, nga radhët e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës shprehi publikisht shqetësim të cilin e ndajmë ne si grup, andaj lusim Kryesinë e Kuvendit ta ketë në konsideratë përgatitjen e një informate lidhur me propozimet e ndryshme për zgjidhjen e çështjes së decentralizimit e në veçanti të Mitrovicës.

Ne shpresojmë që këtë kërkesë të grupit tonë ta merrni seriozisht dhe do t'i përgjigjeni kërkesës ,ashtu siç e ka kërkuar deputeti. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit profesor. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit i nderuari z. kryetar i nderuari kryeministër, anëtarët e kabinetit qeveritar të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është i përkushtuar për funksionimin sa më të mirë të Kuvendit dhe në këtë aspekt jemi të përkushtuar dhe do të kontribuojmë në tri pikat e përcaktuara të rendit të ditës , për të gjitha iniciativat e grupit më tej do ta informojmë me shkrim Kryesinë e Kuvendit. Faleminderit.

KRAETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës z. Jakup Krasniqi. Urdhëroni

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. Kryeministër, të nderuar deputetë.

Pasi vërtet po bëhet, konsideroj ,një lojë me çështjen e Mitrovicës, unë e kam një kërkesë pak më ndryshe që dallohet nga kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Unë mendoj se ky Kuvend,nëse jo me një raport, me një informatë duhet të njoftohemi çka ka bërë koalicioni qeverisës një vit e gjysmë për Mitrovicën, natyrisht kjo informatë ose raport do të duhej të bashkohej me një informatë ose me një raport të Kuvendit komunal të Mitrovicës, çka ka bërë që dy mandate Kuvendi komunal i Mitrovicës për të bashkuar qytetin. Në mënyrë që vërtetë të mos e luaj pozita rolin e opozitës. Mendoj që kjo do të jetë kërkesa e deputetëve që të kemi një informacion të plotë çka është bërë në dy nivelet për bashkimin e qytetit të Mitrovicës.

KRYETARI – Ju faleminderit. Xhezair Murati e ka fjalën.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, poštovani premijeru, zameniče premijera, ministre i kolege. Ja se javljam vezano sa problematikom koju je nova Poslanička grupa „ Za integraciju“ u nekoliko navrata preko skupštinske, dakle skupštinskih zasedanja pokušavaju normalno, ako im to sleduje na osnovu Poslovnika o radu Skupštine da dobiju članstvo u nekim komisijama. Mi kao Grupa 6+ odbacujemo svaku mogućnost uranilaovke dakle prelivanja iz jednog džepa u drugi ili oduzimanjem nekih komisija jednoj grupi, davanjem drugoj grupi, mislim to ne vodi ničemo i to je mimo svake zdrave logike jer je Grupa 6+ formirana u samom startu skupštinskog rada i ona aje deo vladajuće koalicije tako da nema anikakve svrhe niti logike da se od nekog oduzima da bai se dalo drugma nego to treba razmotriti Pravna služba Skupštine na osnovu Pravilnika.

Mi imamo informaciju da svi sem jednog člana koji nije iz manjinskih zajednica imaku komisije, tako oduzimati od manjinski davati, ne znam predstavnicima malih partija iz većinske zajednice i td, to ne smatramo rešenjem nego da se ovom problemu pridjemo ozbiljno i ne na račun drugih poslanikih grupa pogotovo što je ona formirana godinu dana nakon konstituisanje Skupštine već sutra nam se može aviti i neka nova grupa koja će ponovo istim načinom postupiti. Toliko. Hvala!

KRYETARI – Ju faleminderit. Ju lutem do të votojmë për propozimin që dha deputetja Teuta Hadri. Të shqyrtohet sot apo të shtyhet për një seancë tjetër.

Kush është për shtyrje të kësaj pike të rendit të ditës për një seancë tjetër?
Në sallë janë 103 deputetë.

Për.....	40
Kundër.....	62
Abstenim nuk ka	

Nuk kalon propozimi.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i implementimit të standardeve për Kosovën

Në propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe miratim të Kuvendit e me qëllim të përgatitjes së debatit lidhur me këtë çështje „Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që për deputetët dhe për Kuvendin të prezantojë raportin lidhur me zbatimin e standardeve për Kosovën.

Ftoj kryeministrin Çeku që ta marrë fjalën. Urdhëroni z. Kryeministër, foltorja është juaja.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuari z. kryetar të nderuar deputetë zonja zotërinj.

Në emër të Qeverisë mendoj të shprehë faleminderimin për interesimin dhe angazhimin e Kuvendit të Kosovës që sot të debatojmë për procesin e implementimit të standardeve, posaçërisht duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë që kanë standardet në promovimin e procesit ,për të cilin po kalojmë,por njëkohësisht edhe për rolin që kanë standardet në përmirësimin e jetesës së qytetarëve të Kosovës.

Shpresoj se, debati i sotëm do të jetë në funksion të avancimit të përpjekjeve dhe të veprimeve të institucioneve të Kosovës në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ky plan dhe se ky debat do të jetë një shtytje e re për Qeverinë dhe popullin e Kosovës që ta shtyjnë këtë proces edhe më përpara.

Zonja dhe zotërinj, që nga aprovimi i planit për implementim e standardeve në Parlamentin e Kosovës në vitin 2003 implementimi i standardeve e shndërruar në një proces që kur më pak e kur më shumë ka dominuar jetën politike të shoqërisë sonë dhe ka shënuar progres sipas vlerësimit të bashkësisë ndërkombëtare.

Në dokumente prezantuara para jush keni katër vlerësimet e standardeve nga UNMIK-u ,që paraqesin zhvillimet dhe rezultatet që Qeveria e Kosovës i ka arritur që nga periudha e mesit të vitit 2004 e deri në dhjetor të vitit 2005. Shpresoj t'i kemi të krahasuara ato, është evidente se rruga për implementimin e standardeve, me gjithë sfidat dhe me gjithë vështirësitë që i kanë përcjell , ka qenë e suksesshme dhe në funksion të plotë të avancimit dhe të promovimit të aspiratave të popullit të Kosovës.

Pavarësisht nga ajo se Kosovës dhe popullit të saj i mbetet ende për të bërë shumë punë në mënyrë që të realizohen plotësisht objektivat e parashtruara. Sot gjendemi në proceset e reja që janë të mundësuar pikërisht si rezultat i progresit të standardeve.

Të nderuar deputetë, standardet edhe sot mbasin të rëndësishëm për Kosovën dhe për institucionet e saj, andaj edhe janë dhe do të mbeten prioritet i Qeverisë. I marrim seriozisht vlerësimet e subjekteve të rëndësishme ndërkombëtare se standardet dhe shpejtësia e implementimit të tyre përcaktojnë shpejtësinë e zgjidhjes së statusit, sepse aktivitetet tona kanë pikënisje pikërisht këto vlerësime.

Që nga marsi janë marrë shumë veprime të suksesshme që kanë pasur për qëllim ngritjen e dinamikës dhe fokusimin në implementimin e standardeve. Janë bërë ndryshime strukturale në mekanizmat e implementimit të standardeve dhe efektet e këtij dinamizmi po shihen për ditë, qoftë në listën e rezultateve të arritura, qoftë me vlerësimet ndërkombëtare për shkallën e ngritur të dinamikës.

Janë bërë disa ndryshime në strukturat dhe mekanizmat e veprimit, do t'i cek disa:

Ministria e posakrijuar e Drejtësisë i ka marrë përsipër standardet e sundimit të ligjit, kurse Ministria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për plotësimin e standardit të funksionimit demokratik të institucioneve.

Çdo dy javë kemi takime të rregullta me të gjithë kryesuesit e grupeve të punës të Qeverisë dhe të UNMIK-ut për standardet.

Çdo muaj do të kemi takime të rregullta me kryetarët e komunave.

Çdo tri javë secili grup pune për standarde edhe më tutje raporton në zyrat ndërlidhëse të UNMIK-ut, si dhe përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë për shkallët dhe për progresin e standardeve.

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta shndërroj Zyrën për Integritet Evropian në Agjenci për Integritet Evropian, kurse standardet do të jenë pjesë e aktiviteteve të këtij agjencioni. Zyra për Integritet Evropian, bashkë me institucione tjera vendore UNMIK-ut dhe Komisioni Evropian është një proces i shkrirjes së standardeve me prioritetet e bashkimit evropian në një dokument të vetëm që quhet Plani i veprimit të përbashkët të partneritetit evropian. Jemi në proces të finalizimit të këtij procesi dhe është objektiv yni që krijimi i Agjencisë për integritet evropian me 1 qershor të këtij viti të na gjejë edhe me planin të përbashkët të veprimit që do t'i përcaktojë veprimet e Agjencisë në 2 deri 4 vjetet e ardhshme në çështjet që kanë të bëjnë me standardet dhe me prioritetet e Bashkimit Evropian.

Para jush, përveç të katër vlerësimeve teknike të UNMIK-ut, e kemi edhe planin e veprimit tremujor, në të cilin Qeveria e Kosovës në këtë periudhë është e angazhuar ta implementojë. Ky plan është krijuar duke marrë parasysh veprimet e rekomanduara nga grupet e punës të Qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut, kurse implementimi i këtyre veprimeve konsiderohet se do të shënojë edhe një vlerësim pozitiv për Kosovën dhe një hap përpara drejt afirmimit të vlerave për një shoqëri demokratike.

Ky plan është aprovuar në mbledhjen e Qeverisë më 28 shkurt dhe është orientimi yni që shumicën e këtyre veprimeve t'i përmbyllim deri më 30 maj.

E konsideroj të rëndësishme të theksoj se veprimet në planin tremujor nuk janë veprime të vetme që ndërmerren në përmbushjen e implementimit të standardeve, por janë veprime në të cilat ekziston një përqendrim më i fokusuar. Më lejoni t'i përmendi vetëm disa nga veprimet dhe rezultatet e arritura në periudhën e fundit.

Krijimi i Agjencisë për pronën do t'u japë fund uzurpimeve të pronave komerciale dhe atyre bujqësore e që këto uzurpime, përveç dëmeve të mëdha që na kanë shkaktuar në procesin politik, janë gjithashtu pengesë e madhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Krijimi i dy ministrive të reja është duke u zhvilluar plotësisht në përputhje me procedurën me ligjshmërinë dhe si rezultat i kësaj po përgatiten dhe po merren më shumë kompetenca në fushën e drejtësisë dhe të rendit.

Gurthemeli për shtëpitë e banorëve të lagjes së romëve të Mitrovicës do të hidhet në ditët e ardhshme më 25 të këtij muaji. Shumë shpejtë do të jepen çelësat e objekteve për banim të banorëve të kampit të Plemetinit. Është arritur sukses në rritjen e komunikimit me komunat veriore në takimet e përbashkëta. Me përfaqësuesit e këtyre komunave është punua me krijim e strategjisë së kthimit me këto komuna për qytetarët joserbë.

Në 27 nga 30 komuna është arritur kota e plotë e së ashtuquajturës ndarje e drejtë financiare. Janë rritur kontrolli dhe transparencja në të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, është rritur dhe do të rritet edhe më shumë lufta kundër dukurive negative në institucionet, qoftë në krijimin e Agjencisë Antikorrupsion, qoftë me forma të ndryshme të llogaridhënies institucionale.

Zyra e Prokurorit Special e cila është në fazën përfundimtare të krijimit bashkë me Agjencinë Antikorrupsion, do të jenë mbështetje e fuqishme e Qeverisë për politikën e saj të re, zero tolerancë kundër krimit dhe korrupsionit. Janë krijuar njësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në 13 ministri dhe është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit me OSBE-në, që nënkupton vendosjen e ekspertëve ndërkombëtarë nëpër ministri me qëllim të avancimit të respektimit të të drejtave të njeriut.

Progres është arritur në fushën e avancimit të disiplinës fiskale në proporcion dhe duke u përmbajtur marrëveshjes së arritur me institucionet financiare ndërkombëtare. Po ndërmerren aktivitetet konkrete me forcimin e bashkëpunimit ekonomik me vendet në rajon. Shtrohen përparimet për dinamizmin e veprimeve në shpejtimin e krimit të planit nacional zhvillimor. Në javën e ardhshme pritet nënshkrimi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Ligjin për investime të huaja, si dhe Ligjin për koncesione të tjera.

Ne e dimë se të gjitha standardet janë të rëndësishme dhe se asnjë standard nuk është më pak i rëndësishëm sesa standardi tjetër. Faza në të cilën gjendemi, megjithatë kërkon nga ne një fokus më të madh dhe orientim me përmirësimin e pozitës së minoriteteve, është

thënë edhe më parë së shpejti rruga e realizimit të aspiratave të shumicës kalon pikërisht nëpër krijimin të besimit dhe respektimin e pakicave. Pikërisht për këtë orientimi ynë paqësorë në implimentimin e standardeve do të jetë edhe më tutje në ofrimin dhe avancimin e pozitës së minoriteteve dhe krijimin e besimit në procesin që po kalon Kosova. Krijimi i besimit në mes të komuniteteve pakicë dhe asaj shumicë është parapërcaktues i shpeshtë i veprimeve në implementimin e standardeve. Përveç veprimeve të përmendura më herët ne jemi duke punuar në ndërtimin e besimit tek popullata pakicë qoftë me anë të vizitave të shpeshta të zyrtarëve qeveritarë, qoftë me anë të veprimeve konkrete që inkurajojnë minoritetet që të integrohen në shoqërinë tonë dhe të jenë pjesë e zhvillimeve demokratike të shoqërisë sonë.

Jemi në krijim të një force që do të elaborojë dhe do të zhvillojë plane të mëtutjeshme për avancimin e pozitës së minoriteteve, do të punojmë në zgjidhjen e të gjitha kontesteve pronësore që janë të ndërlidhura me minoritetet. Procesi i rindërtimit të kishave të dëmtuara ka filluar dhe po zhvillohet sipas planit të parapar. Besoj se në njërin nga seancat e para të ardhshme të Parlamentit ju do ta aprovoni Ligjin për gjuhë zyrtare dhe Ligjin për religjionet. Po punojmë që për të kthyerit orientimi ynë primar të mos jetë vetëm kthimi fizik pra ndërtimi i shtëpive të tyre, por njëkohësisht edhe integrimi i plotë i tyre në shoqërinë tonë.

Zonja dhe zotërinj, nuk e kam pasur ndërmend të flas këtu vetëm për të arriturat dhe të krijoj përshtypje se çdo gjë është prefekt dhe se ne po korrim vetëm progres. Standardet për Kosovën janë një sfidë e konsiderueshme që c kërkon përkrahje dhe bashkëpunim nga të gjitha shtresat e shoqërisë, standardet e implementimit të tyre shpeshherë janë viktimitë e limiteve buxhetore, zhvillimi paralel i proceseve të tjera të rëndësishme dhe zhvillimit institucional ende i ri. Puna janë në implementimin e standardeve dhe krijimi i një Kosove demokratike tolerante me një ekonomi të qëndrueshme nuk ka përfunduar dhe do të vazhdojë dhe pas vlerësimit të Këshillit të Sigurimit në muajin qershor dhe pas definimit të statutit politik të Kosovës. Ky është një proces i përbashkët ku të gjithë ne kemi rol dhe obligim. E konsideroj të rëndësishme që sot të kërkoj nga ju të gjithë kontribut në avancimin e procesit dhe arritje të rezultateve edhe më të mira, në mënyrë që të gjithë qytetarët e Kosovës të përfitojnë nga veprimet tona. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. kryeministër. Para se të fillojmë me debat ju njoftoj se në pajtim me rregullin 22 pika 5 të Rregullores së Punës radhitja e diskutuesve është si vijon:

Propozuesi i mocionit, kryetarët e grupeve parlamentare pastaj deputetët. Për fjalë është paraqitUR shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së z. Alush Gashi. Urdhëroni profesor.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar. Falënderojmë z. kryeministër për një fjalë të thukët lidhur me këtë çështje.

Standardet janë bërë realitet i punës dhe I jetës në Kosovë. standardet ofrojnë perspektivën evropiane të Kosovës të pavarur. Dhe ne si grup parlamentar e përgëzojmë Qeverinë me entuziazëm lidhur me këtë çështje si dhe me rezultate evidente. Grupi

Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i riafirmon përcaktimin dhe përkushtimin për angazhim me mbështetje të programit të realizimit të plotë të standardeve për Kosovën për një Kosovë të pavarur për një Kosovë evropatlantike. Në fund ftojë deputetët e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që t'i japin kontributin e vet në debat konstruktiv. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit profesor. Për diskutim është paraqitur kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës z. Hashim Thaçi

DEPUTETI HASHIM THAÇI – Faleminderit z. kryetar të nderuar deputetë, dhe ju qeveritarë.

Bashkësia Ndërkombëtar, siç e dinë të gjithë, ka paralajmëruar me të drejtë nëse nuk ndodhin përmirësime në fushën e zbatimit të kriterëve demokratike në veçanti në sundimin e ligjit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, pastaj në funksionimin demokratik dhe efektiv të institucioneve, atëherë nga keqqeverisja e koalicionit aktual mund të rrezikohet edhe zyrtarizmi i pavarësisë së Kosovës, realitet ky i krijuar në qershor të vitit 1999 nga sakrificat e të gjithë qytetarëve të saj.

Qytetarët politikën kosovare, në veçanti Qeveria e Kosovës të cilës dhe i besohet ky mesazh, do të duhet ta merrni shumë më seriozisht këtë çështje. Ky mesazh do të duhej ta bënte Qeverinë të përgjegjshme, korrekte të disiplinuar dhe transparente në punë.

Ndërsa koalicioni aktual atyre që kanë mendim politik në kuptimin pozitiv, të distancohet jo vetëm verbalisht, por edhe praktikisht nga e keqja që ia ka servuar qytetarëve të Kosovës Qeveria aktuale.

Deputetë të nderuar,

Standardet i mirëpritëm së bashku, si përkushtim për të krijuar shoqëri të lirë e demokratike në Kosovë, nëpërmjet të cilëve do t'u garantohej qytetarëve lëvizje e lirë, do t'u mundësohej dhe garantohej komunikim i lirshëm në gjuhën e tyre, do të trajtohen njësoj dhe pa dallime në punë, në rrugë do të jenë të barabartë para ligjit, do të kenë mundësi të barabartë qasjejeje në institucione të shtetit. Do të garantohej kthimi i qëndrueshëm i të zhvendosurve në shtëpitë dhe pronat e tyre, liria e qarkullimit përbën të drejtat elementare njerëzore dhe një nga vlerat bazë politike. Nuk mjaftojnë vetëm veprimet për qëllime mediale, por angazhimet konkrete aktive në terren për të siguruar plotësisht lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës në teritorin e vendit.

Mospuna në lirinë e lëvizjes prodhon drejtpërdrejt efekte edhe në kthimin e pjesëtarëve edhe të atyre që dëshirojnë të kthehen.

Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të shndërrohet në autoritet të pranuar prej tyre të cilit do të mund t'i besohet. Kampi i Romëve në Plemetin dhe në Zhitkocv janë shembujt më të mirë se sa Qeveria nuk është në gjendje të mbajë premtimin e dhënë. Banorët e

zhvendosur hadjan nga trojet e veta, me të drejtë, ndihen të zhgënjyer gjithashtu nga Qeveria aktuale.

Ne përkrahëm edhe punuam për standardet demokratike, sepse deshëm të krijojmë Kosovë të re, ku institucionet zgjedhën dhe funksionojnë në mënyrë demokratike. Qeveria duhet të jetë transparente dhe efikase. Ne investuam të gjithë, si parti politike dhe qytetarët e Kosovës për Kosovën shtet të ri e demokratik, ku do të respektohej e drejta e barazisë gjinore, fetare dhe etnike. Punuam të gjithë të krijojmë realitetin e mundësive të barabarta e jo favorizuese apo përjashtuese. Ne të gjithë e duam një vend ku nuk ka diskriminim ,por vetëm trajtim të barabartë. Ne të gjithë u përkushtuam për Kosovën me ekonomi të zhvilluar e jo për ngecje në zhvillim dhe mirëqenie sociale ,siç ndodh sot nga paaftësia dhe keqmenaxhimi i Qeverisë.

U zotuar me zë të lartë të luftojmë korrupsionin dhe dukuritë e tjera negative me të gjitha mjetet demokratike, kudo dhe kurdo që paraqiten, por kjo nuk ndodhi. Por për fatin tonë të keq në Kosovë po ndodh e kundërta. Në raportin e fundit të Departamentit të shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është kritikuar shkalla e diskriminimit të kushteve, e të drejtave të njeriut ndërsa nga Grupi i Kontaktit dhe nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara është kritikuar gjithashtu Qeveria aktuale për mosplotësimin e standardeve demokratike.

Standardet demokratike në rastin e Kosovës janë të lidhura drejtpërdrejt me zgjidhjen e statusit politik, me jetën e re kosovare dhe procesin e integritimeve euroatlantike.

Partia Demokratike e Kosovës përkrah dhe punon që Kosova të ketë institucione funksionale, stabile dhe demokratike. Ky standard është bazë për zhvillimin e shoqërisë sipas modelit të demokracisë qytetare. Standardet janë shndërruar në dekor dhe blerje kohe nga qeveritarët aktualë. Si mund të plotësojë kriteret perëndimore një qeveri e këtyllë e zhytur në krim dhe korrupsion kur vetë korrupsioni dhe krimi janë dukuri që luftohen më së shumti në botën demokratike. Të marrim shembull standardin e parë funksionimin demokratik të institucioneve dhe funksionimin efektiv, si mund të flasim për institucionet demokratike kur ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme tashmë se edhe vetë emërimi i ministrave dhe kryeministrave është bërë nga struktura krejt parapolitike dhe aspak demokratike, kur ministrat nuk u japin llogari Parlamentit të Kosovës as Qeverisë, por japin llogari parapolitikës ata të cilët edhe i ka zgjedhur dhe emëruar. Ata të cilët diferencojnë dhe spastrojnë në baza krejtësisht politike dhe të interesave financiare, ku shpërfillin kritikën, kritiken edhe të mediave të lira edhe tek opinioni publik. Për kë punon kjo Qeveri.? Shtrohet pyetja nga gjithë qytetarët e vendit dhe e gjithë politika kosovare. Për qytetarët e Kosovës jo se jo, për pavarësinë e Kosovës assesi kjo Qeveri rrezikon demokracinë në Kosovë. Prandaj, miqtë tanë ndërkombëtarë me të drejtë alarmojnë për këtë rrezik. As qytetarët e Kosovës e as ndërkombëtarët nuk e duan një gjë të tillë, shpresoj e besoj se as ne që jemi prezentë këtu nuk e duam të gjithë që të kemi qeveri të korruptuar që udhëhiqet nga krimi i organizuar. Te marrim standardin e sundimit të ligjit. Si mund të lavdërohen qeveritarët e Kosovës dhe UNMIK-u se po zbatojnë këtë standard vetëm ndër më të rëndësishmit , kur vetë kanë qëndruar si sinonim i shkëljes së ligjit, të abuzimit të detyrës me parat publike. Ky standard mund të rrimërtohej lirisht standardi i sundimit dhe i tolerimit nga Qeveria aktuale të krimit të organizuar në Kosovë. Dikush mendon se na duhen fakte dhe dëshmi, unë them publikisht me përgjegjësinë më të lartë politike, qytetare

dhe kombëtare se fakte dhe dëshmi janë emblema dhe adresa e krimit, e korrupsionit është kjo Qeveri dhe ky ekip qeveritar.

Standardi i ekonomisë është dështimi i radhës së këtij formacioni të dështuar qeveritar. Kosovës çdo muaj është duke ju shtuar numri i punëkërkuësve, ndërsa është duke iu rritur shkalla e papunësisë. Ekonomia e Kosovës ka shënuar rënie të theksuar. Buxheti i varfër i Kosovës është në deficit, pagat e arsimtarëve janë të mjerueshme dhe shumë nënçmuese, invalidët e luftës dhe të punës janë në gjendje të rëndë dhe fyese nga Qeveria aktuale për mospërkujdesjet e saj. Sistemi arsimor dhe i shëndetësisë janë para një kolapsi total. Standard për këtë Qeveri është vënia e masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës dhe fillimi i mbylljes së çerdheve parashkollore. Tashmë 40 janë mbyllur në vend që të hapeshin. Pra, Kosova gjendet pra një shpërthimi social me pasoja të paparashikueshme politike dhe qytetare. Gjendja e pensionistëve është alarmante. Interesimi i Qeverisë mungon krejtësisht, ndërsa luksi dhe plaçkitja e fondeve publike nga ana e qeveritarëve aktualë vazhdon papengushëm. Kosova gradualisht po ndërton identitetin qytetar dhe shtetëror, por duhet t'i vendosim bazat e institucioneve stabile, ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore, por këtë nuk mund ta bëjë me këso qeverie. Sot koalicioni aktual që ka krijuar shumica e thjeshtë e këtij Kuvendi nuk e ka bërë asnjëherën nga këto që i theksova. Kualicioni aktual ka dështuar në ndërtimin e një ekipi qeverisës të qëndrueshëm dhe funksional, u ndërruan tre kryeministra, por mentaliteti i vjetër i keqmenaxhimit, keqqeverisjes, i mosrespektimit të ligjit, uzurpimit, grabitjes dhe korrupsionit kanë mbetur, vetëm se është sofistikuar paksa. Për muajt të tërë u shty zgjedhja e ministrave të Rendit dhe të Drejtësisë. Si pasojë e betejës në mes të grupeve dhe klanëve të interesit brenda partive të koalicionit. Prandaj, nuk duhet të heshtet, por duhet të zbardhen vrasjet dhe krimet politike që kanë ndodhur pas luftës e gjithashtu edhe vrasjet dhe krimet e mund të themi, ju e dini se vetëm në një rajon të Kosovës kanë ndodhur rreth 300 vrasje ende të pazbuluara dhe kjo Qeveri e ka obligim t'i zbardhë ato vrasje.

Korrupsioni në Qeverinë aktuale është rrezik për pavarësinë, sigurinë, pengesë për zhvillimin ekonomik, kërcënuese për demokracinë në Kosovë dhe integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Mendimi politik i këtij koalicioni o hiqet sipas logjikës së shtetit absolutist, logjikë që qytetarin e vështron si një shërbëtor të shtetit, si objekt përdorimi për kohë të caktuar. Qytetari ngarkohet me taksa përderisa ato nuk i kthehen me shërbimet e kërkuara.

Kjo është logjika për shtetin e ardhshëm të Kosovës nga Qeveria aktuale që nuk udhëhiqet nga legaliteti i partive të koalicionit aktual, por nga kuzhina e individëve dhe grupeve parapolitike. Qeveria aktuale nuk u shërben qytetarëve të Kosovës, por vetëm njerëzve të parapolitikës dhe parainstitucioneve. Dikush mund të pyesë çka është kjo parapolitika? Parapolitika është ajo të cilën prej kryeministrit dhe këtyre ministrave ju raportojnë dhe kryejnë obligimet dhe përgjegjësitë që kanë marrë para tyre ,atëherë kur i kanë emëruar brenda natës, për qëllimet e tyre krejt private dhe grupore.

Të nderuar deputetë, korrupsioni në Qeverinë aktuale nuk është punë individi, është e keqe dhe fenomen strukturor, është mentalitet i shndërruar në kulturë politike qeverisëse. Segmentet e caktuara të UNMIK-ut, gjithashtu, në emër të një paqe sociale apo politike

vazhdojnë të heshtin dhe tolerojnë korrupsionin. Edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara e konfirmoi këtë fakt të thënë qysh më parë nga opozita kosovare.

Situata ekonomike në Kosovë nga kjo keqeverisje vazhdon të jetë e rëndë. Në fund të vitit 2005 humbjet buxhetore në Kosovë ishin të mëdha. Shpërndarjet buxhetore janë shtuar, është regjistruar një trend i ri i inflacionit. Raporti i zhdrejtë në mes eksportit dhe importit në Kosovë vazhdon. Tregtia me jashtë është reduktuar në 30%. Numri i të papunëve rritet vazhdimisht, është më i larti në Evropë me këtë keqeverisje, shkalla e varfërisë është më e larta me këtë keqeverisje. Ne nuk shohim se ekziston ndonjë strategji e mirëfilltë ekonomike e Qeverisë, që do të krijonte hapësirë fillestare për t'iu shmangur varfërisë në kuptimin e ndihmave humanitare ndërkombëtare. Kosova nuk ka nevojë vetëm për ndihma humanitare, por ka nevojë për zhvillim ekonomik e me këtë Qeveri aktuale po shënon vetëm rënie në zhvillimin e saj ekonomik. Ne nuk shohim politika nga Qeveria aktuale që nga statusi i mbijetesës tenton të kalojë në fazën e zhvillimit edhe mirëqenies sociale. Fatkeqësisht qytetari i Kosovës edhe në vitin 2006 jeton në terr, sepse koalicioni aktual udhëhiqet nga logjika e politikës së izolimit dhe të territ.

Procesi i privatizimit po përcillet me afera korrupsioni dhe komplikime të tjera. Çështja e pronës është çështje juridike, politike, por edhe mund të themi emocionale. Zgjidhja e kontesteve të pronësisë nuk mund të menaxhohet nga kjo Qeveri e paaftë, e drejta e pronës duhet të garantohet me ligj. Kemi një bashkëdyzim interesash të qytetarëve vendorë dhe disa ndërkombëtarë në çështjen e privatizimit, derisa interesi i këtyre ndërkombëtarëve është heqja qafe sa më parë e pronës shoqërore të Kosovës dhe bllokimi i të hyrave nga shitja e saj për t'i dhuruar pjesën më të madhe Serbisë. Ministrat e Qeverisë së Kosovës përdorin privatizimin për t'i mbushur xhepat e tyre dhe të miqve të tyre. Nuk ekziston asnjë pasqyrë reale se si ka ndikuar privatizimi në ringjalljen e ekonomisë. Sa vendet të reja të punës janë krijuar dhe sa të hyra i janë shtuar buxhetit të Kosovës. Nuk është progres ekonomik kur ndërmarrjet ekonomike të Kosovës shndërrohen në hangarë apo depo mallrash. Askush nuk ka të drejtë të bëjë pazarllëqe me resurse strategjike të Kosovës.

Të nderuar deputetë, për fat ndikimi i Qeverisë së Kosovës në procesin e bisedimeve për statusin e Kosovës nuk është vendimtar. Procesi i krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës do të ecën me dinamikën e paraparë. Lënia anash e interesave të ngushta partiake dhe veprimi koncesual paraqet rrugën e plotësimin të veprimit institucional për realizimin e plotë të këtij standardi. Partia Demokratike e Kosovës do ta luajë rolin e saj konstruktiv në këtë proces, por për të arritur në cak - pavarësia dhe sovraniteti i plotë i Kosovës - na duhen ndryshime strukturore e jo planore në Qeverinë aktuale. Korrupsioni nuk është minoritar, është qeveritar. Partia Demokratike e Kosovës, spektri i gjerë politik paraqet ofertën e saj për dalje nga kjo krizë politike dhe institucionale për ta formuar një qeveri me mbështetje të gjerë politike, qeveri të ekspertëve deri në zgjedhjet e ardhshme. Kjo qeveri profesionale do ta çonte vendin drejt pavarësisë së plotë. Tendencë për të bërë ndryshime kozmetike nuk është në emër të korrupsionit, nuk është tendencë që të ndodhin ndryshime, ndërrime apo larje, qërim hesapësh në mes klaneve që udhëheqin Qeverinë e Kosovës për të vënë emra të rij në shërbim të qëllimeve të vjetra. Prandaj edhe një herë, e theksoj së Qeveria aktuale i ka humbur legalitetin demokratik dhe legjimitetin qytetar. Është koha për ndryshime e jo për ndërrime.

Ju faleminderit!

KRYETARI - Faleminderit z. Thaçi. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU – I nderuari z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, kabinet qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i AAK-së me interesim ka pritur vënien në rend dite: debatin për implementimin e standardeve në Kosovë.

Grupi Parlamentar i AAK-së falënderon Qeverinë Çeku për informacionet e bollshme që na u janë prezantuar para se të vinin në këtë debat dhe para se të hapet kjo çështje për debat në Kuvendin e Kosovës.

Më lejoni, i nderuari z. kryetar dhe të nderuar kolegë deputetë, që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ta vlerësojë lart Qeverinë Haradinaj, që nga niveli zero në procesin e implementimit të standardeve në 100 ditshin e funksionimit të saj dhe të atij Kabineti praktikisht i vuri standardet në prioritet të angazhimit të Qeverisë dhe pas 100 ditëve mori vlerësime shumë të larta pozitive si nga vetë ne vendorët, ashtu edhe nga ndërkombëtarët në procesin e implementimit të standardeve.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AAK-së vlerëson lart Qeverinë Kosumi në vazhdimin e procesit të impementimit të standardeve, raporti i Kai Aidës dhe fillimi i mbarë e në kohë i procesit të definimit të statusit përfundimtar të Kosovës janë fakte të cilat argumentojnë përkushtimin e Qeverisë Kosumi në implementimin e standardeve dhe punën e drejtë në këtë proces.

Grupi Parlamentar i AAK-së çmon përkushtimin e Qeverisë Çeku dhe angazhimet që i bëri në implementimin e standardeve vënien e kësaj çështjeje në prioritet të veçantë të punës të Qeverisë, ne e mbështetim angazhimin e Qeverisë në implementimin e standardeve, duke i kuptuar ato si standarde për ta rritur dhe për të ngritur mirëqenien, por edhe për të përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

Deputetët e Grupit Parlamentar të AAK-së do të marrin pjesë aktive në këtë debat për secilin standard veç e veç, do të japin vlerësime dhe propozime.

Të nderuar deputetë, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së t'i hedh poshtë të gjitha supozimet dhe vlerësimet e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të opozitës të shprehura këtu nga goja e PDK-së z. Thaçi. Fjalja e tij për fakte dhe argumente për keqmenaxhim dhe keqpërdorim. Është Qeveria që po e shihni këtu tregon se kurrfarë fakte nuk posedon dhe kurrfarë argumente për këtë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. Maloku, para se t'ia jap fjalën kryetarit të ORËS e shfrytëzoj rastin që edhe në emër tuaj ta përshëndes z. Jakin Ryker nga Shtylla e Katërt e UNMIK-ut.

DEPUTETI VETON SURROI- I nderuari z. kryetar z. Ryker, e nderuara Qeveri, zonja dhe zotërinj.

E mbani në mend para disa vjetësh një ditë prej ditësh kur z. Shtajner vendosi se nuk kishte gjë për të bërë në konferencën e ardhshme të shtypit, dhe në një pasdite kërkoi nga ndihmësja e tij që të përpilojë një listë standardesh që duhet t'i plotësonin kosovarët në mënyrë që të trajtohen si një vend evropian, si shtet i pavarur.

Pasi që e kishte bashkuar Mitrovicën, pasi që e kishte filluar privatizimin, pasi që kishte bërë shumë gjëra të tjera në konkurrencat e tjera të shtypit z. Shtajner doli me një propozim tetë pikash të cilat prej asaj kohe deri më sot i përsërisim në formë të lutjeve biblike, ose uratash që çdo qeveri, çdo parti politike edhe ky Kuvend duhet t'i përsërit.

Ajo çka ka ndodhur në këto vitet e kaluara ndodhë edhe sot. Është në të vërtetë përsëritje mekanike e asaj që është thjeshtësim i një norme të funksionimit të shtetit demokratik, me ekonomi të prosperitetit dhe me shërbimet e veta sociale për qytetarët. Edhe sot do të dëgjojmë se sa përkthyes janë punësuar se sa është rritur përqindja e këtij apo atij komuniteti, në këtë apo atë pjesë të administrimit, do të dëgjojmë se sa tabela dygjuhësore apo trigjuhësore janë vendosur në këtë, apo në atë komunë, por në thelb asnjëra prej këtyre përgjigjeve, ndonëse këto janë të gjitha të nevojshme, nuk do të tregojnë se si funksionojnë ato komuna ose ato institucione, ku ekziston kaq për qind të këtij, apo kaq për qind të atij komuniteti.

Standardet e këtilla, siç janë kuptuar, janë kuptuar si formë mekanike, si formë dhe pa kurrfarë përmbajtje dhe mendoj se këtu është problemi themelor i interpretimit të standardeve dhe në qasjen se si e shohim në opozitë atë që bëni ju në Qeveri, ju e përmbushni formën me ngarendjen që të paraqiteni para Këshillit të Sigurimit së bashku me UNMIK-un, të thoni kemi përmbushur kaq për qind të çështjeve që na janë dhënë si obligime dhe duhet të jepet vlerësimi pozitiv.

Edhe kjo seancë e Kuvendit mund të shndërrohet në një iluzion kolektiv, se të gjithë ne do të ecim në përmbushjen e standardeve për aq sa në qershor të këtij viti Këshilli i Sigurimit raportojë pozitivisht dhe Kosova të ecën në fazën e dytë, më të avancuar të procesit negociator, kjo është një pjesë e interpretimit.

Pjesa tjetër është në përmbajtje, është të shohim realisht çka janë ato standarde dhe realisht si mund t'i përdorim për nevojat e ndërtimit të këtij shteti. Dhe do si do, është e qartë se kanë të bëjnë me ndërtimin e një shteti demokratik dhe funksional. Por të shohim çfarë është qasja p.sh. e Qeverisë ndaj sundimit të ligjit dhe çfarë do të duhej të ishte qasja.

Qasja e Qeverisë në sundimin e ligjit është fakti se është formuar ministria e drejtësisë dhe është mirë që është formuar ministria e drejtësisë, por qasja e Qeverisë ndaj dukurisë së demokracisë, të sundimit të ligjit, do të duhej të ishte edhe fakti se janë botuar raportet e auditorëve të shumë komunave të Kosovës dhe në të gjitha këto raporte, në të gjitha

absolutisht ekziston fenomeni i keqmenaxhimit, i keqpërdorimit të parasë publike. Nuk është shkarje, keqmenaxhimi është normë e sjelljes, është kulturë qeverisëse. Kjo është ajo çka do të duhej të trajtohej edhe këtu sot. Është folur për demokracinë dhe për sundimin e ligjit, por zonja dhe zotërinj, ne i kemi kaluar 12 muaj, që të mbërijmë në këtë fazë që të flasim lirisht. Mos harroni se para tre muajsh ky debat nuk ishte i mundur, në këtë Kuvend të Kosovës. Do të duhej të shënohej si rezultat në implementimin e standardeve edhe fakti se ne si opozitë arritëm së bashku me ju natyrisht, si koalicion qeverisës që të hapim këtë debat këtu në këtë Kuvend.

Ekzistojnë dy forma të qasjes në të ardhmen, besoj në atë që do të ishin standardet, ekzistojnë ato që quhen kritere të Kopenhagës, që janë kritere që çdo shtet evropian duhet t'i përmbushë, në mënyrë që të fillojë procesin e aderimit, procesi i integritimit në Bashkimin Evropian. Kosova, natyrisht, e ka të pambuluar pa përfunduar çështjen e statusit dhe nuk mund të fillojë, por ne kemi filluar në fazë paralele edhe ashtu procesin tonë integrativ dhe çështja e kritereve të Kopenhagës disa prej të cilave janë të futura edhe në këto standarde do të ishin urdhrëfytes, por çështja e dytë apo qasja e dytë, që besoj që do të duhej të ishte e përbashkët, është pyetja e qytetarit :” Çka më sjellin mua këto standarde, çka është ajo që ndryshon në jetën time si qytetar nëse zbatohen, ose nuk zbatohen standardet dhe ky do të jetë kut matës edhe në këtë Kuvend edhe në këtë raportim, për atë se kah duhet të shkojmë.

Nëse shihni nga ky kut matës i qytetarëve të rëndomtë, atëherë do të shihni se pak, ose hiq, është bërë për standardin e tyre. Arsimi i qytetarëve të Kosovës është më i keq seç ka qenë para 20 vjetësh. Shëndetësia e qytetarëve të Kosovës ka pasur sistem para 20 vjetësh, sot nuk e ka pas 30 vjetësh. Pensionet dhe sistem pensional kanë ekzistuar, këto janë çështje që ilustrojnë funksionalitetin e një shoqërie demokratike, për të cilat nuk kemi dëgjuar çka do të bëhet me sistemin tonë arsimor, çka do të bëhet me sistemin tonë shëndetësor, nuk kemi dëgjuar deri sot asnjë iniciativë që do të na tregonte se çka do të bëhet me pensionistët tanë dhe deri më sot në këta 16 apo 18 muaj nuk e kemi pasur as edhe një dhe po përsëris as edhe një iniciativë që do të demonstronte mendim të politikës ekonomike. Në 18 muajt e kaluar politika ekonomike është e hartuar jo në këtë Kuvend jo në këtë Qeveri, është hartuar jashtë këtyre, diku me sukses, diku me mungesë suksesi, por produkt i krejt kësaj është inercioni që ende e ilustron ekonominë e Kosovës me faktin se 70% e buxhetit mbushen nga të hyrat doganore. Ky është një shtet që nuk funksionon në aspektin e vet ekonomik dhe është shtet që për më tepër nuk ka politikë ekonomike. Në çdo seancë, pas çdo ndërrimi të Qeverisë, ne e kemi premtimin se së shpejti do ta kemi programin zhvillimor, natyrisht programin zhvillimor për vitin 2007 – 2013 dhe mirë do të ishte ta kemi, por duhet të dimë çka duhet të bëjmë deri në vitin 2007 dhe 2013. Fakt sot kur vendosët për statusin e Kosovës në këtë vit, ne do të duhej të vendosnim po ashtu brenda këtij debati për standarde se çka do të bëhej një ditë pas pavarësisë, sepse një ditë, pas pavarësisë, në ditën e parë të pavarësisë, Kosova do të ketë 70% të papunë, do të ketë këtë mungesë të sistemit të vet shëndetësor, do ta ketë Universitetin e vet jo funksional, do ta ketë këtë mënyrë të qeverisjes në ekonomi, ky do të jetë debati real për standarde, zonja dhe zotërinj.

DEPUTETI NUMAN BALIQ – Najpre da selamim sve prisutne, i nadam se da će te mi dozvoliti da govorim u ime parlamentarne grupe za integraciju, u odsustvu trenutnog šefa koji rotira ovu grupu za integraciju. Nabrojao bih nake stvari koje su bitne za standarde, kao što je malopre spomenuto ostavljeno nam je od predhodnog specijalnog predstavnika ovih osam standarda da tako kažem, da se sa njima baccemo, u narednom desetljeću, i ono što je vrlo bitno jeste da moramo imati jedan adekvatan pristup ovom pitanju i da moramo uvek znati koliko je od toga urađeno i šta nam preostaje da se uradi. Moram da napomenem da je pitanje standarda jedno od veoma važnih pitanja i da će neki od tih standarda, a posebno onih koji se tiču manjinskih zajednica biti odlučujuće za budući status Kosova. Naravno, napominjem ono što je svima vama poznato da jedan broj standarda se tiče celokupnog stanovništva, ali jedan deo standarda se tiče ekskluzivno manjinskih zajednica. Ja bih želeo ovde da nabrojim neke stvari koje se tiču najpre prvoga standarda, a on je funkcionalne i demokratske institucije. Prema onome što nam je propisano da tako kažem još od vremena Štajnera, a to je da institucije trebaju biti delotvorne, reprezentativne i funkcionalne, da li su zaista onoliko efektivne koliko trebaju biti, da li imaju učinak koji trebaju da imaju, da li su zaista reprezentativne, da li u Vladi, ministarstvima, Parlamentu zaista stoje ljudi, da tako kažem, prvoga reda ili prve klase ili ovde imamo kao što je vrlo često prigovarano nekompetentne i ljude koji su neodgovarajuće na mestima na kome se nalaze. U vezi sa nekim stvarima koje se tiču ispunjenja standarda vrlo je važno pitanje civilnog društva, žena i ljudskih prava. Mislim takode, da i ovi delovi koji se tiču standarda da nisu ispunjeni kao i oni predhodni koje sam spomenuo. Ako su u pitanju manjine nabrojaću neke stvari koje se tiču Vlade, ministarstava, Skupštine, i naravno ureda premijera i ureda predsednika Kosova. U vezi sa Vladom i ministarstvima, znate da imamo petnaest ministarstava, možemo proceniti zajednički da u tim ministarstvima zajednički radi najmanje dve hiljade službenika i da su oni i na višim i na nižim mestima. U čemu je problem? Ne postoji transparentija, ne postoji spoznaja informacija, učinkovita informacija oko toga koliko službenika postoji i koliko od toga je manjinskih zajednica, i šta je dosada ostvareno u fazi realizacije standarda. Mi naravno ohrabrujemo sve ono što se govori o tome i jesmo za to i učinjeno je zaista nešto, i o tome neću govoriti, govoriću o onome što nije urađeno, ali ako je recimo oko dve hiljade službenika u Vladi i ministarstvima prisutno svega nekoliko predstavnika manjinskih zajednica, Bošnjaka, Roma, Egipćana itd, a prema kvotama koje su propisane da bi trebalo da bude najmanje dve stotine onda se radi o tome da su standardi ispunjeni ne dvadeset posto manje ili pedeset posto manje nego pet puta, deset puta možda u nekim ministarstvima čak i do sto puta. Dakle, radi se o jednom strahovitom kašnjenju o ispunjenju standarda i mi moramo imati cjelosnu informaciju oko toga, šta su planirani standardi i šta je učinjeno u afirmaciji oko toga, šta su planirani standardi i šta je učinjeno u afirmaciji i ostvarivanju tih standarda. Moram takode napomenuti i ne samo vezano za broj radnika, hoću da kažem da u svim ministarstvima postoje direktorati, sektori, divizije, odseci, nije dovoljno da kažem pravo da se raspiše neki konkurs i recimo traži se u nekoj instituciji dva službenika, jedan portir i jedan čuvar ili jedna medicinska sestra i jedan, šta ja znam, službenik iz druge oblasti zdravstva a da se radi o desetinama ili stotinama ljudi koje treba uposliti. To jesu koraci, ali su to veoma

mali koraci, treba naći mnogo veće korake u pravcu ispunjavanja standarda i uključivanja manjinskih zajednica u onoj meri koja je potrebna. Ako je u pitanju Skupština ja moram da kažem i da iznesem ovde jednu stvar koja se tiče grupe za integraciju, s obzirom da i govorim u njeno ime, mi mesecima tražimo da se reši problem ravnopravnosti te grupe najbolji zakoni ove zemlje, Ustavni okvir, Poslovnik o delovanju Skupštine, predviđaju po zakonu da grupa za integraciju i sve parlamentarne grupe trebaju biti jednake, mi smo formirali parlamentarnu grupu za integraciju 24. novembra, sada će biti blizu pola godine i još uvek ništa nije urađeno oko toga da ta grupa bude ravnopravna u skladu sa zakonom i da ima mesta u komisijama, dakle, ništa posebno mi tražimo da ravnopravno sa drugim parlamentarnim grupama imamo mesta u komisijama. Rešenje koje smo dobili napismeno nismo stigli to da kažemo, nudi nam se da ta mesta delimo sa drugom parlamentarnom grupom, mislim da je to lakrdija, da je to smešno i da u zakonitom i parlamentarnom radu ne možemo dozvoliti da dve parlamentarne grupe međusobno dele mesto. Dakle, ponavljam da institucije Kosova, parlament Kosova, i sve ostale trebaju poštovati zakone koje smo zajednički doneli, u ovom slučaju o ravnopravnosti jedne parlamentarne grupe. Naravno, izneću još neke podatke koji se tiču Ureda premijera i Ureda predsednika. Ja sam na jednom skupu u Draču iskoristio jedan primjer gde sam upravo imao svežu da kažem taze vjest oko angažiranja savetnika i ljudi u stafi premijera Čekua. Primetio sam da nijedan od predstavnika manjinskih zajednica nije uključena u tim pozicijama. Dakle, niti na onom pozicijama koje se ekskluzivno tiču manjinskih zajednica ka što su standardi, povratak, integracije i tako dalje. Takođe, vezano a u pitanju je bilo 20 savetnika ako se ne varam u tom vreme. Takođe, u Uredu predsednika Kosova nisam siguran, uopšte da ima predstavnika manjinskih zajednica. Dakle, da ponovim u Skupštini, Vladi, ministarstvima, Uredima Premijera i Predsednika moraju biti zastupljeni predstavnici manjinskih zajednica. U protivnom ne možemo govoriti o ispunjenju standarda, ja moram da napomenem jako su ohrabrujuće izjave g. Čekua od pre nekoliko dana i premijera Čekua, kada je rekao, citiram, biće toleranca 0 ndaj korupcionit dhe paregullive tjera, mislim da je to veoma dobro, ili izjavi predsednika Kosova na održanom skupu u Podujevu pre dva tri dana gde predsednik Sejdiu rekao da treba da zaslužimo građani Kosova i institucije Kosova budući status Kosova. To su veoma ohrabrujuće izjave i mi ih potpuno podržavamo, ali opominjemo da razlika između datih izjava i učinjenih stvari na terenu je veoma velika i da stepen ispunjenja standarda najpre je potpuno netransparentan i mi uopšte ne znamo dokle se došlo sa ispunjenjem standarda a na drugoj strani sa reči na dela ide se veoma malim koracima i mora se ići mnogo efektivnije i mnogo snažnije i sa mnogo većim koracima. Dozvolite mi da nabrojim još samo nekoliko slučajeva ove ostale standarde. Ako je u pitanju vladavina prava ili pravosuđa znamo dobro da je 1999 godina bila godina koja je bila u znaku nasilja prema etničkim zajednicama drugim nealbanskim zajednicama. Nažalost, još uvek najveći broj slučajeva toga nasilja, žrtava tih nasilja nije rasvetljena, u današnje vreme situacija je mnogo poboljšana imamo situaciju na terenu koja je mnogo bolja, ali imamo neke banalne slučajeve pomenuću vam jedan, koje će možda izgledati banalan, međutim postoji jedan problem kod manjinskih zajednica da vrlo često ili zbog svoje sopstvene slabosti ili zbog situacije koja postoji u oblasti policije i sudova, nisu u mogućnosti da svoj slučaj reše. Ja sam bio zomljen da pre neki dan posetim građanina u Peći, Bošnjaka u Karagaču Jusa Mekića otišao sam u njegovu kuću i video sam da njegova mala kuća i maleni plac koji on ima da mu je uzurpirano nasilno

mu je oduzeto deo njegovog malog placa u dužini od jedanaest metara i širine do dva metra. Dozvolite mi da nastavim , radi se upravo o standardima, dakle radi se o tipičnom primeru o kome mi svi trebamo da brinemo najpre vi gospodine predsedniče Skupštine a onda ja. Čovek je ušao dva metara u njegovu kuću i natkrio se njegovom velikom kućom njegovu malu kućicu i čovek nema gde da se obrati. Opštinski sud je presudio u njegovu korist, na osnovu dokaza koje on ima na Okružnom sudu jer se on dalje žalio date su pare ljudima i on je poništio odluku Opštinskog suda, na Vrhovnom sudu se takođe žalio i on je poresudio protiv njega, čovek ne zna kome da se obrati. Ovo je pitanje mnogih građana Kosova. Gospodine Beriša radi se o ljudima koji su naši građani, građani Kosova i koji ne znaju kome da se obrate, a neprekidno govorimo o standardima i ispunjenju tih standarda. Dajkle, ovo su primeri koji su veoma bitni i koje moram da napomenem. Ako je u pitanju povratak stvar koja je veoma bitna ja moram da napomenem neke stvari koje se tiču povratka, važna stvar je da se manipulira sa pitanjem povratka da se umesto pravih povratka organizuju lažni povratci da ljudima koji već postoje na Kosovu, žive na Kosovu, a koji su navodno prijavili izbegličke kartone u Srbiji, Crnoj Gori, Sandžaku itd, da preko sijaseta nevladinih organizacija i mnogih drugih organizacija nažalost i vladinih organizacija daje se novac, a da se pravim povratnicima to ne omogućava. Ovde želim da snažno istaknem da se prekine sa tim ne pravilnostima da kao što standardi propisuju da se o tom pitanju i pitanjima svim drugim razgovara sa predstavnicima zajednica i da se ima u vidu da je ogroman broj predstavnika manjinskih zajednica Bošnjaka, Roma, Egipćana oko sto hiljada iseljeno sa Kosova. Mi imamo pouzdane podatke da je najmanje četrdeset hiljada Bošnjaka iseljeno sa Kosova to su građani Kosova. Posao za sve nas je da te ljude vratimo, naravno one koji žele da se vrate, ne nasilno. Isto tako radi se i o Romima, Egipćanima i drugima. Do sada je malo urađeno i da napomenem, mislim da ovaj način dosadašnjeg rada netransparencija, neučešće manjinskih grupa možda će on dovesti do ovakvih situacija kao što smo imali oko primera Mitrovice. Grupe za pregovore, ljudi koji se bave pitanjima i Mitrovice i ostalog doneli su jednu odluku, dok na osnovu jučerašnjih odluka saznajemo da niti su zajednice sa tim upoznate, niti su opštinski predstavnici upoznati niti su upoznati predstavnici parlamenta i imamo jednu skandaloznu situaciju da ljudi pregovaraju, a bez komunikacije i kordinacije sa predstavnicima zajednicama, opštinskim strukturama i svega ostaloga. Moja diskusija je u najboljem pravcu da se te nepravilnosti izbegnu i mislim da oko standarda se mora razgovarati sa svim predstavnicima Kosova. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – JU faleminderit z. Baliq. Fjalën e ka z. Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI - I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, i nderuari kabineti qeveritar dhe deputetë.

Duke çmuar kryeministrin për vlerësimin e shkallës së përmbushjes së standardeve nga Qeveria e Kosovës, ndër të tjera, do të veçoj se është çështje e përcaktimit të njësisë matëse në realizimin e standardeve, thënë ndryshe apo shkurt, ka shumë kritere metoda me të cilat vlerësohet përmbushja e këtyre standardeve që vlerësimi qeveritar është pozitiv dhe real. Në aspektin politik vlerësimi i përmbushjes së standardeve determinohet nga qëllimi që dëshirohet të arrihet me to, ndërsa nga këndi juridik për përmbushjen e

standardeve vlerësimi nga krahasimet në nivelet e standardeve në mes shumicës pakicës dhe qytetarit në tërësi, si dhe respektimit të këtyre standardeve në një rajon më të gjerë se vetë shteti i Kosovës. Vlerësoj ,se Kosova në të gjitha segmentet e organizimit institucional ka përmbushur standardet për Kosovën ,por është çështje se kush i vlerëson, dhe si vlerësohen a shihen vetëm me syza të zeza, apo janë vlerësime reale të mundësive potenciale ekonomike, dhe autorizimeve që ka Qeveria.

Ndonëse institucionet dhe përkrahjet e përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, në të gjitha nivelet janë të zgjedhura në mënyrë të lirë demokratike dhe me të drejtë konform standardeve ndërkombëtare edhe të pranuara. Përjashtim bënë vetëm Kosova Veriore kuptimin gjeografik ku nuk përfshihet sa duhet me vetë bllokimin e atyre që nuk i njohin apo nuk donë të kyçen në pushtetin lokal dhe në atë qendror, këto janë metoda të bojkotimit dhe duhet t'i njoh bashkësia ndërkombëtare dhe ne.

Nën dy, në sferën e sundimit të ligjit në Mitrovicën Veriore dhe në këtë hapësirë nuk zbatohen ligjet e miratuara në Kuvend të Kosovës, jo me fajn tonë por për mosrespektimin e standardeve që veprojnë si paralele p.sh. vepron gjykata paralele atje nuk respektohen ligjet civile, të drejtat, prona, e të tjera.

Nuk respektohen as mjetet e informimit në këtë drejtim. Nën tre, liria e lëvizjes nuk është realizuar në tërësi dhe në të njëjtën masë dhe në të njëjtën mënyrë në tërë Kosovën dhe shtrohet pyetja pse dhe kush është përgjegjës sa dhe ne kemi ndikuar në veçanti kjo lëvizje nuk vlen në drejtimin jug-veri, dhe për këtë nuk mund të jemi përgjegjës.

Nën katër, kthimi si proces u është ofruar të gjithëve, mundësitë dhe rrugët janë të hapura, në realitet, lëvizje ka, por kthimi 23830 shqiptarëve në veri është i bllokuar, po ashtu është edhe i ndaluar, flasim -së paku -deri më sot në vetë faktin se atje funksionon një regjim të them paralel që Mitrovicën e bën problem ashtu si është dhe i ndërlikuar, edhe në sferat ekonomike na është shkatërruar në tërësi baza materiale në një mënyrë riaktivizimi i Trepçës do të kontribuonte shumë në kthim dhe në normalizim të jetës.

E drejta e pronës u është njohur të gjithëve , janë rregulluar edhe me rregullativë, por në shumë lagje të veriut nuk mund të kthehen në shtëpitë, banesat dhe pronat e tyre, jemi, dhe jemi të shqetësuar se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit tani bënë edhe oferta për blerjen e pronës së banesës që është në kundërshtim me ligj, dialogu është në nivelin e qëndrueshëm e të arsyeshëm ka filluar dhe zhvillohet ashtu si kërkohet, andaj dilemat e përmbushjes apo të mospërmbushjes edhe një herë duhet shtruar nga këndë vështrimet ose subjektive, jo profesionale apo edhe tendencioze, nga e tërë kjo rezulton se në Kosovë institucionet e saj dhe populli i saj shumicë po i përmbushin standardet, bile në disa raste pse mos ta themi në një shkallë më të lartë se ato në disa vende të rajonit, për karshi faktit se minoritetet në veçanti serb po i pengojnë përmbushjet e standardeve, vlerësuar përfundimisht standardet se në tërësi kur nuk do të përmbushen por në krahasim në rajon, janë në nivelin shumë më të kënaqshëm se sa ishin më parë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur deputetja Sanije Alijaj. Le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha. Sanije ju kërkoj falje. Emrush Xhemajli e ka fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I respektuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër Çeku, kolegë deputetë dhe pjesëmarrës në këtë seancë.

Edhe pse materiali ka ardhur dje, pra ma mirë dje se sa sot, pra shumë vonë, por kam gjetur kohë dhe me vëmendje e kam lexuar materialin që po e trajtojmë. Në emër të Lëvizjes Popullore të Kosovës që e përfaqësoj, shprehim gatishtëmërinë tonë për të ndihmuar për të mirën e vendit për përmbushjen e gjitha standardeve për integrim dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe strukturat tjera euroatlantike.

Ndërsa këto standarde për të cilat ne po flasim sot në fakt kur s'kanë qenë standarde, por e kundërta e tyre, ato janë rregulla unike e të pazbatuara askund në botë, në formën dhe në mënyrën si po veprohet në vendin tonë.

Nëse ju kujtohet këto rregulla patën disa emërtime, standardet para statusit, do të thotë, qerrja para atllarëve, u pa se kjo nuk shkonte, pastaj u emërtuan standardet për Kosovën, do të thotë rregulla për Kosovën, që me emrin tregohet se nuk është fjala për standarde universale që janë zbatuar dikund, por fjala është për rregulla të posaçme për Kosovën. Por detyrat që përmenden në dokumentin që na është dorëzuar, por edhe në vlerësimet e më hershme teknike të gjendjes në Kosovë kanë të bëjnë me detyra që i vihen një vendi që vazhdon t'i mohohet e drejta për të vetëqeverisur dhe për të ardhmen e tij. Këto janë detyra që koordinojnë kompetencat e ndaluara edhe të rezervuara me ato kompetenca përgjysmuara dhe me esencë që varen nga faktorë jashtë institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Kështu ndodh po t'i referohemi secilës nga 8 kapitujtë e detyrave të materialit që sot po e shqyrtojmë dhe pikërisht pse ka të bëjë me koordinim të shumë pushteteve dhe paralelizmave ato vështirë po koordinohen, sepse janë të përcjella me interesa që nuk janë të njëjta, por dimetrialisht të kundërta. Kuvendi i Kosovës, ligjet po i miraton edhe ashtu ngadalë, një pjesë e tyre sidomos në fushën e pronës, të kulturës të trashëgimisë kulturore, të gjuhës e të privatizimit, të drejtat e pjesëmarrësve të Luftës Çlirimtare na është thënë, ose të hiqen nga rendi i ditës se janë në kuadër të kompetencave të rezervuara ose të na vonohen në procedura duke ndërhyrë në Zyrën Ligjore të UNMIK-ut të shumtën pa vend, apo të vonohen duke u nënshkruar nga PSSP-ja. Ne jemi duke bërë punë të shumëfishta, shumica e këtyre rregulloreve që rregullojnë marrëdhëniet e shumë pushteteve paralele do të bien dhe për këtë edhe na të gjithë jemi të vetëdijshëm me ardhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, çfarë do qoftë ai, andaj në një mënyrë jemi duke bërë një punë Sizifi. I përgëzoj, e potencoj: i përgëzoj 4 qeveritë e Kosovës dhe posaçërisht këtë të fundit që u kanë përballuar të gjitha sprovave rreth punëve që përshkruhen në dokumentet e ofruara, se vetëm një popull që ka përvojë të madhe në robëri- si ky yni- mund të përballojë këtë gjendje karantine që 7 vjet me radhë. Pjesa më e madhe e detyrave dhe e rregullave që parashihen në prizmin e rregullimit të statusit të veçantë të minoritetit serb, kinse po të ishin punët e tjera do të ishte shumë në rregull. Ju lutem z. kryetar që në mbledhjen e ardhshme të shpërndalet edhe një material për nivelin e plotësimin të të drejtave dhe të standardeve jetësore edhe

për shumicën e qytetarëve të Kosovës, që fatkeqësisht, janë jashtë vëmendjes. Jemi dëshmitarë se standardi i vërtetë, niveli i jetesës që u intereson të gjithëve në Kosovë, pavarësisht nga përkatësitë edhe për komunitetet është shqetësues dhe është në rënie. Standardet kanë kuptim vetëm nëse ndërrojnë drejtimin, andaj propozoj që rekomandim i Kuvendit të jetë që standardet për Kosovën të shndërrohen në titull dhe përmbajtje në standardet për integrim dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha.

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ – I nderuar z. kryetarë i Kuvendit z. Berisha, i nderuar kryeministër i Kosovës z. Çeku, të nderuar ministra, ju deputetë të respektuar zonja dhe zotërinj të cilët e përcjellin punën e kësaj seance plenare.

Pas leximit të materialit për vlerësimin e standardeve, kam konstatuar se përkushtimi i institucioneve dhe i shoqërisë së Kosovës për përmbushjen e standardeve është angazhim për përmirësimin e jetesës së qytetarëve të Kosovës dhe përkushtim serioz që të krijojë një shoqëri bashkëkohore, demokratike dhe transparente, që do të ishte e aftë të integrohet në Bashkimin Evropian dhe në institucionet e tjera ndërkombëtare.

Duke i plotësuar standardet për Kosovën ne krijojmë institucione stabile shtetin ligjor, tregojmë shkallën e demokracisë dhe të lirive njerëzore, është projekt gjithëpërfshirës dhe kërkon angazhimin dhe përgjegjësinë e të gjithëve në të gjitha fushat. Në këtë drejtim të arriturat më të mëdha janë organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve të dyta nacionale, të vlerësuara si të lira dhe fer, me të cilat u treguam opinionit vendor dhe atij ndërkombëtar se dimë t'i çmojmë dhe t'i kultivojmë vlerat e demokracisë, se dimë dhe punojmë për ta bërë shtetin.

Kemi kaluar testin nga demokracia zgjedhore në demokracinë funksionale praktike dhe frytdhënëse. Z. kryetar dhe të nderuar deputetë, për të dalë në shqetësimin tim, që do ta ngrit para jush, më lejoni ta jap një pasqyrë të shkurtër të punës së Komisionit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Interesave të Komuniteteve. Në komisionin, që është ndër dy komisionet kryesore të Kuvendit, jam nënkryetarë e parë dhe kam udhëhequr po thuhet mbi 50% të punimeve të këtij komisioni dhe kur deri para pak kohe të gjitha çështjet e shtruara pohuajse janë miratuar me konsensus të plotë. Objektiv kryesor i punës së këtij komisioni është vlerësimi i amendamenteve të projektligjeve që janë në procedurë. Takimi me përfaqësuesit vendorë dhe me ata ndërkombëtarë, vizita e kuvendeve komunale për të konstatuar sa angazhohet kuvendi komunal për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të komuniteteve dhe për integrim, si edhe shkëmbimi i informatave për punën ndërmjet Qeverisë dhe këtij komisioni.

Vlerësimi është ky. Komisioni, në të shumtën e rasteve, ka punuar me konsensus të plotë për të gjitha çështjet e ngritura, të gjitha ligjet të cilat kalojnë në procedurë të këtij Komisioni është konstatim se asnjëri nga nenet e përmbajtjeve të këtyre projektligjeve, nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Sa iu përket standardeve, të drejtave dhe interesave të komuniteteve me rastin e vizitave që ky komision u bën kuvende

komunale, është konstatuar një përpjekje serioze e udhëheqjeve lokale për integrimin e komuniteteve dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tyre.

Më lejoni ta marr një shembull, me rastin e vizitës në kuvendin komunal të Dragashit, nga informatat që kishim marrë nga zyrtarët e komuniteteve, është një pasqyrë ku tregohet se më se 43% të administratës lokale në këtë komunë janë përfaqësuesit e komuniteteve dhe ku të gjitha donacionet dhe projektet humanitare, janë të koncentruara kryesisht në vendbanime për të krijuar mirëqenie për komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në këtë komunë.

Rezultatet e përafërta kemi marrë edhe në vizitat e komunave të tjera. Shqetësim për Komisionin është kthimi i refugjatëve nga diaspora pa vullnetin e tyre, pa u ofruar as kushte minimale për jetesë, por edhe që rrit krizën sociale në Kosovë.

Kjo çështje, nga ana e anëtarëve të Komisionit, ngritet pohuaj në çdo takim me ndërkombëtarët dhe kërkohet mirëkuptim lidhur me këtë. Në institucione ekziston një angazhim i plotë për kthimin e të gjithë atyre që për ndonjë arsye e kanë lënë Kosovën. Për një komision në vazhdimësi kërkohet angazhim dhe trajtim i barabartë për të kthyerit pa marrë parasysh cilit komunitet i takojnë.

Lidhur me këtë janë arritur rezultate sipas informacionit që iu ofrua deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga ana e Qeverisë. Synimi i Qeverisë për rindërtimin e pronave të shkatërruara gjatë akteve të dhunshme të marsit 2004 është përmbushur pothuaj në tërësi. Mirëpo, përmbushja e standardeve kërkon dhe angazhimin dhe kontributin edhe të të gjitha komuniteteve në këtë drejtim, sepse institucionet e Kosovës punojnë në krijimin e një asi mjedisi që do të ofronte qasje të barabartë në shërbime sociale publike, gjuhësore, shëndetësi, në arsim për të gjithë qytetarët. Kjo argumentohet me faktin se këtij parlamenti i janë ofruar për miratim më se 20 ligje që janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me standardet. Ajo çka mua më shqetëson kohëve të fundit, është se puna e Komisionit sikur nuk po shkon në hap me kohën. Ka ngecje në realizimin e planit të punës, ngase, po thuaj e tërë veprimtaria për çështje me interes të komuniteteve zhvillohet në kuadër të Këshillit Konsultativ për Komunitete të cilin e koordinon z. Veton Surroi- anëtar i grupit negociator.

Shtroj pyetjen: pse bëhet përpjekje për zgjidhjen e çështjeve kaq me interes për Kosovën, integrimi dhe mbrojtja e interesave të komuniteteve, në kudër të mekanizmave jo-institucionalë kur ekziston standardi kryesor për funksionalizimin, demokratizimin dhe fuqizimin e institucioneve.

Pse merren opinionet për të drejtat dhe interesat e komuniteteve nga përfaqësuesit e tyre, pse nuk merren vërtet të drejtat dhe interesat e komuniteteve nga përfaqësuesit e tyre në kuadër të Komisionit, ku është vendi meritohet për t'u dhënë frymë institucionale shqetësimeve të përfaqësuesve të komuniteteve. Pse lejohet përpjekje për defaktorizimin e Komisionit dhe për eliminimin e dy deputetëve shqiptarë të këtij komisioni, nga këto rrjedha, ku dihet se të gjithë deputetët, në të gjitha komisionet punojnë dhe veprojnë për interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, por edhe nëse kjo është qasje e drejtë për

interes të proceseve në Kosovë, pse z. Veton Surroi nuk e pa asnjë herë të rrugës t'i jepte informatë Komisionit për punën dhe angazhimin e bërë në këtë drejtim. Unë nuk e kundërshtoj rolin e z. Veton Surroi si koordinator për punë me përfaqësuesit e komuniteteve, por e kundërshtoj qasjen e punës jashtë këtij komisioni dhe e shpresat e premtimet krye në vete. Këtë insistim e mbështes me faktin se deri në kohët e fundit përfaqësuesit e komuniteteve kanë shprehur shqetësimet e tyre para përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare, sepse ky është komision ndoshta ndër më të veçantët që ka rastin të bëjë kontakte me përfaqësuesit ndërkombëtarë.

Nëse është fushatë për të treguar se unë jam human dhe demokratë i madh është çështje tjetër, por edhe një gjë duhet ditur, se punët e mëdha dhe me interes për proceset në Kosovë i zgjidhin dhe i implementojnë institucionet, jo individët. Kërkoj nga ju, z. kryetar, Kuvendi dhe Grupi Negociator që të ndalohet kjo qasje në punën e Komisionit, që kjo të kthehet në rrjedhë normale. Për këtë shqetësim timin kam njoftuar përfaqësuesit e OSBE-së, konkretisht Departamentin e Demokratizimit, por e kam njoftuar edhe përfaqësuesin e projektit për ndihmë institucionit legjislativ të BE-së, z. Alfanso. Sot shqetësimin tim e paraqes para jush, deputetë të nderuar. Kërkoj, në këtë drejtim, të has në mirëkuptim, që Kuvendi dhe Grupi Negociator ta rregullojë këtë qasje për një punë normale. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha, le të përgatitet Gjylnaze Sylja.

DEPUTETI NEXHAT REXHA – I nderuari kryetar, i nderuar kryeministër, ministra dhe të respektuar kolegë deputetë, procesi i standardeve në Kosovë është shtruar në shumë dimensione dhe si i tillë ka filluar të realizohet në nivelet lokale dhe mund të konstatojmë se janë arritur rezultate të mira. Duke i parashtruar obligimet nga organizmat ndërkombëtarë dhe ato vendore, çështja e standardeve është karakterizuar si domosdoshmëri për të arritur në kurorëzimin e statusit final të Kosovës. Vetë qytetarët kanë investuar në veprimet konkrete në arritjen e këtij qëllimi të rëndësishëm. Nëse qytetarët dhe udhëheqësit e tyre nëpër komuna kanë arritur të krijojnë klimë reale për të gjithë qytetarët e cilëso komunë qoftë, shtrohet pyetja: sa janë bërë investime stimuluese për komunat që kanë ecur me kohën për të mirë në këtë proces. P.sh. komuna e Dardanës (Kamenicës) i ka paraprirë këtij procesi, si në lëvizjen e lirë të pakicave edhe në integrimin e tyre në administratën komunale, duke u krijuar atyre siguri aq sa i krijon edhe vetes. Bashkëpunimi ndëretnik është realizuar në shkallë të lartë, mbishkrimet janë në tri gjuhë sa herë të jetë e nevojshme, por edhe kthimi i të zhvendosurve në këtë komunë dhe toleranca, pastaj tregu i përbashkët etj. janë shembuj praktikë për të gjithë qytetarët e kësaj komune.

Mirëpo ky sukses është i demokracisë që e kanë krijuar qytetarët që jetojnë dhe veprojnë këtu, sikur edhe qendrat ilegale të vendosjes në Serbi, nëpër Kosovë, po përpiqen ta prishin këtë. P.sh. në kohët e fundit disa punëtorë arsimorë serbë i refuzuan pagat e buxhetit të Kosovës. Kjo bëhet sipas direktivave politike të Beogradit. Po ashtu, ditët e fundit demtohen mbishkrimet e vendbanimeve. Kjo bëhet krejt me qëllim të keq.

Mirëpo a thua duhet të shikohet çështja e standardeve vetëm në këtë aspekt? Mendoj se çështja e standardeve do të duhej të konkretizohej edhe me investime. P.sh. Kuvendi komunal i Kamenicës edhe më tej nuk ka objekt të vetin, sepse në atë që e kishte para disa vitesh ishte i vendosur KFOR-i rus, që pas largimit të tij ai i shte i papërdorshëm. Ndiqma financiare e Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e një objekti të kuvendit komunal mungon, kështu që administrata e shkapërderdhur mund të krijojë një përshtypje jo të mirë. Si do qoftë përmbushja e standardeve në rrafshin lokal dhe vendor, i ka plotësuar të gjitha kriteret e dhura dhe besoj se edhe shtetet e tjera në Ballkan përafërsisht e kanë të njëjtin standard, pra këto kërkesa të parashtruara janë përmbushur në Kosovë, por sa më shumë po afrohet zgjidhja e statusit final të Kosovës, po vërehen tendencat për ngecjen e zgjedhjes së tij nga një pjesë e politikës së Beogradit.

Delegacioni ynë gjatë takimeve me palën serbe duhet ta ketë parasysh faktin se në Kosovë duhet të zhvillohet një politikë shumë më e avancuar se në Serbi, ndërsa parashtrimi i kërkesave absurde politike serbe bie ndesh me standardet ndërkombëtare. Pra, harta gjeografike e Kosovës, nuk ka nevojë për vija të tjera as për Mitrovicën as për Kamenicën, sepse edhe kështu gjatë historisë sonë atyre u janë ndryshuar vijat dhe u janë marrë territoret, duke u ndryshuar pastaj strukturën etnike. Çdo ndryshim apo gjymtim i pjesëve së saj do ta dëmtonte të ardhmen e Kosovës dhe të gjitha përgjegjësitë deshëm apo s' deshëm do t'i bartim ne, që jemi pjesë e Kuvendi të Kosovës. Konsideroj se faktori ndërkombëtar ka bërë përvojë të gjatë në Kosovë dhe është ballafaquar me problemet, tani i ka hequr dilemat. Për ta arritur rezultatin që kërkohet dhe bashkë me të për të tërhequr investimet ndërkombëtare dhe vendore, tanimë të gjithë jemi dëshmitarë se janë përmbushur standardet me qëllim që në Kosovë të finalizohet pavarësia e saj dhe të fillojë investimet më kapitale për ta ndryshuar gjendjen e rëndë sociale e të papërbalueshme të qytetarëve të saj, sepse, çështja e statusit të padefinuar është pengesë për investitorët që mund të ngritin ekonominë e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për diskutim janë paraqitur edhe 30 kandidatë, që do të thotë se duhet të rrimë edhe 5 orë këtu. E kam një propozim: ta shkurtojmë kohën e diskutimit, në 5 minuta. Nuk po e marr vendim vet, por po e hedh në votim. Kush është për? Urdhëroni zoti Xhavit.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar mendoj që debati është hapur dhe duhet të përfundoj sipas asaj që e kemi filluar, për shumë arsye, ka nevojë për debat. Mendoj që edhe kundërshtimet edhe kritikët nuk e dëmtojnë askënd në Kosovë, as ekzekutivin, as legjislativin, në qoftë se nuk jemi mësuar të lodhemi mund të marrim pauzë dhe të vazhdojmë nesër, pas nesër. Këtu jemi. Mëditjet i kanë të gjithë këtu, Nuk i kemi vetëm ne të Kryesisë, në rregull jemi, pra s'ka nevojë të reduktohen diskutimet. Në qoftë se ka dikush ndonjë punë urgjente, me interes të vendit, mund të marrë pushim. Po më vjen keq prej z. Ryker që ka ardhur pak më herët se sa i vjen radha në pikën e tij, por ne kemi nevojë për debat dhe nuk do të preferojmë ta ndërpresim ose ta shkurtojmë debatin,

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja,

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit i nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, ministra deputetë të nderuar. Dua ta falënderoj z. kryeministër për një qasje realiste, jo vetëm për progresin e standardeve, por edhe për punën dhe për sfidat që e presin Qeverinë për zbatimin e standardeve.

Standardet janë krijimi i mekanizmave që i mundësojnë Kosovës një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe politik dhe funksionim si shtet demokratik. Ato paraqesin çështje fundamentale dhe janë përcaktuese të së sotmes, por edhe e së ardhmes së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Zbatimi i mëtejshëm i standardeve është esencial për të gjithë qytetarët e Kosovës, për jetë në një shoqëri që dëshirojnë vetë dhe për t'i plotësuar kriteret rigorozë për integrimin evropatlantik. Për këtë qëllim është i nevojshëm dinamizmi i mëtejshëm për shpejtimin e zbatimit dhe të promovimit të mekanizmave efektiv për garantimin e të drejtave të minoriteteve, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze, të ekonomisë, të sigurisë, fuqizimin e ligjit. Nga raporti i Zyrës së kryeministrit shihet se deri më tani janë bërë 4 vlerësime të standardeve në vitet 2004 dhe 2005. Vlerësimi i parë lidhet me kohën kur kryeministër i Kosovës ishte Bajram Rexhepi, kurse i fundit me kryeministrin Bajram Kosumi. Vlerësimi i dytë dhe i tretë ndërlidhen me rolin e fuqishëm të kryeministrit Ramush Haradinaj. Këtë rol më së miri e ka ilustruar sekretari për Marrëdhënie me Jashtë i Britanisë së Madhe z. Robin Kuk ,që i ka thënë se me z. Haradinaj me standardet kyçe, siç janë :e drejta e minoriteteve dhe kushtet e kthimit të refugjatëve serbë, është bërë më shumë sesa gjatë pesë vjetve të mëparshëm. Vlerësimi i standardeve bëhet në dy mënyra, teknik dhe politik, por jo mekanik, si u tha më parë. Vlerësimin teknik e bënë UNMIK-u, pastaj debati dhe vlerësimi teknik në Këshillin e Sigurimit bëhet në bazë të dhënave të vlerësimit teknik, do të thotë nëse vlerësimi teknik është pozitiv, atëherë edhe vlerësimi politik është pozitiv. Thënë shkurt katalizator i procesit janë arritjet teknike, prandaj për këtë arsye është shumë i rëndësishme progresi i tyre . Trendi progresiv përcolli të katër vlerësimet, kryeministri Çeku së fundi ka treguar një qasje dinamike të mëtejshme të zbatimit të standardeve dhe ka vazhduar politikën inkluzive të paraardhësve të vet. Megjithatë është e qartë nga raporti se ka edhe shumë punë për t'u bërë, sepse pjesë të raportit pasqyrojnë punët që janë në proces ose në pritje. Puna edhe më tej është e përbashkët : e institucioneve të Kosovës dhe e UNMIK-ut, për shkak se ende ka fusha që janë kompetencë e UNMIK-ut, siç është sundimi i ligjit.

Konsideroj se pas përcaktimit të statusit, zbatimi i mëtejshëm i tyre duhet të bëhet në partneritet me Bashkësinë Evropiane, si hap i mëtejshëm drejt integritetit të Kosovës në Bashkësinë Evropiane, në kuptim të gjerë të fjalës standardet nuk marrin fund asnjëherë, as shtetet më progresive nuk i kanë plotësuar të gjitha standardet. Megjithatë në fokus do të jetë një standard me rëndësi dhe prioritet si është ekonomia.

Promovimi i lulëzimit ekonomik me krijimin e rrethanave për zhvillim ,duke filluar nga zbatimi i ligjeve, siguria, deri te krijimi i stabilitetit i qëndrueshëm politik, janë qenësor për pëmbushjen e këtij standardi prioritar. Prodhimi i vizionit ekonomik është i domosdoshëm për të krijuar bazën e sigurisë ekonomike për të ardhmen, që është jetike për shoqërinë tonë dhe prosperimin e saj. Në këtë kontekst z. kryeministër ju inkurajoj që ju dhe Qeveria sa më parë ta hartoni planin zhvillimor të Kosovës 2007/2013.

Zhvillimi dhe zgjerimi i bizneseve natyrshëm i bashkon njerëzit. Procesi i kthimit nuk mund të jetë i qëndrueshëm pa ekonomi, prandaj nxitja e ekonomisë është mënyra për t'i thyer barrierat dhe për t'i integruar komunitetet në Kosovë, por edhe për të integruar Kosovën në Bashkësinë Evropiane dhe në NATO. Më këtë përfitojnë të gjithë, populli i Kosovës, por edhe bashkësia ndërkombëtare. Në vazhdim do të përqendrohemi në standardin e parë, pra në funksionimin demokratik të institucioneve. Në vitin 2005 institucionet kanë shfaqur reagim të shpejtë dhe pjekuri politike, duke filluar që nga dorëzimi i kryeministrit Haradinaj në Hagë dhe zgjedhja e kryeministrit Kosumi e deri te zgjedhja e kryetarit të Kosovës, pas vdekjes së të ndjerit- kryetarit Rugova dhe kryeparlamentarit Berisha dhe së fundi kryeministrit Çeku. Nuk duhet harruar edhe krijimin e dy ministrive të reja të Rendit dhe të Drejtësisë. Megjithatë standardi që ka të bëjë me personat e pagjetur duhet të përmbushet.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar tanimë dy rezoluta për këtë çështje dhe është i domosdoshëm zbatimi i tyre. Çështja e personave të pagjetur ka të bëjë jo vetëm me të drejtën e tyre për të ditur për fatin e të afërmit e tyre, por edhe me sigurimin e fakteve të nevojshme para drejtësisë së atyre që i kryejnë krimet. Në fund rikonfirmoj përkushtimin tonë për progresin e më tej të standardeve, por njëkohësisht dëshiroj të theksoj se zbatimi i standardeve kërkon angazhimin e të gjithëve, të pozitës dhe të opozitës, të institucioneve, por edhe qytetarëve të Kosovës, të shumicës dhe të pakicës, por edhe të bashkësisë ndërkombëtare. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Në emër të Grupit 6+ fjalën e ka Xhezair Murati..

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, gospodine premijeru, zameniče premijera, ministri i drage kolege. Današnja tema je sigurno jedna od onih krucijalnih tačkaka kojima se već poduže bavimo, mislim da je današnje izlaganje premijera pružilo vrlo dinamičan i ambiciozn plan koji ima za cilj ostvarivanje ovoga o čemu danas imamo sednicu.

Parlamentarna grupa 6+ u principu podržava kako predloženi ambicionzni plan tako i dostojanstvenu debatu koja se vodi. Mi predstavnici parlamentarne grupe 6+ i predstavnici zajednica Bošnjaka i Turaka mislim da je u praksi bilo dokazano da su uložile maksimalan i iskren trud kako bi kosovskom društvu u najboljem smislu te reči pružile istinsku nameru da i mi sa naše strane uložimo maksimum napora kako bi smo ostvarili ono što se od nas očekuje. Složena ekonomska i politička situacija na Kosovu pogotovo u godini kada se odlučuje o budućem status. Danas bih pomenuo jednu situaciju čiji ste svedoci sigurno da međunarodna zajednica, a ponekada i kosovske institucije, ponekada, nisu najiskrenije u nameri kada je odnos prema manjinskim zajednicama. Neke manjinske zajednice su isforsirane, koje ne žele integraciju u kosovsko društvo, druge koje žele samo zarad toga što nisu problematične i što imaju prema Kosovu paternalistički odnos često, valjda zbog toga, se zaobilaze i mi mislimo da će i Vlada i premijer imati u obzir ovakve težnje i konačno mi smo protiv svih paralelizama kao pojave koja je velika kočnica u ostvarenju svega onoga što čini Vlada, što čini Skupština i konstruktivan odnos opozicije. Standardi su veoma složena pojava i

veoma je lako verbalno danas da o tome govorimo, ali njihova implementacija na terenu je veoma teška da se ostvari. U tom smislu ja bih najpre govorio, vezao bih se za jednu rečenicu koju je danas g. Thaci rekao da treba konačno da zaživi sloboda govora svih pripadnika manjinskih zajednica, mislim to je veoma iskrena i duboka misao kojoj treba da daju doprinosa, daju institucije, ali u tome veliku pomoć mogu da pružaju i mediji, i pisani i elektronski, i javni servis što je evidentno da ima prisustva manjinskih zajednica na javnom servisu i ostali mediji ako se interesuju za sredine tamo gde žive manjine kako je danas, moja kolegenica iz Komisije za prava i interese zajednice gđa. Sanije Aljijaj navela apostrofirajući ulaganja u jednu od nerazvijenih opština gde žive manjinske zajednice u velikom broju, mislim da je bilo reči o Dragašu, ali u jednom delu se ne slažem sa njenom diskusijom kada je u pitanju Konsultativni savet o čemu smo pre dva tri dana imali polemiku koji nije van institucionalna nego je pod okrivljenim institucija Kosova i glavne pregovaračke ekipe Kosova, mislim oko toga se malo razilazimo. Ja bih se takođe osvrnuo na jedan fenomen povratka o kojima je danas bilo dosta reči gospodo, međunarodna zajednica nije iskrena kada je u pitanju povratak, pogotovo predstavnika manjinskih zajednica, veoma često nam nasilnim povracima usložnjavaju i onako tešku ekonomsku situaciju koju imamo i veoma često deluju neiskreno prema onima koje vraćaju, nemaju uopšte program i projekat povratka već jednostavno ih obmanjuju i da ovde na Kosovu postoje međunarodne donatorske organizacije koje će rešiti njihov problem i kada oni dođu onda obijaju pragove opština predstavnike među koje ja spadam. Ja bih ovde spomenuo i drugi fenomen, a to je kako da zadržimo predstavnike manjinskih zajednica, kako da ostanu u onom momentu u ovom broju koji imaju s obzirom na to da imamo dosta i eksperata i stručnjaka i dobre želje da pomognemo zajedno i većinskoj zajednici u svemu onome što nas čeka. Pitanje obrazovanja je veoma važno i mi ga na veoma različite načine tumačimo, pokušavamo da implementiramo i ostvarenje onog načela obaveznosti školovanja od predškolskih pa do univerzitetskog obrazovanja itd, i ovo je prilika da kažem da malo više vodimo računa o tome da manjinski predstavnici veoma često su suočeni sa time što nemaju udžbenike, što nemamo udžbenike po kosovskim planovima i programima iako učestvujemo u korikulima, odnosno u izradi plana i programa jer imamo izdavačke kuće kao Libri shkollor koja često opominje da joj se ne isplati da štampa udžbenike u malom tiražu. Mi tu moramo imati malo više razumevanja isto tako kada su procenti za službeni upotrebu jezika u sredinama gde žive u većem broju recimo Bošnjaci, Turci i itd, mislimo da je ta kategorija koja je zahvaćena zakonom o jeziku moramo imati malo više sluha i tu očekujemo malu veću pomoć svih dakle i same Vlade potom kada je zapošljavanje malo više sluha za manjine mada je ovo veliki problem i sada je prilika da kažem da građani Kosova, ama baš svi počev od kategorije nezaposlenih, kategorija penzionera, kategorija mladih, zaposlenih u obrazovanju, veoma dostojanstveno podnose svoj težak položaj i daju nam konkretan doprinos da istrajemo u onome u čemu imamo sva ova nastojanja. I na kraju ja bih rekao da će sigurno naša današnja debata možda i sutra ako bude trajala kako je rekao kolega Haliti dati doprinos iskrenim namerama opve zakonodavne institucije da istrajemo u svemu što nas čeka ova godina, ja nisam pesimista nego oprezan realista i mi ovim želimo da skrenemo pažnju još uvek na one kosovske integrisane manjinske zajednice koje žele da zajedno sa većinskom da točak kosovskog društva pokrenu napred kako to iskreno želim. Hvala vam na pažnji!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi. Le të përgatitet deputetja Sala Ahmeti. Nëse ka nevojë për pushim mund të marrim.

DEPUTETJA NAXHIJE DOJÇI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryetar i Parlamentit të Kosovës, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i raportit lidhur me standardet në Kosovë, është raport që e ka meritën e vet për ta vlerësuar si pozitiv. Plotësimi dhe zbatueshmëria e standardeve në Kosovë janë domosdoshmëri që duhet të respektohet dhe plotësohet te ne në Kosovë. Institucionet e Kosovës, si institucione demokratike, funksionojnë mirë dhe me punën e vazhdueshme të tyre kanë arritur t'i plotësojnë dukshëm kushtet, pra standardet të parapara për jetë të qetë dhe normale të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Kjo punë e mirë dhe e suksesshme shihet dhe në jetën e përditshme, por shihet qartë edhe në bazë të raportit të hartuar nga Qeveria për zbatimin e standardeve në Kosovë. Por, më gjithë angazhimet e vazhdueshme dhe obligative të Qeverisë dhe me përgjegjësinë tonë si popull shumicë në Kosovë, mbetet të punohet edhe më tutje në vazhdimësi, për t'i plotësuar dhe për t'i përsosur sa më mirë standardet në Kosovë. Në raportin e Qeverisë ku flitet për planin e veprimit për muajt mars, prill, dhe maj 2006 përmenden, ndër të tjera, edhe miratimi nga Parlamenti i Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Jemi të vetëdijshëm se ky ligj është shumë i nevojshëm për shoqërinë kosovare, kur është fjala për plotësimin e standardeve, por caktimi i datës - 27 prill 2006 - për miratimin e tij të domosdoshëm - dyshoj se është i ngutshëm.

Projektligji në fjalë shpreh angazhimin dhe vullnetin tonë për shumëllojshmërinë e gjuhëve në Kosovë dhe për standardizimin e tyre si mjet esencial për demokraci dhe për integrim në Bashkësinë Evropiane. Mirëpo që të jetë ky ligj i mundshëm dhe i suksesshëm për implementim të suksesshëm, duhet të punohet edhe më. Projektligji ka nevojë të plotësohet edhe me nene shtesë si dhe me amendamente mbi bazën e vlerësimeve vetëm nga kuvendarët në Kuvendin e Kosovës si edhe në komisionet e caktuara kompetente parlamentare. Kursesit nuk bënë të mos merren parasysh premtimet e individëve të caktuar që u premtojnë komuniteteve pakicë jashtë seancave parlamentare. Projektligji në fjalë është pak sa i vështirë për t'u realizuar vetëm për shkak të implikimeve të shumta buxhetore që i bart me vete. Te radhitja rendore 31 faqe 5 e raportit për zbatimin e standardeve ku thuhet citoj: Të themelohen 9 stacione policore në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54, përmendet se janë paraparë të hapen nën-stacioneve policore të reja, jo vetëm në vendbanime të banuara kryesisht me serbë dhe me turq, mirëpo jo edhe në vendbanimet shqiptare në kufi me Serbinë si p.sh. në Shalë të Bajgores, në Gallap dhe në anë të Gjilanit, ku shqiptarët e atjeshëm të frikësuar nga policia serbe kufitare dhe nga sulmet e herëpashershme që u bëhen nga individë dhe nga grupe të organizuara serbe nga Serbia, detyrohen që të shpërngulen nga vendbanimet e tyre.

Në numrin rendor 46, 47 dhe 48 të faqes 7, ku flitet për kthimin, bëhet fjalë për kthimin në Kosovë të komuniteteve pakicë e sidomos me theks të veçantë për kthimit e

komunitetit serb, kurse fare nuk theksohet kthimi i shqiptarëve të j shpërngulur me mijëra nga dhuna dhe represioni gjatë 10 vjeteshin të fund shekullit XX të gjendjes së luftës në Kosovë, si edhe gjatë luftës së padrejtë të vitit 1999 në Kosovë. Në strategjinë e Qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut për kompletimin e projektit për rindërtimin e objekteve të shkatërruara gjatë ngjarjeve të marsit 2004, e që është në numrin rendor 49 e faqes 7 te raporti në fjalë, ceket se Qeveria është duke bërë çmos që t'i sigurojë mjetet për realizimin e një projekti të tillë gjatë verës 2006. Kujtoj se një rindërtim i tillë, sipas kritereve të caktuara është i mirë dhe i respektueshëm, por të bëhen rindërtimet e përgjithshme dhe jo vetëm të marsit 2004, sepse ende ka shumë banorë shqiptarë, të cilëve u janë djegur shtëpitë gjatë luftës së vitit 1999 e nuk janë rindërtuar ende. Raste të tilla ka në tërë Kosovën, i kam parë edhe vetë, por po i shohin edhe nëpërmjet mediave elektronike se janë pa shtëpi dhe pa kushte elementare për jetës. Konkretisht po e marr shembull, banorët e fshatrave të Gallapit të komunës së Prishtinës thuajse janë shpërngulur të gjithë jashtë Kosovës dhe brenda sa, sepse shtëpitë e tyre u dogjen dhe u shkatërruar krejtësisht nga lufta e vitit 1999. Pak rindërtime janë bërë atje gjatë kohës së emergjencës së pasluftës 1999 dhe tani 7 vjet pas Isaj, po të shkosh në ato vise rurale të Komunës së Prishtinës të kaplon tmëri nga heshtja e gjithëpërfshirëse në mungesë të banorëve.

Në faqen 14 nën numrat rendorë 79 dhe 80 flitet për përgatitjen e broshurave për vendet me trashëgimi kulturore. Këto punë duhet t'i kryejë një komision multietnik për trashëgimi kulturore. Kjo është e mirë, por do të ishte edhe më mirë, ndoshta edhe e domosdoshme, po të thuhej si në citim: TË zgjidhet një komision me punonjës shkencorë nga institucionet e Kosovës, që ka njohuri për historinë e monumenteve historik të Kosovës dhe ky do ishte tekst bazë të cilit tekst pastaj mund të shtohet se edhe në komisionin në fjalë mund të ketë edhe shkencëtarë të tjerë përkatës që përfaqësojnë **multi-etnicitetin** në Kosovë. Në numrin rendor 85 po të njëjtës faqe bëhet fjalë për dëmtimi e monumenteve kulturore dhe historike në Kosovë gjatë marsit 2004 e nuk bëhet fjalë kurrkund për djegien, dëmtimin e shkallëzuar dhe të tërësishëm të monumenteve kosovare gjatë luftës çlirimtare 1999, që sa e sa kulla shqiptare dhe monumente fetare të shqiptarëve u bënë rrafsh me tokë nga militaristët serbë.

Te numri 83, faqe 7 kam vërejtje plotësuese, thuhet, ndër të tjera, trashëgimia joortodokse si edhe trashëgimia otomane, a thua në Kosovë paskemi vetëm trashëgimi ortodokse dhe otomane? Ku është vallë ajo trashëgimi shqiptare. Pse nuk ceket në raport apo pse nuk insistohet të ceket se monumentet e trashëgimisë kulturore në Kosovë ishin shqiptare, por u uzurpuan dhe u tjetërsuan me dhunë nëpër shekuj, të paktën të theksohet disi se ne si shqiptarë shumicë nuk pikëm nga qiellit, por ishim standard në tokën tonë dhe në kulturën tonë në vazhdimësi. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj dhe pastaj do të shkojmë në pauzë.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ- I nderuri kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar të pranishëm.

Nocioni standard së pari duhet të shikohet si vlerë demokratike që do të mund të zbërthehej në një vlerë shoqërore, por edhe vlera edhe standardi janë çështje e kriterëve. Shtrohet pyetja a kanë kritere për standarde institucionet tona. Përgjigjja është jo, në kontekstin e Kosovës si do të duhej t'u qasemi standardeve, a do të duhej të ishin ato një dokument juridik, një manifest apo vlerë morale për mua dhe për shumicën e qytetarëve të Kosovës standardet duhet të konceptohen si përpjekje për institucionalizim të lirisë dhe për funksionalizim të demokracisë ,por cili standard është më i rëndësishëm për Kosovën, liria e individit, respektimi i ligjit apo lufta kundër korrupsionit ,që të gjitha janë paqësore. Edhe në raportin e fundit të Kai Aides dhe në shumë deklarata të të huajve shfaqen shqetësime për funksionimin demokratik të institucioneve, për sundimin e ligjit dhe me theks të veçantë të luftës kundër korrupsionit. Po çka kanë bërë institucionet tona për ta mënjeluar këtë të keqe të madhe, që na ka kushtuar. Përgjigjja është- asgjë. E përsërisim, asgjë. Ato me indiferentizëm, po e legalizojnë korrupsionin që sot është fatkeqësia më e madhe për Kosovën dhe për qytetarët e saj, është kancer .Për fatin tonë të keq institucionet tona për arsye të indiferentizmit shfaqen sikur të ishin kultivuese të korrupsionit, sot ku do që shkon, ngado që të sillesh ,dëgjon këtë fjalë, edhe në media edhe në gazeta edhe te qytetarët, të gjithë kanë një shqetësim, një brengë, një pyetje, a mund ta ndalin korrupsionin ata që e krijojnë, prandaj edhe fjalimet javore të kryeministrit sa do që duket të bukura janë vetëm dëshira, sepse e keqja nuk luftohet me fjalë. por me veprime të guximshme dhe të përgjegjshme/ Shpikja e metodës së auditimit është mënyrë perfide dhe tinëzare e ikjes nga përgjegjësia dhe nga llogaridhënia, është zvarritje e veprimeve, populli e ka fjalën e urtë: Mali që shihet kallauz nuk do". Taksat e qytetarëve të Kosovës shpenzohen në mënyrën më të papërgjegjshme dhe më të padinjitetshme. Milion euro për makina super luksoze, për zyra, për telefonata, pra keqmenaxhimi është shndërruar në normë, përderisa qytetarët e Kosovës jetojnë në varfëri të skajshme më me shumë se 60% pa punë. Dhe si për ironi ,ne që dje luftuam me gjitha mjetet kundër pushtuesit ,sot po lejojmë të rrezikohet e ardhmja jonë nga korrupsioni, sepse si duket nocioni atdhe për qeveritarët aktualë do të thotë t'ia marrësh të gjitha atdheut dhe dilema të kesh dhe të jesh po na përcjell vazhdimisht. Dje donim të kishim ushtri ,por nuk donim të ishim ushtarë, e sot duam shtet, por nuk jemi të përgjegjshëm për të ndërmarrë hapat e domosdoshëm për ndërtimin e tij, me këto institucione të papërgjegjshme nuk bëhet shteti dhe është fatkeqësi të ndihesh i pafuqishëm kur sheh se si ta shkatërrojmë atdheun dhe si rrënohen të gjitha vlerat të paditurit dhe të papërgjegjshmit, se si plaçkitet populli më i varfëri i Evropës, nga realiteti dhe faktet që shohim sikur del se kjo Qeveri si standard ka paaftësinë ,por jo gatishmërinë për veprim, ndërsa si vlerë ka fuqinë e strukturimit parapolitik. Një qeveri e tillë e Kosovës nuk i duhet asaj ,i duhet një Qeveri ndryshe, një Qeveri e përgjegjshme. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Shkojmë në pushim për një orë.

KRYETARI – Fillojmë punën. Për diskutim është paraqitur deputeti Jonuz Kastrati. Lë të përgatitet Shaban Halimi.

DEPUTETI JONUZ KASTRATI – Faleminderit z. kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtarë të tjerë të Kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Duke vlerësuar lart angazhimin e kryeministrit Çeku në ndaljen e veprimeve që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe për t'u ndërlidhur me vlerësimin e katërt teknik ,gjegjësisht me pikën 17, për prioritetet urgjente në institucionet demokratike, i kam disa pyetje për kryeministrin.

A ka ndonjë afat të caktuar dhe si keni menduar të sundojë ligji aty ku edhe më tej vazhdojnë të udhëheqin nga dy drejtorë nëpër shkolla?

A keni ndërmarrë diçka në qendra sociale ,ku tashmë janë vërtetuar keqpërdorimet e drejtorëve të këtyre qendrave, duke qenë në krye, të këtyre keqpërdorimeve bile edhe vetë udhëheqësit komunalë. Por që ministri pas suspendimit të drejtorëve nëpër qendra sociale prapë i kthen në punë.

Dhe e treta, si mund të tolerohet fakti që nëpër komuna brenda vitit fiskal nuk miratohet as nuk rishikohet buxheti.

I bëra këto pyetje edhe për një fakt, sepse opozita mund të ndihmojë aty ku e ka pushtetin lokal, pra të mos lejojë të ketë nga dy drejtorë shkolle, të mos lejojë që vetë shefi i ekzekutivit të jetë përfitues i ndihmave sociale, gjegjësisht i dëshmimeve nga qendrat sociale si dhe të mos lejojë që të menaxhohet buxheti pa pasur brenda vitit fiskal as miratim, as rishikim të buxhetit. Opozita sigurisht nga këto fjalë që i paraqita e ka kuptuar që është fjala për komunën nga vjen deputeti.

Duke mbështetur edhe njëherë kryeministrin dhe Qeverinë për punën që është duke e bërë, ju faleminderit të gjithëve.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Shaban Halimi, le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETI SHABAN HALIMI - Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, ministër të nderuar kolegë deputetë.

Diskutimi im i sotëm , në realitet ka të bëjë me standardet dhe më është dashur ta ndërroja për hir të asaj se u dëgjuan shumë fjalë rreth atyre dhe në këtë drejtim jam i mendimit së deputetët e paraqitur për fjalë, të tërhiqemi në mënyrë që të japim mundësi të diskutojmë për pikën e dytë të rendit të ditës. Nëse kjo shtrohet në votim do të thotë sigurisht se do të heqë dorë nga diskutimi nëse mbetet që të diskutohet edhe më tej ,atëherë do të diskutoj edhe unë për standardet. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI – Ju faleminderit, mungon deputeti Hajredin Kuçi në radhë është deputeti Nimon Alimusaj, le të përgatitet Berat Luzha.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Nuk ka dyshim , z. kryetar dhe z. kryeministër dhe ju kolegë deputetë, se politika e standardeve është ,nën një ashtu së paku si e sheh faktori ndërkombëtar një mjet për ta nxitur dhe për ta shtyrë Kosovën deri të qeverisjes funksionale dhe nën dy, si mjet për akomodimin ndëretnik.

Me siguri se ky funksioni i dytë i standardeve ,së paku këtu shihet nga faktori ndërkombëtar që në këtë proces ,në të cilin ndodhet Kosova, më shumë është i interesuar të shikojë si sillet shumica ndaj minoriteteve, se sa si sillet shumica ndaj vetvetes, është një çështje tepër me rëndësi se duhet të debatohet.

Që në fillim dua të konstatoj, se duke u bazuar në katër vlerësimet që i kemi sot përpara dhe në 85 pikat e planit aksional që i kemi gjithashtu sot përpara ,shihet se Qeveria e Kosovë në vazhdimësi po bën përparim përmbajtjesor dhe jam i sigurtë se gjithë ata që do të merren me vlerësimin e këtyre arritjeve nuk do të mund të mos i pranojnë ato të arritura, përkundër opozitës që është çdo herë e gatshme të mos pranojë asnjë të arritur të Qeverisë së Kosovës.

Unë do të ndalem vetëm në disa nga pikat që i ka parashtruar në ato 85 pika në planin aksionar Qeveria e Kosovës. Në katër vlerësime teknike të standardeve që kanë bërë deri më tash ,siç shihet nga materiali që kemi përpara, si mangësi e implementimit të tyre konsiderohet punësimi i ulët i pakicës në institucionet e Kosovës. Nga një material që e kam siguruar unë nga dy ministri, nga Ministria për Kulturë dhe nga ajo për Arsim kam vërejtur se punësimi i minoriteteve në këto ministri ka arritur diku 10% respektivisht 11%.

Rezultatet do të ishin shumë më të mira dhe se nuk pres rezultat më të mirë se këto që janë arritur, sikur të mos ndikonte negativisht Beogradi me strukturat paralele në Kosovë dhe me ndarjen e serbëve të Kosovës prej politikës së administratës publike në Kosovë.

Dy, sa i përket realizimit të standardeve në fushën e arsimit, kam të dhëna nga Ministria e Arsimit, që na bindin se nuk janë siç u tha këtu nga një diskutues premtive verbale, por rezultate shumë të mëdha që nuk mund të mohohen. Le të më lejohet t'i përmend vetëm

disa

Botimi i teksteve shkollore për klasën e 9 në gjuhën boshnjake dhe i teksteve shkollore për gjuhën turke,që janë në pajtim me standardet evropiane është arritur, sektori për planëprograme ka vlerësuar librat shkollorë të ardhur nga Kroacia për përdorimin e nxënësve në Janjevë për 76 nxënës u janë siguruar tekstet shkollore prej Kroacia dhe janë pranuar si të tilla.

Është duke u mbajtur mësim intenziv për komunitetin rom, hashkali, egjiptian në 9 komuna ku vijojnë mësimin 2000 nxënës. Janë në proces shqyrtimet e disa teksteve në gjuhën rome. Për përdorimin në shkolla nga komunitetet romë në gjuhën e tyre amëtare, janë përfunduar programet e reja për klasën e 4,5, 9, 13 në gjuhën boshnjake dhe turke dhe janë dorëzuar për botim për vitin shkollor në të cilin jemi. Është shpallur konkurs për botimin e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake dhe turke. Kanë hyrë në procedurën e përkthimit në gjuhën boshnjake dhe turke tekstet shkollore për klasën 1, 2, 6 dhe 7.

Në Universitetin e Prishtinës kanë filluar studimet studentët e pakicave në fakultetet të ndryshme sipas numrit të rezervuar për ta. D.m.th. janë vendet e rezervuara për

minoritete. Ministria e Arsimit paguan 121 punëtorë serbë në Universitetin e Mitrovicës të Institutit të Leposaviqit të shkollës speciale në Mitrovicë e etj. Vazhdimi i programit në Fakultetin e Biznesit Pejë për në gjuhën boshnjake etj. Pra janë rezultate, nuk janë fjalë premtive boshe si u tha, dhe nga kjo do të nxjerri një konstatim, Ministria për Arsim, Shkencë, dhe Teknologji, në strategjinë e punës së tij, një nga objektivat kryesore ka integrimin e gjitha komuniteteve në sistemin e arsimit, pa dallim, por qëndrimi i tillë i minoritetit serb në strukturat paralele me arsim nuk e mundëson realizimin e plotë të këtij rezultati. Merrni me mend është siguruar objekti shkollor për nja 16 fëmijë të minoritetit serb në Prishtinë, por ata nuk duan të mbajnë mësim në atë objekt dhe shkojnë në Graçanicë.

Dua të thëm dhe po e marr edhe një shembull lidhur me këtë që u tha më sipër, që të konstatohet njohja e së drejtës që secili identitet ta përdorë gjuhën e vet në arsim dhe edukim, pra zgjedhje ideale e problemit të demokracisë gjuhësore. Çështje tjetër, ndër prioritetet e rëndësishme, konsiderohet edhe miratimi i disa ligjeve që janë në funksion të afirmimit të pozitës së minoriteteve, si është Ligji për trashëgiminë kulturore, Ligji për të drejtat e autorit, Ligji për liritë fetare, Ligji për gjuhët e tjera. Këto ligje nuk kanë marrë formën e përkryer përfundimtare pra, edhe pse miratimi i tyre ka filluar qysh në mandatin e kaluar. Për mospërmbyshjen e kësaj pike të standardëve nuk krejt fajtorë ato ministri detyrë e të cilave është kjo çështje. Unë dua ta argumentojë edhe këtu se një pjesë të fajit për mos nxjerrjen e këtyre ligjeve e ka edhe minoriteti serb. Kur ka filluar hartimi ta zëmë i ligjit për trashëgiminë kulturore, është kërkuar nga ministria, që minoriteti serbë të qojë ekspertë të vetë në hartimin e këtij projektligji. Është kërkuar pastaj që të marrë pjesë me ekspertë e vetë në dëgjimin publik. Është kërkuar që të merr pjesë në komisione për amendamentimit e ligjeve, dhe për tre katër vjet resht kjo nuk bëhet.

Prandaj, unë do të thosha se një pengesë e nxjerrjes së këtyre ligjeve të domosdoshme, janë vetë minoritetet ose minoriteti që nuk merr pjesë në hartimin e tyre.

Edhe një konstatim pra, është zvarritja e nxjerrjes së disa ligjeve dhe kjo është rezultat i mosinteresimit, madje edhe i faktorit ndërkombëtar. Unë dua ta marr një shembull. Ligji për të drejtat e autorit ka filluar të zbatohet në shtator, është pranuar këtu para këtij Kuvendi në shtator të vitit 2004. Menjëherë Komisionit për Arsim, Shkencë, dhe Teknologji, nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut janë dhënë vërejtjet e përgjithshme shumë serioze. Mirëpo që nga ajo ditë askush nuk na ka ardhur nga ajo zyrë ligjore që të argumentojë ku janë ato vërejtje etj, dhe kjo ka bërë që ligji të shtyhet edhe sot e kësaj dite. Është për tu falënderuar Këshilli i Evropës që ka organizuar një punë bashkë me Komisionin për Arsim dhe me Ministrinë e Arsimit që këto ligjet të hartohen dhe të dalin në lexim të dytë shumë shpejtë.

Edhe një çështje tjetër, nuk është mirë të diskutohet fort se cili deputet për trevën e vet, vetëm ne e kemi shumë të qartë, si popullatë shqiptare sa është e rëndësishme ruajtja e monumenteve fetare. Manastiri i Deçanit, dihet, për këtë janë shkruar edhe vepra, është ruajtur pikërisht shekuj me radhë nga vetë komuniteti shqiptar. Janë shkruar vepra se familja e Demë Ukajt e ka mbrojtur manastirin e Deçanit, kurse Manastirin e Pejës po

ashtu e kanë ruajtur shqiptarët. Pra jemi shumë të vetëdijshëm që ato monumente të rëndësishme të veçantë kanë disa standarde që janë evropiane, por mënyra si u tha për ato 800 hektarë rreth manastirit të Deçanit ku përmenden edhe qebaptoret, ka qenë shumë irrituese për popullatën e kësaj anc. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Berat Luzha ,të përgatitet Bislim Hoti.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Ju faleminderit z. kryetar. Sundimi i ligjit është standardi i dytë në planin për zbatimin e standardeve për Kosovën, mirëpo sundimi i ligjit nuk mund të bëhet pa ligje. Infrastruktura ligjore është tejte e varfër edhe pse kanë kaluar 5 vjet nga themelimi i institucioneve të Kosovës.

Dy kryeministrit paraardhës të kryeministrit Çeku, patën premtuar me bujë, në fillim të karrierës së tyre në krye të Qeverisë se vetëm gjatë vitit 2005 do të dërgojnë në Kuvend jo më pak se 100 ligje. Por sikur edhe në dështimet e tjera Qeveria dështoi plotësisht edhe në këtë plan. Derisa në vitin 2004 ishin hartuar 42 ligje nga Qeveria, në vitin pasues 2005 patëm një prapakthim, janë hartuar gjithsej 35 ligje, nga të cilat vetëm 25 kanë kaluar shqyrtimin e dytë. Ndërsa janë nënshkruar gjithsej 12. Kur marrim parasysh se disa prej këtyre ligjeve ishin të bartura nga viti 2004 nga Qeveria Rexhepi ,atëherë shohim dështimin total të Qeverisë për hartimin e ligjeve që janë aq shumë të nevojshme për Kosovën.

Edhe këtë vit hartimi i ligjeve po shkon tepër ngadalë, janë miratuar gjithsej 16 ligje dhe 9 të tjera janë në procedurë parlamentare. Me këtë temp të hartimit të ligjeve Kosova edhe 100 vjet nuk mund ta plotësojë infrastrukturën ligjore sipas standardeve evropiane. Madje kemi edhe fenomenin tjetër të dëmshëm, moszbatimin e ligjeve të miratuara.

Qeveria disa herë ka marr vërejtje serioze nga Kuvendi, por edhe nga mekanizma ndërkombëtarë për mosimplementimin e ligjeve tashmë të miratuara. Një shembull eklatant është pezullimi i Ligjit për lojërat e fatit nga ana e Qeverisë, duke e lënë këtë sferë shumë delikate të veprimtarisë të punojë në të zezë dhe në rrethana shumë të dyshimta kur dihet se Qeverisë nuk i takon ta pezullojë dhe të luajë me ligjet e miratuara dhe të nënshkruara, detyrë e Qeverisë është të hartojë ligje dhe jo t'i zhbëjë ato, por, si është vërtetuar deri më tash, shpesh nuk di se ç'bën. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Luzha. Fjalën e ka deputeti Bislim Hoti le të përgatitet Nazim Jashari.

DEPUTETI BISLIM HOTI - I nderuari z. kryetar i Kuvendit, i nderuar z. kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë të çmuar.

Standardet paraqesin një shoqëri multietnike dhe mundësojnë solidaritet për gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racore, gjuhësore apo fetare. Meqë nuk ka mundësi të flas për secilin veç e veç, do të ndalem në çështjen e kthimeve të

qëndrueshme, ku të gjitha këto standarde ndërlihen me kthimet dhe me të drejtat e bashkësive etnike.

Institucionet vendore në bashkëpunim me ndërkombëtarët, UNHCR, UNMIK-un,, OSCE-në kanë bërë shumë plane, deklarata, platforma e rregullore që kanë të bëjnë me kthimin dhe të gjitha këto favorizojnë vetëm serbët, ndërsa bashkësitë e tjera, posaçërisht komuniteti egjiptian apo hashkali, pas 7 vjetësh mbeten ende në mëshirën e kohës.

Kur flasim për kthim nuk mund të gjejmë mekanizma të duhur për të sfiduar këtë dukuri. Në ballafaqohemi me dy lloj kthimesh, kthimi i padëshiruar, që bëhet nga diaspora, ku njerëzit na kthehen të malltretuar dhe të pandihmuar. Fajtorë kryesor është UNMIK-u, përfaqësuesi në detyrë e nënshkruan marrëveshjen për kthim të cilët tani nuk u ndihmojnë të kthyerve, as që ballafaqohen në këtë drejtim ,sepse tashmë ata e kanë lëshuar Kosovën. Këtë e bëri ish -kryeadministratori Shtajner me Qeverinë gjermane, ku dy javë para largimit të tij nga Kosova e bëri këtë marrëveshje veprimtari të tillë e bëri edhe Lari Losin me qeverinë suedeze që pas tri ditësh u largua edhe nga Kosova.

Ndërsa kthimin që e dëshirojmë e nuk bëhet edhe pas 7 vjetëve , është për të shpërngulurit në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi , në Vojvodinë. Niveli qeveritar dhe komunal, nuk janë angazhuar aq sa duhet në procesin e kthimit, sepse ende nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të marrur mbi vete përgjegjësinë që u takon edhe për pakicat e tjera, duke u angazhuar vetëm për serbët ,ndonëse standardet vlejnë vetëm për serbët. E themi këtë për arsye se atyre u mundësohen të gjitha, komunat etnike, u falen tokë, ju ndërtohen shtëpitë edhe pse të mëparshmet i kanë shitur, punësimi, ndërtohen kisha, e shumë e shumë lutje të tjera u bëhen sikur nuk ka ndodhur nga ta asgjë historikisht.

Ndërsa komuniteti egjiptian apo hashkali nuk mund të kthehet edhe pas 7 vjetësh, sepse shtëpitë e rrënuara ku kanë jetuar me vite nuk paskan qenë pronë e tyre, nuk bëhet zgjidhja e pronës, nuk ndërtohen shtëpitë e aty ku kanë jetuar nuk bëhen vizita se në çfarë kushte të vështira jetojnë, për të kuptuar se mezi presin të kthehen në vatrat e mëparshme.

Por mosgatishmëria nga kuvendet komunale për kthimin e popullatës sonë arsyetohet, se këtu ku kemi jetuar më parë nuk bën të ndërtohen shtëpitë, nuk ka prona komunale për ne, sepse ato tani duhet të rezervohen për kthime masovike të serbëve. Me këtë problem jo që ballafaqohemi vetëm ne, por edhe shumë familje të ndershme shqiptare, familje këto që dhanë më së shumti për Kosovën, familjet e luftëtarëve, familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, familjet e të zhdukurve e shumë të tjerë që kontributi i tyre për çlirimin e Kosovës, po shpërblehet pa përkrahje, pa shtëpi, pa punësim dhe duke harruar se ata ekzistojnë.

Shumë nga ta në pamundësi të mbajtjes së familjes, strehimit, punësimit, i bëjnë vetë shpërblim me vetëvrasje për t'iu përkujtuar institucioneve vendore një përkujdesje për familje të tilla. Problemet e cekura më lartë menduam që do t'i kalojmë me hapjen e Ministrisë për Kthim. Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve është themeluar për të marrë përgjegjësinë për kthimin e të gjitha komuniteteve, por edhe për mazhurancën.

Ndërsa një ministri e tillë fatkeqësisht nuk ekziston. Ministri Petkoviç këtë ministri e ka privatizuar, duke larguar njerëz tanë nga puna, duke mos e pranuar asnjë projekt të vetin për ne, duke mos na pranuar as në bisedime, duke e vështirësuar edhe më tepër kthimin.

Për të gjitha këto probleme,, ne nuk do të merremi më me Petkoviçin, por direkt kërkojmë nga z. kryeministri Çeku, të merret me kërkesat tona të cilat duhet të realizohen këtë vit dhe kanë mundësi të realizohen. Kërkojmë urgjentisht që diaspora ta ndalojë kthimin e popullatës në këto kushte për deri sa nuk kthehen të gjithë nga rajoni Serbi, Maqedoni, Mal të Zi Vojvodinë. E të mos ketë kampe më si është ai i Plemetit dhe i Mitrovicës, të realizohen projektet e kthimit të menaxhuar prej nesh, po që se Qeveria dërgon një gatishmëri bashkëpunimi me ne, do t'u premtojmë se tërë ajo që s'është bërë për 7 vjet , do të ketë besim që në bashkëpunim do ta kemi për 7 muaj. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari ,Je të përgatitet deputeti Ymer Halimi.

DEPUTETI NAZIM JASAHRI - I nderuari z. kryetar,z. kryeministër, të nderuar kolegë deputetë.

Debati që po e zhvillojmë sot është një nga debatet që i mungonin Kuvendit të Kosovës dhe është mirë që po bëhet, sepse po na jepet mundësia të diskutojmë për probleme shoqërore, kurse standardet ose procesi i përmbushjes së tyre është një proces shoqëror që në një mënyrë ose në tjetrën, ka të bëjë me të gjithë ne, pavarësisht. Kur po them me të gjithë ne, po mendoj jo vetëm te ne, por me të gjithë qytetarët e Kosovës, sepse realisht as nuk ka mundësi që Kosova t'i përmbushë standardet pa një front të gjërë të shprehem me një **zhargon**, pak sa më demode të qytetarëve.

Po këto standarde , u tha edhe më parë nga parafolësit , në një mënyrë janë koqkuptuar nga ana e Qeverisë, sepse janë marrë si detyra shtëpiç. E kam thënë edhe një herë në këtë Kuvend dhe detyrat e shtëpisë varësisht nga afiniteti i nxënësit, herë bëhen mirë, herë bëhen dosido, e herë kopjohen në orën e mësimit. Më duket se këto standarde, kjo qeveri e këtij koalicioni, po i kopjon në orën e mësimit dhe po përpiqet t'ia shes mësuesit si detyra të punuara në shtëpi. Ç' është e vërteta unë sot, me thënë të drejtën, intimisht kam menduar se nuk do të raportojë kryeministri Çeku për standardet, por do të dalë koordinatori për standardet, sepse si njeriu më përgjegjës për implementimin e standardeve, që nuk është kurrgjë e pazakontë për raportim edhe në kuvende kur me autorizim të Kuvendit, edhe do të ketë një raportim nga ai për një arsye themelore, sepse, me aftësinë e vet të pamohueshme, këtu e kam fjalën për koordinatorin- ia ka dalë t'i vinte në gjumë tre kryeministra, edhe kur e dëgjon njeriu si shprehet në media, në të tria mandatet, ai është i njëjti dhe gjithmonë e ka të njëjtin optimizëm para kamerave. Po punohet, po përmbushen, u përmbushën u kryen, s'ka më edhe pak ka mbetur, u kryen kështu ishte nën Ramush Haradinajn, kështu ishte nën Bajram Kosumin kështu është edhe nën Agim Çekun.

Edhe për mua kjo është e pakuptimtë. I gjithë Kabineti qeveritar i z. Kosumi u ndërrua, përveç koordinators për standarde, kurse z. Kosumi në rast se nuk keni haruar gjithë ju,

ka qenë posaçërisht i kritikuar për ngecje në përmbushjen e standardeve. Pra, ndërmjet tjerash, por theksi i veçantë është përqëndruar te ngecja në përmbushjen e standardeve.

Koordinatori po vazhdon me optimizëm, mirë boll. Institucionet demokratike është standardi i parë dhe kemi gjithë vërejtje. Opozita ka vërejtje sigurisht më shumë se krejt koalicioni. Ka vërejtje opozita edhe duhet të ketë vërejtje, mirëpo, ato kanë të bëjnë me standardet. Është një standard që në një mënyrë i përvijon të gjitha standardet transparente. Është standard që askund nuk thuhet në mënyrë **eksplicite** dhe së paku nuk rreshtohet, mirëpo është një standard që në një mënyrë apo në një tjetër ka të bëjë me të gjithë standardet.

Dhe është standardi që më së shumti u mungon institucioneve tona, qofshin ato në çfarë do niveli, qofshin në atë komunal, në pushtet legjislativ, apo në ekzekutiv, dhe transparenca përkundër asaj që Ligji për qasje në dokumentet zyrtare është miratuar, edhe sipas atij ligji çdo qytetar i Kosovës do të duhej të kishte të drejtë të ketë qasje në dokumentet zyrtare. Ne si deputetë e shohim ditën e kiametit, për ta marrë një informacion në këtë Kuvend, ndërsa në Qeveri, përveç atyre që botohen në faqe zyrtare të internetit, është e pamundshme edhe të qasemi, sepse së paku kështu ka qenë deri më tani e të mos paragjykoj për të ardhmen.

Një moment tjetër, që desha ta theksoja- aspekti i funksionimit të institucioneve demokratik- që desha ta trajtoja këtu, është problemi i zgjedhjeve, zonja dhe zotërinj. Në vitin 2006, sipas kalendarit të zgjedhjeve, sipas Kornizës Kushtetuese të Kosovës është paraparë të mbahen zgjedhje lokale diku në vjeshtën e këtij viti edhe në këtë dokument që Qeveria na ka pru neve këtu që po e diskutojmë, diku pika 14 thotë : të themelohet korniza ligjore për zgjedhjet lokale të vitit 2006. E di që është punuar në këtë aspekt, e di që edhe në Komision të Legjislacionit ka ardhur një dokument dhe nuk është miratuar ende, por është në proces e sipër. Mirëpo, këtu diku është një fjali, në të cilën thuhet se ende nuk është vendosur për mbajtjen e zgjedhjeve në vjeshtë të vitit 2006. Kjo fletë më së miri për qasjen e institucioneve tona ndaj demokracisë si koncept. Zgjedhjet janë të vendosura me Kornizë Kushtetuese. Ato është vendosur të mbahen në vjeshtë, nuk është vendosur që ato të shtyhen, jo, që të mbahen pra. Çështja se a po i shtyjme apo po i mbajme zgjedhjet është përmbysur dhe po diskutojmë që diskutimi të zhvillohet në nivel. E zeza është bërë e bardhë e bardha është bërë e zezë, si në negativat e filmave dhe tashti nuk diskutohet a t' i mbajme zgjedhjet, por diskutohet, a t' i shtyjme apo ti mbajme. Kjo për mua fletë për një frymë krejtësisht jo demokratike të qeverisjes edhe të atyre që e sponzorojnë këtë qeveri apo që e përkrahin në aspektin legjislativ që mund të jenë edhe nga Evropa, nuk është shumë me rëndësi. Në standardin e dytë ekziston ku thuhet se është sundimi i ligjit, ekziston aty një pjesë ku thuhet se askush nuk është mbi ligjin. Ne zonja dhe zotërinj jemi të gjithë dëshmitarë që në Kosovën tonë të vogël ka shumë njerëz që janë mbi ligjin, dhe që ligji nuk ka të bëjë fare me ta. Janë ata të të gjitha niveleve, janë politikanë, janë biznesmenë, por bile mund të them që ky është standardi i cili le më së shumti për të dëshiruar në këtë procese demokratik, në të cilin po kalon Kosova, sepse pa avancimin e këtij standardi, thjesht nuk ka shans të bëhet, sepse do të ballafaqohemi vazhdimisht me krimet e pandëshkuara, kurse krimet e pandëshkuara nuk zvogëlohen vetvetiu, ato vetëm aplikohen, nuk shkojnë në shuarje por në rritje.

Në këtë kontekst ekziston atje edhe paragrafi që flet për krimet ekonomike dhe financiare. Bëhen shumë auditime, auditimet kontestohen, edhe kontestohet aftësia e auditorëve, kontestohet ligji i prokurimit si ligj i keq, pra i le fajn ligjit dhe gjithmonë atyre që nuk mundën të punojnë pa ligj. Ligji i zë ngushtë, sepse donë liri, vetëm paligjshmëria ua jep lirinë e nevojshme për të qenë të suksesshëm sipas konceptit të tyre të suksesit.

Me rastin e auditimit konstatohet që në kabinetin e ministrit Petkoviç ka shkelje drastike që peshojnë miliona euro, dhe ministri Petkoviç e vazhdon punën normalisht thuaja se mirë është. Kërkohet prej tij ti jep disa sqarime, e që nuk hyhet në procedurën normale të suspendimit, të eliminimit të mundësisë së tij të qasjes në dokumente dhe të përpiket të ndryshojë diçka në dokumentacion, duke marrë parasysh balancimin e pushtetit në Kosovë, nuk është aspak e pamundshme që të bëhet, ose ndoshta mund të jetë që z. Petkoviç po përdorët si një balon prove për ti testuar ata që njëfarë mënyre e mbikëqyrin procesin demokratik në Kosovë dhe bëhet presion maksimal te z. Petkoviç e që në fund duke marrë parasysh që vjen nga komuniteti serb do të shihet nëpër gishta si është parë edhe me rastin e emërimit, dhe këtu jepet mundësia që edhe ministrat tjerë të nxirren si z. Petkoviç, sepse jemi të gjithë të vetëdijshëm se nuk është z. Petkoviç shembull i vetëm i keqmenaxhimit dhe i keqpërdorimit.

Është njëri prej të gjithëve, të shprehem ndoshta pak sa, edhe ekzistojnë fare pak gjasa duke qenë se z. Petkoviç mund të nxirret edhe në parametrat e tjerë. Ekziston edhe një standard tjetër, dialogu i cili është një standard shumë i rëndësishëm edhe në një farë mënyre është kah plotësohet në mënyrë të përsheptuar kohëve të fundit me këtë procesin e negociatave, që është nxit e që duhet të them si deputet që është bukur jo transparent, prapë vijmë te ai momenti i transparencës po e them gjithkund mungon, është i mungueshëm kudo. Edhe negociatat që po zhvillohen në Vjenë, edhe negociatat e tjera mund të jenë për çështjet e të zhdukurve dhe të kidnapuarve gjatë luftës, kurse sot e kam një informacion jo zyrtarë që një delegacion i BPK-së në përbërje të drejtorit dhe zv.drejtorit është në Beograd për vizitë pune guvernatorit të bankës së Serbisë. Sigurisht nuk besoj që është vizitë **kurtuazie**, sepse nuk kemi ardhur në asnjë raportesh akoma me Beogradin fatkeqësisht, dhe që kisha pasur shumë dëshirë nga z. kryeministër dhe nga z. Satri, më duket se është këtu, të na jepet një informacion elementar se në kontekst është duke u negociuar dhe duke u biseduar në Beograd. A është në kontekstin e negociatave që po zhvillohen për Kosovën, që ka pasur kërkesa që disa xhirollogari të hapen, por të jetë xhirollogaria e hapjes në bashkëpunim me bankën qendrore të Beogradit, pra, a është në atë kontekst apo ndonjë kontekst tjetër teknik të negocimit, pra cilat janë rrethanat kanë shkaktuar shkuarjen e z. Svegjin dhe Hashim Rexhepit në Beograd.

Këtu jo për replikë, por jo vetëm për një ndoshta plotësim të asaj që dy deputetët e shtruan çështjen e një deklaratë që ka dalë nga kryetari i partisë sime lidhur me hektarët rreth Manastirit, edhe qebaptoreve, unë nuk e di që qebaptoret janë negative, por sigurisht në rast se Manastiri i Deçanit është Manastiri i Kosovës si po themi gjithë me plotë gojën se ajo është pasuri kombëtare e Kosovës, atëherë mendoj që duhet të gjithë të përkujdesemi që rrethina e atij manastiri ti përngjajë një objekt kulturor historik e jo ta

lëmë si po i lëmë hapësirat tjera nëpër këmbë dhe të bëhen kiç arkitektonik . Unë këtu jam plotësisht i mendimit me ju dhe pajtohem plotësisht se duhet që institucionet tona të jenë më funksionale në këtë aspekt, por pikërisht mos funksionimi i institucioneve tona ka kaluar në forume të tjera që janë pjesë institucionale. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit ma në fund që e përfunduat ju, fjalën e ka deputeti Ymer Halimi le të përgatitet Xhevat Bislimi.

DEPUTETI YMER HALIMI – I nderuari kryetarë Berisha, i nderuari kryeministri Qeku, dhe deputetë të nderuar.

Nga standardi për Kosovën do të veçojë standardin për sundimi e ligjit dhe trupave mbrojtës të Kosovës. Deri sa TMK-ja është në përmbushje gati të plotë të detyrimeve sundimi i ligjit vetëm sa ka filluar të qëndrojë në këmbë dhe mund të them pa bërë hap. Institucioni i përgjegjshëm TMK i përbërë nga njerëz të sakrificës dhe përkushtimit, vështërsitë i kalojë dhe po i kalojë me disiplinë e punë të përkushtuar. E pati dhe ka vizionin e qartë për cakun e vetë përfundimtarë dhe të gjitha arritjet i ka shtruar në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj. E natyrshme se njerëzit që u përballën me vdekje për liri nuk kanë kompleks inferioriteti, janë kulmorë në ndërgjegjeje dhe veprimin e kanë me vlera universale.

TMK-ja po ngritët profesionalisht dhe po ristrukturohet fuqishëm, ajo diti dhe din ti çmojë miqtë e vetë me punë dhe tani është institucioni më i respektuar te ndërkombëtarët por edhe te vendorët. Sa më shumë detyra që po i ngarkohen aq më e përgjegjshme po tregohet, e gatshme për të kap idetë e reja për transformime progresive, e shumë e përgjegjshme për atë që ka me përmbushë, standardi i TMK-së është standardi më i përmbushur, TMK-ja tregojë çartë se institucionet vendore që udhëhiqen nga profesionistët dhe postet që i konsiderojnë përgjegjësi e jo privilegje sukcesi assesi nuk mungon.

Deputetë të nderuar në fushën e drejtësisë veprimi më i arsyeshëm është që të fuqizohet sundimi i ligjit i cili është rregullator qendror i funksionimit të mirë të shtetit, prandaj në këtë seancë duhet ti sulmojmë anët e dobëta të tij.

Këshilli i Evropës dhe të gjitha shtetet e veta i ka kushtëzuar mbi parimin e besnikërisë ndaj sundimit të ligjit, te drejtën e njeriut dhe lirive themelore atëherë, edhe ne kemi përcaktim të ecim nëpër këtë binare. Edhe vetë liria përkufizohet si e drejtë për të bërë atë që e vë ligji atëherë në rrafshin e ligjit ku qëndrojmë ne, Përpjekja që në Kosovë sundimi i ligjit si standardë vendosen në rrafshin mes shumicës dhe pakicës është i gabuar, drejtësia është vlerë universale, mbi këtë edhe kjo te ne duhet mbështetur, e vërtetë është se Kosova ka asimetri funksionale për nga pesha e veprimit, por edhe gjendje të brishtë në rrafshin e drejtësisë. Kjo gjendje ka reflektuar edhe nga praktika ligjore dhe është përgjegjësi institucionale ndërkombëtare vendore. Ligji në Kosovë është si fëmija jashtë kurore, kur se mbështet as nëna as baba, as legjislativi, as ekzekutivi, as vendori, as ndërkombëtari i lënë në dorën e shumë policëve prokurorëve gjykatësve e pa arsyeshëm ndërkombëtare vendor, prandaj natyrshëm është vështërsia e zbatimit të tij.

Drejtësia në Kosovë është bërë në mënyrë selektive sipas ligjit , sepse ligjet po zbatohen në vazhdimësi sipas referencave të caktuara po të mos ishte selektiv nuk do të ishin të qëndrueshme institucionet paralele as burokracia e segmentit të caktuara të UNMIK-ut por edhe idiferenca e pushtetit vendor ndaj shumë fenomeneve negative tash e 7 vite.,

Të drejtat e njeriut gjykimet politike, keqpërdorimet e pozita udhëheqëse në fonde humanitare, prona shoqërorë dhe raste tjera në periudhën e pas luftës me të gjitha spekulohet dhe shumë pak nga kjo u vu në rrafshin e drejtësisë. Policët prokurorët gjykatësit vendor, e ndërkombëtar, mundem me thënë se kanë lëshime, ndërsa dëshira qytetare për përbërjen e shtetit të lirisë kultura, tradita, interesi, feja, morali i individit kanë dhënë efekte komplementare të rëndësishme për ruajtje e gjendjes aq sa mund të themi se është e mirë në rastin e sundimit të ligjit. Në këtë periudhë në fushën e drejtësisë është vepruar në mënyrë ataviste që vetëm pas një kohe analistët do të caktojnë saktë pse është bërë kështu, e pa dobishme për të thënë por ani, se shumë faj kemi ne vendorët pozitë dhe opozitë pse, sa dorëheqje që akt moral u dha në kundërshti të gjendjes së pa qëndrueshme në drejtësi apo në mos funksionimin normal të organeve të shtetit apo të ndonjë institucioni të mos harrojmë për gjendjen të cilën kemi kaluar këto vite nuk ishte aspak për lakmi, unë di vetëm katër raste dorëheqje, dy profesor universiteti që e kundërshtuan korrupsionin elektorale, të korruptuarit u graduan. Tash e sa vite në vështërsi janë ata që e mbështesin ligjin, se sa ata që e shkelin. Ju lutem mijë studentë në universitete dhe fakultete private janë jashtë ligjit, të licencuar dhe të pa licencuar, qindra ambulanca barnatore private janë jashtë ligjit, tash e sa vite Kosova është shëndruar në një qendër e vetme urbane duke u shkelur ligji, për shkelje të ligjit në licencime u fol dhe u përfol me saktësi si dhe falsifikim diplomash të universitetit, po doni të flasim edhe ndryshe por i sigurt jam se gabojnë, të gjitha këto kryhen para syve tanë, para syve të institucioneve, megjithatë shoqëria kosovare është e dëshmuar për shkallë përgjegjësie, prandaj vetëm duhet të funksionalizohet pjesa e ndërgjegjejes së sajë se sot ende

Deputetë të nderuar zbatimi i ligjit është masë emergjente në këtë çast e jo vetëm standardë, kjo duhet të shtrohet në të gjitha nivelet institucionale politike dhe intelektuale. Zbatimi i ligjit jep efekte polidimensionale sjell siguri për të gjithë kosovarët në çdo rrafsh të jetës, ritet besimi në institucionet shtetërore që është që është qenësore prandaj duhet ngritur grupet të caktuara pune për të bërë raporte dhe elaboratë duke analizuar vështërsit e zbatimit të ligjit në çdo pore të shtetit, këtë e kanë për obligim edhe komisionet përkatëse të Kuvendit.

Zbatimi ligjit nuk arrihet mbi bazën e dëshirave por mbi bazën e përcaktimit të detyrueshëm, sundimi i ligjit mbështet në punën e mirë të policëve, revizorëve,, prokurorëve gjykatësve, komisioneve të kuvendeve, të qytetarëve, por jo vetëm kjo e tërë shoqërisë veçmas institucionet duhet të jenë të përgjegjshme.

Që kjo tërësi të funksionojë mirë, duhet të ketë brenda njerëz përgjegjshëm ndaj ligjit pozitë dhe opozitë. Cila donga këto nuk funksion mirë, veprimi i ligjit zbehet, për rritjen e efikasitetit por edhe të cilësisë në fushën e drejtësisë është e domosdoshme të bëhet transformimi i sistemit të gjyqësisë, dhe transferimi i përgjegjësiave të vendore të përmirësohen kushtet e punës, të tjerët mund të na ndihmojnë por jo edhe të na ndërtojnë

në tërësi, këtu ka munguar kam ngutësia e ne vendorëve dhe nuk jemi treguar serioz në masën e duhur për të dëshmuar këtë aftësi. Ngecjen e rrafshit të sundimit të ligjit, nuk është shkak i mungesës së buxhetit por shkak i qasjes jo të drejtë ndaj segmentit të rëndësishëm shtetëror nga ata që është dashur të veprojnë, vendor, e ndërkombëtar, mund të shkurtoheshin shpenzimet e pa nevojshme të pakohshme në institucionet dhe të caktojë prioritetet politika e sundimit të ligjit që është qenësore.

Sa duket mungojë qasja e drejtë apo është qëllimshëm i gabuar, kjo dikujt i ka konvnuar, por popullit dhe institucioneve jo.

Deputetë të nderuar vetëm njerëzit që vetë janë të drejtë, mund të veprojnë drejtë, kot bibla e fjalë e mia në duart e klerikëve të pa ndërgjegjshëm semantike e kësaj shprehjeje dua ta kuptojnë të gjithë drejtë ama të gjithë, unë jam i sigurt që së shpejti, dy ministrinë e reja do të reagojnë dhe do të veprojnë drejtë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit prof. Halimi. Fjalën e ka Xhevat Bislimi le të përgatitet deputetja Safete haderxhonaj.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Z. kryetar, z. deputetë dhe zotërij qeveritarë. Fillimisht kërkoj që materialet që i kemi marrë dje t'u vijnë deputetëve të paktën një javë përpara. E kam fjalën për materialet që vijnë nga Qeveria, që deputetët të kenë mundësi t'i studiojnë dhe të kenë me përkushtim këto materiale.

Si dy pika ujë, që dikur hartonte Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste për Kosovën. Po fillojmë me funksionin demokratik të institucioneve. Tashmë jo vetëm për deputetët e këtij Kuvendi, por edhe për çdo qytetar, çdo analist dhe çdo organizëm ndërkombëtar, është bërë e qartë se demokracia për Qeverinë e Kosovës është fjalë e huaj, është nocion i huaj.

Si mund të pritët që të ketë demokraci në Qeverinë e Kosovës, në institucionet e saj, kur edhe kryeministri i ri nuk pranoi t'u nënshtrohet zgjedhjeve me votim të fshehtë. Si kusht i domosdoshëm për një funksionim demokratik normal të institucioneve për zgjedhjen e njerëzve në krye të tyre, kjo qeveri nuk ka transparencën që duhet ta kishte çdo qeveri. Asnjë qytetar i Kosovës dhe besoj se secili qytetar i saj e ka këtë të drejtë elementare që tash thuhet se është garantuar edhe me ligj, nuk e di sa Qeveria e Kosovës ka shpenzuar dhe shpenzon për blerje veturash, sa janë shpenzimet për derivate që harxhojnë këto vetura, udhë e pa udhë, sa janë shpenzimet që këta zyrtarë bëjnë për dreka dhe darka, për udhëtime "zyrtare", sa janë shpenzimet për telefonat fiks e për ata mobilë, është një kusht i domosdoshëm për funksionim demokratik të këtyre institucioneve, veçmas të Qeverisë së Kosovës. Bërja publike e shpenzimeve të fondeve publike të buxhetit të Kosovës, e parasë së taksapaguesve në fund të fundit.

Qytetari ynë dhe mbarë populli i Kosovës investuan shumë për dëbimin nga Kosova të pushtuesve dhe të një sistemi jodemokratik që kishin instaluar pushtuesit në Kosovë. Në vend të tyre sot është instaluar një regjim, një qeverisje që ngjan shumë me pashallarë dhe agallarë që ndiqen nga pas në sejmene të tyre me vetura dhe me lloj -lloj aparaturash sikur në kohët e vjetra në mesjetë. Në këtë plan të Qeverisë, njëri nga standardet

sundimi i ligjit. Si mund të sundojë dhe të zbaohet ligji nga një qeveri kaq e korrumpuar, kaq e deformuar, kaq anakronike në sjellje dhe në veprimet e saj. Në konceptet e saj dhe në gjithë angazhimin e vet ekzekutiv. Si mund të ketë sundim ligji në një vend kur në gjykata dhe në prokurori janë instaluar si gjykatës, prokurorë që i kanë shqiptuar qindra vjet burg, për të rinjtë shqiptarë në një të kaluar jo fortë të largët.

Si mund të ketë funksionim, zbatim e sundim të ligjit nga gjykata që në vend se të ndjekin korrupsionin, vjedhjet, shpërdorimet e ligjit, merren më shumë me ndjekjen e atyre djemve, e të atyre luftëtarëve që ia sollën lirinë këtij vendi?

Prandaj si përfundim mund të them se korrupsioni në këtë qeveri është ngritur në sistem dhe vetë krijim i Agjencisë Antikorrupsion dihet se është bërë dhe kur propozimi për këtë agjenci vjen nga Qeveria. d.m.th. Qeveria propozon të bëhet një agjenci që do ta luftonte korrupsionin ,por dihet si mund të luftohet korrupsioni nga një agjenci që drejtohet nga njerëz të Qeverisë apo të koalicionit qeverisës.

E njëjta gjë është edhe në çështjen e sigurisë në Kosov., UNMIK-u ka miratuar një rregullore të cilën fatkeqësisht e ka miratuar dhe po përpiqet ta zbatojë edhe Qeveria e Kosovës, me të cilën parashihet krijimi i disa këshillave lokale të sigurisë, krijimi i disa nënstacioneve policore, jo i disa, por në çdo fshat parashihet të krijohet nga një nënstacion policor.. E kam fjalën për fshatrat e minoritetit serb. Defakto dhe de juro është bërë enlavizimi i policisë dhe nga kjo polici nuk mund të presin siguri as qytetarët e shumicës, as qytetarët e pakicës. Duke copëtuar policinë e Kosovës dhe duke e bërë sigurinë e Kosovës xhepa,xhepa me siguri se nuk do të ketë siguri në Kosovë. Ky sistem, kjo rregullore, ky organizim i policisë së Kosovës m. shumë do të prodhojë pasiguri sesa siguri.

Një angazhim ose një fjalomani e pafund po bëhet në raporte, në plane të Qeverisë edhe për kthimin.. Unë nuk pashë askund që këtu bëhet fjalë për kthimin gati të 1 milion shqiptarëve që konsideroj se ishin njerëz të këtij vendi, ishin qytetarë të tij. Nuk pashë asnjë gjysmë fjale, por dhjetëra- mijëra njerëz që po braktisin Kosovën dhe të shtrënguar nga kjo qeverisje po detyrohen nëpër botë të deklarohen jo rrallëherë edhe hashkali edhe romë, edhe egjiptianë që fitojnë një status të azilantit. Dhe tash së fundi po detyrohen të deklarohen edhe homoseksualë, që ta marrin statusin e azilantit politik dhe kjo zotërinj tregojn sa poshtë ka rënë në kohën e qeverisjes suaj dinjiteti i qytetarit të Kosovës, dinjiteti i të riut të Kosovës, dinjiteti i vet Kosovës dhe këta njerëz nuk janë të pakët -nëse ju intereson -mund të merrni informata, janë me mijëra dhe me dhjetëra mijëra që po largohen përditë nga Kosova.

Qeveria duhet të ndërrojë qasje, bashkë me institucionet e tjera të Kosovës për çështjen e kthimit, nuk mund të ketë siguri, nuk mund të ketë kthim të sigurtë der sa nuk ka siguri për shumicën, nuk mund të ketë paqe sociale dhe stabilitet politik në këtë gjendje katastrofike ekonomike ,sociale, politike , në këtë shkallë të korrupsionit, në këtë shkallë të shkeljes së ligjit, prandaj, zotërinj qeveritarë ,vini gishtin kokës dhe kthehuni nga interesat e qytetarëve tuaj, kthehuni nga interesat e Kosovës, sepse me politikat tuaja ekonomike, me politikat tuaja sociale, me politikat tuaja të sigurisë, keni vënë në dyshim

,ky është konstatim edhe i disa organizmave ndërkombëtare, të ardhmen e Kosovës, shtetin e Kosovës dhe të mbarë rajonit, në një mënyrë.

Gjenerali që sot e kemi kryeministër mund të them se nuk do të jetë një kryeministër i suksesshëm përderisa braktisi TMK-në momentet më të vështira, në momentet- kur si thoshte edhe vetë= TMK-në do ta shndërroj në ushtri të Kosovës, një gjeneral që braktis ushtrinë e tij vështirë se mund të jetë i suksesshëm në drejtimin e Qeverisë, prandaj është fatkeqësi edhe për TMK-në edhe për të ardhmen e Kosovës.

Bëhet fjalë në raporte edhe në këtë plane të Qeverisë . aty- këtu edhe për prona. Prona është një çështje shumë e ngarkuar në Kosovë. Zotërinj të nderuar, mund ta përfundoj z. kryetar me keqardhjen time për këtë qeverisje që përveç territ, përveç ikjes, shpërnguljes, nuk i ka sjellë asnjë të mirë Kosovës. Mund të konstatoj,në fund ,se këtu kanë zënë shumë vend në këtë plan edhe çështja e termoelektranave e KEK-ut e Ministrisë së Energjetikës e tjera që qytetarët e Kosovës nuk i kanë borxh KEK-ut, por bëhet fjalë në këtë plan të Qeverisë për një fushatë mediale qeveritare për ta paguar qytetari energjinë elektrike. Energjia elektrike, zotërinj të nderuar është mall .Mallin që nuk e ke nuk mund ta paguash, qytetari i Kosovës nuk e ka këtë mall ,nuk e ka energjinë elektrike, prandaj nuk i ka borxh KEK_ut qytetari Kosovë,por Qeveria dhe KEK-u i kanë borxh dhe janë borxh deri në fyt te qytetari i Kosovës. Prandaj duhet t'ia paguajnë borxhin, ta furnizojnë me rregull me energji elektrike qytetarin, ekonominë, biznesin e vogël,që seriozisht është çrregulluar dhe rrezikohet të falimentojnë për çdo ditë shumë ekonomi të vogla nga mungesa e energjisë elektrike. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka Safete Hadergjonaj,le të përgatitet Mazllum Kumnova.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ- Ju faleminderit z. kryetar që më në fund ma dhatë fjalën, të nderuar deputetë.

Edhe pse janë ndërruar tre kryeministra, punën e Qeverisë në kontinuitet e kanë përcjell mangësi të shumta që janë bërë pengesë e arritjes së standardeve dhe për pasojë kemi gjendjen e rëndë ekonomike. Gjatë mandatit të koalicionit qeverisës ka ardhur duke u thelluar kriza ekonomike .Unë do të ndalesha në standardin e pestë.

Standardi i pestë, që ka të bëjë me ekonominë, gjithëmonë është vlerësuar nga ana e Qeverisë se po realizohet mirë,atëherë do të ishte mirë që koalicioni qeverisës të na shpjegojë pse ka zvogëlim të rritjes ekonomike gjatë vitit të kaluar, pse ka rritje të papunësisë gjatë këtij mandati qeverisës, pse ka rritje të keqpërdorimeve në doganë, pse ka politika fiskale të pafavorshme për biznesin ,me akcent të veçantë për agrobiznesin dhe ndërmarrjet prodhuese, pse ka rritje të evazionit fiskal dhe kontrabandë shumë të lartë, sidomos në pjesën Veriore të Kosovës, pse nuk ka veprime për ta sjellë ekonominë gri.në legalitet, pse ka deficit buxhetor, pse ka jotransparencë dhe papërgjegjësi në menaxhimin e financave publike, pse ka shkelje të ligjit .sidomos ligjeve kryesore për funksionimin e institucioneve demokratike, si Ligji për financat publike dhe

përgjegjësitë, Ligji për prokurimin publik, ligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe të Rregullores së shërbimit civil?

Pse ka afere korruptive në procesin e privatizimit dhe mungesë transparence, pse ka rritje të deficitit tregtar, pse nuk ka investime të huaja, pse ka prodhim të paktë vendor dhe çka është më esenciale, pse nuk ka monitorim dhe kontroll?

Të nderuar deputetë, përgjegjësit për këtë standard nuk po mërzhiten për hallet e qytetarit të thjeshtë, ata dhe as njerëzit përreth tyre nuk kanë dalë jashtë zyrave të tyre në komoditet për të parë ç'po ngjet përreth e më çfarë vështërsishë po përballet qytetari, ata kanë personalizuar buxhetin për interesat e tyre individuale dhe bëjnë planet për rrugët e pandershme për t'i bërë milionat e parë.

Në standardin e pestë kërkohet që procesi buxhetor të funksionojë dhe t'i plotësojë të gjitha kërkesat ligjore. Nuk mund të plotësohet ky standard kur bëhet shkelje e vazhdueshme e Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi, ku bëhet transfer i paligjshëm i një milion eurove dhe nuk pason përgjegjësia, por ka jotransparencë buxhetore, kur ka papërgjegjësi për mjetet e grumbulluara nga qytetarët, që reflekton me keqpërdorime të shumta për të mos i përmend të gjitha me radhë dhe nuk vepron institucioni i përgjegjësishë. Keqpërdorimet e shumta të buxhetit e detyruan Fondin Monetar Ndërkombëtar të tërheq vëmendjen Qeverisë që t'u japë fund shpenzimeve të pakontrolluara dhe të orientohet në investime në arsim, në shëndetësi, dhe në infrastrukturë, që për fat të keq as me buxhetin e këtij viti nuk mund të shpresohet për më mirë. Për t'ju dhënë fund këtyre keqpërdorimeve ne po bëjmë analizën e raportit 6- mujor të buxhetit, kërkuam nga ky Parlament që të formohej një komision kontrolli dhe ndoshta po të kishim formuar komisionin e kontrollit nga ky Parlament, atëherë nuk do t'i kishim të gjitha këto keqpërdorime dhe as reagime të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Nuk mund të plotësohet ky standard kur asnjëra nga organizatat buxhetore nuk kanë shpenzuar mjetet sipas planit të shpenzimeve buxhetore e si pasojë e një planifikimi jo të mirë të buxhetit ku është bërë ndarja e mjeteve pa kritere dhe pa projekte konkrete. Sipas standardit 5. Mjetet e suficitit buxhetor është dashur të koncentrohen në investime e jo të orientohen në mbulimin e deficitit buxhetor e që ka ardhur si pasojë e keqmenaxhimit të financave. Standard nuk është buxheti sa për të mbijetuar që vazhdimisht rrezikon të futet në krizë, por buxhet të jetë një bazë serioze për t'i realizuar prioritetet e programit të Qeverisë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Kjo Qeveri që ka instaluar korrupsionin në institucionet më të larta nuk e ka të qartë sa i kushton Kosovës shfrytëzimi joefektiv dhe joeficient i buxhetit.

Administrata tatimore profesionale dhe pa përzjerje politike është kërkesë e standardeve, nuk mund të implementohet ky standard kur në administratën tatimore në pozitë udhëheqëse vinë njerëzit sipas vijës politike pa kurrfarë profesionalizmi dhe kur në bordin e pavarur të ankesave janë zgjedhur njerëz politik të koalicionit qeverisës.

Nuk është standard, që në ndërmarrjet publike të ketë jotransparencë dhe për shkak të keqmenaxhimit ,të ketë keqpërdorim dhe korrupsion, qytetari i Kosovës të përballet në mungesë të ujit, të pastërtisë dhe meprobleme të tjera në jetën e përditshme.

Papunësia e madhe, korrupsioni në rritje, kriminaliteti, pesimizmi i lartë i qytetarëve, mungesa e investimeve të huaja dhe rënia e besimit në institucione ,kanë çuar deri te zhgënjimi i popullatës dhe rritja e dëshirës së qytetarëve për të emigruar jashtë vendit për të mbijetuar që shpjegim më të mirë i bëri kolegu parafolës.

Nuk mund të tolerohet që për shkak të korrupsionit që Qeveria e koalicionit e instaloi në institucione e që po kryen bazën e burimeve financiare të thellohet varfëria,që pasojë ka edhe në procesin e së ardhmes së Kosovës.

Demokracia kushton, të nderuar deputetë, atëherë nëse duam pushtet ku ka demokraci koalicioni qeverisës duhet të tërhiqet, sepse është bërë pengesë e ecjes përpara. Tërheqjet janë veprime të botës demokratike, këta i bëjnë ndcrë vetes, institucionit dhe atyre që me vota i kanë sjellë aty ku janë për të shërbyer pikërisht atyre që i kanë sjellë me votë. Faleminderit!

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Mazllum Kumnova, le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA - Të nderuar z. kryetar, z. kryeministër dhe ministra, procesi i ndryshimeve në Kosovë për një vetëqeverisje, por nën administrimin e UNMIK-ut që pas luftës e deri më sot në shumë fusha ka dështuar jo për fajin tonë, por të mungesës të një strategjie të Bashkësisë Evropiane dhe të OKB-së dhe dështimi në inkurajimin dhe ndërtimin e një qeverisje funksionale, sidomos menaxhmenti indiferent dhe mospërfillës ekonomik. Këto mangësi, por edhe dështime për mendimin tim janë bartur në standardet për realizimin e të cilave përgjegjësia u bie institucioneve tona. Ka shembuj që argumentojnë këtë të vërtetë,që mohohet nga administrata e UNMIK-ut.

Askush nuk e ka menduar që pas 7 vjetësh duke bërë një bilanc, siç po tentojmë sot ta bëjmë, por treguesit dëshmojnë se Kosova jeton në një varfëri me një papunësi të shkallëzuar, me një prodhim të përgjithshëm kombëtar me të ultin në rajon, me një eksport vetëm 4% të importit etj. Një listë e tërë e dështimit dhe të gjitha këto kompetenca të zhvillimit ekonomik i kanë menaxhuar UNMIK-u.Ky është fakt. Në anën tjetër së pari vendorët pa një kompetencë të tillë kanë zhvilluar një investim, qoftë dhe për ekonomi të vogla ,duke bërë përpjekje të mbulojnë zvogëlimin e asistencës nga bashkësia ndërkombëtare, duke shënuar përparim në import në politika buxhetore e të tjera.

Së dyti nga institucionet vendore janë hartuar dhe miratuar një infrastrukturë ligjor që siguron një ekonomi të tregut të lirë dhe qëndrueshëm, duke siguruar mbrojtjen ndaj çdo vendimi diskriminues dhe kjo tregon një gatishmëri dhe efikasitet, por edhe përgjegjësi.

Politika ekonomike e planifikimit dhe zbatimi i iniciativave të veprimit, jemi të vetëdijshëm se kanë qenë të kufizuara, sepse nuk mund të mbyllet me sukses një proces i tillë, kur nuk stimulohet nga politikat e bashkësisë evropiane një treg i lirë i prodhimeve tona, si ato bujqësore, ashtu edhe të tjera. Qeveria mund të ketë informacione sa është mbështet ky inkurajim për pjesëmarrjen në tregun e lirë të Kosovës nga Bashkësia Evropiane, sipas disa vlerësimeve jo nga institucionet tona, është bazë me zero. Pra, ne i kemi hapur dyert për një treg të lirë, të tjerët na kanë mbyllur. Sa marrëveshje reciproke për tregti të lirë janë nënshkruar deri më tani? Vetëm dy: mes Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe një tjetër për mbrojtjen e investimeve reciproke me Turqinë.

Mund ta di shumë më mirë dhe ministri Dugolli, por e di se me Bosnjën ka zgjatur së paku një vit dhe ende nuk është nënshkruar. A keni marrë ndonjë herë ndonjë donacion për bujqësi për ngritjen e infrastrukturës dhe për përvojën për t'i nxjerrë prodhimet tona jashtë Kosovës. Sa e di unë kurrë. Sa është stimuluar me donacione zhvillimi rural, duhet ta di një shumë më mirë zëvendësministri Hajdaraj.

Mungesa e inkurajimeve të tilla ka shkaktuar zhvendosje të popullatës drejt qendrave urbane, duke thelluar probleme sociale, politike, arsimore, shëndetësore etj. Mungesa e infrastrukturës në pjesët rurale, mundësitë e zhvillimit të bujqësisë të blegtorisë pse jo edhe të turizmit.

Përse po veprohet kështu nga Bashkësia Ndërkombëtare. Kjo nënkupton se ajo nuk na beson në përgjithësinë tonë aq sa na tregon dhe jo më shumë se sa po pretendohet nga disa diskutues. Pra, ne akuzuesi nga Bashkësia Ndërkombëtare se nuk kemi krijuar ende midis të favorshëm për lëvizje të lirë, nuk mund të krijohet një mjedis i tillë dhe të inkurajohet një lëvizje e lirë kur Kosovën politika BE e ka izoluar, nuk mund të jesh i lirë vetëm në shtëpinë tënde, ndërsa lagjja të ka izoluar, ky është izolim.

Sa ka kontribuar Bashkësia Ndërkombëtare me politikën e vizave në këtë drejtim edhe sot veprohet me një politikë diskriminuese. Kjo është e vërtetë dhe nuk mund të mohohet. Tjetër është ajo sa është mbështetur reforma e arsimit me donacione në Kosovë. Këtë e di ministri i Arsimit Veliu. Një formë e mbështetjes së reformës janë edhe studimet jashtë Kosovës, sa është kjo ndihmë e Bashkësisë Ndërkombëtare? Është aq e ulët saqë më tepër ka arsytim bamirësie sesa inkurajim për një proces të ndryshimeve në arsim, për një student tonë dhe kur siguron fonde private për të studiuar jashtë, problem bëhet viza. Këtë hall e kanë edhe tregtarët.

Investimi në dije është investim më i qëndrueshëm për të ardhmen në Kosovë dhe duhet t'i kthehemi kësaj. Këtu deklarativisht pajtohem me të huajt, por në praktikë veprohet ndryshe. Nëse e kemi seriozisht për disa standarde që nuk ka dilema që na duhen, atëherë duhet të formësohen, duke u mbështetur në realitetin tonë, duke i ndarë përgjegjësitë. Në fushën e të drejtave pronësore unë nuk e di se ka qenë çështje e kompetencave të vendorëve e drejta e pronës është çështje më delikate e shtetit dhe rajonit dhe atyre me tranzicion. Edhe sot e kanë në krye të listës së prioriteteve, si Polonia Çekia, Sllovakia; Hungaria etj. Te ne në Kosovë problemi i pronës është shkallëzuar me veprimet okupuese shtetërore të Serbisë -me shpronësim. Edhe këtë

problem - paluajtshmërinë private ,duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale menjëherë pas luftës UNMIK-u,i ka marrë në dorë.

Janë disa rregullore të viteve 1999 dhe 2000, që duke i bartur në posedim një farë Habitati ose HDP, deri para pak kohe ,kur u themelua Agjencia Kosovare e Pronës ,në bazë të Rregullores 2006] 10. Pra kjo që ka anashkaluar të gjitha institucionet vendore në Kosovë. Në bordin mbikëqyrës të kësaj agjencie për të cilën kryeministri ynë mund t'i dërgojë dy përfaqësues, por asnjëri nuk mund të jetë kryesues i këtij bordi. Edhe pse mund të shtohet numri i vendorëve për gjashtë muaj deri sa të jetë në fuqi kjo rregullore ,kryesuesi nuk ka shans të jetë vendor. Kështu shkruan në këtë rregullore shumë nënçmuese. Kjo agjenci ka hapur zyra nëpër Serbi, në Podgoricë dhe në Shkup.E kan një konkurs të hapur. Këto ditë, të gjithë jemi dëshmitarë të dëbimit me dhunë të shumë familjeve të pastreha në mes të dimrit.

Ministri i Drejtësisë mund të sigurojë informacion, sa ankesa të qytetarëve tanë të dëbuar me dhunë janë në gjykata dhe kontestet nuk janë zgjidhur ende. Edhe këtij Kuvendi i kanë arritur ankesa dhe peticione, sepse gjendja e së drejtës pronësore është marrë në vitet 1998 dhe 1999, kur u shënuar shkalla më e lartë e diskriminimit dhe dhunës ndaj pronave të shqiptarëve. Sot në Serbi funksionojnë ditën edhe natën zyrat e qendrës civile dhe të sigurimit serb sipas komunave të Kosovës në disa qytete të Serbisë dhe i kanë të gjitha vulat dhe bëhesh pronar jo vetëm i pasaportës, lejenjoftimit. por edhe i pronave të paluajtshme dhe jo pse edhe i pronës bujqësor dhe komerciale.

Për këtë Habitat, Drejtorat dhe tani agjenci këto dokumente janë valide, kështu janë zgjidhur disa mijëra konteste. Përkundër kësaj përgjegjësia e institucioneve tona në drejtim të respektimit të pronës duhet të kuptohet më thellë dhe si e tillë ajo nuk mund të afatizohet, respektimi i së drejtës mbi pronën do të jetë prioritet edhe për shumë vite për institucionet tona edhe pa UNMIK-un.

Ngritja e një infrastrukture të fuqishme ligjore, regjistrimi i pronave, krijimi i një baze të saktë të transaksioneve pronësore dhe të atyre poseduese, vetëdijësimi për këtë problem, janë sfidat që na presin edhe në të ardhmen, por thelbësore është se ky proces ka filluar.

Unë mendoj se kemi mjaft synime që dalin nga standardet dhe duhet të marrim një notë të kalueshme. Dihet se Qeveria e drejtuar nga Haradinaj ka instaluar një aktivitet të përshpejtuar.

Qeveria Kosumi ka marrë notë kaluese sipas raportit të Kai Aides .

Ndërsa Qeveria Çeku po tregon një qasje serioze pragmatike ndaj këtij objekti, është fakt dhe nuk mund të mohohet. Por çdo vlerësim tjetër eventualisht për mospërbushjen e standardeve dhe për kërcënimet që aktualisht dëgjohen nga një herë se Kosovës i duhet edhe pak kohë për përmbushjen e standardeve, që do të thotë kur përkthehet shqip të vazhdojë një situatë e tillë pa status politik përfundimtar, atëherë edhe ne duhet të jemi të sinqertë dhe korrektë ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare, ashtu siç kemi qenë gjithnjë e

t'u themi nëse ngjan kjo nuk mund të menaxhojmë kriza sociale dhe ato mund të nisnin të shkallëzohen e të dalin jashtë kontrollit. Më së paku do të jenë fajtorë ata që do të dalin në rrugë dhe do të jenë të mashtruar. Më e drejtë është të themi, do të jemi të mashtruar edhe ne si Kuvend edhe si Qeveri edhe si popull, por jam optimist se do të vlerësohem ndaj angazhimeve tona për standarde sepse këto janë edhe synime tona për sot edhe për nesër, thuhet në një libër të politikës se të gjitha qeveritë janë të këqija prandaj z. Çeku.....

KRYETARI – Konsideroj se keni përfunduar z. Mazllum. Fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – I nderuari z. kryetar i nderuari z. kryeministër, zonja dhe zotërinj.

Çështja e standardeve tanimë në Kosovë nuk është çështje që duhet të diskutohet për të marrë vendim politik, pra kundër standardeve, por është më shumë më duket se çështje e diskutimit se si duhet të implementohen më mirë, më drejtë sa më qartë.

Unë do të përqendrohem në diskutimin tim në qasjen për standardet që i kanë implementuesit e tyre dhe qasjet që vijnë nga qytetarët e Kosovës. Fillimisht mund të them se Qeveria aktuale e Kosovës, por edhe dy qeveritë paraprake, çështjen e standardeve e kanë definuar si çështje teknike, si propagandë politike personale ose partiake dhe shpeshherë edhe si obligim që duhet ta kryejmë para Bashkësisë Ndërkombëtare.

Ne besojmë se të gjithë e kemi të qartë dhe duhet ta qartësojmë, nuk është çështja e standardeve a e vemë një mbishkrim të rrugës drejt apo jo edhe pse aty mund të vihen apo të bëhen vërejtje të ndryshe edhe në kuptimin gjuhësor.

Çështja e standardeve është çështje e filozofisë politike dhe e vendimit politik, në këtë drejtim standardet e Kosovës besoj edhe në shumë vende të tjera e kam fjalën paskomuniste dhe pas luftës kanë pasur dhe kanë për qëllim stabilitetin e marrëdhënieve shoqërore dhe ofrimin e mundësive për mekanizma mbrojtës që njerëzit të jetojnë dhe ta planifikojnë të ardhmen e tyre në vendin ku jetojnë ,në rastin konkret në Kosovë. Një fenomen që vërehej vazhdimisht në plotësimin e standardeve është çështje e propagandimit të tyre . Shpeshherë nuk kemi mund ta kuptojmë sa vlen plotësimi i standardeve ,apo është propagandë mbi të cilën fiton një parti politike apo një individ i caktuar. Këtë mund ta hasim në rastin e vlerësimit apo mund ta quajmë në rastin e vetëvlerësimit të standardeve dhe sot kemi vlerësime për standardet para se ato të bëhen nga OKB-ja si organ zyrtar që duhet të bëjë vlerësimet apo qytetarët që në një mënyrë tentojnë të identifikohen në standardet. Unë mendoj që asnjëherë nga implementuesit e standardeve nuk është thënë e as sot nuk thuhet, fatkeqësisht, ku janë pengesat dhe cilat janë mundësitë apo pamundësitë në realizimin e standardeve. Jam i vetëdijshëm se ka pengesa. Në anën tjetër mungonin dhe pengonin idetë e reja në implementimin e standardeve. Kemi edhe standarde të shablonizuara që nga koha e z. Shtajner dhe tani e

tutje mbi bazën e tyre edhe në funksionojmë. Do të thotë jemi bërë një lloj teknokrati në implementimin e tyre teknik.

Element të tretë, që duket për standarde e kemi atë logjikën e flohtë dhe të nxehtë, mund ta quajmë kështu, në kohën kur bëhen vërejtje nga Bashkësia Ndërkombëtare se po plotësohen nëse jo standardet, në atëherë bëjmë presion mbi institucionet, mbi individët apo mekanizmat. Në anën tjetër nuk e kuptojmë se kjo nuk është vetëm obligim që e kërkon Bashkësia Ndërkombëtare që nuk është diçka vetëm nevojë për përcaktimin e statusit final të Kosovës, por janë dy gjëra kryesore për mendimin tim.

E para, implementimi i standardeve duhet ta ndryshojë kualitetin e jetës në Kosovë.

Dhe e dyta, duhet ta ndryshojë mentalitetin qeverisës në Kosovë.

Dhe në këtë drejtim këto standarde janë korniza të veprimit të institucioneve dhe të qytetarëve, natyrisht se gjatë implementimit të standardeve asnjëra nga këto qeveri nuk ka marrë parasysh gjendjen e përgjithshme, në veçanti as aspektet e tërësishme në ekonomi dhe në sfera të tjera, siç janë institucionale e drejtësisë apo edhe mosfunksioni i institucioneve. Është brengosës perceptimi i qytetarëve për standardet dhe mendoj se vjen si rezultat i disa rrethanave:

E para, perceptimi për standarde vjen si rezultat i bregrantit të tyre etnik, nëse i pyetni, shqiptarët kanë perceptim tjetër, minoriteti serb tjetër, ndoshta edhe të tjerët tjetër.

Dhe e dyta është si rezultat që ata që kanë afruar standarde në Kosovë, në radhë të parë, fatkeqësisht po e them, nuk kanë qenë në gjendje vet ta kuptojnë këtë filozofi politike e aq më pak ta bartin te të tjerët.

Unë mendoj se sot e kësaj dite qytetarët e Kosovës ende nuk i kanë prekur rezultatet e standardeve kuptimin, që ta kenë një jetë më të mirë, një rend më të madhe me siguri gjithësesi edhe më të mirë. Në këtë kuptim asnjëherë s'janë pytur qytetarët apo nuk është bërë vlerësim me qytetarët: a po plotësohen standardet a po jo- edhe krejtësisht i saj do të jetë: kush janë ata të cilët janë marrë me implementimin apo prezantimin e standardeve?

E para në kuptimin, në qoftë se filitet për standarde, funksionimi i institucioneve demokratike jo i mirë, ndoshta kanë qenë ata që e kanë penguar këtë funksionim. Nëse dikush është proklamuar me sundimin e ligjit, ndoshta kanë qenë vetë ata që janë identifikuar me shkeljen e ligjit, pra kjo është në vërejtja konkrete, që shpeshherë Qeveria nuk është marrë me akuza që janë bërë, qoftë nga opozita nga mediat, apo dikush tjetër, për korrupsion auditimin e ndryshëm, por më shumë është marrë: "kush po i thotë" dhe mendoj se kjo qasje duhet të ndryshojë, pra më shumë konstatohet a ka pasur a ka shkelje të tilla, por më pak nga kush vijmë ato shkelje.

Dhe e dyta, në rastin kur konstatohen shkelje të tilla nuk ka nevojë t'i jepen dikujt dy javë, tri e një muaj dhe nuk ka nevojë për koncesione politike. Mbi bazën e saj duhet të

kemi parasysh se identifikimi dhe luftimi duhet të jenë jo vetëm vullnet, por edhe veprim konkret politik dhe juridik, por nuk mund të anashkalohen implementuesit e standardeve edhe profili i tyre profesional.

E para, mund të themi se standardet kurrë nuk kanë qenë vetëm të një grupi njerëzish, nuk kanë janë diçka që i takojnë vetëm Qeverisë, por edhe dikujt tjetër.

E dyta, nëse marrim profilin e tyre profesional në kohën kur Kosova ndërtonte sistem ekonomik dhe juridik dhe në tërë Qeverinë e saj, me sa di unë, e kemi një jurist dhe një ekonomist. Me fjalë të tjera ne kemi nevojë për njerëz edhe jashtë Qeverisë edhe jashtë institucioneve që njerëzit të cilët mund të bëjnë implementimin e tyre. Unë dua të them se standardet nuk duhet të kuptohen si pjesë e betejës politike në Kosovë, nuk duhet të kuptohen si pjesë e përfitimeve politike në Kosovë, por si pjesë e filozofisë politike me të cilën ndryshon mentaliteti qeverisës në Kosovë dhe kualiteti i jetës në Kosovë. Faleminderit.

KRYETARI - Faleminderit z. Kuçi. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi një herit edhe ministër. Le të përgatitet deputetja Myrvete Dreshaj.

MINISTRI FATMIR REXHEPI - Faleminderit z. kryetar i Kuvendit, i nderuar kryeministër, të nderuar kolegë deputetë dhe ministra.

Ne sot kemi një debat lidhur me implementimin e standardeve që nuk janë shpikur para një muaji kur u rrua Qeveria në krye me Agim Çekun, por është një paketë e standardeve dhe detyrimeve që kanë institucionet e vendit për të përgatitur procesin e mëtutjeshëm të vendit tonë drejt perspektivës evropiane dhe integruese në pajtim me politikatat të cilat i ka zhvilluar populli ynë.

Prandaj, po them se me përkushtim të madh po punohet dhe se oferta dhe këto garaci do t'i ofrohen Bashkësisë ndërkombëtare dhe se i ka përgatitur Qeverisë e vendit pas statusit që duhet të përfundojë këtë vit.

Edhe në fjalimin e kryeministrit dëgjuam pikat kryesore dhe planin e veprimit që e kemi para veti si Qeveri, lidhur me këto detyrime që dalin për nesh. Prandaj e shoh të udhës të them se shumë po punohet edhe në ngritjen e vazhdueshme të progresit sa i përket sigurisë rendit publik për aq sa kemi kohë dhe kemi perspektivë dhe detyrim shumë të madh ndaj qytetarëve, sepse të arrihet një shkallë më e lartë e lëvizjes së lirë është një obligim shumë i madh për ne, për qarkullimin e lirë të gjithë qytetarëve brenda dhe jashtë vendit, pastaj mbrojtjen e pronës, pasurisë, mbrojtjen e investimeve bashkë me një aktivitet të ri, pra një komunikim të drejtpërdrejtë me të gjitha komunitetet, në mënyrë që të krijojmë besim të të gjithë qytetarët e Kosovës në institucionet e vendit për çështjen e sigurisë, çështjen e lëvizjes dhe të tjera. Më gjithë përpjekjet e mëdha që po i bëjmë institucione dhe si Parlamenti, dhe po kërkojnë të gjithë që pakica serbe të integrohet në të gjitha këto institucione, por ndihet bojkot i madh që është përgatitur i cili po vazhdon por mendojmë që shumë shpejtë edhe ata do të jenë pjesë e këtyre aktiviteteve.

Pra i shohim këto si detyra për bashkëpunim shumë më të mirë, do të thotë, të menaxhohet kjo sferë e sigurisë së përgjithshme dhe të ngriten struktura të sigurisë që duhet ta bëjmë në favor të këtyre çështjeve për të cilat dhe po punojmë.

Kemi po ashtu vlerësimet e komunitetit ndërkombëtar që ndjek punën e institucioneve tona lidhur me zhvillimet e me progresin, por kemi edhe mesazhet e tyre lidhur me vërejtjet se ku të ankohen disa me vërejtjet kryesore që na presin neve në këtë fazë që të punojmë më shumë si Qeveri. Nuk ka dilemë, se luftimi i krimit të organizuar dhe i korrupsionit është njëra ndër objektivat dhe detyrimet më strategjike që i duhen Qeverisë, në mënyrë që këto garancione të shkojnë rrugës së mbarë. Por a thua korrupsioni dhe krimi i organizuar mund të luftohen vetëm me zhurmë nëpër media apo qoftë nga kjo foltore derisa ne nuk jemi vërtet transparentë dhe nuk nxjerrim mësim nga e kaluara mirë mbi bazën e argumenteve, mbi bazën e një strategjie për të parë një të kaluar tonën, një qeverisje të kaluarës tonë të cilën duhet tash ta shpalosim para Parlamentit dhe ta themi të vërtetën se cilët ishin bartësit e tyre, qoftë si institucion, qoftë si individ në kuadër të institucionit dhe të tjera. Prandaj nuk duhet të na shërbejë këtu vetëm të ngremë aktakuza, sepse i bëjmë dëm krejtë perspektivës që punohet për imazhin e vendit tonë dhe për institucionet tona. Nuk ka dilemë se korrupsioni pra edhe për vendet në trasicion, por edhe për demokracitë e reja edhe për institucionet mund të cungojë sovranitetin e tyre, prandaj këtë objektiv e kemi. Këtu duhet të punojmë me përkushtim dhe aposlutisht nuk do të ketë as njëri as institucion që nuk do të përgjigjet para ligjit për këto veprime.

Unë do t'i them edhe dy tri çështje këtu që i dëgjova gjatë këtij debati. Njëra ndër to është edhe çështja që e ngrit lideri i Partisë Demokratike që e prita shumë mirë, po ju them të drejtën nga z. Hashim Thaçi, që tha kështu: Të zbulohen vrasjet dhe krimet që kanë ndodhur brenda këtyre 7 vjetve, kjo është një detyrë shumë e madhe, sepse i kemi obligim para qytetarëve. Ju garantoj se ajo që varet prej Ministrisë që unë e drejtoj, do të ndodhë, por dua t'i pyes të gjitha subjektet politike dhe liderin. 7 vjet kanë shkuar prapa nuk është njësoj ta investigosh një punë që ka ndodhur në vitin 2000 nga dita e sotme edhe një ngjarje që do të ndodhë nesër ose pasnesër. Prandaj, për të qenë parimor e korrekt edhe si subjekt politik edhe si institucion jo vetëm sot, por edhe nesër, është e udhës që në këtë Parlament, mund të jetë mendimi im i gabuar, pra të bëhet një bilanc, sepse 7 vjet këtë punë në kuadër të kornizave të veprimit e kanë udhëhequr departamentet e UNMIK-ut. Pra është mirë ta kemi në rend dite dhe të shohim prej viteve 1999, 2000, 2003 apo 2006, sepse i kemi pasur të gjitha qeveritë, me kryeministra që janë këtu të gjithë dhe të shohim se ky bilanc të nxirret për kohën e caktuar dhe të shihet sa është punuar, a janë ato dosje brenda atje, a është investigu, a janë argumentet edhe pse jo, kushdoqoftë edhe unë nëse jam brenda atyre nuk kam kurrfarë problemi përgjigjem para qytetarëve.

Prandaj në një të ardhme të afërt dua të përgatemi, pra edhe Parlamenti ose të kërkojmë edhe vetë nga institucionet e UNMIK-ut ta bëjmë një bilanc se çka ka ndodhur në të vërtetë në Kosovë në këta 7 vjet, pastaj ta kërkojmë një strategji sa më të shënoshë, pavarësisht kush e kryen atë punë. Pra e përkrah idenë që e ngriti Hashim Thaçi.

Është çështje tjetër ajo që unë si deputet edhe si ministër në këtë punë për vlerësimet edhe një pjesë të akuzave që u ngritën këtu unë distancohem plotësisht sa i përket asaj se

këtu është emblema e krimit dhe e korrupsionit është kjo Qeveri këtu, mendoj që ajo nuk qëndron prandaj mundet më tepër të shërbej si fushatë si denigrim si formë e cila ndoshta është edhe si parlamentare, nuk prishë punë as ajo, por distancohem si deputetë edhe pse nuk qëndron ajo qysh thatë ju.

Në anën tjetër Qeveria e koalicionit nuk është Qeveri që shërben para politikave, nuk ka lidhje me atë, është Qeveri e cila e ka bërë një program, është Qeveri e cila e ka besimin e rektoratit e ka do të thotë me udhëheqë vendin dhe është ka e udhëheqë marrë edhe mirë, tjetër gjë është që mund të ketë edhe në këtë kabinet sikur që ka edhe në kabinetet tjera njerëz që punojnë më pak e më shumë unë thashë që secili do t'i detyrohemi institucionit të cilin e kemi dhe të përgjigjemi për punën e mirë ose jo të mirë, por si Qeveri nuk e pranojë atë konstatim të cilën e kemi ngritë këtu.

Prandaj edhe çështja tjetër në foltore nëse e kemi ngritur sot temën e standardeve ,që është prioritet për vendin për t'i plotësuar këto detyrime para zgjidhjes së statusit, nuk është mirë që këtu në foltore tash t'i shtrojmë të gjitha çështjet, edhe sociale edhe pensionale dhe të tjerat, se vetëvetiu nëkupton që të gjithë qytetarët po e marrin vesh se ajo është më shumë fushatë sesa realitet. I vjen dita edhe asaj, po në Parlament i ngremë vetëm çështjen e pensioneve, bisedojmë dhe e shohim a ka apo nuk ka zgjidhje jo vetëm sa për sy e faqe. Ju faleminderit!

KRYETARI – Faleminderit z. Rexhepi. Fjalën e ka deputetja Myrvete Dreshaj, le të përgatitet Teuta Sahatçiu.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, kabinet qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Tash, kur po punohet në definimin e statusit final problemi i përmbushjes së standardeve në shkallë legislative- ekzekutive, ka marrë dimensione gjithëpërfshirëse . Këtë e ka vlerësuar disa herë në raportet e saj edhe bashkësia ndërkombëtare, e cila e ka shprehur e ka pasur konsideratat për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës ,të cilat gjatë këtyre viteve kanë treguar kapacitete substancioale për ta qeverisur vendin. E shikuar nga ky aspekt, sikur është thënë në disa raporte të komunikimit ndërkombëtar ne implementimin e standardeve janë shënuar rezultate të dukshme, objekti ynë veçues në këtë debat do të jetë standardi i parë funksionimi i institucioneve demokratike.

Fjalën e kemi për tre përbërësit kryesorë të standardit të parë, zgjedhjet, institucionet e përkohshme të Kosovës dhe mediat në shoqërinë civile.

Kosova i ka kaluar deri më tash 4 zgjedhje. Me gjithë se pa ndonjë përvojë të theksuar të demokracive perëndimore, ajo i kaloi zgjedhjet nacionale dhe komunale me sukses, madje duke qenë edhe vetë bartëse e një pjese të organizimit të tyre. Pjesëmarrja e madhe e qytetarëve sidomos në zgjedhjet e para, prania në zgjedhje në Parlament e të gjitha komunitetet si dhe qetësia e rendit që kanë mbretëruar në to, ka bërë që institucionet e dala nga ato zgjedhje të janë stabile dhe t'i kryejnë obligimet e tyre në të gjitha nivelet. Vlerë me vete në këtë kontekst dhe afirmim i standardeve është pjesëmarrja e

kushtëzuar e femrës në këto zgjedhje dhe i ashtuquajtur i diskriminim pozitiv i pakicave kombëtare, sidomos i pakicës serbe. Kemi shpresë së në të ardhmen do të kemi zgjedhje me lista të hapura , kjo do të thotë edhe shtrirje më e gjerë e demokracisë parlamentare.

Ndërtimi i kapaciteteve vetëqeverisëse në Kosovë ka shënuar ,gjithashtu ,disa nivele të kënaqshme. Institucionet e Kosovës janë ndërtuar sipas vendimeve dhe ligjeve të zbatueshme në institucione të instaluara ndërkombëtare. Sot në institucionet e Kosovës qytetarët e saj nga radhët e komuniteteve të ndryshme kryejnë një varg shërbimesh, një përbërës i rëndësishëm i këtyre shërbimeve tashmë është bërë edhe përdorimi i gjuhëve të pakicave nga institucionet lokale deri në ato qendrore, duke përfshirë këtu edhe angazhimin e personelit nga radhët e këtyre komuniteteve.

Po punohet sot me kujdes, gjithashtu, jo vetëm për diskutime dhe miratime të ligjeve me përparësi, por edhe për implementimin e tyre. Në këtë drejtim kujtoj mbetet të punohet me qytetarët për t'i bindur se implementimi i standardeve bëhet për të gjithë qytetarët e Kosovës, shumicën dhe pakicën, por ne ,ndërkaq, nuk mund ta fshehim faktin se pjesa më e madhe e kërkesave për plotësimin e standardeve kanë pikësynim avancimin, respektimin dhe garantimin e të drejtave të minoriteteve . Pra ,kjo po ndodh në një situatë të rëndë ,në papunësi e varfëri të shumicës së popullit të Kosovës. Edhe mediat edhe shoqëria civile, sigurisht përbëjnë një faktor të rëndësishëm në sistemin organizativ të institucioneve të Kosovës. Pas luftës ka qenë vështirë të mendohet se psikologjia e urrejtjes dhe e dhunës,që me dekada i mbolli shtypi i Beogradit, do të mund t'i tejkalojmë për pak vjet. Le të thuhet se,ndoshta, këtë e ndihmoi fuqishëm fakti se shtypi dhe përgjegjësish fjala shqipe, nuk ka trashëguar nga brenda ndonjë fjalë sado të vogël të urrejtjes ndaj fqinjëve dhe komuniteteve të tjera të brendshme.

Në Kosovë tashmë kemi një numër të madh institucionesh publike dhe private në fushën e informimit, të cilat ofrojnë informacion të bollshëm për të gjitha komunitetet dhe në gjuhën e tyre. Gjithashtu janë përgatitur dhe aprovuar një varg rregulloresh e ligjesh, të cilat funksionojnë me përgjegjësi.

Me të gjitha këto arritje të gjertashme mendojmë se Kosova ka përmbushur disa nga përbërësit më të ngutshëm të standardeve të vlerësuara me prioritet për qytetarët e këtij vendi. Kjo do të thotë se ka shënuar nivele të arsyeshme të komunikimit dhe të fjalës së lirë, se ka krijuar institucione me gjithë parametrat e mundshëm të demokracie që të zhvillohet në tranzicion dhe pavarësisht kushteve shpesh të favorshme të cilat i kemi trashëguar, këto institucione po funksionojnë brenda përgjegjësive që u dhanë me Kormizën Kushtetuese. Faleminderit.

Kryetari – Ju faleminderit. Pushim deri në orën 16.

KRYETARI – Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, kurse lë të përgatitet deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ - I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, i respektuar kryeministër Çeku, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë. Unë do të ndalem

në çështjen e lëvizjes së lirë, një prej standardeve që Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje të realizohet, sepse është njëra prej kushteve më fundamentale që e pret këtë Qeveri. Është përgjegjësi e Qeverisë dhe e të gjithë njerëzve të Kosovës të krijohen kushte dhe gjendje që të udhëtojnë, të punojnë dhe të lëvizin të sigurtë të gjithë qytetarët e Kosovës. Lëvizja e lirë është e drejtë fundamentale që duhet të gjithë ta përkrahim që të kemi qasje në institucionet e Kosovës, që të krijohen kushte që të gjitha grupet etnike të shikohen në baza përmbajtjesore e jo në baza etnike ose në diçka tjetër. Unë do të them se lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës, edhe pse mbi 90% është realizuar ky standard, duhet të punojmë edhe më tepër për arsye që të bindet faktori ndërkombëtar se Qeveria e Kosovës është duke bërë çmos për lëvizje të lirë për të gjithë qytetarët. Nëse kjo realizohet dhe se është duke u realizuar, unë shpresoj se edhe statusi i Kosovës do të jetë shumë më i shpejtë dhe ashtu siç tha edhe z. Çeku në fjalimin e tij pas zgjedhjes së kryeministrit, është një përgjegjësi e shumicës ndaj komuniteteve që do të realizohet. Mirëpo, këtë pjesë të përgjegjësisë e kanë edhe komunitetet minoritare, të cilat duhet t'i paraqesin kërkesat e veta, por reale për një integrim të qëndrueshëm dhe disa komunitete të mos e teprjnë me kërkesat e tyre të parrealizueshme, sepse çdo gjë duhet të rregullohet në bazë të standardeve, në bazë të lirive dhe të të drejtave që janë të garantuara me ligjet ndërkombëtare.

Në këtu në Kosovë kemi të bëjmë me një komunitet, komunitetin serb që deri vonë, ka pasur edhe mbrojtjen institucionale edhe mbrojtje shtetërore dhe prapë kërkon të ketë edhe një mbrojtje edhe më të madhe dhe të përfitojë diçka edhe në këtë situatë edhe komunitetet e tjera joserbe, të cilat gjatë regjimit serb kanë qenë të lëna pas dore. Prandaj kjo Qeveri duhet të ketë kujdes dhe në mënyrë institucionale t'i mbrojë edhe komunitetet e tjera dhe të bëjë shtytje pozitive me qëllim të integritetit të tyre të plotë në të gjitha sferat, në të gjitha institucionet.

Me lëvizjen e lirë kuptohet se Qeveria e Kosovës duhet të punojë edhe në lëvizjen e lirë të qytetarëve në Evropë, d.m.th. që një deputet të mos pret 2 ose 3 muaj para një zyre ndërkombëtare për një vizë, ndërsa jemi pjesëtarë dhe qytetarë të Evropës. Nëse gjeografikisht jemi në Evropë, atëherë duhet të lëvizim lirshëm në Evropë edhe ne si qytetarë të Evropës.

Në një pjesë tjetër do të ndalem në standardin e ekonomisë. Unë shpresoj se me zgjedhjen e statusit do ta kemi një zhvillim më të hovshëm ekonomik, sepse pa një zhvillim të hovshëm ekonomik, pa një infrastrukturë të mirëfilltë, pa investime të huaja, nuk do të kemi zgjidhje të problemeve të cilat janë grumbulluar në Kosovën e pasluftës, nuk mund të zgjidhet statusi i pensionistëve, statusi i arsimtarëve, statusi i invalidëve të luftës, pa një ekonomi të hapur, pa një ekonomi të tregut, as ekonomia nuk mund të rregullohet me fjalime boshë, nuk mund të rregullohet me fushata zgjedhore, por duhet ta kemi një strategji të zhvillimit ekonomik. Unë kam informacione se Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me profesionistët, është duke përgatitur një strategji të zhvillimit ekonomik. e cila do të na mundësonte integrim më të shpejtë në Evropë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatçiu, kurse le të përgatitet deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIU – Ju faleminderit i nderuari z. kryetar Kolë Berisha, për pak isha duke menduar që kjo kërkesa jonë për barazi gjinore të mos shndërrohet në një diskriminim gjinor. se herën e kaluar edhe z. Sanije iu mor fjala, tash edhe mua, por si duket jam gabim. I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, ministra dhe ju deputetë. Sot jemi duke diskutuar për standardet, një rëndësi e posaçme për Kosovën në këto ditë, sidomos këtë vit kur do të vendoset për çështje shumë të rëndësishme, për çështjen e statusit. Para se të hy në standarde kisha cekur në disa fjali shumë të shkurta një habi timen, në qoftë se flasim për standardin e parë, në qoftë se flasim për institucionet demokratike kam një habi ku për çdo seancë dëgjoj jo të njëjtat fjale po të njëjtat kuptime. Ka tendenca që kërkojnë zgjidhje për Mitrovicën, ata të cilët edhe në Parlament edhe në zgjedhjet lokale e kanë udhëhequr që sa vjet. Është tendenca që të flitet për këshillin konsultativ, i cili është jashtinstitucional, i cili ka të bëjë me individë. Këshilli për trashëgiminë kulturore nuk është i përbërë prej njerëzve të duhur, sepse aty do të duhej të ishin ekspertë etj. Në të vërtetë kjo po më habit, kjo po e tregon një mungesë të komunikimit, në qoftë se flasim për standardet, atëherë themi që është një mungesë e funksionimit të institucioneve demokratike. Ky këshill i komuniteteve, ky grup i cili merret me trashëgimi kulturore, ky grup i cili vendos për Mitrovicën, është çdo gjë është në Grupin Negociator, në grupin politik, ekspertët të cilët i kanë zgjedhur partitë. Këto parti që po flasin këtu, nuk janë në rregull, atëherë mendoj se këtu është një mungesë e komunikimit, Do të duhej para se të dalin dhe t'i kërkojnë gjërat të komunikojnë brenda partive të veta, brenda grupeve të tyre dhe të shohim se kush i ka zgjedhur ata ekspertë. Ekspertët janë zgjedhur prej partive tuaja, prej partive tona, prandaj të mos habitemi se nuk kanë pikur prej qiellit këta ekspertë, këta njerëz, sikur po flasim për sende të cilat na i ka vendosur dikush prej Japonisë, Australisë. Këta ne vetë i kemi zgjedhur. Po vazhdoj me standarde.

Nga diskutimet e shumta, nga deputetët e të gjitha grupeve, kemi parë një qasje të ndryshme për standardet- disa më pozitive e pak më tepër negative, varësisht nga këndvështrimi i secilit deputet. Nga këndvështrimi si statistika, si numra, si lista mund të thuhet se lista është e gjatë, nga këndi i qytetarit po ashtu është lista e gjatë, por është lista e gjatë e standardeve të përditshme të cilat i ndien në lëkurën e vet qytetari. Kryeministri i cili ka ardhur nga udhëheqja e TMK-së që paraqet standardin e tetë, i cili është nga standardet që ka pasur më së shumti të arritura, po përballet me sfidën e standardeve të tjera të cilat kanë lista të gjata të përmendura më parë dhe të cilat nuk janë shumë të përmendura për të mirë. Shpresojmë se me entuziazëm dhe me punën e tij kryeministri do të ndikojë që edhe standardet e tjera të fillojnë dhe të jenë të suksesshme.

Kritika të shumta nga opozita, të vërtetuara tash së fundi edhe me raportet e auditorit, e tregojnë një qasje jo të sinqertë të Qeverisë në përmbushjen e këtyre standardeve. Mjafton të shkojmë në Batllavë gjatë vikendit ose në Durrës apo në Ulqin, gjatë verës dhe t'i shohim institucionet tona demokratike si funksionojnë në Batllavë, në Durrës dhe në Ulqin. Kur flitet për sundimin e ligjit, për standardin nr. 2, jemi dëshmitarë që ekziston një numër shumë i madh i lëndëve të pazgjidhura dhe zhagjitja e lëndëve të panisura të cilat ndikojnë negativisht në çdo segment të jetës, në çdo fushë, në çdo porë të jetës të secilit qytetar. Gjithashtu mosimplementimi i ligjeve, sidomos i atyre ligjeve që

ekzistojnë sot dhe interpretimi arbitrar i këtyre ligjeve në raste të shumta prej institucioneve tona e edhe më tepër ndikojnë dhe e rëndojnë situatën e përgjithshme në shoqërinë kosovare. Do të ndalesha te standardi nr. 5 te ekonomia, standardi, i cili i përmbush të gjitha standardet, po që se ekonomia është e fortë dhe ka zhvillim ,atëherë do ta kemi buxhetin ,i cili do të jetë i mjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha standardeve, për arsim, për shëndetësi etj. E dimë që ekonomia është në stagnim edhe pas 7 vjetve vazhdon trendi fatkeq negativ i ekonomisë dhe nuk dihet ende se edhe sa do të zgjatë kjo teposhtëz dhe sa kohë duhet të presim deri sa të mbërrijmë në fund, ku do t'ia nisim me një rritje të ekonomisë të zhvillimit tonë. Gjithashtu evazioni fiskal ,i cili e gërryen, së bashku me korrupsionin, mirëqenien e biznesit dhe faktikisht e mbush, e rrit ekonominë, ndikon shumë negativisht në ekzistimin dhe në rritjen e ekonomisë dhe të bizneseve. Në qoftë se mund të thuhet këtu tek ekonomia, mendoj se po të dëshirojmë ta kemi një ekonomi pak më të avancuar dhe ta ndalojmë zbritjen, tendencën zbritëse të ekonomisë sonë, do të duhej t'u kushtonim pak më tepër rëndësi edhe gropave edhe rrugëve, sepse nuk mund të paramendohet një biznes, një ekonomi që qarkullon nëpër këto rrugë, ku prej Gjakovës deri në Prishtinë rruga zgjat së paku 2 orë.

Të flasim edhe për energjinë,në qoftë se dëshirojmë që standardi nr. 5 ekonomia të ketë sukses do të duhej që pas 7 vjetve, me investime të shumta, me mund të madh, të kemi së paku energji të mjaftueshme , e cila do të duhej të stimulojë dhe të ndikojë që ekonomia dhe bizneset tona të fillojnë të gjallërojnë dhe të nisin ta gjenerojnë buxhetin, punësimin etj. Prandaj këto janë sfidat e standardeve, sfidat me të cilat kjo shoqëri jona është duke u përballur dhe do të përballlet edhe në të ardhmen, fatkeqësisht. Kjo është sfidë edhe më e madhe për kryeministrin Çeku dhe për Qeverinë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi, kurse le të përgatitet deputeti Hajredin Hyseni.

Më fal Jakup, urdhëroni z. Shabani.

DEPUTETI SHABAN HALIMI – Unë pak më parë e pata një propozim, ta hedhim në votim për ndërprerjen e diskutimeve të mëtejme se siç duket kjo temë tashme është shterrur, sepse kemi përsëritje të diskutimeve, kjo është një e drejtë e imja që të kërkoj dhe të shpreh mendim të shokëve dhe kolegëve të mi që më përkrahin në këtë drejtim,sepse në të gjitha referatat po përsëriten shumë çështje. Të lëmë hapësirë që së paku edhe nesër të diskutojmë për pikën e dytë të rendit të ditës që e kemi-privatizimin.

KRYETARI – Ju faleminderit, unë mendoj se mund ta shkurtojmë, por jo ta ndërpresim diskutimin, ta zvogëlojmë minutazhën nëse ka nevojë, por jo ta ndërpresim diskutimin, sepse atëherë na mbetet pa e kryer këtë pikë sot, të vazhdojë z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar deputetë. Për mua një gjë është e saktë se Kosova dhe qytetarët e saj i kanë përmbushur standardet që Kosova të jetë shtet sovran dhe i pavarur. Unë nuk dola të flas për standardet që para sa vjetëve na i ka ofruar z. Shtajner se ato standarde janë vendosur të vëhen pengesa për zhvillimin ekonomik, për ndërtimin e sistemit të drejtësisë, për sigurinë dhe për lëvizjen e

lirë të qytetarëve të Kosovës. Unë dola të flas për standardet që duhet t'i përmbushin institucionet e Kosovës, për qytetarët e Kosovës dhe ne mendojmë dhe në këtë rast mendoj, kryesisht, duhet të flasim se çka bëri Qeveria si ekzekutiv i Kosovës, çka Parlamenti dhe institucionet e tjera kanë bërë që të përmbushen standardet për një jetë më të mirë dhe më të dinjitetshme për qytetarët e Kosovës. Bindja ime është dhe realiteti flet se institucionet e Kosovës nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre që kanë qenë në kompetencat e tyre për t'i përmbushur standardet për qytetarët e Kosovës. Ne të gjithë, që jemi në këtë sallë jemi si rezultat i një lufte çlirimtare që është zhvilluar në Kosovë dhe kategoritë që kanë pësuar më së shumti nga kjo luftë që 7 vjet ,pothuajse tepër pak ndihma të domosdoshme u kemi ofruar dhe për këtë, natyrisht mban përgjegjësi edhe Parlamenti, por në mënyrë të veçantë ekzekutivi i Kosovës. Këtu ne dëgjuam dhe sikur ne tash duhet të krijojmë një imazh për Kosovën, se opozita që i jep formë dhe jetë demokracisë, po e prishka imazhin e institucioneve të Kosovës. Unë do të kisha shtruar një pyetje . Kush po e prish imazhin e Kosovës? Ata që po kërkojnë të përmbushen obligimet e institucioneve të Kosovës për qytetarët e saj, apo ata që i keqpërdorin ,i keqmenagjojnë, i keqshfrytëzojnë fondet dhe mjetet e qytetarëve të Kosovës. Unë mendoj dhe ne në Partinë Demokratike mendojmë se imazhin Kosovës ia prishin ata që qeverisin keq, janë ata që jo vetëm janë të korruptuar, por janë edhe duke e plaçkitur buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Unë po sjell disa fakte. Të nderuar deputetë, asnjë ministër në Qeverinë e Kosovës në buxhetin e tij nuk ka mjete për të blerë veturë mbi 130 milion euro, se aty dikund është krejt buxheti i ministrit me stafin e vet që duhet të qeverisë,pra nga i marrin ministrat mjetet për të blerë automjete të blinduara, përveçse nëse e vjedhin buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Edhe Parlamenti ,si institucion legjislativ, ka blerë veturë më se 236.000 euro. Unë jam i bindur që Kryesia e Parlamentit nuk ka pasur në buxhetin e saj mjete kapitale ta blejë veturë 236.000 euro, përveçse të vidhet buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Me asnjë ligj Kosovës nuk i lejohet që as kryetari i Parlamentit as qeveritarët e tjerë të harxhojnë mjete marramendëse për gardërobat e tyre, për ato ata marrin të ardhur. Këto të gjitha bëjnë pjesë në standarde. Të nderuar deputetë vetëm po të hyhet në pjesën ku ish kryetari i Parlamentit e ka meremetuar një pjesë të Parlamentit, është sikur të hysh në një botë tjetër, një botë përrallore nga pjesa tjetër që e shfrytëzojnë deputetët e Parlamentit të Kosovës. Edhe kjo është një standard, ndoshta një standard i përmbushur për një individ në dëm të gjithë Parlamentit.

Ne dëgjojmë nga një pjesë e deputetëve të koalicionit fjalët më të mira për përmbushjen e standardeve nga ekzekutivi.Ju them sinqerisht do të dëshiroja të ishte ashtu, se edhe unë dhe qytetarët e Kosovës kemi nevojë për një qeverisje të përgjegjshme. Nëse i kemi përmbushur mandatet si institucione dhe drejtues të institucioneve, të nderuar deputetë, pse kohë më parë ky deputet e zëvendësoi kryeparlamentarin, pse ky Parlament votoi zëvendësimin e kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit edhe pse këto fjalë" zëvendësim"nuk janë askund në Parlament. Nëse ata si drejtues të institucioneve i kanë përmbushur standardet që u thanë nga shumë deputetë këtu, pse janë ndërruar , pse nuk u lanë ta vazhdojnë dhe ta përshpejtojnë përmbushjen e standardeve. Unë si deputet, por edhe si qytetar ,të isha do ta kisha dhe e kamë një shqetësim Shqetësimi im është se jo vetëm qytetarët e Kosovës, po para së gjithash ata që duhet ta mbrojnë qytetarin e

Kosovës, janë tepër të familjarizuar me krimin, me korrupsionin, me papërgjegjësinë e njerëzve që drejtojnë institucionet e Kosovës.

Të nderuar deputetë a mund t'ia lejojmë vetit këtë komoditet që ne të familjarizohemi me gjithë këto shkelje, grabitje, vjedhje që u bëhen mjeteve publike, mjeteve të qytetarëve të Kosovës. Mendoj se do të ishte në nderin e Parlamentit, në nderin e deputetëve „sidomos të opozitës“, t'u thonë një herë guximshëm jo keqkeqverisjes, keqmenaxhimit dhe vjedhjeve që po i bëhet buxhetit të konsoliduar të Kosovës, sepse në fund të fundit ky buxhet është edhe juaji, më shumë sesa që është i qytetarëve, se ju e keni përgjegjësinë tuaj dhe përgjegjësinë që e keni marrë nga qytetarët, prandaj mendoj se ka ardhur koha që korrupsioni, papërgjegjësia, të mos luftohet me fjalë.

Të nderuar deputetë standard është edhe mosdiferencimi në shërbime publike. Qe një vit e sa në administratën publike të Kosovës ka ndodhur largime, përjashtime, diferencime dhe mos mendoni se do ta mashtrojmë dikë se ne që jemi të gatshëm t'i diferencojmë njerëzit që na sollën në këtë Parlament, t'i largojmë nga puna edhe njerëzit e plagosur, t'i largojmë nga puna njerëzit që kanë punuar me ne për nja 20 apo 30 vjet e që kanë udhëhequr mirë edhe një këshill financiar qendror, që e kemi pasur në vitet e 90-dhjeta, janë diferencuar nga Këshilli i Lartë për Emërime, pse nuk i ka zbatuar urdhrat e kryeministrit apo të zëvendëskryeministrit. Të nderuar deputetë, shumica e zyrtarëve të lartë në Qeverinë e Kosovës janë ushtrues detyre dhe të gjithë këta zyrtarë të lartë kanë qenë të pranuar me të gjitha procedurat dhe me ligje në fuqi, këta njerëz janë si ushtrues detyre jo për t'i mbrojtur ligjin dhe ligjshmërinë, por për të bërë veprime të paligjshme dhe për t'i mbrojtur veprimet e paligjshme të ministrave të Kabinetit qeveritar. Unë kisha dëshiruar dhe kam kërkuar dhe po kërkoj edhe sot nga kryeministri që t'i shikojë kërkesat edhe të shefit të UNMIK-ut, të cilat janë bërë për t'i kthyer në punë punëtorët që padrejtësisht janë larguar nga kabineti që e udhëheq kryeministri i ri. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Krasniqi, fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, kurse le të përgatitet deputeti Xhelal Canziba.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Z. kryetar, kryeministër, ministra të pranishëm, zotërinj deputetë. Standardet në Kosovë kanë një kuptim krejtësisht të ndryshëm nga kuptimi i vërtetë i standardeve që kanë në vendet e tjera si një faktor i zhvillimit dhe i progresit shoqëror. Në Kosovë standardet lidhen me përmbushjen e kërkesave e të superkërkesave ekskluzive të komunitetit serb, duke përjashtuar shpesh komunitetet e tjera të cilat nuk kanë kërkesa të kësaj natyre. Në të kuptuarit e tillë të standardeve ka kontribuar edhe Bashkësia Ndërkombëtare, e cila ka bërë një trysni në institucione për të keqkuptuar misionin e vërtetë që do të duhej t'i përmbushnin standardet. Ndërsa Qeveria e Kosovës suksesin apo mosesuksesin përpiqet ta paraqes pikërisht me realizimin e këtyre kërkesave të pakicës që kanë qenë shtytje kryesore e faktorit ndërkombëtar. Për funksionimin e institucioneve demokratike dhe për ndërtimin e një shteti demokratik, të cilin e aspiron Kosova „nevojitet depolitizimi i këtyre institucioneve të cilat do të garantonin një ndërtim të qëndrueshëm të këtyre institucioneve, por në Kosovë ne jemi dëshmitarë në të kundërtën e kësaj, sepse sot për të punuar në institucione kriter themelor është përcaktimi politik dhe aderimi partiak që të mund të punosh në administratën

publike. Të nderuar deputetë një gjë që sot është bërë dukuri është vazhdimi i kontratave të punëtorëve, ku oferta për t'u anëtarësuar në parti është ofertë për t'u vazhduar vendi i punës, një praktikë që ta rikujton të kaluarën e një kohe të turpshme, se për të qenë në funksione qoftë edhe arsimore duhej të ishe anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Në raportin e Qeverisë, ku bëhet fjalë për funksionimin demokratik të institucioneve, pos fjalëve të përgjithshme, retorike që bazuar në realitetin ngërthejnë në vete një demagogji, nuk gjejmë asgjë që do të na bindte se është duke u punuar dhe bazuar në praktikën e veprimit në institucione, institucionet çdo ditë po ngulfaten nga familjarizmi, punësimi pa konkurs dhe pa kriter të stafit civil, i cili po bëhet çdo ditë shërbyes i politikës ditore. Duke e politizuar jetën shoqërore dhe duke degjeneruar atë në një praktikë fisnore. Për ta ilustruar këtë do të merrja një fakt të praktikës që veprohet në kryeministri, si tenderi për blerjen e makinave, kontratat e dyshimta në firmën zero pozitiv, për të cilën do të duhej të bëhej një auditim, apo rasti ku 22 punëtorë në kryeministri marrin shtesa nga 108 euro dhe këtë e lejon jashtë çdo rregulli Ministria e Financave, me çka u vonon nga dy muaj pagat punëtorëve dhe askush nuk u jep asnjë sqarim, sepse punëtorët nuk kanë të drejtë të kërkojnë llogari se mund t'u kushtojë me vend të punës. Se sa është në praktik funksionimi demokratik i institucioneve, po marr vetëm edhe një shembull të Ministres së Shërbimeve Publike e cila jo që e zbaton ligjin, por e bën shkeljen, ku në vend të sekretarit permanent nënshkruan vetë dhe luan të gjitha rolet. Ky është funksionimi demokratik i institucioneve? Besoj se kjo nuk do koment.

Kryeministri përmendi si standard kthimin e pronave dhe në këtë aspekt mendoj se është bërë një punë në kthimin e pronave të minoritetit serb. Unë pyes se çka po bëhet me kthimin e pronave të shqiptarëve në Mitrovicë, pse nuk e thotë këtë kryeministri. Habitati, i cili merret me këtë çështje urdhëron shqiptarët që t'i lëshojnë pronat e serbëve dhe t'i lirojnë ato, por këtë nuk e bën për pronat e shqiptarëve të uzurpuar nga ana e serbëve në Mitrovicë dhe për më keq, pronarët shqiptarë nga Habitati urdhërohen që t'i shesin ato dhe Qeveria e Kosovës fare nuk merret me këtë çështje që bën Habitati, sikur të mos kishte të bënte asgjë me Kosovën.

Improvizimet demagogjike nga udhëheqësit e institucioneve nuk i nevojiten popullit të Kosovës, sot nevojitet funksionim i vërtetë demokratik dhe bazueshmëri ligjore për t'ua kthyer shpresën e humbur qytetarëve, por kjo nuk mund të bëhet derisa qeveritarët vazhdojnë ta abuzojnë pushtetin dhe atë pushtet e rikthejnë në mundësi të pasurimit të tyre dhe të familjarëve dhe shokëve dhe miqve të tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI – Fjalën e ka z. Canziba, kurse le të përgatitet për diskutim Fatmire Mulhaxha – Kollçaku.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA - I nderuari z. kryetar, i nderuari kryeministër dhe ju ministra dhe ju kolegë deputetë. Domosdoshmëria e fillimit të përmirësimit të gjendjes ekonomike duket se është reduktuar në nevojën e përmirësimit të standardit të ekonomisë, që më pas bashkë me pavarësinë si me një shkop magjik do t'i zgjidhë të gjitha problemet ekonomike e sociale të Kosovës .Pse të mos jetë kështu.? Realiteti

megjithë atë është pak më ndryshe, së pari zhvillimi i mirëfilltë ekonomik nuk ka qenë kurrë në rend të ditës, as për UNMIK-un, as për Qeverinë e shkuar e as për këtë të sotmen. Së dyti, për hallet e qytetarit të thjeshtë nuk është interesuar askush në instancat udhëheqëse të vendit, as udhëheqësit e institucioneve, as njerëzit përreth tyre nuk kanë dalë jashtë zyreve të tyre për të parë se çka po ngjet përreth dhe me çfarë vështërsish përballet qytetari i thjeshtë për shumicën prej tyre e dhëna 60% të papunë është variabël matematikore me një domethënie të caktuar, kush e di se çfarë. Se 60% me të vërtetë paraqet afro 300.000 njerëz se ministrat apo deputetët, për dallim prej tyre kanë një vend të punës, bëjnë një jetë të zymtë me plotë halle pa ndonjë vizion për të ardhmen, duket se nuk i bën përshtypje askujt, kurse gjendja keqësohet nga dita në ditë si shtresa të përkrahura institucionalisht më se 52.000 familje që marrin ndihma sociale. Qindra mijëra pensionistë dhe mijëra familje të dëshmorëve jetojnë në prag të varfërisë me më pak se 2 dollarë në ditë. Kosova jo vetëm që po mbetet pas vendeve të rajonit, ajo edhe më keq po stagnon në të gjitha sferat e ekonomisë. Bumi ekonomik i pasluftës i shkaktuar nga kthimi i refugjatëve, vendosja e Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë dhe rindërtimi janë shuar që moti. Rritja ekonomike në Kosovë gjatë viteve të fundit ka qenë në rënie e sipër, ndërsa në vitin 2005 pritet të jetë inekzistente apo negative. Me një rritje të tillë negative Kosova është ballafaquar edhe gjatë viteve të 90-ta kur regjimi serb shkatërronte në mënyrë sistematike shtyllat kryesore të ekonomisë kosovare. Mungesa e sigurisë, papunësia e madhe, korrupsioni në përhapje, kriminaliteti, repetimi i ndërmarrjeve, pesimizmi i lartë, mungesa e investimeve të huaja dhe rënia e besimit në institucione, kanë çuar deri te zhgënjimi i popullatës dhe rritja e dëshirës për të emigruar jashtë vendit.

Kush gëzon privilegjin të jetë i punësuar në Kosovë do të përballet me faktin se si punëtor kosovar do të ketë të ardhura më të ulëta mujore në rajon. Madje dyfish më të ulta se kolegët në Serbi apo Maqedoni, por në të njëjtën kohë punëtori kosovar do të mund të krenohet se shpenzimet mujore në Kosovë janë shumë më të larta, madje mbi mesatarën e rajonit. Vlerësohet se për një familje mesatare kovare shpenzimet bazë sa për të mbijetuar arrijnë në 350 euro në muaj, përpos kësaj kosovarët paguajnë për rrymë, nëse paguajnë fare shumëfish më shumë se gjermanët, zviceranët e austriakët. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, gjendja sociale është bërë edhe më e vështirë dhe më e papërballueshme. Varfëria është në rritje, ndërsa programet qeveritare për luftimin e saj mungojnë. Se sa dramatike është gjendja në vendet rurale tregon një e dhënë e UNHCAER-it sipas së cilës rreth 40% të popullatës nuk kanë furnizim adekuat me ujë të pijshëm, sikur të mos ishin investimet e pasluftës të bëra nga Qeveria gjermane për rehabilitimin e ujësjellësit në mbarë Kosovën, gjendja sot do të ishte edhe më dramatike. Ekonomia e Kosovës mbështetet aktualisht në importe e këto ndërlidhen me konsumin privat e publik që është në rënie, prandaj edhe ndryshimi pozitiv në bilancin tregtar nuk ka të bëjë me ngritjen e eksportit, por me zvogëlimin e importit që është si pasojë e rënies së konsumit. Rënia e fuqisë blerëse ka të bëjë edhe me zvogëlimin kontinual të parave që vijnë nga kosovarët jashtë atdheut. Duket se burimet e diasporës të quajtur edhe si lopa qumështore janë duke u shterruar vazhdimisht. Si pasojë e kostos së jetësës në Perëndim, etablimi familjar atje dhe zvogëlimi të dëshirës për t'u riatdhesuar.

Pas disa viteve të paraqitjes së suficitit buxhetor Kosova gjatë këtij viti për herë të parë në kohën e pasluftës duhet të përballet me deficit. Ky deficit mund të jetë në rritje për shkak të transferimit të kompetencave të reja te institucionet vendore dhe për shkak të rritjes së pakontrolluar e shpesh dubioze të shpenzimeve qeveritare. Pasi që nuk ka burime alternative financiare për të kredituar burimet buxhetore është fare e mundur që në vitin 2006 Qeveria të gjendet buzë falimentimit.

Kosova është vendi me shkallë më të ulët të investimeve të huaja në Evropë, ndoshta edhe në mbarë botën. Rrjedhimisht pa investime nuk ka as transferim të dijes dhe teknologjisë moderne, nuk ka kapital të freskët dhe vende të reja të punës e prodhim vendor, përkundër ekzistimit të një legjislacioni relativisht stimulues dhe angazhimeve sporadike të UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës për të bërë diçka më shumë për ndryshimin e kësaj gjendjeje alarmante. Kosova ende mbetet larg shijimit të përparësive që sjellin investimet e huaja. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës përmendin çështjen e statusit si pengesë për investimet e huaja, por kjo nuk është e vetmja pengesë, arsyet për mosinvestimet e huaja janë shumë më komplekse, përdërisa në rajon është shënuar një rritje progresive e investimeve të huaja, Kosova edhe më tutje zë vendin e fundit në vetëm rreth 30 milion euro vlerë të investimeve direkte të akumuluar gjatë tërë periudhës së pasluftës. Kjo shumë është përmendur para dy vetëve nga zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, por realisht askush deri më sot nuk ka qenë në gjendje të tregojë ku dhe nga kush janë bërë këto investime, në cilët sektorë të ekonomisë dhe me çfarë vlerash dhe efektesh, përkundër pyetjeve që janë shtruar disa herë duket se përgjigjen për këtë nuk e di askush.

Nëse të dhënat për 30 milion euro investime direkte në Kosovë janë me të vërtetë të sakta atëherë del se Kosova nga 22.31 miliard euro të investuara prej 99-tës e deri më tani në Evropën Juglindore ka qenë në gjendje të tërheqë vetëm 0,13 të vlerës së përgjithshme të këtyre investimeve, që të zbutë gjendjen e rëndë ekonomike e sociale, duke përfshirë këtu edhe gjendjen e rëndë në industri, bujqësi e në sektorin e shërbimeve dhe që krijon kapacitete prodhuese. Të hapen vende të reja të punës dhe të sigurohet kapital i freskët, nevojiten investime të huaja, që të ketë stimulime të huaja duhet bërë stimulimi i organizuar sistematik i ndërmarrjeve të huaja, mu nga këto vende që sot po i pushtojnë tregjet e Evropës Juglindore. Për të investuar në Kosovë, informimi i mirëfilltë për sektorët më tërheqës për investime edhe paraqitjes së denjë të përparësive të investimit, përmes një marketingu profesional të zhvilluar në vend të perëndimorëve, është një rrugë e sigurtë e tërheqjes së investitorëve të huaj. Vetëm nxjerrja e ligjeve nga ana e Kuvendit, pa implementimin dhe aplikimin në praktikë nuk është e mjaftueshme, as deklaratat shterpë për gatishmërinë institucionale për të përkrahur iniciativa në këto drejtime nuk mjaftojnë. Angazhimi i sinqertë, serioz dhe profesional i përfaqësuesve të institucionit dhe veprat e tyre konkrete mund të dëshmojnë përkushtimin që e kanë për zhvillimin e ekonomik të vendit. Në të kundërtën me apo pa sistemin e paralajmërimit të hershëm të cunamit që mund të shpërthejë në çdo çast e ta prishë kështu paqen e brishtë sociale. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Canziba, fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku, kurse le të përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Faleminderit z. kryetar, deputetë të nderuar dhe ju qeveritarë. Fillimisht kam një vërejtje parimore sa i përket rendit të ditës sot dhe futjes së gripit të shpendve si pikë të tretë. Ju z. kryetar e dini shumë mirë se materiali duhet t'u ofrohet deputetëve para seancës e jo në ditën e seancës. Këtu e kemi dokumentin nga Ministria e Shëndetësisë të 20 prillit, po që se dikush mendon se bën të debatohet për gripin e shpendve pa prezencën e ministrit të Shëndetësisë dhe pa raportin detal të Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm pjesërisht e kemi. Nga një ministri reperkusionet kryesore janë në shëndetin e njeriut, d.m.th. të vëhet një pikë. Kjo është vërejtje parimore dhe kam menduar se ju do ta bëni këtë vërejtje e nuk do të vijë në radhë një pikë e cila nuk e ka raportin komplet.

Si vazhdim i rendit të ditës unë jam paraqitur ta marr fjalën, mu për shkak të prezencës së kryeministrit dhe mendoj se kjo është një mënyrë e mirë e komunikimit me Qeverinë dhe e përshëndes ardhjen e kryeministrit këtu sot, me qenë se për herë të parë kam mundësi ta informoj për një problem i cili shumë po më shqetëson jo mua, por unë këtu e prezantoj një rajon në grupin tim parlamentar, prandaj tendenca që të limitohen debatet ku ka të bëjë me tema kaq të rëndësishme siç janë standardet, duhet të kihet parasysh se edhe brenda subjektit të njejtë politik përfaqësojmë rajone të tjera dhe duhet t'i shprehim shqetësimet edhe të popullatës nga të cilat vijmë këtu. E kam ngritur edhe një çështje edhe në seancën e kaluar, e cila ka të bëjë me debatin që është bërë për ligjin "Mirësjellja e shërbyesve civilë". Njëri nga standardet është funksionimi i institucioneve demokratike që në fakt duhet të jetë prioritet urgjent. Unë dëshiroj ta informoj kryeministrin dhe ta pyes se a është në dijeni për shkelje drastike të Rregullores për shërbyes civilë, të mos respektimit të 12 udhëzimeve administrative të nxjerra nga Ministria e Shërbimeve Publike, duke u nisur nga procedurat e rekrutimit e deri tek ai i fundit. A është bërë një revizion nëpër institucione tona publike që të shikohet se si punojnë shërbyesit tonë civilë sot, pa kontrata, një numër i madh i ka kontratat 3 mujore, 6 mujore, varësisht prej udhëheqësve sa e ka simpati, sepse nuk ka rregullore që pas kontratës 2 -vjeçare ka mundësi që një shërbyesi civil t'i lëshohet kontrata 3 -mujore apo 6- mujore. Shumë, e shumë dëshmi i kam që mund t'ia paraqes kryeministrit, por mjafton që Qeveria ta marrë vetë një hap të tillë, ta bëjë një revizion dhe t'i shikojë se si janë shkelur të drejtat e njeriut në Kosovë në kontekst që po flas këtu për shërbyesit civilë dhe mendoj se çdokush që ka qenë dhe është shërbyes civil duhet ta prekë kjo temë.

Sa i përket asaj se a duhet t'i sigurojmë standarde kujdo dhe në rend të parë duhet t'ia sigurojmë popullit shumicë, që të jemi shembull i mirë se si t'i tërheqim edhe të tjerët të vijnë se do të kenë një siguri, çfarë sigurie ka sot shërbyesi civil në punë? Si shembull po e marr Ministrinë e Shërbimeve Publike që edhe vetë i shkel rregulloret që vetë i ka nxjerrë, të ashtuquajturit ushtrues të detyrave, sekretarë permanentë, kemi sekretarë permanentë pa kontratë, kemi ushtrues të detyrave që e kalon çdo kufij kohor, me çka po merret Këshilli për Emërime të Larta. Besoj se kur të vazhdohen kontratat apo gjatë emërimit, do ta ketë parasysh dhe një analizë të thuktë të sferave me të cilat merren zyrtarët e lartë. Këtu e kam fjalën konkretisht për shëndetësinë. Një fjalë që dëgjohej në terren është se situata në shëndetësi është katastrofale, po që se është standard dhe është situata katastrofë, kurgjë nuk ndryshon. Ministrat ndoshta janë në poste politike, mund të

mos jenë dhe të mos kenë njohuri për shëndetësi, por së paku zyrtarët e tjerë duhet të kenë njohuri të mira dhe duhet ta udhëheqin mirë shëndetësinë sot në Kosovë. Por çka do të bëjmë në nëse ballafaqohemi me gripin e shpendve, kur ne sot nuk kemi as gjilpëra, nuk ka analgjetik elementarë, s'ka antibiotikë elementarë që duhet ta trajtojmë pacientin, s'ka insulin, ju lutem po të diskutohet gripin i shpendve ka rëndësinë e vet, mirëpo unë e preka çështjen e funksionimit të institucioneve demokratike. Unë e kam informuar sot kryeministrin dhe duke u bazuar në zotimin e tij duhet të marrë shumë informata edhe nga ne deputetët, sepse edhe ato janë shumë të vlefshme besoj do të pres që një informatë dhe nuk do të jetë si në atë që e marr unë fjalën dhe i shprehi 100 shqetësime dhe ma bën faleminderit, tjetri. Kjo është dukuri në këtë kuvend, cilido problem që preket këtu nuk shqyrtohet më tutje, ta bën faleminderit dhe vazhdon tjetri, sikur të mos kishe thënë gjë me rëndësi. Unë e përshëndes kryeministrin dhe besoj se ai do ta rishqyrtojë këtë kërkesë timen që nuk është shqetësim imi, por i shumë shërbyesve civilë. Faleminderit

KRYETARI – Ju faleminderit. Nuk kam mundësi tash t'i zgjidhi problemet që parashtrohen këtu. Vazhdojmë, fjalën e ka z. Bajrush Xhemajli, kurse të përgatitet deputeti Ylber Hysa.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar, kryeministër, ministra, kolegë deputetë. Unë do të përqëndrohem vetëm në standardin e pestë që ka të bëjë me ekonominë. Deficiti marramendës në këmbimet tregtare ku importi mbulohet vetëm rreth 5%, shkalla e papunësisë tepër e lartë, buxheti në vend se të rritet krahas rritjes së nevojave po vjen e duke u zvogëluar, korrupsioni i shndërruar në diçka të rëndomtë, varfëria e skajshme në rritje e sipër - para ndonjë shpërthimi social, janë vetëm disa nga shifrat që e rrënojnë çdokënd në problemet ekonomike. Prandaj të thuash se e kemi përmbushur standardin për ekonomi është absurd. Standardet është mirë të përmbushen jo vetëm kur t'i kesh standardet dhe të dhënat, por për hir të mirëqenies së qytetarëve. Sa i përket standardit të pestë, kjo Qeveri e koalicionit ka treguar se as që ka kapacitete të mjaftueshme për të realizuar, por as vullnet dhe si e tillë ende nuk ka as vizion e as strategji zhvillimore. Fillimisht do të ndalem në pikën 51 të veprimit që e kemi marrë si material, aty ku ka të bëjë me ligjet ekonomike të mbetura për t'u miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Qeverisë nuk i ka ndodhur vetëm ngecja e hartimit të projektligjeve dhe rënia e cilësisë së tyre, por ajo që më së shumti brengos është mosimplementimi i tyre. Për këtë flet fakti se edhe nga 5 ligje të parapara si standard në sferën e ekonomisë vetëm një po zbatohet. Kjo tregon më së miri për kapacitetet e varfëra të këtij koalicioni qeverisës për t'i hartuar dhe implementuar ligjet edhe pse jemi larg standardeve që kërkohen nga ne. Çështja tjetër, për të cilën dua të ndalem, ka të bëjë po ashtu me standardin e pestë, konkretisht në pikat 57, 58, 59 dhe 60 të këtij materiali, që asnjëra nuk është përmbushur dhe kanë të bëjnë me furnizimin e qytetarëve. Dua të shtoj me radhë sipas pikave anëtarët e zgjedhur nëpër borde absolutisht nuk janë apolitikë, por janë pozicionuar plotësisht partiakisht e këtë nuk e lejon ky standard. Pika 58 ka të bëjë me fuqizimin dhe me thellimin e rregullimit të nevojshëm të procedurave gjyqësore, në mënyrë që të mbështetet inkasimi i llogarive nga furnizuesit e shërbimeve publike dhe në planin e veprimit të përbashkët UNMIK, IPVQ mbi furnizimin me rrymë. Kjo pikë në asnjë element nuk është realizuar. As pikat 59 dhe 60, të cilat kanë të bëjnë me

organizimin e fushatave të gjëra publike lidhur me pagesën e faturave dhe me fazën e dytë të fushatës së mediave, nuk kanë dhënë kurrfarë rezultatesh. Ja pse ndodhi kjo.

Të nderuar deputetë edhe pse që nga lufta e këndeje, në emër të KEK-ut është investuar një shifër marramendëse prej gati 1 miliard euro, prapëseprapë kriza energjetike po thellohet në mënyrë rapide drejt një kolapsi dhe për kundër kësaj gjendjeje ka 6 vjet, por askush nuk dha kurrfarë përgjegjësie qoftë edhe morale. Institucioni i përgjegjësishë nuk ekziston as formalisht, por për këtë gjendje Qeveria dhe stafi menaxhues i KEK-ut fajtorë kujdestarë i ka gjetur qytetarët e Kosovës të cilët akuzohen edhe për pagesë të rrymës edhe për vjedhje pa e drejtuar në rend të parë gishtin nga vetja për të gjitha të palarat e tyre dhe pa e arsyetuar shpenzimin e të gjitha këtyre parave apo të taksave të qytetarëve që edhe i kritikojnë. Në KEK inkasimi vërtet është një problem i madh, por jo më i madhi, problem numrë 1 janë menaxhmenti i KEK-ut dhe Qeveria, prej kujt kërkohet llogari, kur vetë nuk janë në gjendje as ta faturojnë rrymën, ashtu që nuk e dinë se ku humb rreth 60% e rrymës që e prodhon, kur vetë i kanë sjell minierat në atë gjendje sa të mos mund të sigurohet qymyr edhe pse dihet se qymyr në Kosovë ka sa të duash. Qeveria ia miraton kontratën ESB-isë edhe pse vetë deklaroi se në asnjë parametër nuk e ka përmbushur atë kontratë, por absurdi qëndron se ministria në fjalë e kundërshton ESB-në, kurse në veprime e përkrah atë. Qeveria bëri edhe një gabim tjetër kardinal karshi menaxhmentit të KEK-ut ESB-isë, siç thonë menaxhmentit irlandez i KEK-ut, pasi ka pasur luhajtje të mëdha, madje edhe ekstreme në lidhje me planin për inkasim që quhet ABC, ku fillimisht nuk e ka përkrahur, pastaj jo që e ka përkrahur, por edhe bëhet altoparlant i ESB-isë dhe ky plan nuk ka si të mos dështojë, sepse kyçja në rrjet dhe kontrata janë individuale, kurse dënimi është kolektiv. Kjo nuk do të thotë vetëm shkelje e të drejtave dhe e lirive të njeriut, por, para së gjithash është shkelje e ligjit në fuqi, që do të thotë e Ligjit për energjinë, të hartuar dhe miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Me këtë nuk dua ta amnistoj askë dhe ata që janë rast social duhet ta paguajnë rrymën, por dikush është i interesuar të shpikë plane të përealizueshme, siç është plani ABC, sepse vetëm në këtë mënyrë krijohen ujëra të turbullta dhe bëhen manipulime të skajshme, vetëm kështu mund të lëshohet rrymë 24 orë në lagjet ku banojnë personalitete të caktuara të koalicionit qeverisës, vetëm kështu mund të ndëshkohen rajone të tëra sipas preferencave, vetëm kështu mund të ndëshkohen politikisht rajone të tëra, vetëm me planin ABC përgjegjësia nuk adresohet dhe bëhet kolektive, ashtu siç i bën denimet e konsumatorëve kolektivë. Vetëm kështu faji mund të mbetet jetim, apo në rastin më të mirë t'u hidhet qytetarëve, siç po u hidhet, përndryshe të mos ishin interesa të caktuara të menaxhmentit dhe të Qeverisë, zgjidhja sa i përket inkasimit tashmë është në horizont dhe vetëm duhet zbatuar, pra IPBQ – UNMIK, siç thuhet edhe në këtë standard, por për këtë duhet një organizim i lartë dhe angazhim serioz i të gjitha strukturave dhe institucioneve. Qeveria e koalicionit këtë nuk ka mundur ta bëjë dhe nuk do të mund ta bëjë as në të ardhmen.

Të nderuar deputetë sa i përket energjetikës do të mbahet mend si Qeveri e territ, ndërsa Ministria përkatëse jo vetëm që nuk i ka përmbushur standardet që po i shqyrtojmë sot, por me veprimet e dëmshme do të mbahet mend edhe si shkelëse e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe shkelëse e ligjeve në fuqi. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ylber Hysa, kurse le të përgatiten Zylfije Hundozi, Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti.

DEPUTETI YLBER HYSA - Më falni që kartela ime sot nuk i plotëson standardet për të biseduar. Kolegë të nderuar kanë mbetur 11 ditë sipas informatave tona që kur përgjegjësit në UNMIK duhet ta përgatisin raportin i cili duhet të paraqitet në Nju Jork, prandaj edhe gjithë ajo zhurmë edhe në UNMIK për të kaluar të gjitha ato ligje që kanë mbetur në sirtarë, për të pasur një mesatare në atë raport që duhet paraqitur atje. T'ju them menjëherë se ky nuk është ndonjë lajm i gëzueshëm dhe nuk na lë indiferentë. Këto janë situata sikur Kai Aide do të duhej paraqitur raportin në mënyrë që nëpërmjet standardeve të hapte procesin për status dhe para disave nga ne që jemi këtu dhe nuk jemi këtu dhe atje kjo është një situatë e cila na lë me dy dilema. E para ne nuk dëshirojmë që të jemi denoncues të asnjë procesi negativ nëse kjo do të ishte në dëm të Kosovës dhe e dyta që ne njëkohësisht jemi shumë të vetëdijshëm që këto zhagitje, nëse jo gjatë statusit dhe pas statusit do të na bindnin ne për të mirë dhe për të keq. Dhe në këtë aspekt pasi jemi këtu, në këtë rrugë duke e ndarë edhe procesin negociator, duket së paku e çuditshme që për këtë kemi sot disa kolegë tonë deputetë që kanë shtruar disa nga pyetjet më të çuditshme. Ne e kemi ditur që pluralizmi është standard, por nuk e kemi ditur që pluralizmi brenda partive është një standard dhe duket që pikërisht kjo po ndodh këto ditë se më së shumti pluralizëm ka brenda partive, andaj nuk është për t'u çuditur që disa deputetë në këto vende vendimmarrëse e kanë prej udhëheqësit të kësaj seance zëvendëskryeministrin , i cili ishte më heret me ne, presidentin dhe me të gjitha këto instanca vendimmarrjeje këtu para nesh, kamerave dhe qytetarëve bëjnë pyetje për trashëgiminë, për komunitetet, për Mitrovicën. Nëse kjo nuk është një standard i përbashkët i brendshëm dhe nëse kjo nuk është një standard që të bisedohet brenda partive, atëherë ju lus si kolegë të mos i sillni para nesh këto çështje, sepse detyrohemi të përgjigjemi disave prej tyre. Ne i kemi hyrë kësaj rruge bashkarisht, por nëse këtu ka asi që mendojnë që ne jemi të tepërt ose ne nuk duhet të marrim pjesë në definimin e proceseve që do të definojnë statusin e Kosovës, atëherë ju lutem na tregoni, d.m.th .ne nuk kemi hyrë këtu me dhunë, as nuk kemi hyrë që është një punë që automatikisht dihet që do të ketë vlerë dhe do të jetë e lehtë, prandaj ju kisha lutur këtu si kolegë edhe juve edhe ata që duhet t'ju informojnë dhe nuk ju kanë informuar se çka bëjmë dhe çka do të bëjmë, të merreni vesh , pastaj të na kurseni para kamerave të mos i bëjmë këto gjëra. Nëse ne jemi në gjendje që t'i bëjmë të gjitha këto kursime në emër të asaj që dëshirojmë ta arrijmë e nganjëherë edhe t'i mbyllim sytë dhe veshët, atëherë ju kisha lutur edhe juve që së paku të jeni kolegjale dhe të merreni vesh, pra na tregoni nëse vendi ynë në atë proces është i tepërt. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryetar, z. kryeministër, deputetë të nderuar, ministra të pranishëm. Plotësimi i standardeve nuk është vetëm obligim të cilin duhet plotësuar që të arrijmë te pavarësia, por edhe parakusht për krijimin e një shoqërie demokratike të zhvilluar, e cila do të jetë e gatshme të integrohet në Bashkimin Evropian. Njëri prej standardeve të rëndësishme për ta plotësuar është edhe diafogu ndërmjet të institucioneve të Kosovës dhe homologëve të tyre në Beograd, për çështje

teknike, por edhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Institucionet kosovare i përmbushin detyrat prioritare të parapara me këtë standard, duke u angazhuar aktivisht për dialog të vazhdueshëm, për çështje teknike me rëndësi për të dyja palët. Pala kosovare asnjëherë nuk ka bërë obstrukcione, por përkundrazi është përpjekur që bisedimet të jenë konstruktive dhe me angazhimin e tyre të sjellin progres në këtë proces. Krahas dialogut me Beogradin institucionet e Kosovës kanë filluar bashkëpunimin bilateral me shtetet fqinje të rajonit dhe kanë krijuar marrëdhënie paqësore stabile. Angazhimet që dialogu të ketë sukses nuk janë të barabarta nga të dyja palët, ala serbe bën vazhdimisht obstrukcione. Trajtimi i çështjes të të zhdukurve ka mbetur i njëjtë si më parë. Kufomat e të zhdukurve kthehen kohë pas kohe në grupe të vogla, duke mos e zbardhur fatin e tyre gjer në fund, fajtorët nuk janë ndëshkuar gjerë më tani. Pala serbe në mënyrë indirekte po e pengon edhe kthimin e personave të zhvendosur duke bërë presion në ata që janë në Kosovë që mos t'i marrin rogat nga institucionet kosovare dhe duke penguar kthimin e deputetëve serb në Kuvendin e Kosovës dhe institucionet tjera. Nëse pengohen serbët që jetojnë këtu nga ana e Beogradit që të integrohen në jetën në Kosovë, si të kthehen të tjerët, me çka të motivohen ata që të bëhen qytetarë të barabartë të Kosovës, kur për këtë pengohen vazhdimisht nga ana e Beogradit. Në materialet që i kemi marrë në pjesën ku është dialogu njëra prej detyrave për institucionet e Kosovës dhe UNMIK-ut është që të formojnë delegacionet e tyre për 4 grupet e para të punës dhe të sigurojnë përfaqësim të barabartë të femrave. Ky draft është dorëzuar më 31 mars 2004, prej asaj dite e gjer më tani me përjashtime krejtësisht të vogla ky rekomandim nuk është përfillë nga ana e institucioneve të Kosovës dhe të UNMIK-ut. Politikanëve kosovarë jo vetëm që nuk u është dhënë shansi gjer më tani dhe në të gjitha kohërat e vështira për Kosovën kemi qenë së bashku me meshkujt e jo vetëm pranë tyre. Duke dhënë kontribute të rëndësishme për të mirën e këtij vendi. Ndërrimi i mentalitetit për çfardo çështje le të jetë edhe ai për çështje gjinore. Është proces i gjatë psikologjik dhe nuk ia zë për të madhe shumë palës kosovare që nuk ka reaguar në këtë drejtim, por drejtuesit e UNMIK-ut që nuk kanë reaguar në këtë drejtim është për t'u habitur kur dihet se vijnë nga vendet me traditë demokratike të gjatë. Ata e kanë pjesën e vet të përgjegjësisë në plotësimin e standardeve. Plotësimi më i shpejtë i të gjitha standardeve do të jetë i mundshëm nëse do të kemi edhe ndihma financiare nga Bashkësia Ndërkombëtare, me çfarëdo forme dhënie e kredive dhe investimet e huaja, sepse me këtë zhvillim ekonomik të ngadalshëm, plotësimi i kushteve për jetë është i vështirësuar e me këtë edhe plotësimi i standardeve.

Unë kisha dashur një replikë me deputetin Ylber Hysaj, sepse që disa herë deputetët e partisë Ora po u japin leksione deputetëve të koalicionit dhe që disa herë po ceket këtu që ne nuk kemi të drejtë këtu të parashtrijmë pyetje, as ta kritikojmë Qeverinë ose thenë shkurt t'i parashtrijmë mendimet tona, nuk e di se me çfarë diktati ne duhet të punojmë.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër ju përgëzoj për qëndresën, për një sistem të ri të sjelljes në Kuvend. Kam parasysh sidomos Qeverinë e cila është e disiplinuar dhe po dëgjon këtu këto bisedime të cilat me të vërtetë janë të

gjata dhe janë substanciale, nganjëherë edhe formale. Por kështu ngjet edhe në parlamente që janë pak më të forta se ky yni. Ne kemi një grumbull fjalësh që janë bërë si klishe të na, standardet, implementimi, procesi etj. Këto i përdorin të gjithë gati njësoj edhe me vend dhe pa vend dhe fjalët kur përdoren si klishe humbin kuptimin e vet të parë, edhe puna e standardeve në Kosovë gati është shtjerr, gati e ka humbur kuptimin e parë, kështu që tash për tash edhe në diskutimet tona të sotme është shfaqur gati mendimi se standardi është një thes universal për të cilin secili mendon që ka brenda atë që ai e mendon. Si do që të jetë ne kishim një temë shumë të specifikuar të kërkuar nga partia kryesore e opozitës, Partija Demokratike dhe unë e përgëzoj Qeverinë që i është përgjigjur kërkesës së Kryesisë së Kuvendit që për këto pika të dalë para nesh me materiale të shkruar dhe unë besoj që kjo praktikë do të vazhdoj tutje. Meqë po flas kah fundi i ditës, normalisht që është e pamundur të flas diçka që nuk përsëritet, në një farë mënyre ose të flas diçka që reflekton diçka që është thënë më parë dhe unë mendoj që është në rregull se fundi i fundit kjo e krijon bisedën si një dialog. Nga ajo që kam dëgjuar unë sot këtu mund të them që kishim njëfarë paralelizmi gati të habitshëm rreth Qeverisë më shumë se rreth standardeve, sepse ne e kemi temën e standardeve, nuk e kemi temën e Qeverisë. Sot duhet t'i precizojmë problemet, pra kishim një mohim total të partisë opozitare, të Partisë Demokratike dhe një pohim gati total që vjen nga deputetët e partive që mandatojnë Qeverinë e tashme. Unë po ju them menjëherë që nga këndi im që këto dy tipe të të folurit, pohimi total dhe mohimi total funksionalisht janë gati njësoj, kështu që unë kam pritur që do të kemi bisedime shumë më substanciale dhe shumë më të bindshme për probleme të veçanta. Pse po e them këtë? Po e them sepse na vlen shumë më shumë edhe neve edhe Qeverisë që e kemi mandatar dhe e kontrollojmë dhe dihet çka ajo do sot dhe çka do të bëj nesër. Shumë herë një shembull i argumentuar flet shumë më shumë se të gjitha përgjithësimet e mundshme. Unë po kthehem te tema e standardeve. Kjo është një temë që na ndjek që 3 vjet dhe unë nuk do të heq dorë nga mendimet e mia të shprehura që atëherë në këtë foltore. Ata që i kam moshatarë në këtë Kuvend e dinë që edhe atëherë edhe sot mendoj që standardet si norma zhvillimore, demokratike, politike dhe ekonomike kanë kuptim që është universal që e do çdokush, vetëm standardet si kushtëzim për të blerë kohë, për të mos u shtruar problemi i zgjidhjes së statusit të Kosovës është një problem tjetër. Në diskutimet tona politike edhe në këtë Parlament edhe jashtë tij gjithmonë janë konfrontuar, është bërë një konfuzion i këtyre dy koncepteve. Po mendoj që tash është koha që këto dy koncepte s'kanë pse të konfrontohen dhe dihet që ne standardet i interpretojmë si nevoja tona dhe prapë si kushte që po na bëhen për çdo ditë rreth standardit për Kosovën dhe kjo duhet të bëhet e qartë sot këtu për çdo njërin. Pra duket që puna e standardeve merr n karakter të një fushate politike, kjo është shumë e vërtetë, prandaj kjo na duket që merr karakterin jo të substancialitetit, por të propagandës që është shumë e vërtetë që po i prek njerëzit politik, jo vetëm të Qeverisë, por edhe të partive opozitare dhe të qytetarëve të rëndomtë. Unë vetëm mund të shtoj që për mua standardet edhe njëherë po them se nuk do të plotësohen pa u bërë pavarësia e Kosovës. Këtë e kam thënë edhe para 3 vjetësh, jam i bindur në këtë dhe nuk heq dorë, për arsye të shumta, në radhë të parë për arsye të injektiveve ekonomike që duhet të vijnë nga jashtë dhe për arsye të zhvillimeve politike të brendshme.

E dyta, mendoj se standardet kurrë nuk do të bëhen në kuptimin maksimal duke thënë se jemi vendi më i varfër në Evropë dhe mendojmë se do të bëhemi të pasur, sepse s'ka

zhvillim se s'ka shoqëri që prej një vendi të varfër e bëjnë të pasur menjëherë. Këto janë dy premisa themelore. E treta, mendoj që nëse standardet mendohen si mbështetje dhe plotësim të nevojave imediate ose sistematike vetëm të pakicave në Kosovë, kurrë nuk do të realizohen dhe është gabim orientimi i standardeve si plotësim i të drejtave dhe i detyrimeve ndaj pakicave. Standardet flenë nëse merren esencialisht me shumicën. Ne kemi një problem shumë aktual, kemi 8 standarde që na sillen neve qe 3 vjet, ndërsa ne kemi harruar padiktueshëm ne na është bërë standardi nr. 1 ose i vetmi në Kosovë – decentralizimi- i cili ka prekur, jo punën e zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës, por punën e esencave të statusit të Kosovës . Kur jemi këtu nuk dua t'i bëjmë veshët e shurdhër as pozita e as opozita, as Qeveria ajo përpara e as kjo tash, as ndërrimet që kanë ndodhur as Grupi Negociator ose si po i thonë Grupi i Unitetit. Mua më vjen mirë që i kemi 4 prej këtyre këtu, mos të them ky është Kuvendi që na ka dhënë mandat dhe na mungon Fatmir Sejdiu, të tjerët janë këtu, kështu që nuk ka nevojë të flasim me figura. Nëse ka nevojë ky 4 së bashku me të 5 të na shpjegojnë për procedurat e standardeve, për procedurat e standardit nr. 1 të decentralizimit, nuk ka nevojë z. Hysa të lodhet për atë punë hiç se vjen si rend i dytë në atë hierarki. Unë mendoj se ka nevojë nëse jo sot një ditë tjetër që të bisedojmë, më në fund është detyrim, është detyrë e Ekipit të Unitetit që t'i bëjë këto gjëra transparente para këtij parlamenti se s'ka ku tjetër ku i bën më transparente dhe këtu e përmend tash ta përfshijmë në dialog edhe z. Hashim Thaçin. Ai në fjalimin e tij interesant mohues total të Qeverisë me dy elemente që mua më bëjnë përshtypje të jashtëzakonshme, sepse janë thënë edhe në ditën e inaugurimit të Qeverisë, që kjo Qeveri është mandatuara nga politika pak a shumë dhe e dyta që bën thirrje të ndriçohen vrasjet politike, për këtë që është e mandatar nga parapolitika unë edhe tash kërkoj shpjegime ma konkrete .Pra ky Kuvend nuk është parapolitikë, atëherë merre edhe vetën që jeni parapolitikë .Po e pranoj edhe unë, ky është Kuvend i zgjedhur me shumicë mandatohet . Nëse ky Kuvend pranon që është parapolitikë, po pranoj edhe unë. Mendoj që nuk është, kjo nën një. Nën dy, puna e zbardhjes së vrasjeve politike, unë jam me Hashim Thaçin 100%, Hashim Thaçi në biseda edhe parandej më ka thënë, unë e kam dëgjuar edhe në gazeta dhe në televizion, unë e përgëzoj që para Kuvendit të Kosovës, shefi i opozitës së këtij Kuvendi lyp që të ndriçohen deri në fund vrasjet politike në Kosovë dhe mua më ka aleat në këtë. Këtu jemi në Parlament, kurse vrasjet politike kanë tingëllim tjetër. E thërras Hashim Thaçin si shef të opozitës edhe si qytetar me krejt të dhënat që mund t'i ketë, unë nuk di çka ka, që t'ua ofroj organeve që merren me këto punë dhe t'u ofrojnë të gjithë të tjerëve që kanë. Tutje unë e di që në Parlamentin e një vendi të varfër ,siç jemi ne, gjithmonë të folurit për tema sociale është më i përshtatshmi dhe është më i prekshmi, po ju them drejt që edhe sot e kam parë këtu një trajtim social që merr karakterin e demagogjisë sociale. Këtë e bëjnë të gjithë nga pak, unë vetëm kisha lutur që kur bëjnë fjalime të tilla që marrin kuptimin e demagogjisë sociale, kushto që flet le ta mendojë veten për sa vite ku ka qenë, ku ka ardhur , ku ka jetuar, ku jeton sot, çka ka pasur pardje dhe çka ka sot dhe këtë të shkojë dhe t'ua thotë në vendet e origjinës zgjedhësve të vet. Ju faleminderi!

KRYETARI – Ju faleminderit profesor Hamiti, për replikë është paraqitur deputeti Ylber Hysaj, dy minuta ju lutem, urdhëroni.

DEPUTETI YLBER HYSAJ – Pasi m'u përmend emri vetëm desha ta sqaroj një keqkuptim të koleges së nderuar Zylfije Hundozi dhe të gjithë deputetëve të tjerë se kurrë nuk ua kam sugjeruar të mos e kritikojnë Qeverinë, përkundrazi ky është një lajm i mirë dhe mirë se vini në klubin tonë. Ajo që unë e thashë në fakt dhe që dua t'ia shpjegoj e z. Hamiti është që unë jam plotësisht për transparencë, mirëpo të mos i përziejmë këtu detyrat e shpisë e t'i bëjmë detyra të klasës. Besoj është më lehtë që presidenti ose z. Kolë Berisha t'ja shpjegojë z. Hamiti ose deputetes Sanije Alijajt pse funksionon Këshilli për Komunitete, pse jemi marrë vesh për Mitrovicën, është më lehtë se t'ju tregoj unë ose dikush tjetër, d.m.th.sh këto janë disa kanale të cilat janë të supozuara që funksionojnë para se t'i sjellim këtu, në mënyrë që pastaj në mënyrë transparente dhe me debat t'i hapim të gjitha këto pyetje pa kurrfarë dilema r pa kurrfarë problemesh, Mirëpo nuk mund dikush të pretendojë këtu pse e keni bërë ju Mitrovicën, e kemi bërë ne Mitrovicën ose pse e keni bërë atë apo këtë, nëse nuk funksiononi ju ashtu në ato mënyra, më falni unë nuk jam këtu përgjegjës që të shpjegoj se si funksiononi ju në partitë tuaja.

KRYETARI – Ju faleminderit, po urdhëroni profesor.

SABRI HAMITI -Unë e përgëzoj kolegun tim pak më të ri që flet për detyra e mosdetyra, nuk mund t'i shpjegoj askujt asgjë në këtë formë qysh po flet. Sa për transparencë unë kolegut tim Jasharit i thashë, kur e shtroi këtu, nuk di a ishte ti apo nuk ishte, i thashë nëse të pëlqen, por mua nuk më pëlqen ajo mënyrë e komunikimit. Pse po lyp transparencë kur e ke Veton Surroin dhe pyete, d.m.th është kjo mënyrë e komunikimit që z. Hysa po e kërkon. Mua nuk më pëlqen ajo mënyrë e komunikimit. Si do që të jetë ju po lypni ja e keni. Në anën tjetër nuk desha ta përmend askë tjetër, unë kam mënyra të bisedimit sa të doni, nuk dua të përmend emra të tjerë, por nëse vazhdojmë mund të vazhdojmë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Faleminderit profesor, urdhëroni z. Hundozi

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Qe disa herë pas diskutimeve të deputetëve të pozitës, deputetët e Orës po na sugjerojnë të mirremi vesh më së pari me anëtarët e partisë ose shkurt si po kuptohet ne të marrim diktate prej partisë se si duhet të diskutojmë këtu. Kjo është e kaluar moti .Kjo formë ka qenë në socializëm e tash jemi në zhvillimin e proceseve demokratike edhe secili prej neve pa marrë parasysh se i cilës parti është, ka të drejtë të flasë dhe ta thotë atë çka e mendon . Më mirë është nëna ta kritikojë fëmijën se sa kojshia.

KRYETARI – z. Jashari nuk është përmendur emri juaj, po sigurisht në kontekstin pozitiv, urdhëroni.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit shumë z. kryetar. E patëm një debat të vogël në bufenë e Kuvendit me z. Hamiti, jo debat, por një bisedë lidhur me këtë aspekt dhe në një farë mënyre parimisht e përkrah z. Hamiti se ky Kuvend ka nevojë për informata oficiele, zyrtare, mirëpo këtu po përmbysen çështjet që i thashë edhe më poshtë. Nuk është Ora pozitë, Ora është opozitë. Koalicioni qeverisës ka shumicën e gishtave në këtë Kuvend dhe mund të diktojë procese më shumë se Ora që mund të

diktojë. ORA po e bën një punë që është dashur, ju zotërinj, por nuk e kenë bërë e po duhet ORA ta bëjë sot, kurse ju po e shani sikur që jeni ju opozita. Kjo nuk ka hije, kjo është nonsens. Më falni.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.
Don të replikojë Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Shikoni ne e dimë që është ORA është opozitë, ata ndoshta s’e dinë, ne e dimë. Pse nuk e dinë, nuk e dinë sepse e kanë krijuar një trup që i ka dhënë vetes fuqi vendimmarrëse e ku kanë hyrë me një marrëveshje të këtij Kuvendi, por këta po harrojnë. Këtu është problemi, që ai organ ka fuqi të bisedojë, por jo të vendosë derisa nuk thotë ky Parlament. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, urdhëroni z. Xhavit Haliti

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar, kryeministër dhe ju deputetë, mendoj se unë dhe kolegu Sabri Hamiti jemi më të privilegjuarit në këtë Kuvend, sepse s’na ka transmetuar asnjërin e as tjetrin Televizioni i Kosovës, kështu që jemi të barabartë. Duke dëgjuar diskutimet e parafolësve shumë herë më është krijuar përshtypja se a duhet apo nuk duhet ne të dikutojmë për standardet. Ka konstatime që i kemi realizuar, që nuk është dashur ne të kemi standarde dhe që nuk kemi obligime, sulme ndaj Qeverisë, sulme ndaj bashkësisë ndërkombëtare, sulme ndaj vetvetes, por përgjegjësia asnjëherë dhe askund fatura nuk po shkon. Me sa di unë të gjithë ne, së bashku, pa marrë parasysh zëra të veçantë dhe duke pasur parasysh përgjegjësitë që i kemi pasur dhe i kemi në raport me protektoratin dhe protektorët, ta kemi parasysh këtë obligim, që t’i plotësojmë mbi bazën e mundësive tona të gjitha ato që mund t’i plotësojmë. Në qoftë se sipas ndonjërit që po deklorohet këtu kundër çdo gjëje që ka ardhur nga jashtë, shumë herë e kam pyetur veten sot a thua do të duhej të luftohej për Kosovën, a thua do të duhej UÇK-ja të jetë aleate e NATO-s, apo problemet tona do të na i kishte zgjidhur Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë? Prandaj në këtë aspekt mendoj se duhet të mendojmë pak më mirë, më realisht. A thua e dimë ne që Bashkimi Evropian në Kosovë ka investuar pas luftës rreth 1 miliard e 500 milion euro dhe këtë nuk e besoj që e ka pasur si standard për ta plotësuar për Kosovën, por meqenë se i ka investuar dhe po vazhdon të investojë edhe ne po pretendojmë me hyjmë atje, duhet ta kemi parasysh këtë çështje dhe për të mos u ndalur më gjatë te kjo do të filloja te standardi nr. 1 dhe te standardi, të cilin ne mund ta realizojmë së bashku, sepse të gjithë kemi obligim.

Funksionimi i institucioneve demokratike do t’i thjeshtësoj, transparenca në vendimmarrje dhe do të pyesja këtu a ka transparencë në vendimmarrje, në cilat institucione të Kosovës është kjo transparencë, në Qeveri, në Kryesinë e Parlamentit, në ekzekutivët komunalë? Jo, sepse transparencë do të thotë që vendimet t’i marrësh para medimeve dhe debatet dhe diskutimet t’i bësh para medimeve. Institucione demokratike do të thotë kur këto institucione zhvillojnë debatin jo vetëm me vetëveten, por edhe me qytetarët. Çështje e cila nuk po ndodh dhe nuk ka ndodhur, ndoshta jo për fajin e deputetëve, jo për fajin e Qeverisë, por nga lazdrimi i kuvendeve komunale dhe i kryetarëve të komunave, të cilat janë barrikaduar në vetvete dhe deri më tash nuk janë

përpjekur për asnjë minutë për t'u dhënë hapësirë deputetëve për ta zhvilluar aktivitetin e tyre dhe obligimin e tyre kushtetues në kuadër të kuvendeve komunale. Ne kemi pasë marrë vendim këtu dhe kryetari i Kuvendit, ish- kryetari i Kuvendit ka pas arritur një marrëveshje me kryetarët e komunave që deputetëve në çdo komunë t'u sigurohet zyra dhe të bëhet kujdestari dhe në fund të fundit kryetarët e komunave kanë obligim që t'u krijojnë hapësirë për punë deputetëve. Kjo nuk ka ndodhur. Unë po e përmend vetëm një rast në komunën time, më është dhënë përgjigjja se ju keni punë në Prishtinë dhe nuk keni punë në Pejë. Në rregull. A thua institucion demokratik do të thotë që për gabime të rënda, për gabime të cilat bien ndesh me moralin e politikanit dhe të udhëheqësit të rajonit ose të Kosovës, ku shkelet çdo normë e qytetarit dhe jo e politikanit, sepse ata që e drejtojnë duhet të jenë shumë më të kujdesshëm se qytetarët. Po i përmend nja dy raste. Vallë një kryetar komune që dehet në kafene dhe rrethet me policë, meriton ta përfaqësojë një subjekt politik të Kosovës dhe a meriton ta përfaqësojë ai një elektorat të qytetarëve? Jo, le të jetë kush të jetë. Një kryetar komune që me makinë zyrtare në kushte dhe rrethana që dihen bën aksident dhe e mbyl njeriun dhe prapë do të mbetet përfaqësues i qytetarëve, them se ky s'e meriton dhe nuk është problem imi, do të duhej të ishte problem i atyre që e kanë zgjedhur, ta shkarkojnë dhe i atyre që e kanë propozuar, ta ndërrojnë.

A kemi transparencë në shpenzimet e buxhetit? Them se jo, sepse konstatimet deri më tash më bëjnë të them se asnjë vendim lidhur me shpenzimet e buxhetit nuk është marrë në mënyrë transparente dhe nuk janë njoftuar të paktën qytetarët për shpenzimet që janë bërë dhe për vendimet që janë marrë, procedurat që janë ndjekur, deri te tenderimi i shpenzimeve të buxhetit. Po themi që si standard të dytë kemi ligjin, funksionimin e ligjit, kemi një prokurori, kemi një gjykatë supreme, kemi gjykatat lokale, gjykata kushtetuese mungon në Kosovë. Gjykata dhe hetuesia ndërkombëtare punojnë dhe të gjitha këto në një farë mënyre janë në përplasje me njëra tjetrën. E thashë një ditë në një bisedë me disa miq që problemet të cilat duhet t'i zgjidhë prokuroria nuk janë çështje të politikave. Më pyeti a ka prokurori në Kosovë? Unë e di që ka, por si funksionon dhe sa funksionon nuk e di. Në takimin e parë dhe të vetmin që e kam pasur me prokurorin e përgjithshëm të Kosovës kam konstatuar që ky njeri edhe po të donte të punonte, nuk mund të punojë, sepse nuk ka as kushte, s'ka as mbrojtje, s'ka as pagë dhe s'ka as mbështetje politike. Prandaj ky prokuror e ka vështirë të marrë guxim dhe të veprojë për t'i zbuluar ato që u thanë më parë edhe krimet e rënda edhe ato më të lehta, edhe të hajduteve edhe të atyre që e shkelin ligjin e përditë.

Gjykatat dhe prokuroritë lokale janë shndërruar në sekser(???) me ata që ndërhyjnë për t'i ulë denimet, për t'i denuar më pak dhe normalisht po të bëhej një auditim, na u ka mbushur plotë goja auditim, për pasurinë e shumicës së tyre do të shihnim se janë shndërruar në njerëz të pasur në rrethet e tyre, veçanërisht prokurorët. Funksionimi i ligjit dhe i institucioneve demokratike nuk mund të garantohet pa gjykatë kushtetuese. Në shumë herë këtu kemi pasur probleme lidhur me ankesat që i kemi bërë edhe si deputetë edhe si ish -ministra, sepse ne jemi mësuar ankesat le t'i shqyrtojë Komisioni për Ligje dhe Komizë Kushtetuese. Zonja dhe zotërinj, kjo nuk është demokraci, sepse në demokraci janë të ndara pushtetet. Në qoftë se nuk ka gjykatë kushtetuese nuk mund të zgjidhen kontestet që i kanë politikant në mes veti, sepse komisioni për ankesa dhe

parashtrës do të na sjellë vetëm konstatime dhe s'kanë obligime vepruese asnjëherë. Liria e lëvizjes mendoj që është problematizuar kot tani, unë e kuptoj që ka pasur probleme në të kaluarën, e kuptoj që pas luftës nuk ka qenë e lehtë të lëvizesh as nga veriu në jug e as nga jugu në veri, veçanërisht komuniteti serb ose edhe disa nga komunitete të vogla, të cilat menjëherë pas luftës kanë pasur probleme dhe duhet t'i pranojmë këto, por tani për tani disi, unë për vete jam i bindur që nuk ka askush problem lidhur me lëvizjen, janë probleme më shumë të imagjinuara, më shumë të imponuara nga politika e Beogradit për të përfituar sa më shumë gjatë këtij procesi të negociatave. Prandaj si çështje që lidhet me kthimin, liria e lëvizjes mendoj se janë një pjesë e madhe e atyre që po i dëgjoj edhe pakicat e vogla do të thosha këtu që kanë probleme me kthimin .që janë dëbuar nga Kosova që dikush po i pengon të kthehen . Unë mendoj që kjo nuk qëndron e veçanërisht me disa nga pakicat, sepse ne e dimë sjelljen e deputetëve. Për vete e di që disa nga deputetët e pakicave kërkojnë këtu kthimin e qytetarëve të tyre që janë në Evropë, s'do të fitojë në vota, ata po bëjnë presion që të mos i kthejnë në Kosovë, sepse kushtet janë më të mira në Evropë, unë do t'i arsyetoja në këtë rast, se nuk kanë ku kthehen, s'kanë punë, s'kannë 70% e qytetarëve të Kosovës dhe nuk është faji i institucioneve, ky është një problem krejt tjetër.

Sa i përket ekonomisë, Kosova është në kolaps ekonomik, korrupsioni, fenomeni tender dhe kontrabanda janë në nivelin më të lartë të mundshëm në Kosovë. Doganat janë vendi më i korruptuar i mundshëm në Kosovë, sepse përmes tyre zhvillohet krejt kontrabanda e Kosovës dhe mallrat që hyjnë me faktura të dyfishta nuk janë të pakta në Kosovë. Kam një informatë që para disa ditësh në Mitrovicë një polic me uniformë ka hyrë dhe e ka detyruar doganierin ta heqë videokamerën, kasetën që ka incizuar futjen e maunave me naftë. Ky nuk është bërë problem nëpër institucione, sepse unë për vehte nuk e di se kush ka qenë as mbrapa kamionit e as para kamionit, por informatën e kam të saktë dhe të sigurtë, prandaj është detyrë e atyre që thanë dhe janë në punë që ta hulumtojnë këtë çështje. E thashë futja e mallrave në dogana për faktin se ne jemi qirur në këtë foltore gjatë për krijimin e hapësirës së prodhuesve vendorë dhe prodhuesve bujqësorë, ndërsa në anën tjetër me dije apo pa dije të Qeverisë mallra të gatshme në Kosovë futen si lëndë e parë dhe u bëjmë konkurrencë të pandershme prodhimeve vendore . Në qoftë se kjo vazhdon ende, prodhuesit vendorë normalisht që një ditë do të falimentojnë, do t'i ngrehin duart dhe ndoshta AKM-ja do të merret edhe me ato prona të tyre private . Për çudi kemi problemin e ART-së,të UNMIK-ut dhe kjo kalon në heshtje në Qeveri, kalon në heshtje në Parlament, kalon në heshtje nëpër media. UNMIK-u e anulon vendimin për Mobitel – Mobikos, ata vendosin antena me 063 dhe tani besoni që njëfarë Sali Bananja që po i thonë në Pejë më thanë se po i vendos antenat e 064 ,por me lejen e kujt unë nuk e di. Më kanë thënë qytetarët se n e ka mbështetjen e disa zyrave shumë të fuqishme në Kosovë. Ne drejtorin e ART-së e kemi pas zgjedhur në Kuvend dhe mendoj se është koha e fundit që na ose ta shkarkojmë ose ai të marrë masa kundër këtyre çështjeve, ose të vijë e të raportojë si është gjendja, për çka funksionon, kush ka lejuar të vihen antenat e 064 tash në Pejë ose në rajonin e Dukagjinit, ku funksionojnë këto dhe kush qenkan ata të mëdhej që nuk mund të ndërhyjnë as ART-ja as Qeveria, as UNMIK-u . Tani, me qenë se disa bënë fushatë për zonat e tyre, unë dua të them që Peja me një zhvillim të madh ekonomik që e ka pasur është shndërruar në një zorrë qorre për zhvillim në Kosovë. Atje as nuk ka polici, as nuk ka rend, as nuk ka zhvillim ekonomik. Arsyet janë të shumta, por

në kushtet e funksionimit dhe të veprimit të një policie të politizuar dhe të papërgjegjshme ,mendoj se nuk mund të garantohen as rendi dhe as të zbulohen veprat e rënda të cilat u përmendën këtu. Është vrarë një qytetar i lidhur në pranga në stacionin e policisë në Pejë dhe unë do ta them publikisht dhe do të vazhdoj ta them këtë: Ministri i Brendshëm i Gjermanisë ka dhënë dorëheqje kur është vrarë një terrorist i brigadave të kuqe në stacionin e trenit, vetëm pse ishte vrarë i paarmatosur, terrorist i ndjekur 10 – 15 vjet. Derisa e ka zbuluar policia dhe tani në qoftë se ky moral që po e përmendim ne është demokratik, do të duhej të funksiononte për të gjithë ne, duhet të funksionoj edhe për drejtuesit e stacionit të policisë në Pejë dhe të rajonit të Pejës, në qoftë se nuk do të japë dorëheqje as Vitrupi dhe as Sheremeti, dikush duhet të japë përgjegjësi politike dhe duhet të jepë dorëheqje për veprat e ndodhura dhe për këtë vepër shumë të rëndë që ka ndodhur atje. Jo pse dikujt ia kam inat, asnjërin nuk e njoh, as njërin s'e kam takuar, asnjëri s'më ka penguar në asgjë, por mendoj që janë akte të pa-moralshme të politikave dhe të atyre që e drejtojnë dhe kanë marrë përgjegjësi ta drejtojnë. Në qoftë se ne e kemi shumë lehtë të digjemi, qytetarët i kanë punët e veta dhe nuk digjen asnjëherë ,por e vazhdojnë punën. Ne kemi një problem shumë të madh që mendoj në të ardhmen mund të na kushtojë dhe ka të bëjë me arsimimin e pa perspektivë në Kosovë. Ne kemi një superprodhim në Universitetin e Kosovës, me një kosto të lartë për familjen dhe të paperspektivë për tregun e punës, do të kërkoja nga Qeveria ta ndërmarë një hap të guximshëm për qytetarët e Kosovës. Mendoj se është grumbulluar borxhi i KEK-ut dhe Qeveria së bashku me UNMIK-un duhet ta marrë një vendim të guximshëm që borxhin e qytetarëve t'ua falë të gjithëve dhe të fillojë prej fillimit grumbullimin e parave, sepse ky do të jetë borxh mbas borxhi dhe kurrë nuk do të mund të shlyhet, veç nëse njerëzit dënohen me burg, por ata më llogari kanë të shkojnë në burg, se s'kanë me cka paguajnë.. Dy, do të kërkoj prej Qeverisë që në të ardhmen në kuadër të këtij korrupsioni që po duam ta dimë se procedurat e dhënies ose të marrjes së ndërtesave me qira për ministritë përkatëse, do të duhej të ishin transparente mënyra e lidhjes së kontratave . Do të dëshiroja ta dija a i kanë ndërruar mobilet apo jo ? Nëse i kanë ndërruar sa kanë kushtuar dhe cili ka qenë qëllimi? Është një problem shumë i madh që lidhet me sistemin piramidial të bankave në Kosovë. Kush do ta marrë përgjegjësinë për këtë punë? Ne kemi pasur një informatë publike këtu dhe kemi dalur nëpër televizione se ata që janë marrë me financa thoshin se sistemin bankar e kemi më të mirin në Kosovë. Është paraqitur piramida e parë bankare në Kosovë, por kush është përgjegjës për këtë punë, kush do të japë llogari para ligjit dhe kush do t'u përgjigjet se gjoja kanë kursyer para aty ,por edhe çështja tjetër: Kush do të përgjigjet politikisht për humbjen e besimit të qytetarëve dhe të kursimtarëve në sistemin bankar të Kosovës? Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, në përputhje me Rregullorën e punës, Qeveria ka të drejtë ta marrë fjalën nëse dëshiron. Urdhëroni z. kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, do të përpiqem të mos marr shumë kohë, me vëmendje e dëgjova këtë debat për të cilin dua t'ju falënderoj të gjithëve. Ishte kryesisht konstruktiv.E pamë shumë qartë mendimin e të gjithë deputetëve për standardet, morëm shumë sugjerime të nevojshme nga deputetët dhe se një debat i tillë e vlerësoj se do t'i japë shtytje të re Qeverisë për implementimin e standardeve. Nuk kam ardhur as unë e as Qeveria të raportojmë se i kemi përmbushur

standardet dhe besoj që nuk do të ketë ditur as kryeministri që do të thotë këtu në Parlament se u përmbushën standardet. Ato është vështirë të përmbushen, por dua t'ju them se kemi bërë progres në përmbushjen e standardeve dhe ajo që kërkohet nga Qeveria, është jo reale, të pritët që të përmbushen të gjitha standardet, sepse ato nuk kanë limite dhe përmbushja e tyre është në funksion të procesit të definimit të statusit. Pas statusit fillojnë kriteret e Kopenhagës, fillon partneriteti evropian dhe fillojnë kërkesat e standarde shumë më të komplikuar se këto.

Ne vërtet mendojmë që kemi bërë progres, por ka mbetur edhe shumë kohë. Jemi të vetëdijshëm se standardet kanë qenë gjithmonë të rëndësishme, por kurrë nuk kanë qenë më të rëndësishme se në këtë periudhë, kur janë drejtpërdrejtë të lidhura me procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës apo me dinamikën e këtij procesi. Nuk kisha thënë se janë vendimtare dhe se prej tyre varet statusi, por dinamika e zhvillimit të këtij procesi do të varet dukshëm nga progresi i implementimit të këtyre standardeve, prandaj për këtë punë ne- edhe pse dëgjuam këtu shumë brenga të qytetarëve, të deputetëve, të Qeverisë, por në këtë moment ne e kemi vënë si prioritet të Qeverisë përmbushjen e standardeve. Debati zgjati shumë, thashë ishte konstruktiv, por për fat të keqë nuk ishin të gjithë të fokusuar vetëm në standarde dhe ta ndihmonin dhe ta inkurajonin Qeverinë për implementimin e standardeve. Nuk është obligim vetëm i Qeverisë progresi i përmbushjes së standardeve, por i të gjithë neve, i të gjithë qytetarëve, është interes madhor i të gjithëve dhe kam pritur që të gjithë do të japin kontributin e tyre, që të ndihmojnë dhe të punojmë të gjithë në avancimin e përmbushjes së standardeve. Më lejoni që të shpreh, gjithashtu, edhe keqardhjen në këtë institucion aq të rëndësishëm të Kosovës. Nga disa deputetë këtu po përdoren, prapë ofendime dhe shumë akuza të përgjithshme, të paargumentuara me aq lehtësi dhe pa asnjë dinjitet, as njerëzor as intelektual. Vërtet është për t'u befasuar! Janë këto të njëjtat akuza, është ky i njëjti fjalor që jemi duke e dëgjuar që nga dita e parë që u zgjodh kjo Qeveri, pavarësisht nga vendi dhe nga tema. Pyesim a jemi në Parlament, a jemi në debat televiziv a jemi në intervista për gazeta etj, kështu që ne si Qeveri, me insistimin tim, asnjëherë nuk kemi reaguar në këto akuza, duke qenë të përgjegjshëm ndaj qytetarëve të Kosovës që të mos jemi edhe ne ata që ngrisim tensione politike në shoqëri në momentet shumë të rëndësishme për Kosovën. Parlamenti është vendi ku zhvillohen debatet me plotë të drejtë dhe askujt nuk ia mohoj të drejtën që të mos e thotë atë që e mendon, sepse këtu është vendi ku edhe ne do t'i themi mendimet tona.

Debati i sotëm nga disa deputetë u bë dëshmi e qartë sa mashtrim i madh paska qenë parulla se ne luftojmë për shtet dhe jo për pushtet. E dimë dhe të gjithë u pajtuam se standardet janë në favor të statusit për shpejtimin e procesit, janë argumenti kryesor për statusin e Kosovës, por nga bisedat e disa deputetëve u vërejt shumë qartë se ata e dëshirojnë, punojnë dhe mendojnë për dështimin e Qeverisë në përmbushjen e standardeve. Nëse dështon Qeveria në përmbushjen e standardeve, kemi dështuar të gjithë dhe ka dështuar Kosova.

Tash do t'u përgjigjem disa akuzave. Është fushatë e orkestruar dhe reagimi ishte shumë i orkestruar, por e drejtë juaja është, absolutisht nuk e mohoj edhe këtë të drejtë, por disa nga vërejtjet tuaja kanë qenë shumë të dobishme, disa vërejtje do t'i marr në konsideratë,

bashkë me të disa deputetëve të tjerë edhe do t'i shqyrtoj, se është obligim që do ta kryej. Ju falënderoj për disa vërejtje që kanë qenë në funksion të përmirësimit të Qeverisë. Disa nga kritikantët që u adresuan do t'u drejtohen ministrave tanë të cilëve u takojnë. Që në fillim u përmend një çështje, çështja e kufirit. Në vazhdimësi në forume të ndryshme po më imponohet diçka, kinse kam thënë apo kinse kam bërë diçka që është në dëm të Kosovës edhe në media të stimuluar dhe të kontrolluar dhe këtu zotëriu tha diçka që kurrë nuk e kam thënë, se unë do ta zgjidh çështjen e kufirit me kryeministrin Vuçkovski. Kurrë s'e kam thënë dhe lus të jemi transparentë, të jemi të përgjegjshëm ndaj qytetarit, se kurrë nuk e kam thënë atë dhe as nuk pretendoj një gjë të tillë. Unë do të veproj konform ligjit, brenda kornizave që i ka vendosur ky Parlament. Ky Parlament nxori një rezolutë për çështjen e kufirit dhe unë do të sillëm plotësisht sipas saj. e kam thënë këtë dhe do t'i përmbahem, por nuk kam thënë se do të bëj zgjedhje dhe do të marrë hapa, sidomos asi hapash që do të ishin në dëm të Kosovës, po jua heqi atë vesvese.

Vazhdimisht kontestohet legjitimiteti im si kryeministër dhe legjitimiteti i kësaj Qeverie. Unë nuk e kontestoj një gjë të tillë, qytetarët e Kosovës nuk e kontestojnë, unë jam i mandatuara nga presidenti legjitim i Kosovës i zgjedhur nga ky Parlament. Jam i zgjedhur me shumicë votash dhe në mënyrë demokratike nga ky Parlament dhe jam dhe e konsideroj veten dhe Qeverinë legjitime dhe të përgjegjshme ndaj të gjithë qytetarëve e edhe ju jeni qytetarë të Kosovës dhe e ndiej veten të përgjegjshëm edhe ndaj jush. Kësaj qeverie i imponohen paaftësia- një fyerje tjetër që i bëhet- paaftësia nuk e di se me çka matet. Qeveria nuk është vetëm kabineti qeveritar, Qeveri janë 70.000 punonjës civilë të paguar nga buxheti i Kosovës, është një administratë publike ndoshta shumë e madhe. por e trashëguar nga Qeveria në Qeveri etj, Pajtohem e kam parë se ka shumë probleme në emërimet, në kontratat etj, është një trup i cili ka qenë i panjohur deri vonë, por kam filluar të ballafaqohem me te dhe ju siguroj se çdo vendim e çdo kontratë do të jenë konform ligjit dhe do të merrem edhe me këto çështje, por nuk varet vetëm nga ministri se sa një Ministri do të jetë më shumë produktive apo efektive, varet edhe nga stafi, i cili është trashëguar, i cili është zgjedhur vite më parë, kështu që mendoj se është akuzë jokorrekte paaftësia e saj. Ka mungesa, nuk them që është Qeveria më e mirë, nuk themi se jemi duke punuar më së miri, nuk ka edhe kënaqësi në Qeveri etj, por ka gatishmëri dhe vullnet ajo është me rëndësi.

Korrupsioni, është bërë termi më i përfolur këto ditë. Me korrupsion e lidhim edhe ryshfetin edhe keqpërdorimin e detyrës, keqmenaxhmin e buxhetit edhe abuzimet në detyrë dhe të gjitha po i quajmë korrupsion. Ne e kemi thënë dhe prapë them se korrupsioni do të luftohet në Qeverinë e Kosovës, është dukuri shumë e dëmshme, është dukuri dhe besoj se ka korrupsion dhe atëherë kur ta dimë ku është, sigurisht do ta luftojmë. Korrupsioni nuk është diçka që lidhet vetëm me Kosovën apo vetëm atë që e lidh emblema e kësaj Qeverie. Korrupsioni është një sëmundje që e vuajnë shumë shtete edhe më të zhvilluara se ne dhe korrupsioni nuk ka filluar me këtë Qeveri, por ndoshta me këtë Qeveri do të fillojë lufta kundër korrupsionit dhe parandalimi i tij. Nuk mendoj se nuk janë të sigjerta akuzat apo thirrjet për luftën ndaj korrupsionit, kam bindje se kërkohet vetëm koka e disa ministrave apo e kryeministrit edhe me kaq përfundon lufta kundër korrupsionit, u zhduk korrupsioni në Kosovë, përbuzen përpjekjet tona të sigjerta, deklaratimet tona të sigjerta, injorohen instrumentet legjitime, të cilat edhe ky Parlament i

ka aprovuar, siç janë Këshilli Antikorrupsion. Përpjekjet tona për formimin e kësaj agjencie antikorrupsioni plotësisht si të pavarur, u injoruan vlera, pesha dhe rëndësia e auditorit përgjithësisht, por për çudi kur ka ardhur në Parlament të gjithë e kanë mbështetur, mirëpo kur e ftuam tash në Qeveri u tha hajgare është ajo punë. U përmend ministri Petković që nuk është këtu, auditimi i auditorit është negativ, por ne do të veprojmë konform ligjit, por edhe do t'i respektojmë dinjitetin njerëzor, të drejtën e çdo individi të përgjigjet dhe të sqaroj se ku janë problemet. Ministri Petković e ka këtë të drejtë, këtë të drejtë ia garanton ligji, jo kryeministri apo Agim Çeku. Kështu do të veprohet në të ardhmen dhe të mos të harrojmë që akuzat për korrupsion pa fakete janë vepër penale, janë krim në vete, gjithashtu, prandaj të jemi të kujdesshëm. Të vazhdojmë me përkushtim të plotë ta luftojmë dhe t'i parandalojmë korrupsionin dhe çdo parregullsi. Do të vendosim instrumente të ndryshme. Para jush ka qenë Kodi i Mirësjelljes i shërbyesve civilë dhe e ka kthyer Parlamenti dhe ate do ta shndërrojme në një udhëzim administrativ në kuadër të kompetencave të Qeverisë. Ne e kemi miratuar udhëzimin administrativ për qasje publike në dokumentet zyrtare, çdo qytetar do të ketë të drejtë qasjeje në dokumentet publike, do ta inkurajojmë transparencën, do t'i bëjmë publike shpenzimet edhe të telefonave edhe të automobilave. Ju siguroj që do t'i bëjmë publike të gjitha këto dhe do të informohen edhe Parlamenti edhe opinioni për të gjitha këto, por gjithashtu, do ta bëjmë auditivin gjithëpërfshirës që nga fillimi i Qeverisë në Kosovë, jo vetëm nga fillimi i kësaj qeverie, por si kanë punuar edhe qeveritë e mëparshme.

U tha këtu se miqtë tanë na alarmojnë se kemi qeveri të keqe dhe nuk e duan këtë qeveri. Nuk është e vërtetë, miqtë tanë të vërtetë e mbështesin e përshëndesin dinamikën e Qeverisë, mjafton t'i lexojmë vetëm gazetatat, ka asi që nuk e mbështesin, jo vetëm këtë qeveri, por nuk e dëshirojnë që Kosova të ketë fare Qeveri. Besoj se ata s'i ka miq askush. Manipulohen vërejtjet që u dhanë sot këtu. Përgjigja dihet. Skema sociale është një plagë e rëndë e shoqërisë sonë e të gjitha institucioneve. Nuk i ka formuar këto skema sociale kjo Qeveri, nuk është përgjegjëse pse nuk rriten pensionet, pse nuk luftohet varfëria vetëm nga kjo Qeveri, janë probleme që janë pasoja të kaluarës sonë, nëpër të cilën ka kaluar Kosova, janë prioritete të kësaj Qeverie, por dihet se nuk mund të presim që për diçka të akuzohet Qeveria për diçka që nuk ka mundësi. Të gjithë i dimë përgjigjet e këtyre pyetjeve, por që vetëm ceken dhe manipulohet opinioni, që vërtet këto kategori mendojnë se vërtet kjo Qeveri apo Agim Çeku me ministrat e vet pse s'i kemi pensionet apo ai na i ka caktuar 40 euro etj. Këto janë mashtrime, janë nënçmim i opinionit se ata fortë mirë e dinë dhe mos u mundoni se qytetarët tonë e dinë si është dhe sa mund të përmirësohet situata.

Disa nga ligjet që u përmendën këtu, ligjet për lojërat e fatit. E pranoj këtë fakt z. Berat. Jemi duke e shqyrtuar këtë fakt dhe disa vendime të tjera dhe po ju siguroj që të gjitha vendimet do të jenë konform ligjit. Nuk ka mbledhje të Qeverisë që nuk miratohet një ligj dhe nuk është e vërtetë që vetëm 6 ligje presin në Parlament, por 26 ligje presin të miratohen nga Parlamenti, kurse ai në aprovimin e këtyre ligjeve do ta ndihmojë përshpejtimin e standardit. Standardet vetvetiu janë çështje teknike, siç tha z. Bislimi, si i ka shkruar Qeveria. Standardet nuk i ka shkruar Qeveria, standardet të gjithë e dimë se nga koha e Shtajnerit na janë dhënë si të tilla dhe nga ne pritët t'i përmbushim. Nuk e

kisha komentuar atë se a i përngjan një dokumenti të shkruar në forume të Partisë Komuniste, por është e vërtetë se kam qenë i detyruar të jem anëtar i Partisë Komuniste në njëfarë kohe, por atëherë kam qenë shumë i ri dhe s'kam pasur qasje në dokumente të mëdha, ata që kanë qenë në struktura udhëheqëse, mund ta dijnë më mirë.

Pa marrë parasysh ju falënderoj për debat, ju falënderoj në sugjerime konstruktive. Qeveria pa marrë parasysh e respekton të drejtën e çdokujt që ta kritikojë, por kritikata të jenë të bazuara. Nuk mund të thotë z. Haliti se unë kam fakte të sigurta, fakti i sigurtë janë targat e automjetit, dita, data, ora, polici, emri, mbiemri, ky është fakt i sigurtë. Kurse më ka thënë një mik imi nuk janë këto fakte. Korrupsioni luftohet me këto, me bashkëpunim të të gjithëve, të qytetarëve, me fakte, ngjarje, me data me emra dhe para opinionit qoftë ai Agim Çeku apo kushdo tjetër, por të jemi shumë korrektë dhe të mos flasim me thashetheme. Ne do ta vazhdojmë me të njëjtin përkushtim punën. E dimë sa rëndësi ka që vlerësimi të jetë shumë pozitiv edhe tani kur të fillojë vlerësimi teknik, sepse janë dy vlerësime që bëhen. Me 30 prill bëhet vlerësimi teknik dhe kjo seancë do të jetë një argument i fortë në implementimin e standardeve. Standardet janë debatuar në Parlament, do të jetë edhe një argument i fortë dhe një kapitull i veçantë në këtë vlerësim teknik. Është ky vlerësimi i parë dhe i dyti do të bëhet në raportimin e drejtpërdrejtë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurimit më 6. Pasi e kemi prioritet e dimë rëndësinë, jemi të vetëdijshëm për këtë, prandaj Qeveria do të vazhdojë me përkushtim të plotë të shënojë progres në arritjen e standardeve. Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve.

KRYETARI – Ju faleminderit z. kryeministër, fjalën e ka ministri Shatri.
Për replikë është paraqitur Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Faleminderit z. kryetar. Ta them të drejtën z. kryeministër e kam ndier veten keq kur ju kam dëgjuar duke biseduar deri më tani. Ju kisha preferuar që herave të tjera, unë bëjë gabime, kurse kujtoj që ju jeni student, ju mos bëni gabime, mos mendoni se ne jemi ushtarët tuaj. Në anën tjetër ju preferoj që të folni me letër të shkruar, jo kështu çfare ishit, Është shumë gabim të thuhet se ka pasur ofendime, lexojini Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Kornizën Kushtetuese. Deputetët, me përjashtim të ngritjes së urrejtjes nacionale, çdo diskutim tjetër kanë të drejtë ta bëjnë. Tjetër është parulla për shtet dhe pushtet, secili individ që ka hyrë në parti politike ka ambicie pushtetin. Kjo nuk është iluzore, këtë e keni dëshmuar edhe ju z. kryeministër. Edhe keni ardhur për pushtet. Tjetër ju thuani që fati i Qeverisë është fati i Kosovës. Ju lutem Kosova ka pasur shumë qeveri të këqija, por kurrë fatin e saj nuk e kanë përcaktuar ato. Edhe kësaj radhe mos u bëni merak, as unë e as ju nuk e përcaktojmë fatin e Kosovës. Për demarkacionin keni biseduar ju dhe është bërë pluhur nga ju e jo nga dikush tjetër. Çështja e korrupsionit dhe faktet. Ata të cilët i kanë faktet ju çojnë në burg, mua, juve dhe secilin prej nesh, por diskutimet për korrupsionin mendoj se duhet të keni vullnet politik, duhet të keni qëndrueshmëri politike dhe se auditivi nuk është luftë kundër korrupsionit. Më falni unë u shpjegoj njerëzve se çka është auditivi dhe korrupsioni dhe në këtë drejtim po e them, auditivi është për keqmenaxhim të buxhetit, auditivi është për vjedhje të buxhetit, korrupsioni është diçka tjetër dhe mos e mbuloni korrupsionin politik, ekonomik dhe administrativ mbi bazën e auditivit. Mendoj që skema

sociale, askush nuk mendon në Kosovë që kryeministri aktual apo Hajredin Kuçi ka mundësi t'i rritë pensionet, por çdokush në Kosovë prit që Qeveria të bëjë programe sociale. Kjo është e natyrshme; Nuk kërkoj prej jush rrogën si profesor me ma rrit për një ditë, por kërkoj prej jush që ta keni programin se si keni me e ba për një vjet, dy vet, pesë vjet dhe në fund çështjet teknike që duket se aludoi pak edhe me diskutimin tim. Unë po ju them që vendosja e bustit të Volterit ose të Rusos para Asamblesë Franceze nuk është qëndrim teknik, është qëndrim politik dhe filozofi politike e Francës, pas kujt shkojnë, standardet janë filozofi politike, pas të cilave qytetarët e Kosovës duhet të shkojnë. Unë po ju lus që të mos shqetësoheni për vërejtje, po ju citoj Nën Terezen e cila thotë " Nëse dëshironi me u bë njeri i madh keni me fituar miq të rrejshëm dhe armiq të vërtetë," ju keni dashur me u bë i madh dhe i keni të dyjat. Ju faleminderit.

KRYETARI – Urdhëroni ministër Shatri.

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit z. kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë ministra dhe kryeministër. Unë do të sillem rreth vlerësimit dhe përmbushjes së standardit të pestë, standardit për ekonomi. Ju falënderoj shumë për vërejtjet parimore të atyre që kanë bërë vërejtje parimore në përmbushjen e standardit të pestë. Nuk do të përgjigjem për disa qasje të cilat në emër të përmbushjes së standardit të pestë janë sjellë rreth disa temave që nuk kanë të bëjnë me standardin e pestë, por kanë të bëjnë me problemet e zhvillimit ekonomik dhe me problemet sociale etj. Kur jam caktuar në rolin e kryesuesit të përmbushjes së standardit të pestë nga ana e kryeministrit, kam pasur vetëdijen plotësisht të kthjellët që përmbushja e standardeve, në kuadër të tyre dhe e standardit të pestë, do të jetë në dobi të qytetarëve të Kosovës, do të jetë në dobi të institucioneve të Kosovës, të Qeverisë, të Kuvendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës që dëshirojnë të realizohet ëndërra shekullore e këtij populli. Prandaj jam angazhuar unë dhe ekipi që kanë punuar në përmbushjen e këtij standardi me përkushtim, do të themë që jemi angazhuar edhe për një arsye krejtësisht të veçantë dhe praktike. Kemi dëshiruar që me përmbushjen e këtij standardi Ekipit Negociator t'ia krijojmë një platformë të sigurtë që kur të shkojë dhe të ballafaqohet me palën negociatore dhe faktorin ndërkombëtar të ketë ku t'i mbështet këmbët në një terren të fortë, sepse e kemi përmbushur një standard. Nuk e kam të qartë në qoftë se dikush nga anëtarët e Grupit Negociator dëshiron t'i minimizojë rezultatet e arritura dhe t'ia rrënojë dheun nën këmbë vetëvehtes, që çdo ditë e pret dhe që ka fillua.

vlerësimi rresht për rresht i standardit të pestë sikurse i të gjitha standardeve prej 1 deri në 8, bëhet me një teknikë të veçantë. Unë kam pritur që rreth vlerësimit të përmbushjes së standardeve sot dhe rreth këtij debati të kemi materialin e standardeve dhe të shkojmë nga nënstandardi në nënstandard, nga pika në pikë dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave të merret në përgjegjësi për mospërmbushjen e ndonjë nënstandardi që figuron aty i shkruar dhe të kërkohet raportim para vlerësimit teknik të faktorit që është relevant për vlerësimin e realizimit të këtij standardi dhe konkretisht, vlerësimi rresht për rresht i standardit të pestë ka rezultuar se ky standard dhe të gjitha nënstandartet janë realizuar ose janë në proces që do të thotë se asnjë nënstandard nuk ka mbetet me ngjyrë të kuqe, siç është teknika e atyre nënstandardeve që s'kanë filluar në asnjë hap të shënojnë progres. Vlerësimi bëhet në procedura që një deputete këtu i ka përmendur dhe është pra vlerësimi teknik dhe më vonë, vlerësimi politik dhe ky vlerësim u është bërë vlerësimit të

standardit të pestë dhe vlerësimi i këtij standardi është përcjell deri te strukturat relevante siç janë z. Kai Aide, i cili në raportin e vet e ka vlerësuar realizimin e standardit të pestë dhe në raportin e tij decidivisht ka shënuar se një ministri e financave punon sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi dhe rezultojnë se do të kemi një proces buxhetor stabil dhe të qëndrueshëm. Pastaj raporti i Komisionit Evropian dhe më pas raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara „po ashtu „decidivisht dhe shprehimisht ka shprehur me vlerësim pozitiv punën që është bërë në realizimin e standardit të pestë, punë të cilën kryesisht e bëjnë Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, Shtylla e katërt e UNMIK-ut dhe disa ministri të tjera pjesë të të cilave janë në kuadër të standardit të pestë dhe këto raporte janë bërë bazë reale për fillimin dhe hapjen e negociatave për statusin e Kosovës. Nuk besoj që ndonjë qytetar i Kosovës dëshiron që përmbushja e këtyre standardeve dhe rezultati do të ishte ndryshe, përndryshe ne e dimë kush dëshiron që ky standard dhe standardet e tjera të mos realizohen. Dëshmi janë këto raporte dhe këto raporte për të gjithë ne janë të pranueshme dhe janë të kapshme, sepse janë botuar në mjetet tona të informimit.

Si rezultat i këtij procesi pozitiv duhet të them se kemi edhe vlerësime pozitive, të cilat i ka bërë gjatë vitit 2005 Fondi Monetar Ndërkombëtar për proceset buxhetore, pastaj vlerësimet që i bën mekanizmi i stabilizimit asocimit, i cili çdo tre muaj vjen dhe vlerëson punën në përmbushjen e këtij standardi dhe së fundi gatishmërinë e Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian për organizimin e një konference ndërkombëtare me donatorë. e cila është realizuar vetëm pas marrjes së vlerësimit pozitiv nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar, konferencë e cila ka rezultuar me ofrimin nga ana e donatorëve të një shume afro 60 milion euro ndihmë për proceset buxhetore për projektet të cilat Qeveria e Kosovës i ka paraparë si projekte me prioritet.

Çka ka nevojë që të përgjigjem në disa nga çështjet që janë shtruar nga deputetët lidhur me standardin e pestë. Në fund të vitit 2004 Qeveria e z. Haradinaj e ka bërë një gabim, them një "gabim" sepse ka pranuar të paguaj ato fatura të cilat janë përcjellë në tre vjetët e parë në fund të vitit 2004 në përmbyllje, në ditët e para të marrjes së mandatit nga kabineti Haradinaj. Ky është një gabim që është përcjellë dhe duhet ta pranojmë, sepse e kemi vazhduar. Raporti i auditorit, unë besoj se të gjithë këtu në sallë e dinë që raporti i auditorit të përgjithshëm bëhet për vitin që ka kaluar deri në qershor të vitit vijues. Raporti që e kemi marrë nga auditori ka të bëjë me vitin 2004, ju lutem z. kur flasim për shkeljet në bazë të raportit, janë shkelje të argumentuara dhe duhet të flasim me adresë, kush i ka bërë, pse i ka bërë dhe si i ka bërë? Tashmë kemi edhe procedura të ngritura penale në bazë të raporteve të auditorit nga strukturat e atëhershme përgjegjëse në kabinetin qeveritar të asaj kohe, presim raportin për vitin 2005, raportin e auditorit dhe ne do t'i pranojmë vërejtjet dhe rekomandimet, që do të na bëhen me siguri.

Lidhur me transparencën e shpenzimeve buxhetore. Unë jam i sigurtë që edhe ju e dini që raportet mujore, raportet periodike dhe raporti final i dërgohet rregullisht Kuvendit të Kosovës nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Raportin për vitin 2005 e kemi marrë me kohë dhe sipas dispozitave që parasheh ligji për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe është çështje e Kryesisë së Kuvendit dhe e këtij Kuvendi se kur do ta vëjë në rend dite për shqyrtim dhe miratim. Dua të them që raporti ditën që

është dërguar institucioneve relevante, pra atyre që kemi obligim t'ua dërgojmë është publikuar edhe në Veb Faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe të financave dhe unë nuk di tjetër rrugë se si mund të jetë një raport ndryshe transparent. Ne raporte nuk shpërndajmë përmes gazetave dhe nuk shpërndajmë përmes poste.

Buxheti ka pasur vërejtje që bëhen shpenzime që sipas disave janë të paarsyeshme, organizatat buxhetore e kanë buxhetin të cilin e ka miratuar r ky Kuvend, mënyra e menaxhimit të buxhetit në organizatat buxhetore është kompetencë dhe përgjegjësi e vet organizatës buxhetore dhe keqpërdorimi i asaj vjen dita që përmes auditorit vjen dhe publikohet ose qartësohet. Dua të them që standardi i pestë, pra si çështje tjetër ,si çështje zhvillimore nuk janë një, do ta kemi ditën që do të flasim për çështjet zhvillimore dhe për problemet zhvillimore të Kosovës. Lidhur me disa çështje që u thanë këtu, po ju them se Qeveria ka formuar së bashku me Shtyllën e Katërt një grup që quhet Task-forc,që ka filluar qe 2 muaj të funksionojë dhe të arrijë rezultate, jo ku da aq sa në përmirësim, por në inkasimin e fakturave, ka bërë fushatën mediale , të cilën ne e shohim çdo ditë në mjetet e informimit etj. Lidhur me transparencën edhe një herë. Çdo deputet i interesuar mund të vijë në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, por të paraqitet si deputet dhe do të ketë informata të mjaftueshme për cilëndo organizatë buxhetore që i intereson me kusht që ajo të mos keqpërdoret në forma që mund të keqpërdoret dhe mund t'i ketë informatata më të reja deri në ditën e sotshme se kush çka dhe për çka i ka shfrytëzuar mjetet. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Xhevat Bislimi. kërkon 2 minuta replikë.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar, pa dashur më duhet të replikoj. Humbja e durimit nga ana e kryeministrit, përpjekja e tij në paraqitjen e parë që t'i kundërvihet Kuvendit dhe ta marrë në mbrojtje korrupsionin, të bëhet avokat i korrupsionit dhe i krimit të organizuar i shkeljes së ligjeve, është një provë se edhe ky kryeministër do të dështojë si paraardhësit e tij. Unë me të vërtetë shprehi keqardhjen për shprehjen e tij, më vjen shumë keq që në vend se të zotohet para këtij Kuvendi se do ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar, do t'i luftojë të gjitha shkeljet që janë bërë të ligjeve, shpërdorimin e ligjeve, shpenzimet e pakontrolluara të buxhetit dhe në kundërshtim me të gjitha procedurat financiare, ky zotohet se do të vazhdojë të bëhet avokat i të gjitha shkeljeve, i korrupsionit, i krimit të organizuar. Shpreh vërtet keqardhje, për deklaratat që ka bërë, unë nuk kam qenë me te kur i ka bërë, por për ato që i kam parë në gazetë dhe s'kam parë ndonjë reagim të tij në shtyp, mendoj që kryeministri dhe kjo Qeveri, jo pse po e them unë, por është konstatim edhe i ndërkombëtarëve që e kanë humbur bazën legale, e kanë humbur çdo lloj legjitimiteti për ta qeverisur këtë vend, Rohan ka konstatuar se korrupsioni, shpërdorimi i ligjit, krimi i organizuar do ta pengojnë pavarësimin e Kosovës. Këtë nuk e kam thënë unë, vetë OKB-ja ka dalur me këtë konstatim se korrupsioni në Kosovë është në rritje dhe e keqja është se nuk luftohet as nga Qeveria e as nga disa segmente të UNMIK-ut dhe nuk është konstatim imi z. Çeku, kurse sa për akuzat që i bëjmë ne, urdhëroni

KRYETARI – Ju faleminderit, Gjynaze Sylja e ka fjalën:

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA- I nderuari z. kryeministër, ministra. Unë ju falënderoj për bashkëpunimin dhe shprehjen e vullnetit që edhe në të ardhmen me bashkëpunu edhe më tepër dhe përkushtimin tuaj për standardet. Ju falënderoj dhe ju inkurajoj që të vazhdoni në progresin e mëtejme të tyre. Por për të dëshmuar edhe përkushtimin e Grupit Parlamentar të Aleancës dhe timin, në këtë aspekt që konsiston me Rregulloren në fuqi, gjegjësisht të Rregullores së punës së Kuvendit, i nderuari z. kryetar ju lus që të zbatohet rregulla 22.10, në të cilën thuhet se kryetari i Kuvendit, kujdeset për rregullin në Kuvend dhe ia tërheq vërejtjen secilit deputet të Kuvendit ose anëtarit të Qeverisë kur a) diskutuesi largohet nga çështja e shtruar për diskutim, gjë që ngjau sot në Kuvend dhe g) për gjuhë joparlamentare të folur apo të shkruar në Kuvend, i) ofenduese apo shpifëse apo kërcënuese përdoret për sulme apo fyerje personale. Mendoj që e kemi të gjithë përgjegjësinë për mbarëvajtjen e Kuvendit, të jemi jo vetëm racional, por edhe të përgjegjshëm, I kam edhe disa vërejtje, por edhe shqetësime dhe i konsideroj provokim nga deputetët e Partisë Demokratike ngase është paradoksale të ftoheni qytetarët të jenë të papërgjegjshëm ndaj institucioneve, gjegjësisht të mos paguajnë rrymën. Të nderuar deputetë të PDK-së, institucionet e Kosovës janë shtylla e shtetit të Kosovës, kurse qytetarët e Kosovës janë shtetformues, si të tillë kanë obligimin qytetar që të paguajnë rrymën, tjetër është z. Haliti, unë jam qytetare e Pejës dhe në Pejë ka polici dhe zhvillimi ekonomik është më i mirë se në vendet e tjera, kurse Sheremet Ahmeti është kolonel dhe sa i përket z. Ylber Hysa, unë ju falënderoj shumë për ftesën, me qenë pjesë e klubit tuaj, por t'ju kujtoj se ne e kemi klubin tonë dhe quhet Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Me gjithë atë do të vazhdoj në mënyrë konstruktive që të bashkëpunojmë me ju.

E kam edhe një vërejtje të fundit. Kur është folur se zgjedhja e kryeministrit që kryeministri nuk ka pranuar të bëhet me zgjedhjen e votës së fshehtë, rregullat në fuqi flasin se zgjedhja e kryeministrit nuk bëhet nga kryeministri, por nga ky Parlamenti dhe Parlamenti ka vendosur që ta bëjë me aklamacion. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministri Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI - Faleminderit kryetar, pothuase të gjitha i tha kryeministri dhe ministri Shatri çka ka këtë bërë për standardin e pestë, ku ne jemi të përfshirë. Më vjen keq që ne kemi dëgjuar sot shumë nivele të ulta të fjalimeve nga disa deputetë dhe kemi dëgjuar nivele shumë të larta, entuziaste dhe qëllimmira për të punuar më shumë për përmirësimin e gjendjes, të kushteve dhe të standardeve. Ne sigurisht si qeveri nuk mund të merremi me ato nivele, e deklarata që i bënë disa deputetë të opozitës që më shumë i ngjajnë fjalimeve të kafeneve, ku pihet rakia se sa fjalimeve parlamentare. Si do që të jetë unë dua të përgjigjem pasi që nesër me siguri do të diskutojmë për pjesën e privatizimit dhe këtu nuk do të flas edhe pse ai është një vlerësim pozitiv dhe raporti i parë i Këshillit të Evropës flet për suksesin në këtë fushë që e ka pasur Kosova, por do të kemi mundësi të flasim edhe nesër, por do të flas për investimet e huaja që u përmend se nuk ka pasur. Kjo nuk është e vërtetë, vetëm në procesin e privatizimit kemi 15 kompani, ndërkombëtare që kanë blerë prona në Kosovë dhe kanë zhvilluar veprimtari biznesi pa përmendur shumë kompani private që janë duke operuar në mënyrë të suksesshme në Kosovë dhe janë duke krijuar një zhvillim të jashtëzakonshëm. Sido që të jetë ne për këtë çështje mund t'i japim edhe statistikën, në

rast se si deputet do të jeni të gatshëm të vini t' i dëgjoni. Së pari dua ta bëj më të qartë se përvec problemeve politike, moszgjidhjes së statusit dhe çështjeve tjera, problem është shfaqur kohëve të fundit për dekurajimin apo pengesën e investimeve të huaja nga vetë disa zotëri të opozitës, ku kanë marrë pjesë edhe në protestat kundër investimeve të huaja dhe kundër investitorëve të huaj. Ky është një fakt i argumentuar shumë mirë, por si do që të jetë ne kemi arritur që brenda kësaj kohe në fushat e kompetencave që i kemi të krijojmë një infrastrukturë ligjore, disa shërbime për investitorët e huaj, shërbimet në ofrimin e informacioneve dhe ofrimin e dokumentacionit që ata e kërkojnë, por definimi i statusit dhe plotësimi i standardeve dhe të gjitha këto do të krijojnë parakushte që investimet kapitale nga sektori privat, kompanive prestigjioze ndërkombëtare, pa dyshim që priten pas statusit. Mirëpo kësaj çështjeje duhet t' i kontribuojmë të gjithë dhe njëra anë të punoj dhe tjetra anë të ngritet kundër një investitori të huaj dhe të krijohet një imazh i keq për Kosovën, prandaj në këtë fushë imazhit të keq të Kosovës i kontribuuaat edhe ju zotërinj dhe ky është një fakt që ne e dimë, por mendoj se nuk ja keni arritur. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, Bajrush Xhemajli(replikë).

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI –Temperatura e qeveritarëve është për të ardhur keq, më së buti, për të mos thënë për të vajtuar dhe është një shenjë tepër e keqe për institucionet e Kosovës. Qeveritarët që nuk bëjnë kritikë, nuk di sa meritojnë të jenë qeveritarë e atë për shkelje dhe punë të këqija që i bëjnë. Kjo tregon edhe për nivelin e tyre sigurisht, për nivelin që flet z. Dugolli është mirë të shikohet niveli juaj më së pari që jeni në institucione shumë përgjegjëse. Unë desha t' i them tri fjalë z. Shatri sa i përket standardit nr. 5 për të cilin keni folur. Ju z. Shatri ,nuk keni nevojë ta merrni kryeministrin Çeku në mbrojtje se ai ka qenë i obliguar të jetë këtu para së gjithash dhe nuk është mirë të hyni në punë që nuk i njihni , për shkak se për dimensionin që ju flisni është katastrofal ,prej se ka ardhur z. Çeku aty. Ka qenë puna e faturimit që e përmendët ju si argument, ju keni folur shumë në mënyrë të përgjithësuar, këtë argument e keni përmendur dhe këtë e keni gabim. Ka qenë 50% shkalla e mosfaturimit, tash është bërë 60%, E kundërta është dashur të ndodhte për t'u plotësuar ai standard që po flisni, prandaj edhe ju keni përgjegjësi, siç kemi ne dhe siç ka çdokush sipas nivelit dhe përgjegjësisë që ka e ka në shoqëri. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUIP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Diskutimet e fundit më obliguan që të dal edhe një herë në foltore edhe pse nuk isha as për diskutimin e parë dhe as për të dytin , por megjithëatë dua t' i them disa çështje. Unë sinqerisht nuk mund ta kuptoj kryeministrin z. Çeku, prej nga e merr guximin për ta mbrojtur një kabinet qeveritar të trashëguar i cili ka shkelur të gjitha ligjet dhe procedurat në fuqi të cilat ata kanë qenë dhe janë të detyruar t' i mbrojnë dhe t' i avancojnë. Me këtë e bëni gabimin më të madh të mundshëm dhe sinqerisht më vjen keq. Nuk di se si diksh nga koalicioni qeverisës merr guxim të vendosë të bëjë lëvdata për ata individë apo ish- individë që kanë instaluar keqqeverisjen, korrupsionin, papërgjegjësinë, paligjësinë në institucionet e Kosovës dhe të gjitha këto dukuri janë duke e rrënuar në rend të parë standardin e

qytetarëve të Kosovës. Unë nuk po flas për standardet politike, prandaj edhe unë dëshiroj të distancohem edhe pse distancimi është relik i sistemit të kaluar, por unë dëshiroj të distancohem nga ata që nuk janë të gatshëm ta dëgjojnë zërin e opozitës, që unë mendoj që ishte zë shumë i arsyeshëm, zë që vjen nga shqetësimet.....

KRYETARI – Keni kaluar kohën z. Krasniqi, jeni paraqitur për replikë. Le t'i vazhdohet koha.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Ne nga fillimi i kësaj legjislature në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kemi kërkuar formimin e një komisioni hetimor, në mënyrë që t'i hulumtohet dukuritë negative dhe jo të njerëzve të Qeverisë aktuale, por t'i hulumtohet dukuritë negative edhe në Qeverinë e kaluar, por as koalicioni qeveris që me vota ka penguar hulumtimin dhe vërtetimin pasi po i quani akuza, të akuzave që i kemi ngritur ne edhe pse nuk kanë qenë akuza, kanë qenë shqetësime të bazuara të cilat po vërtetohen dita ditës, prandaj edhe një herë z. kryeministër më vjen keq që po i merr në mbrojtje një kabinet që në kontinuitet i ka shkelur ligjet dhe vërtet nuk ka sunduar me ligje, por ka sunduar me urdhëra që i kanë marrë nga parapolitika që është thënë dhe është përsëritur disa herë këtu.

KRYETARI – Ministri Agim Veliu e ka fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU – Faleminderit kryetar, të nderuar deputetë. Edhe pse nuk jam në udhëheqjen e asnjë grupi për përmbushjen e standardeve, me gjithë atë unë dhe Ministria e Arsimit jemi të përkushtuar në përmbushjen e standardeve që lidhen me lëmin e arsimit. Të arriturat janë evidente, disa prej të cilave i theksoi edhe deputeti Nimon Alimusaj ,për çka e falënderoj. Të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës i falënderoj për vërejtjet, sugjerimet konstruktive dhe këto vërejtje sigurisht do të më shërbejnë gjatë punës sime të mëtejme.

Sa u përket akuzave deputetët kanë të drejtë të dyshojnë, mirëpo nuk kanë të drejtë të akuzojnë pa fakte dhe argumente. Akuzat, ju lutem drejtoni në organet kompetente, sepse ato janë për ate që të mirren me çështjet që janë në fushëveprimtarinë e tyre. Në foltore dola për t'i sqaruar edhe dy çështje, gjegjësisht për t'u dhënë informacion deputetëve të Kuvendit të Kosovës, sepse disa prej deputetëve gjatë diskutimeve të tyre po shërbehen me gjëra që nuk qëndrojnë dhe janë të pavërteta. Nën nje, deputeti Hashim Thaçi e tha se janë mbyllur më se 50 çerdhe të fëmijëve, kjo nuk qëndron. Të gjitha çerdhet e fëmijëve në Kosovë punojnë, e kam fjalën për çerdhe publike, po ashtu janë të licencuara edhe disa çerdhe private të cilat punojnë në Kosovë. Është fjala për mbylljen e disa paraleleve parashkollore në Kosovë dhe këtë mund ta ngatërroj z. Thaçi meqë nuk e njeh mirë sistemin e arsimit në Kosovë, për këtë lloj edukimi parashkollor janë kompetente komunat e Kosovës. Unë ju informoj edhe për numrin e paraleleve që janë mbyllur deri tash në Kosovë nga komunat e Kosovës pas vështirësive që i kanë pasur me numrin e dëbuar të punëtorëve të arsimit. Në Komunën e Kaçanikut janë mbyllur 8 paralele, në Podujevë janë 5, në Shtime është mbyllur një paralele, në Vushtri janë mbyllur 6, në Mitrovicë është mbyllur 1 dhe në Skenderaj janë mbyllur 14 paralele parashkollore. Unë e pashë një tendencë të politizimit të kësaj çështjeje nëse kët doni ta shëndërroni në

politikë, atëherë unë ju them se prej 35 paraleleve 23 paralele janë mbyllur në komunat ku udhëheqë PDK-ja, kurse 12 paralele janë mbyllur në komunat ku udhëheqin të gjitha partitë e tjera. Një sqarim tjetër u tha nga Veton Surroi se arsimi në Kosovë sot është më keq se para 20 vjetëve. Unë këtij konstatimi i përgjigjem me një kundërkonstatim. Para 20 vjetëve në Kosovë regjimi i Millosheviqit ka qenë në kulminacion të fuqisë dhe pikërisht në këtë kohë kanë qenë të suprimuara të gjitha programet nacionale shqiptare. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, ministri Ardian Gjini e ka fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – I nderuar z. kryetar i Kuvendit, kryeministër të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sot kam besuar dhe jam përgatitur se do të flitet shumë më tepër për standardin e 6 dhe nuk është folur shumë befasisht, prapëseprapë do t'i radhis disa të arritura. Është folur vetëm shkarazi dhe është përmendur çështja e Hades dhe çështja e Kampit të Plemetit. Kampi i Plemetit po mbyllet, është e vërtetë se ka pasur ngecje, nëse do të ketë edhe kërkesa konkrete pse ka pasur ngecje deri sot, një prej arsyeve që do të mund ta them këtu ka qenë edhe mosparashikimi i motit, ndoshta do t'ju duket interesante po ka pasur një kohë të gjatë që s'ka mund të punohet sidomos për çështjen e gypave. Çështja e Hadës duhet të shpjegohen disa detaje këtu për shkak se kanë mbetur disa si të mbuluara. Nën një, vendimi për zhvendosjen e fshatit Hade është marrë në vitin 2001 diku në qershor, në qershor të vitit 2004 janë vendosur edhe kriteret për vlerësimin e pasurisë së fshatit Hade, në vitin 2004 është paraparë edhe dinamika e kompensimit të këtyre pronave, ajo që ka ndodhur aty e tutje ka qenë përmbushje e dinamikave dhe planit të paraparë në qershor të vitit 2004 bile, ish- kryeministri Rexhepi edhe e ka venë gurthemelin e objektit i cili është paraparë që banorët e fshatit Hade të strehohen. Ata sot e refuzojnë një gjë të tillë, mirëpo atëherë është vendosur kjo. Çka ka bërë Qeveria tash i ka ndërruar disa prej kushteve ose kriterëve për vlerësim në dobi të banorëve të fshatit Hade, edhe të fundit që do ta them dhe nëse dikush mendon se janë të zhgënjyer me Qeverinë e Kosovës, ata kanë të drejtë të jenë të zhgënjyer me Kosovën për shkak se kanë ardhur në pozicion që të largohen prej shtëpive të tyre, mirëpo sa i përket kompensimit besoj se vlera e kompensuar për një shtëpi nuk mund ta kompensonte çmimin e shtëpive të shumicës të njerëzve që janë prezentë në këtë sallë të deputetëve, ministrave dhe shumë të tjerëve, d.m.th. ka qenë një kompensim më se fer, kjo edhe është vlerësuar.

Pikat e tjera nuk janë përmendur dhe unë nuk do t'ju lodh shumë, por do ta theksoj një të arritur shumë interesante në implementimin e standardeve në Kosovë. Po na kalon disa si e fshehur. Në vitin 2003 dhe në vitin 2004 Qeveria e atëhershme e Kosovës së, Kuvendi i Kosovës edhe deputetët e saj jo vetëm që kanë hezitur të kyqen në implementimin e standardeve, mirëpo edhe kanë refuzuar disa prej ministrave që t'i udhëheqin grupet e punës për implementim të standardeve. Po flas për deputet sot të opozitës, ndërsa sot të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, Qeveria akuzoht për mosimplementim të standardeve. Është shumë ointeresant, kjo është një e arritur shumë e madhe, po ju tregoj pse është e arritur shumë e madhe, për shkak se kjo tregon që standardet për Kosovën nuk janë një proces që udhëheqet vetëm prej Qeverisë së Kosovës, këtë e ka kërkuar Bashkësia Ndërkombëtare prej nesh. Është një proces nacional tanimë për shkak se

Qeveria po pretendon para popullit se po i implementon standardet dhe po konsideron se implementimi i standardeve është diçka e mirë edhe për popullin e Kosovës, ndërsa opozita në të njëjtën kohë po i thotë Qeverisë nuk i keni implementuar standardet dhe prapë dëshmon se është diçka popullore që është shndërruar dhe besoj se kjo duhet të shënohet në raportin si teknik po ashtu edhe politik të implementimit të standardeve.

Diçka tjetër është shumë interesante, po ashtu. Duhet të ndahen dy pjesë të implementimit të standardeve për shkak se ky forum nuk bën ta lë përshtypjen as te publiku i Kosovës, po as te vlerësuesi ndërkombëtar se ne vetë kemi dilema, a janë implementuar një pjesë e standardeve apo jo. Edhe këtë do ta shpjegoj. Standardet, për të cilat sot kemi folur në Kosovë janë diçka tjetër nga standardet të cilat janë vendosur si standarde prioritare për t'u implementuar, të cilat janë shumë të thjeshta dhe të qarta. Bashkësia Ndërkombëtare që moti e ka kuptuar se përmbushja e standardeve çfarë janë kërkuar sot këtu do të marrë shumë kohë, për atë arsye i ka thjeshtuar në pika të sakta të cilat janë qoftë legjislacion, qoftë veprime konkrete që duhet të implementohen në teren. Unë nuk dyshoj fare se shumica e deputetëve i ka lexuar këto pika dhe duke mos e pasur këtë dyshim nëse ishim ndalur te vlerësimi pikë për pikë dhe nëse dikush do ta kishte shtruar pyetjen, p.sh për ministrin e Mjedisit, pse ka grumbullim të rasteve nëpër gjykata që ka të bëjë me pronën, do ta kishim pa se Kuvendi po interesohet për atë implementim të standardeve i cili i hap shumë procese në Kosovë. Është shumë mirë që Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe nga Kosova që të plotësohen edhe standardet tjera, mirpo ne nuk guxojmë të dalim nga ky forum duke lënë përshtypjen se Kosova nuk po i implementon standardet prioritare të cilat janë në listë për shkak se ato janë duke u implementuar, ka qenë vlerësim i vazhdueshëm që janë duke u implementuar dhe besoj se të gjithë ju besoni se është tepër me rëndësi që ne të tregojmë që besojmë se standardet po implementohen, në të kundërtën do të kishte pasoja shumë serioze edhe për Kosovën dhe për të gjithë ne definitivisht, për popullin e Kosovës duke mos pranuar implementim të standardeve dhe duke e rritë në atë formë pa e ndarë e njëfarë forme sikur po ja largojmë cakun vetes, po e largojmë cakun që duhet goditur, caku i cili pritet që do ta godasim shumë shpejt, për shkak se do të jetë tepër e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Ju falënderoj shumë, nëse ka pyetje për standardet jam i gatshëm përsëri të përgjigjem.

Ju kisha lutur shumë edhe për një minutë z. kryetar i Kuvendit. Të kthehem për dy çështje që janë diskutuar këtu në lidhje me qeverisjen në përgjithësi. Disa i preka po flasim për korrupsionin, foli pak më gjatë kryeministri i Kosovës, besoj se koncepti i korrupsionit, pesha që e ka fjala korrupsion dhe dëmin që ja shkakton shoqërisë si e tillë dhe perceptioni i njerëzve për atë dëm që e shkakton korrupsioni është degraduar totalisht, është degraduar për shkak se fjala korrupsion është përdorur për gjithçka në cilin do rast edhe tani më është krijuar njëfarë ndjenje te njerëzit e Kosovës që gjithçka është korrupsion, çdokush është i korruptuar dhe s'kemi çka me bë. Kjo është shkaktuar kryesisht prej opozitës e pak më tepër prej mediave. Unë thërras sot këtu që kur flitet për korrupsionin të argumentohet, është e pavërtetë që shumica e Qeverisë janë të korruptuar, është e pavërtetë që shumica e Kosovës është e korruptuar, është e pavërtetë që gjithçka që është në Kosovë është korrupsion. Duke paraqitur gjithçka si korrupsion po e topisim

energjinë e vendit tonë, jo vetëm të Qeverisë, por të vendit tonë për ta luftuar këtë fenomen kaq të keq. Ju falënderoj të gjithëve.

KRYETARI – Ju faleminderit, për fjalë është paraqitur Fetah Berisha

DEPUTETI FETAH BERISHA - Faleminderit z. kryetar. Atëherë kur e kërkova fjalën në fillim e që është dashur të ma jepni kisha parasysht t'ju thosha këtë. Nëse ju z. kryetar sonte na siguron fjetjen në Prishtinë debatin e vazhdojmë deri nesër në mëngjes, por nëse jo atëherë është mirë që të përcaktohem se këtë debat do ta vazhdojmë nesër, pse po them kështu, sepse u pa një riaktivizim i debatit në këtë Parlament, gjë që edhe unë jam në takord, por jo në këtë mënyrë. Zëri i opozitës duhet të dëgjohet zotëri, jam në takord plotësisht, por jo zëri i opozitës të dëgjohet në mënyrë destruktive, ju lutem a është e mundëshme se kjo Qeveri e koalicionit tani e formuar pas 3 zgjedhjeve që u bënë të shihet çdo gjë e zezë, apo ndoshta dikush e përdor parimin se aty ku nuk jam unë çdo gjë është e zezë, aty ku jam unë çdo gjë është e bardhë, në asnjë mënyrë, aty ku jam unë çdo gjë bëhet mirë dhe tani sikur e dëgjojmë se i del kuptimi se këtu në këtë Qeveri të quhet ëmble e kimit, të quhet ëmble e korrupsionit është e tmerrshme dhe kjo është destruktive, kjo nuk është konstruktive, prandaj ju lutem sot e kemi pasur temën ne për implementimin e standardeve, z. kryetar është mirë që foltorja të mos përdoret asnjëherë më jashtë temës që e kemi këtu në rendin e ditës, sot ka ndodhur kjo d.m.th është përdorur në një lojë fjalësh destruktive, ju lutem të përcaktohem dhe ta vazhdojmë nesër apo sonte nëse na siguron fjetjen në Prishtinë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Nuk varet prej meje se a do të vazhdojmë sonte apo nesër, varet prej atyre që e kërkojnë fjalën dhe unë dua të jem i sinqertë dhe i drejtë para secilit, e kam të drejtën me Rregulloren të punës që edhe Qeveria ta marrë fjalën e cila sulmohet tanë ditën dhe me një fjalor shumë të vrazhdë. Fjalën e ka z. Veton Surroi.

DEPUTETI VETON SURROI – Ju faleminderit z. kryetar. Meqë u ftova këtu edhe si anëtar i delegacionit të Kosovës t'i them pesë pika të shkurtra. E para është se debati është disperzuar tej nevojë, ne jemi fokusuar në funksionimin e shtetit dhe ky është thelbi i standardeve, nëse merret nga ky aspekt nga aspekti i dallimit dhe formës së përmbajtjes ashtu siç thamë në fillim atëherë njeriu do të shfajtoj se nuk ka këtu anëtar të Kuvendit të Kosovës i cili është kundër implementimit të standardeve as që do të ketë anëtar të Kuvendit i cili do t'i gëzohet mosimplementimit nga ana e Qeverisë, unë besoj se vërejtjet e opozitës duhet t'i kuptoni si ngasje që të implementohen e jo si keqdashje që standardet të mos implementohen. Në masë të madhe nga aspekti i makropolitikës të them ashtu, nga aspekti i procesit negociator standardet do të marrin një notë pozitive, sepse dinamika e procesit negociator nuk është e vendit, tjetërkush e tërheq këtë dinamikë edhe ata të cilët e ndihmojnë procesin negociator ata do të ndihmojnë që të jepet një notë pozitive e që është ajo pjesë e bashkësisë ndërkombëtare e cila e ka ndihmuar këtë çështje. Për tri çështje jam ndier sikur në kursin fillestar për funksionimin shtetit. Çështja e parë te standardi ekonomik, kur e kemi vlerësuar ose kur thash se 70% e buxhetit të Kosovës mbushet nga të ardhurat doganore kjo është karakteristik e funksionimit të shtetit, kjo është natyra e funksionimit të ekonomisë dhe të politikës në Kosovë. Ju mund

të thoni se është rritë ky ose ai, ajo pikë e standardeve ekonomike; por në thelb kjo është ekonomi disfunksional dhe ekonomia disfunksionale krijon shtet disfunksional dhe ju nuk keni krijuar struktura funksionale të ekonomisë, në radhë të parë ato që merren me tatime. Më tregoni ju lutem se çfarë është përpjesëtimi, cili është dallimi i përpjesëtimit në mes të ardhurave doganore dhe tatimit të brendshëm dhe ku ka ndryshuar ky përpjesëtim gjatë qeverisjes tuaj, nuk ka ndryshuar. Çështja e dytë, te sistemi pensional nuk ka pasur kush këtu që do të thoshte që për 30 ditë këtu duhet të krijohet një sistem pensional ose do të përmirësohen pensionet, çështja është se a ka Kosova sistem pensional apo jo dhe përgjigja është jo, sepse Ministria për çështje sociale është Ministri e cila ka më së shumti para e këto para janë më të shumta sepse jepen në formë pensionesh që janë ndihma sociale, nuk kemi ndërlidhje në mes të kapitalit të ri të krijuar dhe pensioneve që u jepen pensionistëve. Çështja e tretë korrupsioni, e kisha lutur Qeverinë që të mos dalë këtu dhe të mbrojë korrupsionin duke thënë se nuk jemi konkret, konkret është raporti i auditorit i kuvendeve komunale, konkret ka qenë dokumenti i Vila Gërmisë dokument që është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës, këto janë të gjitha çështje konkrete të keqpërdorimit të parasë, është tjetër se a është përgjegjëse kjo Qeveri apo jo, por fenomeni i korrupsionit ekziston, pse është kaq i disperzuar. Pse është nocioni kaq i gjerë, për shkak të mosndëshkimit, sepse qytetarët mendojnë se me qenë se nuk ndëshkohet korrupsioni të gjithë janë të korruptuar, duke na përfshirë të gjithë neve deputeteve të Kuvendit të Kosovës. Çështja e katërt, e arsimit, unë thashë 20 apo 30 vjet, mund të jetë viti 85, mund të jetë viti 75, në masë të madhe funksionimi i Universitetit të Kosovës edhe në kushte të rezistencës ndaj pushtetit të Millosheviqit edhe funksionimi i shkollave fillore dhe të mesme ka qenë më cilësor në standard karshi standardeve të tanishme të arsimit, sepse kemi një gjendje të këtyllë e që duhet sanuar. Karshi rrethanave të tanishme ne kemi një devalvim të sistemit arsimor dhe shëndetësor në të cilin qytetari përfshihet në një lloj darvinizmi, po që se nuk ka para, nuk do të ketë arsim, as shëndetësi, po që se do të ketë para do të ketë një lloj arsimit dhe një lloj shëndetësie. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, janë apostrofuar Xhavit Haliti dhe Berat Luzha dhe diskutime tjera nuk ka.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Dola për dy replika, i kam katër minuta. Z. kryeministër besoj që fjala ime ka qenë të të ndihmuoj ty e jo me të ofendoj.

I është drejtuar Qeverisë, sepse tani kemi një ministër të brendshëm, dhe mendoj që qoftë se ju informoj publikisht dhe shqetësohem publikisht. Ju obligojmë më shumë të punoni për interesat e këtij vendi, se nuk e pata ndë mend me t'ju ofendua dhe me të kritikuar personalisht, as qeverinë tënde, por realiteti është ky:

Në qoftë e mendon që nuk është kështu, atëherë tu kisha lutur, meqenëse e di që nuk ke mundësinë të dalësh andaj kufirit në Mal të Zi, ta qosh dikën te kulla dhe të shohësh kamionët e varguar që presin nga pesë gjashtë ditë kur vjen ndërrimi i përshtatshëm të hyjnë në doganë, pa dogana me kalua në Pejë, shko kah Shkupi dhe shihe se atje presin të njëjtën mënyrë nga pesë gjashtë ditë për të hy kur të vjen ndërrimi i përshtatshëm dhe shko nga Mitrovica dhe shih atje patriotizmi serbo shqiptar ose internalizmi serbo shqiptar është ndërtaur në nivelin më të madh të duhur e ndoshta edhe ai Ivanoviq, jo ky

deputeti, por ai tjetri është pjesë i kësaj formule që po funksionon, prandaj unë nuk jam polic dhe nuk jam ministër i tyti me të raportuar, unë publikisht po tregoj atë që jam shumë i sigurt që është, ti vërtetoje ose mos e vërteto është problem i Qeverisë.

Sa i përket z. Gjynaze, e cila merr nga një herë kompetenca pa pasur nevojë dhe pa qenë e obliguar, dua t'i them se s'e di kur ka qenë në Pejë për herë të fundit ndoshta ke qenë në Dukagjin dhe ke parë ata punojnë, e ke parë që funksionon Dukagjini dhe vërtet funksionon shumë mirë, firma Dukagjini, punon dhe funksionon dhe ndoshta e ke parë Fabrikën e birrës në Pejë, e vetmja punon dhe e vetmja ka mbajtur një kategori vërtetë njerëzish, po dua të them se Peja ka pasur një Kombinat të Këpucëve, i cili ka punësuar me mijëra punëtorë e veçanërisht gjininë të cilin ke obligim edhe ti më shumë por edhe unë që ta mbrojmë shumica kanë qenë femra, dhe ai është i privatizuar dhe është i mbyllur tërësisht që nuk po punon.

Po shkojmë më poshtë, ka qenë një fabrikë Ufta që i kanë pas thanë e pjesëve metalike që edhe ajo nuk punon, është privatizuar, është një Kombinat i Drurit i cili privatizua dhe është shëndëruar në park dhe pret fillimin e ndërtimit, dhe shumica e teknologjisë që ka qenë e blerë aty rinë.

Është një fabrikë e auto pjesëve Ramiz Sadiku që ka pas disa mijëra punëtorë dhe të shkretët janë pa punë dhe ai është i mbyllur dhe privatizuar dhe përveç se të shitet ai nuk ka mundësi funksionimi, dhe është një fabrikë e biçikletave e cila është shndëruar në vetëshërbim dhe është blerë për fabrikë edhe ajo nuk funksionon dhe më tutje.

Dyqanet njerëzit i kanë hapë për me mbijetua, nuk i kanë hapur me fitua. Ka përendu koha e çarshisë ku thoshin ku ka kushtuar një metër katror 100 mijë marka, sepse ka qenë qendër e biznesit, qendër ku është shitur ari. Njerëzit dalin në dyqane, por unë kam informata që ata ndodhë që në dite as 5 euro mos të bëjnë pazar, prandaj ky biznes nuk qëndron në Pejë. Dhe dua të them edhe diçka për siguri, t'i besoj që je nga qyteti, kur bëhet ora 6, 30 në Pejë qyteti boshatiset dhe kjo për shkak pa sigurisë jo për shkak qefit, as për shkak të iftarit se iftari ramazan e kuptoj që shkojnë njerëzit e bëjnë iftar në shtëpi, po është një dukuri që tek qytetarët e vjetër tek njerëzit të cilët janë mësuar dhe është bërë një traditë që në orën 10 qytetarët dalin më shpesh, sepse thonë që problemat kanë shkuar dika dhe janë fshehur se s'kanë guxim me dalë natën. Është përgjegjësi e rendit kjo dhe për të dhënë si akt moral dorëheqje mendoj që ministrit aktual po i drejtohet në qoftë se kërkon për njerëzit përgjegjës që të japin dorëheqje detyra për shkak gabimeve që ka bërë administrata e tij ky do të jetë ministri më i suksesshëm se do të ketë fuqi t'i kontrollojë të tjerët. E kemi pas një komandat të madh që tash i mban paletat e gjeneralit dhe po them që ka ndodhur që ai ka pirë tërë ditën në kafe nga 4, 5 orë dhe ushtarët janë mbajtur në shpinë dhe ky e ka mbajtur pizgaverin se po flasë me gjuhën e ish- ushtarëve dhe prapë askush s'ka kërkuar llogari prej tij dhe sot i mbanë paletat e gjeneralit. Nuk po dua që të përsëriten gabimet e kaluara edhe me gjeneralët e kushdo qofshin ata. Ju faleminderit.

KRYETARI – Faleminderit. Z. Luzha, 2 minuta i keni.

BERAT LUZHA- Faleminderit z. kryetar. Unë vetëm dua ta njoftoj z. kryeminister se qysh në shtator të vitit të kaluar i kam bërë një pyetje parlamentare kryeministrit paraparak para tij, dhe dy herë është fut në rendin e ditës pyetja ime parlamentare dhe asnjëherë nuk është përgjigjur. Edhe pyetje të tjera kam pasur e Kabineti nuk është përgjigjur për ato pyetje.

Pyetja ka pas të bëjë me Ligjin për lojnat e fatit. Një ligj i cili është suspenduar, është pezulluar nga Qeveria. Qeveria nuk ka të drejtë t'i pezullojë ligjet që i miraton Kuvendi dhe i nënshkruan PSSP-ja, nuk ka kryeministri se çka ta vërtetojë a është ashtu a po nuk është për shkak se është e drejtë ekskluzive e PSSP-së dhe jo e Qeverisë t'i zhvlerësojë, t'i pezullojë ligjet.

Sa për numrin e ligjeve unë kam thënë se janë 6 që janë në procedurë parlamentare dhe ajo qëndron, duhet të shihet lista e ligjeve të miratuara dhe të shihet se vërtetë kjo Qeveri, unë kur e quaj këtë Qeveri, e quaj që nga dhjetori i vitit 2004 e jo që nga tash se është e njëjta përbërje dhe këto ligje kjo Qeveri edhe ato ligje që janë miratuar nuk i zbaton Qeveria e Kosovës vepron ende i zbaton ligjet e miratuar dhe të ish- Jugosllavisë.

KRYETARI – Diskutuesi i fundit ministri Rexhepi.

MINISTRI FATMIR REXHEPI – Faleminderit z. kryetar. Unë edhe një herë vetëm për një sqarim apo një sugjerim që me gjithë atë u mbajtën disa leksione ,por edhe u shtruan drejtë disa çështje s'po dimë a duhet krejt në këtë seancë me i shterë krejt ato. Fjalën e kam te z. Xhavit Haliti, i cili herën e parë kohën që e mur si anëtar i Kryesisë kuptoj se ishte tepër, duhet me pa vetë, mua s'më ka penguar ajo, por do të thotë është mirë me e pa.

Tjetra temë që nxirren një pas një dhe që trajtohen nuk besoj që kemi kohë edhe mundësi që tash të gjithave me i dhanë përgjigje adekuate, duhet të jem të përgjegjshëm. Unë po e them për atë që e shtroj çështjen që e ngriti lidhur me Pejën që e përmendi apo përgjegjësinë nuk ka pse as ministri e as kush tjetër, as sot as nesër të mos kërkojë përgjegjësi për një punë që është bërë. Do të ishte shumë e keqe shumë e ulët mos me bë një veprim konkret, prandaj kur t'i vjen koha do të bëhet.

Por e kam këtë tjetrën se mendoj se e di shumë mirë Komizën Kushtetuese jo veç sot por prej fillimit interpretuesi i drejtë i saj, prandaj duhet me u sjell edhe na konformë asaj çfarë mundësie kemi dhe çfarë detyre mund t'i kryejmë sot. Unë nuk jam ai që i jap shumë kohë ose gjatë ose gjerë, por një po e them. Sa i përket kontrollimit të pikave kufitare shumë mirë e din ti se kush i menaxhon ato, në qoftë se thuhet kjo është Shërbimi Doganor i UNMIK-ut ose është kështu, ose në qoftë se thuhet se Shërbimi Policor i Kosovës menaxhohet nga komisari i policisë e di ku është edhe ai e ka adresën edhe emrin, e në qoftë se thuhet në Rregulloren 2005/54 se do t'i delegohet një pjesë e përgjegjësisive në fazën e dytë tek gjatë muajit maj e tutje në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që është themeluar para pakë ditësh, atëherë kujtoj se kjo të jetë një përgjigje, nuk kemi çka me hezitu as unë, unë do të jem për veti në këto detyra me

punua për të mirën e kësaj, së si pesë e parë për atë çka the ti që nuk do ta marrin përgjegjësi dikën.

Ndërsa raportimi brenda Qeverisë i ministrit me kryeministrin që potencove mendoj që ishte jokorrekt tu i ditë këto mundësi edhe këto rrethana. Është një punë jona që e bëjmë për ditë, prandaj duhet të raportojmë, duhet të japim llogari, duhet të japim përgjegjësi, ata që e kanë detyrën. Absolutisht unë do të jap si ministër në momentin kur i kam përgjegjësitë e mia për detyrat dhe veprimet në qofshin ato çfarë i sjell koha. Faleminderit.

KRYETARI - Ju faleminderit. Pas 9 ore debati herë të vrazhdë, prapë ju faleminderoj për kontributin që e keni dhënë, natyrisht edhe Qeverinë që është përgatit nga partitë. Shihemi nesër në orën 10,00 dhe vazhdojmë me pika të tjera të rendit të ditës.

VAZHDIMI I SEANCËS PLENARE MË 21.4.2006

KRYETARI – Të nderuar deputetë, ju dëshiroj mirëseardhje në seancën e sotme plenare që është vazhdim i seancës së kaluar.

Një mirëseardhje të veçantë, shefit të Shtyllës së Katërt të UNMIK-ut z. Ruecker Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë

Ju njoftoj se në sallë janë të prezentë 82 deputetë. Me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe me miratimin e Kuvendit e me qëllim të përgatitjes së debatit lidhur me këtë çështje, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që deputetëve dhe Kuvendit t'ua prezantojë raportin lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë.

Njëkohësisht Kryesia e Kuvendit iu ka drejtuar shefit të Shtyllës së Katërt të UNMIK-ut z. Joachim Ruecker me kërkesë se një informatë me shkrim dhe një fjalë hyrëse e tij do të ishin mirëpritur nga deputetët e Kuvendit.

Z. Ruecker iu përgjigj kërkesës së Kuvendit, andaj e ftoj që i pari ta marrë fjalën.

Urdhëroni z. Ruecker.

SHEF I SHTYLLËS SË KATËRT TË UNMIK-ut JOACHIM RUECKER - Z. kryetar i Asamblesë, z. kryeministër, ministra, anëtarë të respektuar të Asamblesë,

Është kënaqësi dhe nder për mua që t'ju flas sot për procesin e privatizimit në Kosovë.

Ky proces është me të vërtetë vendimtar për ekonominë e Kosovës, e cila është ende në rrethin vicioz të zhvillimit të ulët, papunësia e lartë, një çekuilibër i madh dhe përmbajtje fiskale. Rruga e vetme për të dalë nga ky rreth vicioz është nëpërmjet zhvillimit të fuqishëm të sektorit privat, duke tërhequr investimet e fuqishme në sektorin privat. Për këtë, procesi i privatizimit është kryesor – dhe po fillon të funksionojë. Nga të gjitha që ne i dimë dhe ato të konfirmuara nga misioni i fundit i FMN-së, ekziston një zhvillim i rëndësishëm në sektorin privat në Kosovë, duke çuar në zhvillimin e projektuar të gjithmbarshëm të ekonomisë rreth 3% në këtë vit, me gjithë zvogëlimet e shpenzimeve publike. Me fjalë të tjera: sektori privat, jo më tutje sektori publik ka filluar të bëhet mjet i zhvillimit dhe se kjo është e tëra që ka të bëjë me funksionimin e ekonomisë së tregut.

Më lejoni ta shfrytëzoj këtë rast që në fillim për të shprehur mirënjohjen time për të gjithë personat dhe institucionet që janë duke e përkrahur privatizimin në Kosovë: ju si anëtarë të Asamblesë, të Qeverinë dhe në veçanti zëvendës kryesuesin e Bordit të AKM-së ministrit Bujar Dugollin po ashtu edhe ministër Haki Shatri dhe znj. Sllavica Cvijanoviç, alternativë e ministrit Sllavisha Petkoviç. Po ashtu do të dëshiroja të falënderoja Agjencinë Evropiane për Rindërtim dhe USAID-in për përkrahjen e tyre të fuqishme të programit të privatizimit.

[I. Procesi i privatizimit fiton nga përvoja e mbledhur nga ekonomitë e transformuara]

Është me rëndësi të përmend se procesi ynë i privatizimit fiton nga përvoja e mbledhur nga ekonomitë e tjera të transformuara – ajo nuk parashihet sërish zbulimin e ndonjë çudie.

- Për shembull, sa i përket pronësisë ose kërkesave kreditore, ne e ndjekim parimin "kompensim, por pa dëmshpërblim fizik".
- Dhe natyrisht, si edhe e kërkuar sipas Kartës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, së cilës Rregullorja e AKM-së i referohet disa herë, kërkesat e tilla janë i kanë trajtuar si duhet gjyqësia dhe Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme.
- Ne, po ashtu, po përpiqemi të bëjmë të sigurt që procesi të ndiqet me kujdes pa ndërprerë, për të siguruar efektivitetin e ti për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Në këtë kontekst, ne punojmë me maturi të instrumentit të Spinoff-it Special, të kushteve të veçanta të tenderit, duke pasur ndërmend se kjo me të vërtetë mund të jetë e vlefshme për një ndërmarrje dhe për ekonominë, por në anën e kundërt, duke pasur ndërmend se privatizimi nuk është dhe nuk mund të jetë ringjallje e strukturave të vjetra.
- Më me rëndësi është që ne të përpiqemi të bëjmë të sigurt se procesi udhëhiqet me kujdes dhe në një mënyrë transparente.

Sa i përket transparencës, më lejoni të shtoj se jam i shqetësuar për akuzat e përsëritura të AKM-së, duke i thyer rregullat e veta ose madje akuzat e korrupsionit. Ju lutem ta keni ndër mend se gjatë mandatit tim si kryesues i Bordit të AKM-së nuk nuk di për ndonjë shkelje as materiale as të Rregullores së AKM-së as të politikave operacionale të

AKM-së. Ju lutemi të keni parasysh se Politikat Operacionale janë studiuar vazhdimisht nga Bordi i AKM-së dhe se në kohë të fundit janë paraqitur disa ndryshime që kanë të bëjnë me tërheqje të paligjshme të fituesve të tenderëve. Po ashtu ju lutemi të keni parasysh se të gjithë fituesit e tenderëve të përkohshëm janë të kontrolluar nga Shtylla I e UNMIK-ut përpara se të bëhen fitues realë të tenderëve.

AKM-ja po i shqyrton dhe po u përgjigjet me kujdes të gjitha akuzave të dorëzuara me shkrim. Nëse kjo është e menduar e pamjaftueshme, AKM-ja mund të dërgohet në gjykatë dhe nëse ka akuzat e natyrës penale si korrupsion etj. ka rëndësi shumë të madhe që dëshmia të merret dhe të dorëzohet tek prokurori.

Megjithatë, autoritetet e Kosovës nuk duhet t'i pranojnë akuzat, p.sh. nga tenderuesit e dëshpëruar për të cilat nuk kanë asnjë dëshmi.

[II. Procesi i privatizimit prodhon rezultate konkrete]

Çka është arritur deri më tash me procesin e privatizimit? Më lejoni t'ju jap disa fakte.

- Në prill 2005, përafërsisht para një viti, procesi i privatizimit në Kosovë ishte ndalur. Ishin përfunduar vetëm 2 valë të privatizimit, Bordi i AKM nuk ishte takuar për më shumë se një vit.

Sot, ne kemi një gjendje më të mirë.

- Vala 15 sapo ka filluar zyrtarisht
- 230 ndërmarrje të reja janë vendosur në tender deri më 1 prill, që përbëjnë më shumë se 150 nsh
- 123 nga këto ndërmarrje të reja kanë arritur përfundimin e kontratës dhe asetet u janë bartur pronarëve të rinj. 67 kontrata të tjera janë duke u përgatitur. Natyrisht, disa kontrata nuk janë përfunduar dhe duhet të ritenderohen.
- Megjithatë, progresi është relativisht i shpejtë dhe çdo muaj përgatiten 20 ndërmarrje të reja për shitje dhe fillon një valë e re. Gjatë tre muajve të fundit, 60 kontrata janë nënshkruar dhe ratifikuar, e kjo do të thotë se për çdo ditë pune, lind 1 ndërmarrje e re.

Pasqyra e programit të privatizimit tregon se:

- Të ardhurat e tërësishme për spin-off, të paguara apo që pritet të paguhet janë përafërsisht 160 milion €

- Të ardhurat e tërësishme për spin-off special, të paguara apo që pritet të ,anë përafërsisht 80 milion €
- Zotimet e tërësishme shtesë për investime në spin-off special janë 114.0 milion € dhe
- Zotimet për vende të lira të punës janë më shumë se 6,000 vende (kjo përfshin edhe spin-off special që janë në pritje).

Nëse të gjitha zotimet respektohen, deri më sot do të ishin mbledhur rreth 240 milion € nëpërmjet tenderëve gjatë programit të privatizimit.

Është e njohur se hapja e ofertave për ndërmarrjet e rëndësishme siç janë: Hoteli Grand, Veraria Rahoveci, Ramiz Sadiku, Hotel Iliria dhe Birraria e Pejës është bërë kohëve të fundit dhe jemi duke punuar në përfundimin e këtyre shitjeve.

Më vjen mirë t'ju informoj se sa i përket Ferronikelit, Marrëveshja për shitblerje ndërmjet AKM dhe International Mineral Resources/Alferon ka përfunduar dje. Kontrata është nënshkruar dhe shuma e madhe prej 30.5 milion euro për çmimin e shitjes dhe 2.5 milion € për përvetësimin e tokës është transferuar në xhirollogarinë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nën BPK IMR/Alferon, i cili do të investojë së paku 20 milion € dhe të punësojë së paku 1000 punëtorë, do të fillojë menjëherë dhe ata tashmë janë takuar me menaxherët dhe me përfaqësuesit e punëtorëve, duke krijuar marrëdhënie të mira të punës.

Jam i bindur se Feronikeli shumë shpejtë do të kontribuojë në zhvillimin dhe punësimin në Kosovë, ashtu siç ka ndodhur me firma të tjera, të cilat janë privatizuar kohëve të fundit. T'i marrim pesë shembuj:

- Llamkos – Fabrika e Lllamarinës ,e cila nuk ka funksionuar para privatizimit, tash kjo fabrikë ka punësuar 338 punëtorë me orar të plotë, ka investuar 28 milion € në teknologji të re dhe ka shitje të parapara në 50 milion € në vitin e parë (95% e të cilave janë eksport, e kjo Kosovës i nevojitet më së shumti).
- Fabrika e miellit Silosi – një fabrikë e vjetruar. Kohëve të fundit është rinovuar me investime të cilat tash për tash janë 6 milion € dhe ka më se 200. Ky mulli është projektuar të punësojë 350 punëtorë para fundit të vitit 2006 dhe do të ketë 20 milion € të investuara në teknologji të re. Përveç për miell, parashihet të jetë një linjë prodhimi edhe për makarona.
- Banja e Kllokotit – e ka dyfishuar prodhimin e ujit mineral në shishe që kur është privatizuar
- Magazina Buzagillek tash i ka të punësuar 164 punëtorë aktivë (nga 0) dhe Magazina UNIS i ka më se 170 punëtorë aktivë (nga 4)

- Hurdha e peshqve "Trofta" – ka rritur numrin e punëtorëve nga 55 në 80 sish, në të njëjtën kohë edhe u trefishua prodhimi i troftës në 300 ton në vit.

Zonja dhe zotërinj,

I gjithë ky përparim nuk do të ishte i mundshëm pa punën e shkëlqyeshme dhe profesionale të punëtorëve të AKM. Atyre u jam mirënjohës. Do të ishte ide e mirë të ruhej shumica e këtij ekipi fitimtar.

Më lejoni të shtoj edhe një gjë shumë të rëndësishme: procesi i privatizimit është proces gjithëpërfshirës, i cili stimulon zhvillimin dhe punësimin në tërë Kosovën. Megjithatë dëshiroj t' ju bëj thirrje, sidomos komunitetit serb të Kosovës, të merrni pjesë aktivisht, jo vetëm në procesin e ofertimit, por edhe në procesin e identifikimit të NSH të përshtatshme në zonat e minoriteteve. Asgjë nuk fitohet nëse qëndrojmë duke pritur, por është e kundërta, pa marrë parasysh a është fjala për Shtërpcë apo për diku tjetër.

III. Tri çështjet e veçanta: të ashtuquajturat shoqëritë aksionare të Gjakovës, 20% nga çmimi i shitjes për punëtorët dhe likuidimi i shitjeve(? ??)

Tash më lejoni t' ju tregoj se s'i po mundohemi të bëjmë përparim në fushat ku gjërat kanë lëvizur shumë ngadalë.

- Rasti i parë janë të ashtuquajturat shoqëritë aksionare të Gjakovës. Bashkëpunimi po vazhdon me 30 nga 49 ndërmarrje të Gjakovës dhe disa janë përfshirë në tender. Pra, po vazhdojnë përgatitjet e tenderëve të tenderëve përcaktimi i statusit të tyre.
- Rasti tjetër është pagesa e 20% të çmimit të shitjes për punëtorët. Ju lutem, ta keni parasysh se në secilin rast lista e punëtorëve është sfiduar nga gjykata – në secilin rast! Por kemi mbetur në duartë e Dhomës Speciale dhe në aftësinë e saj për të proceduar këto sfida. Megjithatë, jam i kënaqur t' ju raportoj se vendimet kanë filluar të dalin nga Dhoma Speciale dhe 4 ndërmarrje janë liruar kohëve të fundit. Ne me besim presim që dinamika e këtyre vendimeve të lëvizë në mënyrë substanciale gjatë muajve të ardhshëm. Kohëve të fundit e kam diskutuar shumë shpesh këtë çështje me kryetarin e BSPK Bahri Shabanin, anëtar i Bordit tonë të AKM. Më lejoni t' ju them se kjo nuk është fusha e vetme për të cilën ne mundohemi të bashkëpunojmë me BSPK edhe pse nuk pajtohemi gjithmonë, kryesisht sa i përket asaj se sa ndërmarrje mund të tenderohen në mënyrë efektive me Spin-Off Special.
- Rasti i tretë është likuidimi i shitjes kundrejt shitjes së asetëve. AKM ka përfunduar gjashtë shitje të likuidimit. Tenderuesit pjesëmarrës, kanë ofruar 58 oferta dhe vlera e kombinuar e ofertave fituese tejkalon pothuajse 1.34 milion €. Ky proces do të vazhdojë edhe për një kohë.

IV. Tri çështjet politike: paratë e Fondit të Mirëbesimit, privatizimi i NP dhe kombëtarizimi

Më lejoni të ngre disa çështje që luajnë rol në debatin politik të privatizimit.

Së pari, kërkesa për të investuar paratë e Fondit të Mirëbesimit të fituara nga të ardhurat e privatizimit ekskluzivisht në Kosovë. Është e qartë se natyra e Fondit të Mirëbesimit nuk i jep të drejtën të besuarit, AKM-së, që t'i japë këto të holla, p.sh. për BKK. Është diskutuar në Bordin e AKM se në çfarë kriteresh mund të investohej brenda sistemit bankar të Kosovës. Megjithatë, duhet të kihet parasysh, në këtë kontekst, se kamatat e larta dhe afatet e shkurtra për kthimin e tyre, nuk janë rezultat i problemeve në anën e furnizimit, por më shumë janë rezultat i problemeve (mungesa e kolateralit, mungesa e planeve të mira të biznesit).

Së dyti, jemi pyetur pse nuk i privatizojmë së paku disa pjesë të NP. Përgjigjja për këtë është shumë e thjeshtë: Kjo nuk është në mandatin tonë. E gjithë ajo që mund ta bëjmë nën mandatin e tanishëm është t'i përgatim NP për privatizim të mundshëm pas statusit.

Çështja e tretë është se herë pas herë kemi dëgjuar kërkesa për ta ndalur privatizimin në disa industri dhe në vend të privatizimit t'i "kombëtarizojmë" ato. Përpos faktit që një gjë e tillë do të dërgonte sinjal të gabuar te komuniteti i investitorëve, ngase do të mund të interpretohej si kthim në kohërat komuniste, nuk do të ishte as e mundshme; në asnjë rrethanë nuk do të ishte e mundshme që sektorët publikë të krijojnë investime tejet të mëdha, të cilat janë të nevojshme në industritë kryesore, e lëre më aftësinë e sektorit publik për të udhëhequr efektivisht këso industrish. Përveç kësaj, ne kemi bazë ligjore dhe institucionale, e cila siguron që privatizimi në Kosovë të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe përfituese për popullin. Për shembull, së fundi, një ndër universitetet prijëse e vlerësoi legjislacionin aktual për mihjen si një ndër legjislacionet më të mira botërisht.

[V. Trepça]

Më lejoni të kthehem te Trepça. AKM-ja është në dijeni për dimensionin politik dhe shoqëror të kësaj ndërmarrjeje shoqërore mjaft të rëndësishme. Mu për këtë shkak, në pajtim me Qeverinë, ne kemi ndjekur një strategji tridegëshe.

- Të mbrojmë Trepçën nga pretendimet e mëdha të kreditorëve;
- Të fillojmë prodhimin kudo që të jetë e mundshme, në mënyrë që të krijojmë punësim dhe të hyra;
- Të përgatisim një strategji të drejtë të privatizimit eventual.

Vitin e kaluar është qartësuar se për t'u mbrojtur Trepça efektivisht nga pretendimet e mëdha të kreditorëve, të cilët fatkeqësisht kishin filluar të gjenin vrima në sistemin

gjyqësor, pa vonesë duhet të fillonim një procedurë me paaftësi pagese. Në kontekst të kësaj procedure, ardhja e administratorit është e pashmangshme. Ky administrator do t'i raportonte Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

Mirëpo, rregullorja e përmirësuar rishtazi mbi Paaftësinë Paguese në Kosovë është e tillë që administratori gjithsesi duhet t'i marrë parasysh përmasat politike dhe shoqërore të këtij rasti. As nga perspektiva afariste, administratori nuk do të fillojë "shitjen e përshpejtuar" të Trepçës. Përkundrazi, ai do të duhet t'i marrë parasysh këshillat tona të përbashkëta sa u përket strategjisë së privatizimit të Trepçës, sepse duhet të kryhet më se miri dhe me zell që të sillte rritje dhe punësim në rajonin e Kosovës.

Mu për këtë arsye, është e rëndësishme të themelohet Bordi Këshillues për Trepçën me të gjitha palët e përfshira. Ky bord do të ishte i ngjashëm me atë të ndërmarrjeve publike. Jemi mirënjohës për mbështetjen që i është bërë kësaj ideje.

Më lejoni ta shpreh mendim tim lidhur me pretendimet kreditore kundër Trepçës: AKM-ja është plotësisht e njoftuar për faktin se qëllimet e Ekipit Negociues të Kosovës për bisedimet për statusin janë zgjedhjet gjenerike të pretendimeve që kanë të bëjnë me vitet e 90-ta. Mirëpo kjo nuk e vjetëron procesin aktual. Për më tepër, administratori ka për obligim që të integrojë këtë aspekt në qasjen e tij dhe sigurisht që nuk do të ngurrojë për të bërë një gjë të tillë.

[VI. Transferin e AKM-së në IPVQ ?]

Para se të mbylli fjalën, dëshirojë të jap një komentim të kërkesave lidhur me transferin e pjesëshëm apo të tërësishëm të AKM-së në IPVQ. Pak pas ardhjen sime këtu, pra para një viti, UNMIK-u kishte marrë propozime përkatëse nga Qeveria dhe si rrjedhojë, këto propozime i kam diskutuar. Madje, me ministrin Dugolli kemi diskutuar detajisht. Fundja, posti i administratorit që ushtron AKM-ja mbi ndërmarrjet publike dhe mbi ato shoqërore është një fuqi e rezervuar dhe transferimi i pjesëshëm apo i tërësishëm i saj do të kërkonte ndryshime në Kornizën Kushtetuese dhe në Rregulloren e AKM-së, ndryshime për të cilat me sa e dimë ne, Kombet e Bashkuara nuk do të pajtohen përderisa është UNMIK-u. Por edhe nëse supozojmë që pajtimi është i mundshëm, ky proces do të zgjatej aq shumë sa që me siguri që më parë do të vendosej statusi i Kosovës sesa të përfundonim ne procesin e transferit. Për shkak të kësaj, rekomandoj që në vend se të përqendrohemi në atë që në të paktën do të ishte një projekt i komplikuar transferi, të përqendrohemi në atë që do të mund të quhet një përfundim i arsyeshëm i punës së privatizimit të periudhës së vitit 2006. Pra 90% të vlerave dhe 50% të numrit të ndërmarrjeve shoqërore tashmë janë realizuar. Pas kësaj, po qese statusi ende nuk është zgjedhur, ne mund t'i rikthehemi projektit të transferit.

Siç na duket sot, përfundimi i arsyeshëm dhe vetë statusi janë gjëra që mund të arrihen dhe që nuk janë shumë larg. Për shkak të kësaj, vazhdoj të besoj që nuk duhet të shpërqendrohemi duke u marrë me projekte të tilla dhe të komplikuar para statusit.

Më lejoni të shtoj që natyrisht se periudha pas statusit është një çështje krejtësisht tjetër dhe natyrisht që njerëzit përqendrohen në atë pikë.

Pas këtij mendimi të lumtur, do të dëshiroja që t'ju falënderoj për vëmendjen tuaj dhe për mundësinë për të biseduar për çështjen e rëndësishme të privatizimit.
Faleminderit shumë.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit Z. Ruecker për informata që na dhatë dhe faleminderit për pjesëmarrje dhe për respektin e kohës dhe për respektin që ja keni bërë Parlamentit të Kosovës. Tani në radhë është ministri Bujar Dugolli, që në emër të Qeverisë do ta paraqes raportin. Urdhër z. ministër.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Faleminderit z. kryesues Haliti, të nderuar anëtarë të Kryesisë, të Kuvendit, deputetë të nderuar, kolegë ministra, z. Joachim Ruecker, zëvendësërfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm dhe shefi i Shtyllës së Katërt.

Shumëçka u tha nga shefi dhe kryetari i Bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit gjërat pozitive veç që kanë ndodhur në këtë proces që nga fillimi i punës së Bordit të Ri të AKM-ës. Nuk ka dyshim se privatizimi i shpejtë është vendimtar për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Potencoj se ky proces në Kosovë zhvillohet në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të nënshkruar më 13 qershor 2002 nga ish -Përfaqësuesi Special z. Shtajner. S'ka dyshim ,po ashtu ,që kjo rregullore është e mbështetur në Rregulloren 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme të Kosovës. respektivisht kreu VIII i kësaj Kornize ku flitet për kompetencat e rezervuara për Bashkësinë Ndërkombëtare.

Në bazë të këtyre akteve normative, institucioneve të Kosovës u lejohej pjesëmarrja në Bordin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit me tre përfaqësues ,do me thanë tre ministra prej tyre një është obligativ të jetë nga komuniteti serb. Dhe kur është planifikuar të hartohet kjo rregullore më kujtohet që në këtë Kuvend është hap një debat një debat konstruktiv për të dhënë kontributin dhe rekomandimet e veta institucionet e Kosovës para se të nënshkruhet Rregullorja 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Edhe pse Kuvendi i Kosovës atë kohë bërë një debat konstruktiv që rekomandimet e secilit do të ishin në punë faktorit ndërkombëtar për të pasur një proces më të shpejtë më efikas dhe për t'u përmbyllur shpejt ky proces, fatkeqësisht nga ish-kryeadministratori nuk u morën parasysh dhe mund të them të nesërmen ai e nënshkroi Rregulloren pa marrë për bazë asnjë rekomandim të këtij Kuvendi.

Problemi qëndron se edhe Qeveria e kaluar disi e kaloi në heshtje dhe filloi punën pa u bërë asnjë përpjekje,të paktën për të pasur ndryshime esenciale për qëllime të mirakuptohet për ta vazhduar këtë proces të privatizimit, por vazhdoi ashtu siç vazhdoi dhe ne erdhëm në një situatë që tre vjet i humbëm kot në këtë proces ,sepse ky u bllokua. Normalisht faktorë për bllokimin e tij ishte nga disa zyrtarë ndërkombëtarë të asaj kohe, që, qeverisshin me UNMIK-un dhe Shtyllën e Katërt pa dyshim ishin presionet e Beogradit ,qendrat e vendosjes, por nuk kishte këmbngulësi të insistuar që kjo çështje të zgjidhet dhe të vejnë në rrugën e mbarë, rrugën e mbarë dhe të duhur.

Edhe tash në këtë vit UNMIK-u ende nuk ka propozuar kurrfarë transferi në fushën e ekonomisë për vitin 2006. Qeveria e Kosovës ka vazhduar me buxhetin e saj, buxhetin e konsoliduar, t'i financojë programet e privatizimit që nga fillimi dhe janë qindra miliona që ka derdhur për këtë proces, Vetëm vitin e fundit janë 67.711, 792 milion euro që ne i ndajmë për procesin e privatizimit.

Pavarësisht se i ndajmë të gjitha këto mjete për proces, por edhe më tutje nuk mund ta kontrollojmë qind për qind këtë proces dhe se procesi i privatizimit vazhdon të mbetet po ashtu pjesë e rezervuar dhe ne mendojmë që ato i tha z. Ruecker tani ka ardhur koha që ne të mendojmë seriozisht për transferin e kompetencave në këtë fushë. Siç dihet institucionet e Kosovës kanë përgjegjësi në bazë të ligjeve ekzistuese edhe Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe agjencitë e tjera qeveritare si dhe ministritë që në këtë moment duhet ta dhënë kontributin e tyre konstruktiv dhe rekomandime për këtë proces, por jo diçka më shumë. Nuk ka dyshim që zhvillimi ekonomik është shumë i rëndësishëm edhe për zbatimin me sukses të standardeve,. Ne dje folëm për standardet dhe standardi i pestë u diskutua në mënyra të ndryshme. Po ashtu zhvillimi i mëtutjeshëm i këtij procesi shënon edhe plotësimin e një standardi që për mendimin tonë është crucial për një zhvillim të suksesshëm në fushën e ekonomisë. Prandaj është konstatuar nga shumë faktorë relevantë, ekspertë së procesi i privatizimit krijon perspektivë pzhvillimi, vende të punës dhe mirëqenie për qytetarët tanë.

Edhe komuniteti ndërkombëtar vazhdimisht kërkon dhe posaçërisht Bashkimi Evropian që duhet të ketë reforma politike dhe ekonomike që institucionet e Kosovës do t'i pasqyronin para faktorit ndërkombëtar, në bazë të cilave do të krijonin për ndihma dhe përkrahin nga ata. Ne kemi dilema që mund të arrihen sukses më i madh në këtë fushë pa pas transfer jo vetëm në fushën e privatizimit apo Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit por edhe në sektorët tjera të fushës së ekonomisë që edhe dje janë përmendë shumë nga deputetët e këtij Kuvendi.

Nuk ka diskutim se në këtë proces kanë ndodhë ndryshime pozitive, ardhja e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm z. Petersen bën edhe zotit Rosin dhe posaçërisht shefit të Shtyllës së Katërt z. Joachim Ruecker, krijuan te faktori ndërkombëtarë te UNMIK-u një klimë krejt tjetër të re, sa i përket këtij procesi, dhe këta u angazhuan të zhbllokohet ky proces. Ky proces pozitiv që ka ndodhur deri më tash nuk do të mund të merret me mend pa pasur një qasje pozitive dhe një punë të suksesshme të institucioneve të Kosovës, në veçanti të Qeverisë nëpërmjet anëtarëve të saj në Bordin e AKM-ës. Ne posa morëm pushtetin nga ky koalicion qeverisës në janar të vitit 2005 , diskutuam edhe në Qeveri dhe për këtë çështje nga faktori ndërkombëtar për problemet e ekonomisë që u organizua një konferencë në Angli me insistimin e Qeverisë angleze në Villtonpark, përveç përfaqësuesve nga Qeveria e Kosovës që ishim, ishin edhe nga agjencitë donatore ndërkombëtare, zyrat e huaja jo vetëm në procesin e privatizimit dhe të zhvillimit ekonomik. Dhe 10 pikat e rekomandimeve që u nxorën nga ajo konferencë i dhanë shtytje edhe Zyrës ligjore të Organizatës të Kombeve të Bashkuara që t'i miratonte kërkesat tona, që të bëhen ndryshime në Rregulloren e AKM-ës me qëllim që të zhbllokohej ky proces,. Nuk ka diskutim që për zhbllokimin dhe për ndryshimin e

rregullores me quajturin domenin eminent dhanë kontribut edhe zyra diplomatike dhe qendrat e vendosjes të faktorit ndërkombëtar, që dëshiruan ta zhbllokojnë këtë proces.

Domeni eminent që u miratua nga Zyra Ligjore në Nju Jork i hapi mundësinë privatizimit të shpejtë duke mënjanur që për çdo përpjekje të privatizimit ,për çdo ndërmarrje të merret miratimi i gjykatës, por u adresua se për proces të privatizimit është kompetente AKM-ja që lënda apo kontesti gjyqësore mund të vazhdojnë të shqyrtohen pasandaj në gjykata dhe sipas vlerësimit , gjykata mund të bëjë kompensimin e atyre kreditorëve apo pretenduesve që kanë të drejtë mbi ato prona. Nuk ka dyshim që ky ndryshim i dha mundësi të privatizohen edhe ndërmarrjet statusi i të cilave tyre ishte i paqartë, sidomos pas marrjes së autonomisë së Kosovës ku u aprovuan disa ligje tash të quajtura të Markoviqit, që një farë mënyre bënë ndryshime në disa ndërmarrjeve dhe u hapi mundësi ,do me thënë që edhe atyre ndërmarrjeve të privatizohen dhe kontestet gjyqësore t'i zgjedhin nëpërmjet gjykatës.

Bordi i AKM-ës, bord i ri që filloi tash një vjet punën, filloi t'i evitoj ato pakënaqësi që ishin shfaqur në opinion dhe vetë në punën e bordit . Ne arritëm t'i bëjmë disa ndryshime në politikat operacionale që ishin pengesë e një zhvillimi të shpejtë. Ne bëmë disa ndryshime, dua ta përmend një që ishte shembull në spinofet e rregullta ku lejonte dy raste ofertimi të bëhen për shitjen e një ndërmarrje me spinof të thjeshtë që ishte edhe e rëndë, por edhe e mundimshme edhe nuk ishte efektive. Bëmë ndryshime që të rriten depozitat për ofertuesit dhe të merren masat për ata të cilët tërhiqen apo dështojnë në proces të privatizimit që të gjobiten sipas depozitës së tyre dhe të pamundësohen në të ardhmen që prapë të konkurrojnë në rast se ofertat e tyre kanë qenë mashtruese dhe janë tërhequr nga gara. Ashtu siç e tha z. Kuechner e bëmë planin e privatizimit 90% të vlerës së aseteve për një vit dhe ne jemi në rrugë të mbarë që këtë plan ta përfundojmë.

Bëmë caktimin e rregullt të mbledhjeve mujore,që nuk kishte ndodhur në të kaluarën, u vendos që për çdo mbledhje të bordit të shpallet nga një valë e privatizimit, ashtu siç e tha edhe z. Kuechner. Nga koha kur ne e morëm detyrën ishin vetëm 23 ndërmarrje të privatizuara, prej tyre vetëm 10 kontrata ishin të nënshkruara , që do të thotë që për 3 vjet ky proces tashmë dështoi.

Ne filluam punën përveç procesit të privatizimit u bë korporatizimi i ndërmarrjeve publike si Posta, Telekomunikacioni,Aeroporti i Prishtinës,KEKU,Hekurudha,Ngrohtorja e Prishtinës dhe në Gjakovë zgjodhën bordet e re menaxhuese dhe mbikëqyrëse dhe për herë të parë edhe institucionet e Kosovës jo me një numër të kënaqshëm po me gjithë atë kanë dërguar në borde menaxhuese ekspertë nga fushat të ndryshme që janë prezentë në bordin e secilës ndërmarrje.mirëpo normalisht nuk janë shumicë dhe pa dyshim që këta kanë pozitiv në mbarëvajtjen e punës së këtyre ndërmarrjeve. U tenderuan dhe u privatizuan 230 ndërmarrje të reja vetëm në 12 valët e privatizimit,pastaj edhe 70 ndërmarrje të reja u tenderuan në valët e 13, 14, 15 që nënkupton 300 ndërmarrje të reja do të privatizohen- do me thënë me rrumbullakimin e 15 valëve të privatizimit.

U bë një numër i konsiderueshëm nënshkrimesh të kontratave, 120 sosh. Shuma e përgjithshme e deponuar në xhirollogari të AKM-ës tashmë ishte, të mos e përsëris- se

ju e keni me shkrim. Duhet t'i përmendi këtu vetëm të spinofit special që u garantuan investime në spinof- special rreth 78 milion e 950 mijë euro dhe numri total i punëtorëve të premtuar me spinof special është 6 mijë e 306 vende pune. Pa llogaritur spinofet e rregullta që nënkupton qindra vende të punës që janë hapur dhe janë duke ecur në proces të mirë. Nuk ka dyshim që shumë ndërmarrje kanë vështirësi për shkak të politikave kreditore dhe të politikave të tjera që nuk mundësojnë në një afat shumë të shkurtër të aktivizohen ato, por e kemi një problem tjetër që ne si institucione duhet ta kemi parasysh në një të ardhme të afërt se si t'i ndihmojmë zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesmeve. Këtë janë duke menduar Qeveria dhe faktori ndërkombëtar.

Që nga dhjetori i vitit 2004, kur Shtylla e Katërt, propozoi transferin e disa kompetencave dhe në atë kohë Zëvendëspërfaqësuesi Special z. Rosin e njoftoi kryeministrin për transferin e disa kompetencave në fushën e ekonomisë, që Qeveria mund të propozojë legjislacion fiskal, menaxhimi i pyjeve të pronës shoqërore transferohet te Ministria e Bujqësisë. Kryeministri mund të shërbejë si kryesues i Këshillit Ekonomik Fiskal. Ministria e Transportit mund të rregullojë stacionet e autobusëve dhe operatorët e tjerë do me thënë atë që ka edhe për detyrë. U themelua një Komision i pavarur për miniera – minerale, që e zëvendëson organin e mëhershëm. U tha që menaxhimi i frekuencave do të kalojë tek autoriteti rregullator të telekomunikacionit, u transferua në mënyrë të jepej një rol më i madh në mbikëqyrjen e BPK-së -IPQ do t'i lejohet që të emërojnë anëtarët e bordit mbikëqyrës, bordet menaxhuese. Ne thamë që kjo ndodhi, por rezultati është 3 me 5 në favor të UNMIK-ut dhe AKM-ës. Rregullatorët e pavarur u tha se do të kosovarizohen më vonë. Nuk ka dyshim që ne edhe atëherë edhe tash e kemi çmuar atë transfer të kompetencave thuaja se këto pika tanimë kanë një funksionim të përbashkët në këto çështje. Por edhe më tutje mbetet përgjegjësi procesi i privatizimit, mbikëqyrja e ndërmarrjeve publike, doganat do me thënë pikat kryesore, por ende mbesin në përgjegjësi të rezervuara.

Ne e kuptojmë që edhe me diskutimet me z. Ruecker që i kemi pasur për transferin e kompetencave, se çështjet e rezervuara nuk mund të transferohen para se të zgjidhet statusi i Kosovës, por unë mendoj që institucione e Kosovë kanë nevojë dhe për obligim që të marrin më shumë përgjegjësi me qëllim që puna të ecën më shpejtë puna të ecë më mirë.

Unë dua t'i përmend disa veprime që për ne nuk janë të kënaqshme në këtë proces dhe duhet të jemi vetëkritik themi se aty ku s'ka pas sukses themi që është një dështim. Vonesa në zgjedhjen e lëndëve nga Gjykata e Lartë Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme, kjo është diçka që ka dështuar dhe nuk mund ta fshehim askush, as UNMIK-u, as institucionet edhe pse kjo gjykatë funksionon jashtë institucioneve të Kosovës.

Vonesat në pagesën e 20% të punëtorëve, po ashtu. Janë edhe një dështim, moszhbllokimi i fondit të privatizimit është dështim, vonesat e kontrollit financiar që bëhen nga Shtylla e Katërt është dështim po ashtu, nuk duhet të them që këto dështime i bartë bordi i AKM-ës apo Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, por janë faktorët e tjerë që janë në shtylla të tjera të UNMIK-ut, të cilat nuk janë efektiv dhe nuk ju përgjigjen kërkesave që i ka zhvillimi i këtij procesi.

Pagesa e punëtorëve 20% ka mund dhe mund të bëhej më shpejtë dhe ai nen i Rregullores që nuk e qartëson statusin e punëtorëve që kanë punuar para marrjes së autonomisë, para futjes së masave të dhunshme apo gjatë masave të dhunshme dhe pas çlirimit të Kosovës, do me thënë shumë konfuz dhe ne nuk mund të veprojmë me tri forma- nivele, me tri lloje punëtorësh të këtyre ndërmarrjeve, thjeshtë duhet të qartësohet dhe kjo e drejtë, duhet t'i lihet Bordit të AKM-ës të përcaktoj 20% e punëtorëve në bazë të dokumentacioneve që i kanë ndërmarrjet shoqërore në bashkëpunim me sindikatën.

Ne e kuptojmë që fondi i privatizimit është një fond i mirëbesimit dhe nënkupton edhe definimet e statusit për t'i dhënë mundësi zhbllokimit të këtij fondi, por ne e kemi thënë se duhet të hartohen disa termave të referencës që u mundësojnë bankave kosovare të marrin pjesë të caktuara në një pjesë të caktuar të këtij fondi me një kontroll të rreptë të Bankës Qendrore dhe të autoritetet qeveritare që t'u jepet një injeksion pozitiv që këto të kanë mundësi të japin kredi më të volitshme për sektorin privat në Kosovë. Nuk ka pasurndryshime edhe pse kemi kërkuar- në përbërjen e Bordit të AKM-ës- do me thanë as nga faktori ndërkombëtar. Shumë më mirë do të ishte që shefi i Shtyllës së Parë të UNMIK-ut të jetë anëtar i Bordit, sepse me të AKM-ja, do me thanë me Shtyllën e Parë ka shumë vështirësi në rregullimin e shumë gjërave.

Ne kemi thënë që nuk ka pas efekt të duhur në prodhimin e investimeve dhe nxitjen e investimeve të huaja, pas themelimit të agjencive të huaja. Pas themelimit të Agjencisë për promovimin e investimeve kemi bërë kampani edhe jashtë vendit me qëllim të nxitjes së investimeve të huaja, po është pak paradoksale që fondet për promovimin e investimeve janë të pesëfishuara më shumë në AKM-ë se sa tek agjencia që është themeluar me urdhër të Përfaqësuesit Special. agjenci që mbikëqyr këto mjete dhe duhet t'i aplikojë politikat e veta të promovimit dhe nxitjes së investimeve të huaja. Shumë më mirë do ta bënim ne nxitjen e investimeve dhe promovimin e tyre se sa AKM-ja. këtë e kemi kërkuar, por nuk është bërë ende një hap pozitiv.

Tërheqja e investitorëve nga gara mund të konsiderohet dështim, por nuk kemi mundësi t'i obligojmë të mos tërhiqen, kjo ishte dukuri që ndodhë ndoshta edhe për shkak politikave operacionale që kanë filluar në fillim të aplikohen. ose do t'i merret e drejta atij që tërhiqet për arsye të panjohura, dhenuk do t'i lejohej mos të konkurrojë më, ky projekt ka dominuar në bordin e AKM-ës, që këto masa bordi nuk kishte mundësi t'i merrte.

Çështja e kërcënimit dhe të tjerat, që kanë ndodhur dhe ndodhin shpesh, ndër të tjera, është edhe çështja e Ministrisë që tash nëse i merr kompetencat, por edhe e Shtyllës së Parë të Policisë, që t'i japë, t'i evidencojë dhe t'i pengojë keqbërësit të veprojnë në këtë çështje.

Si përfundim mund të them që shtytja që ia dha këtij procesi qasja e re pozitive e udhëheqësve të UNMIK-ut z. Petersen dhe z. Kuecker. angazhimi pozitiv që e bëri Qeveria e Kosovës dhe agjencitë donatore si USAID-i AER-i pjesëmarrëse në cilësinë e vëzhguesit në Bordin e AKM-ës, ishin disa elemente shumë të rëndësishme që e

zhbllokuan këtë proces. Ne mund të themi që gjatë këtij viti patëm një sukses i cili kishte qenë e udhës të ndodhte shumë më parë.

Secili vend i ka politikat dhe ka aplikuar politika të ndryshme në procesin e privatizimit, por Kosova është vend specifik, statusi i saj i pazgjidhur e kanë bërë të veten dhe janë aplikuar metoda ndoshta të veçanta në këtë proces, por megjithatë dëshira e të gjithëve ishte që ky proces të ecte sa më shpejt dhe të kishte zhvillim të punësimit dhe zhvillim të të gjitha degëve të industrisë. Ne e kuptojmë që edhe pse bashkëpunimi ynë nuk ka munguar ndërmjet faktorit vendor dhe faktorit ndërkombëtar, ka pasur pakënaqësi. ato i kemi diskutuar dhe vazhdojmë t'i diskutojmë, por edhe t'i mënjanojmë pengesat, që na dalin në punë.

Qëllimi ynë ka qenë ta vazhdojmë procesin e privatizimit dhe të mos ndalemi, duke kundërshtuar njëri - tjetrin dhe duke mbyllur këtë proces, se mbyllja i shkakton dëm shumë të madh ekonomisë së Kosovës dhe ngecje në këtë proces. Ne i kemi bërë disa rekomandime të mbështetura në ligjet ekzistuese që na shtyjnë të mendojmë tani se statusi i final i Kosovës do të zgjidhet sivjet dhe kjo agjenci duhet të kontrollohet nga institucionet e Kosovës. Rekomandimet ju i keni parë, i keni lexuar, duhet të menaxhohet programi, privatizimi nga institucionet vendore.

Pika 2 është e domosdoshme të zhvillohen bisedime ndërmjet UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës që AKM-ja të jetë pjesë e transferit të kompetencave tek institucionet vendore. Unë i kam dhënë dy alternativa do me thënë alternativa e parë është që Qeveria e Kosovës me një vendim apo pas ndryshimit të Rregullores që duhet negociatat të bëjë Përfaqësuesi Special ose me një ligj të veçantë nga Parlamenti të themelohet Agjencia Kosovare e privatizimit.

Gjashtë kosovarë përbëjnë bordin, duke përfshirë Ministrinë e Tregtisë Industrisë, atë të Financave, Komunitetin dhe Kthimin, Ministrinë e Energjetikës dhe të Minierave, Transportin dhe Telekomunikacionin dhe kryetari i PSPK të jetë nga pala vendore anëtar në këtë bord.

Dy ndërkombëtarë të emërohen nga Përfaqësuesi Special në këtë bord që do të jetë shefi i Shtyllës së Katërt të UNMIK-ut, që është njëherit edhe përfaqësues nga Bashkimi Evropian dhe drejtori i AKM-ës

Po ashtu në cilësinë e vëzhguesit ne e kemi propozuar të jenë agjencitë donatorët të cilat i ndihmojnë qoftë funksionimin e ndërmarrjeve publik, po edhe ndërmarrjet pas privatizimit dhe është shumë e drejtë që AIR, SUAID, Banka Botërore dhe Oda Ekonomike e Kosovës të marrin pjesë në cilësi vëzhguesi në këto mbledhje.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm së bashku me presidentin e Kosovës mbajnë të drejtën e vetos ndaj ndonjë vendim të Bordit të AKM-ës. Do me thënë këtu dëshirojmë të themi që në rast se Bordi i AKM-ës merr ndonjë vendim që mund të konsiderohet që ka qenë i ngutshëm apo jo i pranueshëm këta dy persona në konsultim me njëri-tjetrin marrin kështu vendimi.

Dhe alternativa e dytë që është transferi 100% i kompetencave, që këtë agjenci ta udhëheq si kryetar i bordit kryeministri i Kosovës dhe do të jenë ministratë relevante prezent në Bordin e AKM-ës, duke i përfshirë agjencitë donatore si vëzhgues, Odën Ekonomike të Kosovës dhe duke i lënë të drejtën presidentit të vendit që kundër vendimeve të Bordit të këtij agjencie që vetëm në rast se konsiderohet vendim i paduhur.

Ne mendojmë që kjo agjenci me një emër të ri duhet të ekzistojë edhe pas zgjedhjes së statusit edhe pas shkuarjes së ndërkombëtarëve. Me qëllim të mbikëqyrjes së kontratave afatgjate të sfinof-it afatgjat speciale, sepse kemi kontrata që zgjatin implementimi i tyre diku 2 e diku 3 vjet, mund të ndodh 5 vjet, duhet një organ i posaçëm që i shikon si investitorët po i realizojnë investimet në ndërmarrje po edhe si po realizohet punësimi i atyre që duhet të punësohen në bazë të kontratës. Për të mos lënë pa adresë, është e nevojshme që kjo të jetë agjenci mbikëqyrëse.

Riaktivizimi i mbikëqyrjes së fondit të privatizimit të jetë obligim

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Të nderuar deputetë, unë ju kërkoj falje prej jush, në emër të z. Ruecker, se për shkak të angazhimeve që ka ai duhet të shkojë, ka kërkuar leje dhe ne s'mund t'ia ndalojmë për të dhënë sqarime janë ministri Bujar Dugolli dhe z. Shatri, që marrin pjesë në AKM. Kjo është kërkesë e z. Ruecker.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI - Mbikëqyrjen e fondit të privatizimit do ta bënte kjo agjenci sikur edhe mbikëqyrjen e punës së ndërmarrjeve publike. Pra, për alternativat unë besoj që Kuvendi i Kosovës është organ i cili mund të na japë ndihmë. Unë mendoj që kontributi që e jep Kuvendi i Kosovës është shtytje për ne që të vazhdojmë edhe më me sukses përmbylljen e këtij procesi dhe mbikëqyrjen e tij. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Dugolli. Para se të fillojmë me debat ju njoftoj se në pajtim me rregullën 22.5 të Rregullores së punës, radhitja e diskutuesve është si vijon: I pari e merr fjalën propozuesi i debatit, pastaj kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët sipas radhitjes dhe kërkesës që kanë bërë. Para se të hyjmë në debat dua t'ju njoftoj që të mos e rifillojmë debatin në fund, që në fund pas debatit të deputetëve fjalën e kanë ministrat, të cilët e përfaqësojnë AKM-ën Z, Ruecker nuk e di a to të ri a do të shkojë dhe në përfundim fjalën e ka propozuesi i debatit, i cili mund të shprehet pajtueshmërinë ose jo pajtueshmërinë me sqarimet që janë bërë. Me kaq do të përfundonte debati. Ky është rregull. Z. Gashi për procedurë.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues.

Në mbështetje të plotë të procedurave të punës së këtij Kuvendi ne kemi shprehur gatishmëri dhe z. Ruecker ka pranuar t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve, andaj z. Ruecker do të gjejë kohë t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve natyrisht nën udhëheqjen e Kryesisë së Kuvendit. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Unë kam qenë i obliguar ta jap informatën, sepse kërkesa ka ardhur me shkrim nga këshilltarët e z. Ruecker. Tani fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës i cili ka kërkuar debati z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – I nderuari kryesues, z. Ruecker të nderuar deputetë.

Jemi të vetëdijshëm për vështirësitë që e përcjellin procesin e privatizimit në Kosovë. Me këto vështirësi janë përballur të gjitha vendet që kanë kaluar nëpër fazën e transicionit, kishim bindjen fillimisht se pasi kjo po ndodhte pas një përvoje tanmë të fituara nëpër vendet e rajonit e të Evropës Lindore, duke llogaritur këtu edhe përvojën e Bashkimit Evropian dhe të ekspertëve të tin, ne do ta kalonim këtë fazë më shpejtë e më lehtë se të tjerët. Është fatkeqësi që u përmbush pak nga pritja jonë modeste.

Qeveria në raportin e saj të punuar shpejtë e shpejtë e të vonuar, kontradiktor nuk ka afuar kurrfarë zgjedhje apo ka afuar zgjedhje shumë sipërfaqësore. Ne në PDK privatizimin e kemi mirëpritur dhe përkrahur si një proces i cili do të jepte rezultate dhe njëkohësisht do të ndikonte në rritjen e ekonomike, në punësimin e gjeneratës së re në ngritjen e investimeve të jashtme dhe të brendshme, do të kishim të hyra më të mëdha nga prodhimi e doganat për buxhetin e Kosovës dhe në përgjithësi si një gjenerim ekonomik. Mirëpo këtë proces që nga fillimi e kanë përcjellë të metat e natyrave të ndryshme subjektive dhe objektive.

Së pari është zgjedhur forma më e favorshme për privatizimin e ndërmarrjeve publike e shoqërore, paratë e fituara nga privatizimi në vend që të ndahen për punëtorët e ndërmarrjeve në proporcion, Shumicës po i mohohet kjo e drejtë, është dashur që nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore të mendohet edhe për pensionistët, fondet e të cilëve janë plaçkitur nga Beogradi, pastaj pjesa tjetër 80% të derdhet në buxhetin e Kosovës. Me këtë variant të privatizimit është krijuar një fond ku një pjesë e madhe e këtyre parave janë të bllokuara dhe pa dashur të paragjykojmë ekzistojnë mundësi që nëpërmjet dokumenteve fiktive dikush të paraqitet si kreditor dhe të përfitoj në mënyrë të pa drejtë nga ky fond, që në fakt do të duhej të ishte fond i qytetarëve të Kosovës për zhvillimin e infrastrukturës dhe për shërbimin më të mirë publik. Politikat operationale janë të padrejta dhe sidomos pas ndërrimit të tyre, ku me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve me spinof special është mundësuar të zhvillohen procedura në dy runde dhe është krijuar mundësia për kurdisje ndërmjet ofertuesve dhe implikimet e ndikimet nga jashtë të ofertuesve të pandershëm.

Shkelja e procedurave dhe e Rregullores, siç është rasti me Feronikelin ku Alferonit zgjaten afatet e pagesës së parave në kundërshtim me këtë rregullore dhe këto afate i zgjaten vetëm ofertuesit në fjalë, Alferonit për disa herë radhazi pa kurrfarë baze juridike.

Në cilindo vend ku funksionon e sundon ligji një veprim i tillë do të sanksionon do të përgjigjen juridikisht, ndërsa tek ne një veprim i tillë juridik nuk po ndodh. Kjo shkelje e rregullores bëhet duke dhënë arsyttime të paqëndrueshme se kjo ndodhë për arsye që

Alferonit t'i mundësohet lidhja e kontratës me KEK-un për furnizim me energji elektrike derisa ky veprim që bëjnë zyrtarët nuk ka qenë i paraparë në procedurat e privatizimit.

Gjatë këtij procesi ka pasur implikime nga jashtë dhe lirisht mund të themi se këtu ka konflikt interesash. Kjo na jep të drejtë të dyshojmë se në Ministrinë për Tregti dhe Industri disa persona janë implikuar në këto procedura të paligjshme në forma të ndryshme, ndonjëri prej tyre kërkon edhe të punësohet tek Alferoni pasi ia ka ndihmuar në rastin e privatizimit të Feronikelit.

Qeveria nuk ka gjetur ndonjë formë si t'i deblokojë parat e grumbulluara nga privatizimi mbi 200 milion euro, që të angazhohen përsëri në ekonomi me kushte shumë më të volitshme se kreditë e tashme të bankave komerciale dhe në këtë mënyrë të ngitet fuqia financiare. Kjo do të ndikonte në rritjen ekonomike të Kosovës.

Qeveria së bashku me AKM-ën, duke pasur për bazë se Qeveria e ka ministrin në Bordin e AKM-ës, nuk janë të efektshëm në përcjelljen dhe kontrollimin e respektimit të kontratave të nënshkruara nga blerësit e ndërmarrjeve të privatizuara me spinof-in special dhe rreth lartësisë së investimeve të cilat janë zotuar se do t'i kryejnë këto investime në ndërmarrjet e privatizuara, numri i të punësuarve dhe elementet tjerë të kontratës.

Në procesin e privatizimit kanë ndodhur raste kur edhe pse është ditur pronari i vërtetë i pronave të caktuara këto prona kanë hyrë në procedurat e privatizimit, pronarëve u është bërë edhe një e padrejtë tjetër. Nga ndonjëherë dëshirojmë të pafthësojmë disa objekte që është shumë më e logjishme t'u lejohet atyre që u takojnë, siç është rasti me hotelin Union. Përveç që ka shkelje të rënda të procedurës së privatizimit, ka edhe mangësi transparence, implikime, konflikte interesash, kurdisje të blerjes, Qeveria së bashku me AKM-ën ka rezultate të dobëta në menaxhimin e ndërmarrjeve publike, pasi që sipas kësaj rregulloreje janë kompetente dhe përgjegjëse për rezultatin. Shumica e ndërmarrjeve publike si kompanitë e ujësjellësit, hekurudhat, KEK-u kanë vështirësi të mëdha financiare dhe janë të pa qëndrueshme vetë financiarisht. Shumë prej këtyre kompanive kanë pasur humbje teknike, kanë probleme me faturimin, sidomos me inkasimin e mjeteve dhe normalisht kanë edhe shumë fatura të perealizuara.

Këto ndërmarrje publike nuk kanë fonde të cilëve u mundësojnë të blejnë pajisjeve e teknologjisë për ruajtjen e kontinuitetit të punës dhe me rastin e tërheqjes së donatorëve ose të bëhen barrë e buxhetit, siç dhe ndodh që në vend që të kontribuojnë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës këto ndërmarrje shpenzojnë para të buxhetit ose do të falimentojnë. Se këto ndërmarrje nuk menaxhohen më së miri tregon fakti se qytetarët e Kosovës kanë problem me furnizimin e energjisë elektrike, kanë mungesë të ujit të pishëm, papastërtia në qytete dhe probleme tjera në jetën urbane.

Rasti i vetëm që ka një profit është PTK-ja, në saje të pozitës monopoliste në treg dhe me shërbime shumë të shtrenjta dhe jocilësore, por disa nga këto para nuk investohen dhe menaxhohen si duhet njëkohësisht dhe rrezikohen, siç është rasti me miliona të PTK-së që ishin në bankën kreditore.

Qeveria duhet të mendojë që duke pasur për bazë formën e zgjedhur të privatizimit kur parat nuk dihet ku do të përfundojnë, duhet t' u faturojë të gjitha ndërmarrjeve, të cilave u ka dhënë para nga buxheti, në këtë rast edhe Trepçës dhe ndërmarrjeve të tjera që në rast të privatizimi të mbetet kreditor potencial ,që buxhetit t'i kthehen mjetet të cilat realisht janë dhënë për këto ndërmarrje , jo të fitojnë kreditorët me dokumentacionet fiktive .

Privatizimi, si proces i mirëpritur dhe i përkrahur ,nuk ka dhënë rezultate të mundshme as sa i përket punësimit, as zhvillimit ekonomik, as tërheqjes së investimeve, as rritjes së eksportit dhe as përmirësimit të balancit tregtar, por është shumë e nevojshme të rritet transparenca, të pengohet konflikti i interesit te personat e përcaktuar ,të ndërpritet kurdisja nga ky privatizim në Kosovë dhe të ndryshojë në një proces të ndershëm me respektim të rregullave dhe të ligjeve në fuqi.

Ne jemi të bindur se procesi i privatizimit është domosdoshmëri e kohës, prandaj propozojmë që Qeveria të hartojë strategjinë e interesit nacional, në të do të hynin disa nga ndërmarrjet publike të interesit të veçantë, minierat e Kosovës, KEK-u, Feronikeli, ujërat dhe një pjesë e pasurisë pyjore. Këtu u tha se kërkesa për strategjinë e interesit nacional është kërkesë komuniste, atëherë në botë paska shumë vende të tilla se shumë vende e kanë, shumë ndërmarrje publike janë të paprivatizuara -janë shtetërore.

Qeveria duhet ta miratojë në Kuvend Projektligjin për privatizimin,me të duhet t'i përcaktojë drejtimin dhe formën e re të privatizimit sipas standardeve më të mira të përdorura në rajon. Kërkesa që e ka bërë Qeveria është e jashtëligjshme, ajo duhet ta nxjerr Ligjin për privatizim, pastaj të bëjë kërkesa dhe kërkesat janë në ligj dhe nuk ka nevojë të bëhen kërkesa jashtëligjshme.

Të ndryshohen politikat operacionale dhe atë që të gjitha kapaciteti prodhuese dhe tokat bujqësore të privatizohen me metodën e spinof-it special për arsye të ruajtjes së destinimit themelor të tyre, të ndryshohet mënyra e shitjes për rastet kur ofertuesi i parë të hiqet, të negociohet me ofertuesit e tjerë sipas radhës, por me kushtet e çmimit të të parit. Këtu kur po tërhiqet ofertuesi i parë, besoni që po bëhet një lloj biznesi mes ofertuesit të parë dhe ofertuesit të dytë. Të shqyrtohet mundësia e formimit të agjencisë për vlerësimin e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore që nuk është bërë, të formohet grupe ekspertësh për mënyrën e shfrytëzimit të fondit kosovar të mirëbesimit dhe në fund, të korrigjohet Rregullorja 2003/13 neni 10 pikë 4 dhe t'u mundësohet e drejta e përfitimit 20% e fitimit nga asetet e shitura për të gjithë ish të punësuarit që janë të evidencuar në listën e punëtorëve të paraqitur para qershorit të vitit 1999. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Krasniqi. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës kryetar i Grupit z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues zonja dhe zotërinj deputetë, ju anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe shumë i nderuari z. Ruecker.

Z. kryetar apo z. kryesues ju falënderojmë që më në fund si Kryesi e radhitët në rend të ditës këtë çështje kaç me rëndësi. Vlerësojmë që ky debat është shumë i vonuar ,sepse dy

të tretat e ndoshta më shumë ndërmarrjet që është dashur të privatizoheshin janë privatizuar dhe ky debat nuk mund ta japë në plotësi kontributin e vet lidhur me këtë çështje ,sepse shumë çështje kanë shkuar ashtu si ne natyrisht nuk kishim pasur dëshirë.

Lidhja Demokratike e Kosovës privatizimin e ka parë dhe e sheh si pjesën më të rëndësishme të programit të vet nacional të zhvillimit të Kosovës, të hartuar, të lanësuar dhe të fituar nga qytetarët e Kosovës nën udhëheqjen e të ndjerit president Rugova. Ne si Grup Parlamentar vazhdojmë programin nacional të zhvillimit ekonomik dhe të privatizimit në tërësi ashtu siç ju kemi afuar qytetarëve të Kosovës. Me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të disa vendeve evropiane filloi në atë kohë procesi i privatizimit të ndërmarrjeve të Kosovës, fatkeqësisht ndodhi një ngecje e çuditshme e procesit të privatizimit në kohën e udhëheqjes së këtij procesi nga z. Llamzdorf dhe z. Fuqi. Tani kemi një përshpejtim të këtij procesi pas ndërrimeve në udhëheqje dhe me ardhjen e një energjie pozitive nën udhëheqjen e z. Joachim Ruecker ky proces është përshpejtuar, motoja jonë është që ky proces të mos përcillet me vështirësi, të cilat nga jashtë për shkak të mungesës së informatave institucionale për njerëz të zgjedhur fitohet përcipioni i keqpërdorimeve në menaxhimin e këtij procesi.

Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për ekonomi tregu, angazhohet për privatizim, por insiston që procedura të jetë transparente dhe në informim institucional të këtij procesi. Andaj për evitum të përcipionit se me këtë proces ka keqpërdorime,të cilat disa i formulojnë edhe me një gjuhë shumë të ashpër, ne si Grup Parlamentar kërkojmë që tërë ky proces t'i nënshtrohet auditimit të përgjithshëm.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon auditim të përgjithshëm të procesit të privatizimit në Kosovë duke përfshirë zyrtarët vendorë dhe ata ndërkombëtarë natyrisht në kuadër të kompetencave ekzistuese të njoftohen Kuvendi i Kosovës natyrisht dhe Këshilli i Sigurimit të OKB-ës dhe Unioni Evropian ,i cili ka investuar në këtë proces. Ne kërkojmë që në bazë të ndërrimit të filozofisë së udhëheqjes nga pjesa ndërkombëtare në atë vendore , zotërinjtë që e njohin këtë proces, t'i ofrojnë Kuvendit të Kosovës konceptin e tyre për vazhdim të këtij procesi pas statusit.

Lidhje Demokratike e Kosovës kërkon të formohet një agjenci e pavarur e privatizimit në Kosovë ,që këtë pjesë e cila nuk është përfunduar, ta përfundojë në mënyrë të rregullt ligjore dhe në interes të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Ne shpresojmë që edhe në këtë fazë vetëm një pjesë e vogël sipas t'fë dhënave statistikore është paprivatizuar duhet të ofrohet kreativitet më i madh nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit,se [shtë më pak se një e katërta..

Lidhja Demokratike e Kosovës bënë përpjekje ta kuptojë çka po ndodh me Trepçën kjo çështje është pjesë e debatit me strukturat tona udhëheqëse në kontinuit me grupin parlamentar ,i cili këtë çështje e përcjell me shumë përkushtim, dhe ne ende nuk jemi në dijeni të plotë pse duhet Trepça të jetë nën një administrim të ri ndërkombëtar.

Shë këndejmi kërkojmë si Grup Parlamentar mbështetjen e grupeve të tjera që lidhur me Trepçën dhe fatin e saj të organizohet një debat i posaçëm në Kuvendin e Kosovës.

Duke e mbështetur përpjekjen vendore dhe ndërkombëtare për një zhvillim të mirë ekonomik, Grupi Parlamentar e përshëndet këtë proces dhe kërkon transparencë të plotë institucionale. Ju faleminderit .

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Gashi. Fjalën e ka z. Gjylnaze Syla në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari kryesues, Kabinet qeveritar, deputetë të nderuar.

Z. ministër.Ju faleminderit për Raportin. E mbështetim raportin e tij Z. Ruecker, mirësevini në Kuvend. Ju falënderoj për gadishmëri që t'u drejtoheni deputetëve.

Të nderuar deputetë,

Procesi i privatizimit në Kosovë ka disa specifika të veçanta në krahasim me privatizimin në vendet e tjera të Europës Lindore dhe Juglindore. Mund të thuhet lirisht se në Kosovë po bëhet privatizimi më liberal me elemente të pakta sociale.

Institucionet e Kosovës nuk kanë pasur qasje për ta zgjedhjen metodën e privatizimit në Kosovë. Ishte UNMIK-u, ai që përzgjodhi metodën dhe inicioi procesin.

Sidoqoftë, institucionet e Kosovës nuk mund të jenë indiferente ndaj procesit sepse:

- Pasuria e Kosovës po privatizohet ;
- Zhvillimi ekonomik i vendit varet esencialisht nga ky proces dhe
- Vendet e punës për qytetarët tanë janë në mëshirën e këtij procesi.

Duke pasur parasysh këto çështje jetësore për Kosovën, unë nuk do të ndalem te metoda e privatizimit, por te procesi.

Me qëllim që ta përshkruaj objektivisht procesin, duhen të merren parasysh dy aspekte.

Në njërin anë institucionet e Kosovës dhe të gjitha subjektet politike në Kosovë e mbështesin privatizimin si një proces kyq, për nxitjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Për këtë arsye është e padiskutueshme që ky proces të përkrahet nga të gjithë.

Në anën tjetër, Agjencia Kosovare i Mirëbesimit, i cili menaxhon këtë proces, nuk ka kredibilitet të mjaftueshëm

AKM me disa veprime, ka reflektuar sjellje pak a shumë të paballansuar. Përderisa në kohën kur Z. Lamsdorf ishte udhëheqës i AKM-së nuk nënshkruheshin kontratat dhe kemi pasur ngecje të procesit të privatizimit, në kohën e Z. Ruecker, kryetari i Bordit, privatizimi përshpejtohet. Këtë qasje të Z. Ruecker e përshëndesim.

Koordinimi në mes të anëtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë në Bordin e AKM-s është përmirësuar dukshëm, falë kontributit dhe anëtarëve vendorë.

Interesimi i investitorëve, edhe pse kryesisht vendorë, është i dukshëm dhe me një trend pozitiv. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, janë disa dukuri që na brengosin ne dhe qytetarët.

E para: Edhe pse AKM-ja, nga buxheti i konsoliduar i Kosovës merr më shumë se 67 milion €, ende nuk ndien përgjegjësi ndaj Kuvendit dhe as ndaj ndonjë institucioni tjetër. Pos raportit të parashtruar nga ministri Dugolli, asnjëherë më parë s'kam pasur në dorë raport për punën e AKM-së.

AKM-ja është pavarësuar deri në skajshmëri nga të gjitha insitucionet e tjera. Është e qartë se Bordi i AKM-së ka mbikëqyrjen direkte mbi këtë insitucion. Megjithatë, për shkak se anëtarët e bordit kanë edhe pozita të tjera të larta, një fleksibilitet i madh në veprim i është krijuar menaxhmentit të AKM-së.

Si rezultat, AKM-ja është bërë një institucion tejet ekskluziv. Vërejtje për këtë kanë edhe qytetarët. Unë nga qytetarët marr vërejtjet për arrogancën e këtij institucioni dhe mospërfilljen e ankesave të tyre. Përgjigjet e AKM-së në ankesat e qytetarëve janë me një letër shablon, që përmban vendimin, pa arsyetim dhe pa referencë se mund të bëhet padi në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme për atë çështje.

Duke marrë parasysh edhe restriksionet e shumta për qasjen në këtë gjykatë, konsideroj se kjo është sjellje e papërgjegjshme.

Çdo qytetar, ka të drejtë të marrë vendim që pasqyron se ankesa i është shqyrtuar seriozisht, pavarësisht se çfarë do të jetë vendimi. Përdorimi i një shkrese standarde, ku vetëm ndryshon vetëm emri i të adresuarit është nënçmim dhe mospërfillje e qytetarëve.

E dyta: paratë e mbledhura nga privatizimi, ende janë të ngrira dhe nga ato nuk përfiton as ekonomia dhe as mirëqenia kosovare. Është e domosdoshme që ato mjete të zhbllokohen sa më parë, në mënyrë që të veihen në qarkullim, ose të përdoren për projekte të infrastrukturës, ato ekonomike ose sociale. Argumenti se nga ato mjete duhet të kompensohen kreditorët e mundshëm, nuk qëndron.

Po të konsiderohej kompensimi i ish -pronarëve legjitim, kjo do të ishte e justifikueshme. Por, këtu flitet për kreditorët të cilët kanë pretendime ndaj ndërmarrjeve të Kosovës, për periudhën e masave të dhunshme të viteve 1989-1999.

Dihet se në atë periudhë menaxhmentet e dhunshme të ndërmarrjeve të Kosovës u kanë sjellë ndërmarrjeve humbje serioze, duke marrë kredi pakontrolluar, duke shitur assetet e ndërmarrjeve dhe duke falur assetet e ndërmarrjeve të Kosovës ndërmarrjeve të Serbisë. Kemi raste kur menaxhmentet e dhunshme kanë vendosur që ndërmarrja kosovare t'i bashkohej si ndërmarrje simotër asaj të Serbisë. Është e pajustificueshme që për këto veprime të piligjshme të pësojë ekonomia e Kosovës.

Menaxhmenti i dhunshëm nuk ka pasur legjitimitet të marrë asnjë vendim. Të gjitha këto vendime duhet të shpallen të pavlefshme, sepse as e drejta ndërkombëtare nuk i mbron kreditorët në keqbesim. Të gjithë ata që kanë dhënë kredi dhe kanë bërë afarizëm me menaxhmentin e dhunshëm nuk meritojnë mbrojtje ligjore. Ata e kanë ditur se menxhmenti i dhunshëm nuk ka legjitimitet dhe përkundër këtij fakti kanë bërë afarizëm me ta.

E treta: Procesi i privatizimit në opinion ka krijuar përshtypje të një proces transparent. Për këtë kanë kontribuar një mori ngjarjesh dhe spekulimesh lidhur me kurdisjen e tenderëve të privatizimit. Është fakt se në shumicën e tenderëve të rëndësishëm, ofertuesit tërhiqen nga ofertat me të larta, duke fituar kështu oferta më e ulët. Duke pasur parasysh numrin e madh të tërheqjes së ofertuesve nga oferta e parë, dyshimet e opinionit nuk mund të trajtohen më në nivelin e spekulimit. Këto dyshime duhet të trajtohen seriozisht. Gjer më tani, Bordi i AKM-së nuk ka treguar seriozitet në këtë punë. Ai ka heshtur, edhe pse ka pasur indikacione të shumta për marrëveshje të fshehta në mes të ofertuesve. Këtu kryesisht e kam fjalën për ndërmarrjet që janë me rëndësi të veçantë për Kosovën dhe të cilat privatizohen me spinof special. Kjo procedurë ka kritere më rigorozë se ato normale, por, ato kanë për qëllim ruajtjen e levërdisë ekonomike të ndërmarrjes, ruajtjen e kontinuitetit afarist dhe ruajtjen e vendeve të punës. Rregullat e përcaktuara në këtë procedurë duhen të zbatohen me përpikëri. Përndryshe, të pakualifikuarit për këto biznese do të kenë qasje në to dhe në këtë mënyrë nuk do të arrihet qëllimi për të cilin është zgjedhur procedura e spinofit special, për ndërmarrjet në të cilat është aplikuar kjo procedurë nuk ka pasur asnjë nevojë të ndruhemi për mungesë interesimi nga investitorët. Lëshimet procedurale në parakualifikim kanë shkaktuar disa anomali të dëmshme për ekonominë e Kosovës. Kështu ndodh që fabrika e Pejës, të shndërrohet në vetëshërbim, toka bujqësore të shndërrohet në tokë ndërtimore, ferma në magazinë, kooperativa bujqësore në livadhe etj.

Si shembuj konkret dhe aktual për lëshime në procedura të AKM-së do t'i përmendim privatizimin e Ferronikelit dhe të hotelit Grand.

Në rastin e Ferronikelit, AKM-ja ka lejuar prishje të konzorciumit nga konkurrentët, ndryshimin e mëvonshëm të konzorciumit, shtyrjen disa herë të afatit të pagesës. Pastaj, kushtëzimi nga kompania që privatizon këtë gjigant për të blerë rrymë me tarifë të ultët dhe privilegje të tjera të cilat nuk janë paraparë as me procedurën e privatizimit dhe as me kontratën për privatizim.

Nga ana tjetër Hoteli Grand është një nga hotelet me kapacitete të mëdha në rajon që punëson më se 600 punëtorë. AKM-ja përkundër rregullave të tenderit që kërkojnë ekspertizën hoteliere, përvojën në menaxhim të hoteleve të mëdha dhe bonitetin finaciuar për investime, i lejon firmës ndërtimore, pa asnjë përvojë në hoteleri dhe pa mjete të mjaftueshme për pagesën e çmimit dhe investimeve të nevojshme të marrë pjesë në privatizim dhe ndoshta nesër edhe ta blejë hotelin.

I nderuar, Z. Ruecker dhe anëtarë të Bordit,

AKM-ja nuk është Agjension e patundshmërive, por agjenci e privatizimit të ndërmarrjeve me qëllim të rivitalizimit të ekonomisë. Kosovës më pak i intereson një çmim që jepet për një patundshmëri. Ky nuk është qëllimi i privatizimit.

Qëllimi i privatizimit është ringjallja e ekonomisë prodhuese nga ish ndërmarrjet dhe gjigantët në Kosovë dhe punësimi i qytetarëve. Po e theksoj edhe një herë, se për ndërmarrjet që privatizohen me spinof special gjithmonë ka pasur dhe do të ketë investitorë serioz. Detyra e AKM-së është që t'i inkurojë këta investitorë duke i përfillur rregullat e tenderit dhe duke ia përshtatur ato ringjalljes ekonomike të ndërmarrjes.

E katërta : Menaxhimi i ndërmarrjeve publike është jotransparent. Ndërmarrjet publike i lejojnë vetes përjashtime dhe privilegje të shumta të cilat janë të paimagjinuara për sektorin privat ose shoqëror.

Duhet të kihet parasysh se shërbimet të cilat ofrohen nga këto ndërmarrje janë jetike për qytetarët. Këto shërbime, qoftë në fushën e telekomunikacionit, të pastrimit, të furnizimit me rrymë elektrike apo me ujë, për nga cilësia janë të mangëta, por për nga çmimi të shtrenjta, më të shtrenjtat në rajon. Pse ndodhë kja? Për shkak të monopolit dhe të menaxhimit jo të mirë. E njëjta gjë do të ndodhte edhe në vendin nga vjen z, Ruecker,

Jam e bindur se rrugëdajla nga kjo situatë janë mbikëqyrja më efektive e menaxhmentit, hapja e konkurrencës dhe hapja e ndërmarrjeve për pjesëmarrje të kapitalit privat. Në këtë mënyrë mund të krijojmë një sektor të shëndoshë dhe të qëndrueshëm. Çdo vonesë në këtë aspekt shkakton zvarritje të problemeve dhe është në dëm të qytetarëve të Kosovës. Në fund, Grupi Parlamentar i AAK-së mbështet fuqishëm qëndrimin e kryeministrit dhe të Qeverisë, për luftën kundër korrupsionit dhe inkurajon Bordin e AKM-së që t'i bashkëgjitet këtij qëndrimi.

Në të njëjtën kohë apelojmë që sa më parë të bëhen ristrukturimi dhe riorganizimi i AKM-së.

Qeveria duhet ta përgatitë planin për bartjen e kompetencave në fushën e privatizimit dhe të naxhimit të pronës shoqërore dhe publike nga UNMIK-u te institucionet vendore. Nuk dëshirojmë të paragjykojmë formën e re të organizimit, por do të donim që ky proces të inicohej që nesër. Grupi parlamentar gjithashtu ka hartuar një rezolutë të cilën në fund të mbledhjes së Kuvendit do ta parashtrrojë, meqenëse dëgjuam nga shefat e grupeve parlamentare të LDK-së dhe PDK-së dhe ata kanë gjithsesi rekomandime, prandaj ftoj shefat e grupeve që ta hartojnë një rezolutë dhe në qoftë se pranoni ta kalojmë rezolutën. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Sipas radhës fjalën e ka z. Surroi në emër të grupit parlamentar ORA,

DEPUTETI VETON SURROI – I nderuari kryesues, i nderuari z. Ryker, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj.

Në elokuencën e fjalimit të ministrit e fjalimit 27 minutësh e gjysmë dhe në këto materiale që janë prezantuar nuk pashë asnjë analizë të cilësisë së procesit të privatizimit, por vetëm një mekanikë të përshkrimit të procesit si të tillë. Unë besoj se një pjesë e debatit të sotëm duhet të përqendrohet në cilësinë e procesit, në efektet që i krijon ky proces dhe po qe se ky proces dhe ky debat do të vazhdojnë, është mirë të kemi në materialet e ardhshme përgjigje për pyetjet e tjera. Si p.sh.: sa ka pasur efekt pozitiv procesi i privatizimit në punësim? Sa e ndihmon industrializimin apo deindustrializimin e Kosovës posaçërisht në 7 qendrat industriale, a është ndryshuar struktura prodhuese pas privatizimit apo jo? Sa po e ndihmon apo sa po e dëmton bujqësinë procesi i privatizimit. Çfarë është efekti i privatizimit në masën e parasë që qarkullon në këtë ekonomi? Këto janë gjitha pyetjet të cilat kanë nevojë për përgjigje, në mënyrë që të hartohet një përkrahje apo një ndryshim i politikave ekonomike karshi politikës që krijon privatizimi.

Privatizimi është ristrukturim i shoqërisë, e ridefinon shoqërinë në mënyrën se si punon shoqëria, sepse ridefinon qendrat e pronës dhe mënyrën se si komunikon ekonomia me pushtetin, është një formë e avancuar e demokracisë dhe si e tillë kërkon institucione të tjera.

Ne si grup parlamentar e kemi përkrahur edhe e përkrahim procesin e privatizimit. Çështja nuk është ajo që të dihet sot a e përkrahni apo jo procesin e privatizimit, por me cilin model, me çfarë korigjimesh, apo nuk janë të nevojshme korigjimet fare.

Është një lajm jashtëzakonisht i mirë ky hov në procesin e privatizimit, por duhet të shohim se sa aklimatizohet ky proces i privatizimit, në një mungesë të politikave ekonomike, çfarë kemi sot në Kosovë. Do të veçoja tri apo katër çështje të cilat mendoj që janë me rëndësi të cilat duhet të adresohen në qeveri nga Qeveria dhe në këtë Parlament.

Çështja e parë është nga aspektet e aseteve strategjike: a jemi duke bërë çështjen e duhur. A ka nevojë njeriu ta shesë Ferronikelin sot kur është çmimi i pasigurisë i cili e dikton tregun apo mund të shitet mbas një viti kur statusi i jep siguri atij çmimi dhe nuk është më vlera e çmimit të pasigurisë. Nuk vjen investitori nga Kazakistani, por ndoshta do të vijë një investitor tjetër.

Çështja e dytë është ngrirja e parasë publike. Nga debati i sotëm dhe nga ajo sa di unë për mënyrën se si menaxhohet paraja publike, sot për sot diku mbi gjysmë miliard euro janë të ngrira, janë jashtë dispozicionit të këtij parlamenti. Janë jashtë dispozicionit të qytetarëve, janë para të qytetarëve por ne nuk i menaxhojmë ato, nuk kemi dijeni për to bile. Dhe kjo largësi, mes parasë publike dhe nesh, që e përfaqësojmë interesin publik, është një çështje e cila do të trajtohet edhe nga ky parlament edhe nga kjo qeveri. Tek asetet strategjike, paramendojeni një situatë të cilën ne mund vetëm ta imagjinojmë, por edhe format e tjera të menaxhimit. Qeveria çdo vit paguan mbi një milion euro në qira, pse të mos e marrë me qira Ilirinë me 1 euro në vit, është pronë publike, aty do të mund

të vendosëj Ministria e Kulturës. Kalon edhe kjo çështje, por po them, -ka mënyra se si mund të menaxhohet kjo pronë dhe si të ruhet interesi publik edhe pa hyrë në këto forma dhe të tjera.

Dhe çështja më eklatante që besoj unë, të cilën do trajtuar, është çështja të cilën e përmendi edhe ministri si sukses, por unë mendoj se është sukses gjysma, ajo është korporatizimi i ndërmarrjeve publike. KEK-u është ndërmarrje publike, PTK-ja është ndërmarrje publike, por pronë e kujt është, çka d.m.th. publike sot. Kush është aksionar në atë pronë dhe çfarë është ndërlidhja jonë si përfaqësues i interesit publik me atë aksion. Pse të mos mendojmë për formën se si aksionet e këtyre ndërmarrjeve gradualisht shndërrohen në të mira të përbashkëta të një fondi pensional të ardhshëm. Kush menaxhon 200 milionët e PTK-së. Këto janë çështje të cilat janë shtruar dhe për disa prej tyre ka pasur përgjigje edhe nga z. Ryker. Unë pajtohem pjesërisht se kamatat janë të larta për shkak se është problemi në kërkesë e jo vetëm në ofrim, por në burim paraja është e monopolizuar, është oligopolizuar, prandaj kamata është e lartë, sepse të vetmet bankat e forta kanë aq para sa për të menaxhuar dhe ato e kanë një treg të cilin ato diktojnë, në mungesë të një konkurrence me para tjetër, këta mund të menaxhojnë, po të kishte Kosova fond pensional të fortë edhe ai fond pensional do të dilte në tregun financiar, ai do të ndikonte në zbritjen e këtyre kamatave dhe do të kishte nga rendi nga bankat komerciale, por bankat komerciale janë shndërruar në oligopole të cilat e menaxhojnë një shkallë të lartë të interesit.

Çështja e dytë për të cilën gjithmonë edhe është arsyeimi pse duhet ta kemi fondin të shkrirë dhe investues nga këto para publike, është se kjo para nuk do të shkojë gjithmonë në destinime të duhura. Sot është shumë lehtë të marrësh kredi për tregti, por nuk është lehtë të marrësh tregti për bujqësi, e fondi i zhvillimit duhet të favorizojë ato pjesë të zhvillimit të kësaj shoqërie që kanë nevojë për një përkrahje plotësuese.

Ekziston sot një shpërputhje mes dekapitalizimit dhe kapitalizmit, përkatësisht, kapitalizmit të ndërmarrjeve, shndërrimit të tyre në pronë private dhe kapacitetit financiar të blerësit të ri për të menaxhuar këto. Kjo është kriza më esenciale të cilën do ta shohim në procesin e privatizimit, ndërmarrësit e lirë do të blejnë, nuk do të kenë para për të riaktivizua, sepse paraja është e shtrenjtë.

Dhe çështja e tretë e cila lidhet me tërë këtë segment, është se procesi i privatizimit nuk mund të shikohet jashtë institucioneve të reja të cilat duhet të ndërtohen. Ne mund të flasim sot për shkrirje fondesh, ngrirje fondesh, privatizim, shitje, por nuk e përmendim faktin se Kosova nuk ka bankë qendrore, pra nuk ka autoritet a institucion, i cili do të jetë një lloj arbitri në këtë tregun financiar apo një lloj ndihmësi i rregullimit të marrëdhënieve në këtë treg financiar. Për të gjitha këto, zonja dhe zotërinj, nevojitet politikë bërje, nevojitet një koncept i ndërtimit. Kam frikë se privatizimi e ka përkrahjen tonë elementare, por nuk e ka njohurinë se brenda çfarë konceptit të zhvillimit të shoqërisë brenda çfarë koncepti qeverisës është futur. Këtë na ka borxh natyrisht qeveria dhe kësaj ne duhet t'i ndihmojnë të sajohet në këtë parlament. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Sipas radhës fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar 6+ Xhezair Murati.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Poštovani presedavajući, gospodine Rikeru, ministri, poštovane kolege, parlamentarna grupa 6+ prilazi procesu privatizacije kao jednom od najviših prioriteta u restrukturiranju posleratne ekonomije Kosova. Znajući, misleći i tvrdeći da nije pronađen najbolji modus, odnosno formula da se inicira razvoj ekonomije na bazi lokalnih resursa Kosova. Jasno je da ne postoji ni jedna bezbolna privatizacija, ali je nejasno zašto su mnoga očekivanja i uveravanja od nekih kompetentnih faktora na Kosovu, ali i od međunarodnih ostalih neostvarenih. Da takva očekivanja nisu bila kompetentno zasnovana pokazale su i analize koje smo vršili u našem političkom subjektu još kada je donešena uredba 2002/12 koju je potpisao g. Štajner. Da proces privatizacije nije najbolje koncipiran, ja bih volio da nismo bili u pravu, ali ću navesti primer da promena koncepta privatizacije ako to iziskuju uslovi nije nikakav smak sveta. Ja ću navesti primer Slovenije koja je u svojoj privatizaciji primenjivala, odnosno menjala četiri dosadašnja koncepta privatizacije. Time ne želim da osporim niti uvodno izlaganje gospodina Rikera, g. ministra Dugolija, prihvatajući dobar deo onoga što je rečeno, ali bih volio da nisam u pravu ako kažem da je izostao preko potreban ekonomski preko privatnog sektora. Već su prošle četiri godine ovim samo potvrđujem napred iznetu konstataciju da nije izabran najbolji model privatizacije jer je izostao glavni temelj za budućnost Kosova, a to je upravo rekonstruiranje odnosno dinamiziranje kosovske ekonomije što ću popuniti i još nekim primedbama. Naime, model privatizacije je ostavio po strani neke značajne aspekte koje ću pomenuti od kojih ću pomenuti samo dva: sredstva od prodaje preduzeća u visini od 80% nisu vraćena za razvoj ekonomije, nama nisu poznati razlozi i dosadašnja izlaganja nekih mojih kolega su upravo ukazala na to. Mislim da je g. Krasnići najviše o tome govorio, ali i kolegenica Đulnaze je to pomenula. Drugo, izostala je socijalna politika koja nije mogla da podrži proces privatizacije u stvaranju novih vrednosti koju stvara samo proizvodnja. Ovo su neki od razloga koji nemaće razmatranje pomenutih aspekta u procesu privatizacije bar sada sa mnogo više osećanja i odgovornosti u sprovođenju dalje politike privatizacije i to u kontekstu jedan da se sredstva od prodaje preduzeća kao što sam naveo u visini od 70 posto vrata za razvoj ekonomije. Socijalnu politiku prilagoditi tako da podrži proces privatizacije time bi se zaustavio porast nezadovoljstva radnika koje je evidentirano u manjoj meri nego što to može biti. Dakle, oni koji su radili u društvenim preduzećima i to sve preti da možda prouzrokuje neke socijalne posledice koje trebamo preduprediti većom transparentnošću radnici koji su radili u društvenim preduzećima koji nisu obuhvaćeni za sada procesom privatizacije imaju puno pravo da traže nadoknadu koja im nije za sada realno data i u tom smislu transparentnošću ćemo sigurno smanjiti to nezadovoljstvo ne rešiti ga, mora javni servis stalno jasno da iznosi koliko i šta se privatizira, koja je početna cena koji su uslovi i koliko radnika se obuhvata time. To su neke elementarne stvari u svakom procesu privatizacije i ja se nadam da ću ovim sugestijama koje nisu kritezerske, ja mislim da su to samo konstruktivne sugestije da ćemo napraviti neke pomake ubaciti ponešto što će već kako je rečeno proces koji je imao svoje uspone i padove i zaostajanja itd. Ja mogu da kažem neke od primedaba u vezi Kosovske Poverilacke Agenciju, u njenom borbu nema nijednog pripadnika manjinskih zajednica, to je nedopustivo. Zašto da ga nema ako imamo eksperte

ekonomske itd. Drugo, nemamo jasan procenat zapošljavanja manjina u privatizaciji, zar to nije jedan od standarda, zar to nije važno pitanje koje trebamo da obuhvatimo, veoma lako primećujemo dosadašnju slabu aktivnost rada u već privatizovanim preduzećima, znate kako, visok kredit prvo se kupi na kredit firma pa onda visok kredit za početak njene proizvodnje i onda onaj koji je to privatizovao zaptatne u nove poteškoće i onda nezna šta će kosovska privreda sa takvim ljudima da urade. Dakle ja ću da se zadržim na rečima g.Rikera koji je rekao proces privatizacije stimuliše zapošljavanje, do sada to na delu mnogo nismo videli g. Riker. Još jedan aspekt, kažemo za Kosovo da ima desetine hiljada zaposlenih u zemljama sa visokom razvijenom ekonomijom, među njima ima i prapadnika manjina, govorim za svoju zajednicu, bošnjačku, kako da privučemo taj kapital da stalno ne zavismo od takozvanog zapadnog kapitala od kojeg smo zavisni itd. Kako ćemo privući, privučićemo sigurnošću ulaganja ali vrlo transparentnim zakonima i dogovorima oni moraju da znaju jasno kakva je poreska stopa, kakve su carine koje su carine na uvoz repromaterijala itd, kako zaštititi domaće tržište od svega toga, i od prilike da ne bi ispalo da sam ja veliki pesimista, na bazi svega iznesenog želim da svaka debata koja se posvećuje privatizaciji kao današnja da postignemo koncenzus, da imamo nekog pomaka od toga, jer ćemo pospešivanjem proizvodnje efeikasnijom privatizacijom sigurno izgraditi bolju budućnost Kosova koja će biti i ekonomičnija ali i prosperitetnija mislim da nam je cilj svima to. Hvala!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Në emër të Grupit për Integritet dhe Drejtësi dhe të merr fjalën? Deputeti Zylfi Merxha, mikrofonin ju lutem.

DEPUTETI ZYLFI MERXHA – Zotni kryesues i nderuar, z. Ryker i nderuar, ministra të nderuar, zonja dhe zotërinj deputetë.

Më vjen mirë që sot po bisedohet për privatizimin në Kosovë, gjoja se do të përparojë Kosova, do të bëhet shumë më mirë, mirëpo sa po e shoh unë, punëtorët të cilët kanë punuar nëpër sipërmarrje ose nëpër fabrika, sot janë nëpër rrugë, të uritur, pa punë, pa ndihmë, pa sigurim social. Po e marri veten ku kam punuar 32 vjet si udhëheqës në Printeks, 2600 punëtorë Printeksi, i cili ka pasur 16 hektarë tokë, Printeksi i cili ka pas disa halla të objekteve, Printeksi që ka pasur disa magazina, Printeksi i ka sot makinat e të mbyllura. Halla ende pa ia filluar punës është shitur për 3 milion e diçka euro.

Ata njerëz që e kanë blerë Printeksin krejt punëtorinë e kanë qitur jashtë, asnjë nuk e kanë marr në punë e tash po e shesin atë Printeks copa -copë edhe njëri po bëhet menjëherë miliardë, se në qendër të qytetit i ka disa halla, disa magazina, disa makina, e mos të hyjë në punë, të mos punësojë njerëzit, vetëm t'i qes në sokak ata që kanë punuar para disa kohe, as rrogën nuk ia kanë dhënë, qenë ankuar. Askush me ta nuk ka biseduar as nuk do të, bisedojë. Kisha me thënë se për këtë duhet të bisedojmë, se na jemi në Parlament, por ata punëtorë që na kanë zgjedhur, a njeri prej tyre jam unë që kam punuar aty, do të thosha se duhet t'u thotë dikush këtyre zotërinjve si po e bëjnë këtë punë kur po e shesin se duhet të marrin punëtorët në punë, kurse Printeksi asnjë s'po e merr. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Tani po fillojmë sipas radhës që janë paraqitur deputetët dhe për fjalë është paraqitur i pari Sadudin Berisha. E keni fjalën, urdhëroni

DEPUTETI SADUDIN BERISHA - I nderuari kryesues, të nderuar ministra, i nderuari z. Ryker.

Neve sot na u prezantua një informacion mjaft i plotë i procesit të privatizimit si nga udhëheqësi i Shtyllës së IV z. Ryker, njëherit edhe udhëheqës i AKM-së ,në njërën anë dhe në anën tjetër anëtari i përkatës i zëvendësimit të AKM-së z. Dugolli për procesin e arritur të privatizimit në këtë periudhë deri ditën e sotme.

Vlerësimi është se procesi i privatizimit ishte mbështetur nga institucionet e Kosovës si domosdoshmëri, si proces që do të ndikonte në zhvillimin e ekonomik dhe në punësimin në vend, në futjen e ekonomisë së Kosovës në tregun konkurrues dhe të lirë. Rezultatet nuk mund të thuhet se kanë munguar, veçmas kohëve të fundit ,por a janë të mjaftueshme, mendoj se jo. Procesi i privatizimit edhe sot po udhëhiqet nga AKM-ja. Qeveria e Kosovës është jashtë këtij procesi, për deri sa në këtë vit nga buxheti i Kosovës, si u thua AKM-së i janë ndarë, hiq ma pak se 68 milion euro për të financuar veprimtarinë e AKM-së pa asnjë llogaridhënie ndaj financuesit -Qeverisë së Kosovës.

Unë nuk do të marrë pjesë në debat, por do t'i shtroj disa pyetje konkrete, për z. Ryker. A janë arritur objektivat që ka synuar AKM-ja në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore për këtë periudhë të deritanishme? Nëse po, cilat janë objektivat e programuara dhe ato të arritura? Sa janë përmbushur detyrimet kontraktuese mes AKM-së dhe pronarëve të rinj të ndërmarrjeve të shitura? Nëse po, sa? Nëse jo, pse?.

Pse ka aq vonesa në zgjidhjen e lëndëve të cilat procedohen në Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës, si pengesë e finalizimit të ndërmarrjeve të shitura. Pyetja tjetër, Pse nuk janë paguar ish- punëtorët e ndërmarrjeve të shitura 20% i vlerës së shitjes? Mendoj se këtu është bërë një padrejtësi e madhe e mundshme të ish -punëtorëve të ndërmarrjeve të shitura dhe ato mjete sot janë të deponuara në një bankë jashtë vendit për t'u kapitalizuar për interesa të caktuara.

Pyetja tjetër, pse dhe cili është qëllimi, që parat e ndërmarrjeve të shitura të deponohen në bankat jashtë vendit e jo në bankat tona këtu në Kosovë, pse kjo ndodh? Kujtoj se sistemi bankar në Kosovë edhe për kundër vështirësive që ka pasur, janë krijuar rrethana mjaft serioze të besueshme dhe të interesuara për ta ndihmuar ekonominë kosovare dhe zhvillimin e saj. Sa do të përfitonte ekonomia e Kosovës sikur ato mjete jashtë të deponuara të investoheshin në ekonominë e saj, që është aq e etshme për investime në biznes dhe në ekonomi, por të gjithë e dimë se zhvillimi ekonomik i Kosovës është parakusht kryesor për ndërtimin e një shoqërie stabile integruese. Kujtoj se ky moment që kërkon që sa më parë të bëhet transferimi i kompetencave dhe përgjegjësive të AKM-së në Qeverinë e Kosovës. Krejt në fund rekomandimet e propozuara nga ministri Dugolli, alternativa e dytë, mendoj se duhet të miratohen dhe të mbështeten si nevojë e domosdoshme e transferit të kompetencave. Ja faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, z. Berisha, fjalën e ka Safete Hadergjonaj,

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – I nderuari z. kryesues ,të nderuar deputetë.

Procesi i privatizimit është mirëpritur në Kosovë- u tha këtu nga të gjithë diskutuesit .si çështje me interes parësor dhe si një nga shtyllat bazë të transformimit të ekonomisë së tregut. Përvojat e privatizimit në rajon kanë dhënë sinjal të çartë se për privatizim të suksesshëm është e nevojshme strategjia e qëndrueshme e privatizimit ,ku do të përfshiheshin .. dhe si një nga shtyllat bazë të transformimit të ekonomisë së tregut. Përvojat e privatizimit në rajon kanë dhënë sinjal të çartë, se për një privatizim të suksesshëm është e nevojshme strategjia e qëndrueshme e privatizimit ku do të përfshiheshin metodat dhe modelet e përparuara të privatizimit,aspektet ligjore dhe parakushti ligjor i privatizimit që është transparenca.

Mungesa e kësaj strategjie ka bërë të ketë pasiguri rreth pronësisë në të ardhmen, ka çuar te oportunitizmi menaxherial, solli prishje të disiplinës në punë, duke manipuluar me procedurat e ofertimit dhe natyrisht edhe të një performancë e dobët e procesit që është një ndër sfidat kryesore të ngecjes së zhvillimit ekonomik dhe të rritjes së problemeve sociale. Se nuk do të kemi qasje serioze nga Qeveria ndaj këtij procesi fundamental për zhvillimin e ekonomisë së tregut është vërejtur qysh kur na është ofruar për shqyrtim programi i Qeverisë për vitin 2004-2008, ku kanë munguar objektivat e qartësuar se çfarë qasje do të ketë Qeveria në çështjen e privatizimit. Krejt çka thuhet në këtë program është se duhet të sigurohet një rrjedhë normale e procesit, duhet të evitohen paqartësitë, korrigjimet sipas nevojës së politikave operacionale, duhet të zbatohet me përgjegjësi modeli atraktiv për investitorët, duhet të gjendet zgjidhje për zhbllokimin e fondeve për të vazhduar ne duhet prapë edhe me dy tri fjali të tjera që t'i përmbyllim tërë objektivat e Qeverisë për këtë çështje kaq me rëndësi. Raportin që e paraqiti ministri, i cili na u ka dhënë edhe në shqyrtim prapë nuk vërehet ndonjë angazhim konkret apo qasje konkrete ndaj këtij procesi nga ana e Qeverisë, megjithatë Qeveria është pjesëmarrëse në procesin e privatizimit dhe ka për obligim të bëjë më shumë për privatizimin dhe duken naive arsyetimet për mungesë kompetencash ,ku nuk kanë punuar seriozisht për t'i marrë kompetencat, sepse ua ka zënë sytë lakmia e tenderomanisë. Do të ishte mirë që Qeveria të na njoftonte se çka ka bërë për evitimin e paqartësive dhe për korrigjimin e politikave operacionale në favor të procesit të privatizimit e jo në favor të krijimit të mundësive për marrëveshje të fshehta. Cilat janë përpjekjet konkrete të Qeverisë për të bërë zhbllokimin e fondeve. Çfarë ka bërë Qeveria që 20% i shumës të shitjeve t'u jepet punëtorëve, çka ka bërë Qeveria për të ofruar model atraktiv për investitorët, a ka bërë analiza, Qeveria, cilat efektet pozitive dhe negative të këtij procesi?Sa ka ndikuar procesi privatizimit apo në fakt privatizimi në rritjen e ekonomike dhe në rritjen e investimeve të jashtme. Do të kishte qenë mirë të kemi edhe ndonjë shifër përpara. Është krejt logjike se, duke e vërejtur këtë joseriozitet të Qeverisë për t'iu qasur kësaj çështje kaq vitale të ekonomisë në mënyrë profesionale AKM, si përgjegjëse për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë,e llogariti veten të gjithëpushtetshme dhe të vetëmjaftueshme, pa e ndier nevojën për një komunikim të hapur dhe për bashkërenditje të veprimeve me

aktorët kyç të privatizimit, si dhe për transparencë ndaj Parlamentit dhe opinionit në tërësi, ndonëse ishte proklamuar si parim kyç i AKM-së.

Mungesa e transparencës, të nderuar kolegë deputetë, le hapësirë për të dyshuar se ka korrupsion sidomos kur kemi të bëjmë me privatizimin e kompanive të mëdha, të cilat shumë me lehtësi mund të bëhen edhe kompani profitabile. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe në valën e fundit të privatizimit të Grandit dhe të Ilirisë. Qeveria dhe as AKM nuk kanë marrë përgjegjësinë për kontrollin dhe gjetjen e mekanizmave për mbrojtjen nga dukuritë negative gjatë procesit të privatizimit, por u bënë bashkëpjesëmarrës të dukurive negative që janë pengesë e zhvillimit ekonomik si janë: larja e parave. Marrëveshjet e fshehta në mes të blerësve potencialë lejuan subjektivitetin gjatë zgjedhjes së ofertuesit fitues, bënë zgjedhjen e ofertuesit fitues me pak transparencë, dhe hapur ju qasën manipulimit potencial. Nga mosefikasiteti i procesit të privatizimit ka pësuar ekonomia, sidomos komunat e varfra që kanë pësuar edhe dëme nga lufta. P.sh. në komunën e Deçanit deri në valën e 13 asnjë ndërmarrje nuk ka qenë në ofertë për privatizim. Do të ishte mirë të njoftohemi nëse është neglizhencë e komunës, e AKM-së, apo është fjala për marrëveshje të fshehta. Komercijalizimi i të vetmes ndërmarrje fabrika e mobileve masive ka dështuar. Pronari i saj nuk ka qenë i interesuar ta aktivizojë prodhimtarinë dhe ka ikur duke lënë borxhe të mëdha Askush nuk merr përgjegjësinë për të. Nuk dihet çfarë do të jetë fati i ndërmarrjes APIKO, as i kompleksit turistik, që të dy janë pronë shoqërore, por janë në pjesën e 24 hektarëve të uzurpuar nga Manastiri me një vendim të Qeverisë të Millosheviqit në vitin 1997. Kjo nuk është çështje që mund të heshtet nga ky Parlament apo të anashkalohet e të injorohet nga Qeveria. Numri i madh i të papunëve të regjistruar në zyrat e kësaj komune që kanë shpresuar se ndonjëri nga ata do të gjejë punë me privatizimin e ndërmarrjeve të tyre, bredh rrugëve apo është larguar nga Kosova për të siguruar ekzistencën. Shqetësuese është se edhe aty ku ka pasur ndërmarrje të privatizuara nuk ka pasur rezultate pozitive. Shumë ndërmarrje të cilat janë privatizuar kanë pasur vështirësi për t'i implementuar programet e tyre, sepse kreditë që japin bankat tona nuk janë rentabile për implementimin e programeve të tyre. Politika fiskale nuk është e favorshme, infrastruktura publike jo e mirë, problemet me KEK-un, konkurrenca jo lokale etj. për të gjitha këto çështje është dashur të ketë më shumë interesim Qeveria dhe t'u qaset më me seriozitet. Deputetë të nderuar, ekonomia e Kosovës është në krizë të thellë, popullata para vështirësive të mëdha sociale, është nevojë urgjente që për privatizim të nxirret rregullativa e mirëfilltë ligjore, ligji për privatizim i miratuar në këtë parlament si dhe strategjia e qëndrueshme e privatizimit. Nëse nuk ndryshohen forma dhe modeli i procesit të privatizimit dhe nuk merren masa të tjera që ky proces të jetë më efektiv, ashtu që të shpreh interesin tek investitorët e huaj dhe tek ata vendorë dhe në diasporë ai praktikisht është dhe do të jetë pengesë kryesore e zhvillimit ekonomik dhe funksionimit të ekonomisë së tregut në Kosovë.

Ky debat në Parlament, protestat e shumta të qytetarëve të cilat janë bërë ditë më parë, debatet e shumta publike në përpjekje për të luftuar korrupsionin e instaluar në instancat më të larta të Qeverisë, duhet të jenë një sinjal i fuqishëm për koalicionin qeverisës të korruptuar e të inkriminuar, se durimit të qytetarëve po i vjen fundi. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. deputete, fjalën e ka deputeti Shaban Halimi.

DEPUTETI SHABAN HALIMI –I nderuari zoti kryesues, ministra, z. Ryker, të nderuar kolegë deputetë.

Sot kur po e diskutojmë privatizimin, në emër të tij,unë për vete e kam kuptuar se një prej elementeve kryesore duhet t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik të vendit, si janë edhe dy elementet e tjera. Korniza legjislative e cila tanimë nga ky Parlament është e kompletuar, po ashtu edhe buxheti i konsoliduar i Kosovës që tanimë mund të konsiderohet buxhet i qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik.

Edhe privatizimi i cili në bazë të gjitha informatave që kemi është i realizueshëm,gati dy të tretat e ndërmarrjeve në përgjithësi duhet t'i nënshtrohen privatizimit, janë të privatizuara. Unë mendoj se në parim është arritur qëllimi kryesor që tri kushtet elementare janë të krijuara për një zhvillim ekonomik të Kosovës, për një punësim, pak më të madh dhe për të ndikuar në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve dhe të njerëzve në Kosovë.

Gjatë procesit të privatizimit çështjet të cilat më së tepërmi më brengosin janë çështja e përcjelljes së ndërmarrjeve të privatizuara në të dy metodat tani të njohura sipas spinof-it special dhe spinof-it të thjeshtë apo atij të rregullt. Kemi ndërmarrje të cilat sipas spinof-it të rregullt të privatizuar,që kanë mbetur nën mëshirën e atyre privatizuesve dhe nuk ka hapa të ndërmarrë drejtë konsolidimit apo zhvillimit të aktiviteteve ekonomike me qëllim të punësimit. Në këtë drejtim kemi, po ashtu,situatën edhe me spinof-in special, ku shumë ndërmarrje edhe pse u cek se disa janë vënë në funksion dhe kanë kryer obligimet e tyre në bazë të rregullave të privatizimit ,kemi edhe shumë prej tyre të cilat nuk i kanë kryer obligimet e tyre qoftë në investimin në zgjerimin e kapaciteteve të kushteve për një prodhim më të mirë, por gjithashtu edhe në punësimin ose premtimet që kanë marrë për punësimin e punëtorëve në ato ndërmarrje të privatizuara. Me këtë dua të them se AKM-ja duhet të jetë e vëmendshme me ofertuesit të cilët ofertojnë duke parë referencat e tyre se janë ofertues seriozë për të privatizuar ndërmarrje për të cilat kanë afinitete për t'u udhëhequr, apo janë thjeshtë njerëz të interesuar vetëm që kanë emër dhe të privatizojnë ndërmarrje të cilat nuk tregojnë aftësi menaxhuese për resorë të caktuar.

Çështja tjetër që për mua është prengosëse, është privatizimi i ndërmarrjeve bujqësore, ndërmarrje që në të gjitha komunat e Kosovës përfshijnë sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore dhe kullotave. Në këtë drejtim kam parasysh se këto ndërmarrje janë të themeluara nga ish- pushtetet e dikurshme atëherë komunale dhe që kanë të bëjnë me prona kadastrale të cilat janë të fshatrave dhe prona komunale që dikur në i kemi quajtur otrina. Në këtë drejtim neve nuk kemi një ligj mbi pronën i cili do të rregullonte statusin e tyre, se janë prona publike, se janë prona shoqërore dhe kush menaxhon këto prona. Prandaj unë në këtë drejtim, po ashtu, kam preferencën time, që pa miratimin e Ligjit mbi statusin e pronës publike apo shoqërore të mos ngutemi me privatizimin e këtyre ndërmarrjeve ,sepse me siguri në të ardhmen do të ketë edhe tendenca nga pushtet

komunale, në realitet nga pushteti lokal, po ashtu edhe nga komunat kadastrale të fshatrave që ato t'u dalin zot atyre pasurive.

Dhe çështja e tretë, është ajo një që sot e kemi në materiale dhe vjen nga Ministria për Bujqësi dhe Pylltari, privatizimi i aseteve të ekonomive pyjore dhe objekteve të tjera përcjellëse. Unë mendoj se pjesa më e madhe e pyjeve diku 60%, është në menaxhimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe kjo agjenci për të menaxhuar dhe për t'i kontrolluar pyjet në përgjithësi, përdor infrastrukturën e trashëguar nga ekonomia pyjore, ku janë objektet dhe kemi disa fidanishte të cilat janë në kuadër të Agjencisë pyjor të Kosovës. Po ashtu kemi edhe objektet e ekonomisë pyjore që kanë shërbyer në të kaluarën do të thotë për ushtrimin e veprimtarisë së asaj ekonomie dhe ato sot, si duket, duhet t' i nënshtrohen privatizimit. Unë mendoj se në këtë drejtim është mirë të arrihet kompromisi dhe të vihen kontaktet me kontaktet me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit që të gjendet një zgjidhje për transferin e këtyre pasurive në Agjencinë e pyjeve të Kosovës.

Këto dhe për mendimin tim, janë ato tri çështjet për të cilat kam shfaqur interesim t' i paraqes.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Halimi fjalën e ka deputetja Brikenda Kryeziu, le të përgatitet për fjalë Naser Osmani.

DEPUTETJA BRIKENDA KRYEZIU – Ju faleminderit, përshëndes edhe pjesëmarrjen e z. Ryker në këtë debat.

Kolegë të nderuar, gjendja e pasluftës mjaft e rënduar dhe e tendosur, si dhe problemet të cilat e kanë përcjell gjithë kohën në vazhdimësi gjendjen ekonomike të Kosovës, që ka kaluar nëpër disa faza, të cilat nuk kanë treguar sukses të veçantë.

Për këtë arsye, për të krijuar kushte sa më të volitshme, është edhe Agjencia Kosovare e mirëbesimit, e cila mbështetet në rRregulloren 2002/12/ dhe e cila si pikë synim në vete ka ruajtjen dhe shtimin, gjithashtu qëndrueshmërinë e vlerës afariste në qeverisjen e përbashkët të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë. Ky proces tani konsiderohet se është dinamizuar mjaft kohëve të fundit, vitin e fundit në krahasim me vitet e mëparshme.

Suksesi mund të konsiderohet që është arritur në privatizim të një numri të ndërmarrjeve shoqërore si dhe në korporratizimin e ndërmarrjeve publike, duke llogaritur të gjitha valët e privatizimit që janë arritur deri tani. Vlerësoj që në gjendjen aktuale ky proces i ka disa mangësi, të cilat paraqiten si mungesë e vizionit të zhvillimit të mirëfilltë që do të tregojë sukses në të ardhmen. Këtë koment e bazoj në vlerësimin e metodave të privatizimit që zbatohen tani. E kam fjalën për metodën spinof që në shumicën e rasteve metodë e privatizimit bazohet vetëm në shitjen e ndërmarrjeve, sipas çmimit pa përfshirë fazën e dytë të fazës së spinof-it të thjeshtë, ku janë të përcaktuara dhe duhet të merren parasysh edhe të merren në konsideratë edhe veprimtaritë e-propozuara nga investitori,

investimet ,punësimi dhe disa kritere të tjera. Kjo është çështje mjaft e rëndësishme që në disa raste anashkalohet në vlerësimin apo në shitjen e ndërmarrjeve publike.

Sa i përket spinof-it special vlerësoj që edhe këtu janë paraqitur disa ngecje. Kjo konsiston që me faktin në shumicën e rasteve në shitjen e ndërmarrjeve me spinof special, kushtet e përcaktuara dhe kushtëzimi i veprimtarisë të ndërmarrjes pas shitjes nuk ka vazhduar, do të thotë është ndryshuar komplet destinacioni i veprimtarisë i ndërmarrjes, si nga aspekti i zhvillimit të ndërmarrjeve industriale, gjithashtu edhe nga pronat apo shitja e pronave bujqësore në përgjithësi.

Çështje tjetër, me rëndësi, është edhe çështja e definimit të statusit të shoqërive aksionare. Nuk e di nëse z. Ryker i kujtohet me 1 prill të vitit 2005 janë dorëzuar vullneti dhe dëshira e 17 mijë punëtorëve të ndërmarrjeve aksionare të komunës së Gjakovës që është premtuar që do të rregullohet me ndërrimin e rregullores. Kjo rregullore është ndërruar, lëvizjet e para janë vërejtur pikërisht këtë javë me vizitën e ministrit Dugolli dhe përfaqësuesit të AKM-së në Gjakovë, të cilët kanë paraqitur risi në aspektin e zhvillimit të ndërmarrjeve aksionare që do të shohim nëse do të ketë sukses. Në fund e kam edhe një pyetje për këtë.

Procesi i privatizimit, gjithashtu, është mjaft kompleks që në vete përmban edhe disa problematika të tjera që ballafaqohen jo vetëm në ndërmarrjet në tërësi ,por edhe me organet komunale dhe të nivelit qendror dhe të atij komunal e të qeverisjes në përgjithësi.

Në problemet që paraqiten në menaxhimin e ndërmarrjeve pyjore, e të shtretërve të lumcnjve dhe shfrytëzimit të zhavorrit ,që nuk janë paraparë më parë dhe në disa raste janë si ndërmarrje shoqërore, për të cilat ende nuk është kryer privatizimi dhe nuk menaxhojnë ashtu si duhet. Ka probleme edhe në paraqitjen ose në aspektin e planifikimit urbanistik dhe hapësinor që ndërliidhen dhe duhet të paraqesin qasje pozitive dhe AKM-së lidhur me planet zhvillimore në të cilat përfshihen pronat me destinim të pacaktuar, që janë të përfshira në planet e interesit të përgjithshëm si komunal edhe në atë qendror.

Sa u përket ndërmarrjeve publike deri më tani kjo është një qasje shumë pozitive, të cilën AKM-ja besoj se ka, por nuk vërehet aq mirë në menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Këtu do të veçoja, përveç PTK-së e cila ka vetë qëndrueshmëri financiare me ndërmarrjet e tjera publike, me krijimin e bordeve nuk kanë treguar një sukses të pritur. Këtu mungojnë investimet kapitale edhe grantet të cilat janë dhuruar, nuk arsyetojnë raportin e mjeteve të investuara dhe afatet për përmirësimin e gjendjes së paraqitur, nuk janë krijuar partneritete të barabarta të qeverisjes dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike në tërësi. Problem tjetër është edhe funksionimi jo i mirë i ndërmarrjeve pas privatizimit. Ka ngecje për shkak të rasteve të pazgjidhura të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, konfliktet e interesave ndërmjet aksionarëve të rinj si dhe kreditorëve të ndërmarrjeve që kanë qenë përpara.

Funksionimi i mirëfilltë i ndërmarrjeve vërehet në disa ndërmarrje që e keni cekur edhe ju Z. Ryker, me 5 shembuj që i paraqitët në fjalimin tuaj. Zgjidhjet e përkohshme janë vërejtur në disa çështje, posaçërisht në çështjet e aktivizimit të shoqërive aksionare.

Pyetja ime është : Cilat do të jenë metodat që do të aplikohen pasi shoqëritë aksionare nuk kanë status të definuar si ndërmarrje shoqërore, që do të privatizohen, apo ndërmarrje publike në të cilat do të krijohet bordi dhe do t'i udhëheqë ato. Cili është mekanizmi që do të përdoret në tridhjetë ndërmarrje, posaçërisht në ndërmarrjet e Gjakovës. Kolegë të nderuar, e kam bindjen që ka edhe nëpër komunat e tjera dhe është problem i gjithë ndërmarrjeve të të njëjtit nivel në Kosovë.

Mekanizmi i parashikimit të suksesit të këtij procesi duhet t'i parashohë edhe ngecjet të cilat i ka, identifikimin e ngecjeve, ofrimin e opsioneve si dhe zgjidhjen e këtyre problemeve që paraqiten në këto tri fazat si në ndërmarrjet publike, ndërmarrjet shoqërore dhe në shoqëritë aksionare në tërësi. Unë vlerësoj që si rekomandime të cilat anëtarët e Qeverisë do t'i përcjellin nëpërmjet bordit të AKM-së, duhet të jenë që Qeveria nëpërmjet përfaqësuesve të vet ta tregojë vendosmërinë e mëtutjeshme dhe përkushtim të plotë në përcaktimin e kriterëve të sakta, të cilat e krijojnë mundësinë dhe një baraspeshë në krijimin e realizimin e një sukseesi dhe gjendjes aktuale. Domethënë t'i vlerësojmë shkallët me mekanizma të caktuar, sa kanë arritur sukses privatizimi në tërësi. Përcaktimi dhe zbatimi më përpikëri i privatizimit me metodën e spinofit special, së cilës posaçërisht duhet t'i kushtohet vëmendja në pronat bujqësore, kemi shumë raste kur ato janë shndërruar në objekte, pompa benzenit apo restorante, kështu që definimi i veprimtarisë me spinof special të zbatohet në tërësi në bazë të projekteve investive, që ofrohen nga investitorët.

Realizimi ose shfrytëzimi i kapitalit të akumuluar si kapital i freskët, që mund të shfrytëzohet në ndërmarrjet publike, nuk është duke ndodhur dhe e dimë të gjithë jemi të vetëdijshëm jemi, për situatën e cila ekziston në ndërmarrjet publike. Cilësia e shërbimeve është e ulët, por mos të them nën nivel, kjo shihet nëpër rrugë të qyteteve, kjo shihet edhe në çmimet të cilat ofrohen nga këto ndërmarrje.

Gjithashtu çështje me rëndësi është edhe definimi i çështjes së statusit të përhershëm të ndërmarrjeve shoqërore, që do të krijojë një sukses të vazhdueshëm në investimet, të cilat krijohen në të ardhmen, sepse në gjendjen aktuale të premtuar nuk e di sa do të ketë sukses kur mjetet të cilat investohen apo kreditori nuk dihet i cili ka me qenë plani investiv kur nuk dihet sa do të zgjatë kjo periudhë e investimit ose kur do të definohet statusi i përhershëm i të gjitha këtyre ndërmarrjeve.

Këto ndërmarrje janë legjitimur në bazë të ligjeve të para vitit 1999, ligjeve për transformimin e kapitalit, gjithë kjo procedurë të përcaktohet me përcak mekanizma të saktë që do të marrin masa për vazhdimin e zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve shoqërore në tërësi. Besoj që Qeveria do të angazhohet edhe më tutje në tërësi, edhe angazhimin e tyre në bordin e AKM-s, që këto procese edhe gjithë rekomandimet e përfshira në këtë proces të zbatohen në të ardhmen. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Fjalën e ka Naser Osmani, le të përgatitet për fjalë z. Fadil Gashi.

DEPUTETI NASER OSMANI – Z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Si po duket kjo temë duhet të ishte tema qendrore e interesimit në Kuvend në krahasim në ditën e djeshme mbeti disi pa një interesim. Sigurisht që është kompetencë e rezervuar dhe aty nuk po na e mban të flasim me ta në këtë relacion.

Procesi i privatizimit në Kosovë ,pa dyshim ,është njëra nga sfidat më të mëdha që po kalon Kosova në fazën e transicionit politik dhe ekonomik. Kur është formuar AKM-ja në fillim është menduar të jetë agjenci e pavarur që do të bënte transferimin e pronës shoqërore në pronë private në kuptimin e asaj që t'ia jap një inercion ekonomisë së shkatërruar.

E vërteta është që kështu nuk ka ndodhur, nuk është realizuar ajo që është menduar në fillim, arsyeja është se si në start ka pasur menaxhim të dobët, nuk janë pranuar që në kuadër të AKM-së të ketë edhe menaxhues vendorë, AKM-ja i ka keqpërdorur privilegjet e veta edhe kështu është shndërruar në një superqeveri në vete.

E kisha përgëzuar z. Ryker për arsye se pre ardhjes së tij ka marr një dinamiëk më të shpejtuar, mirëpo si prej fillimit ka pasur ngecje që ka ndikuar në stagnimin e tjetërsimit të pronës shoqërore dhe drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Dhe kjo ka ndikuar që të ketë një amortizim ekonomia në përgjithësi, një amortizim teknologjik, një amortizim fizik dhe nga ajo më e keqja ,që ka ndodhur një amortizim moral, që ka të bëjë me këtë potencial, i cili nuk ka qenë bashkë për një nënvlerësim por ka qenë solid në Kosovë. AKM-ja nuk ka marrë parasysh asnjëherë nevojat shoqërore, nuk ka marrë asnjë herë në konsideratë kontestet pronësore -juridike, që kanë të bëjnë me tjetërsimin e pronës së patundshme dhe më e keqja është që AKM-ja asnjëherë nuk ka marrë një konsideratë ato nevoja që janë paraqitur drejtë për së drejtë komunave, duke tjetërsuar pronën mu në mes të qytetit që komunave nuk ia ka mundësua ta realizonin planin strategjik zhvillimor dhe urbanistik.Kjo ka ndodhur edhe në qytetin e Prishtinës, që në mesin e Prishtinës të tjetërsohet prona shoqërore , pa e informuar blerësin me kohë se cilat janë planet urbanistike të qytetit e të qytetit dhe kjo sigurisht në të ardhmen ka me krijuar një konflikt në mes të interesave të komunës dhe interesave të blerësit.

Çështja në vete është, ndoshta kjo është menduar që të rregullohet edhe me një rregullore që është nxjerr sivjet Rregullorja 2006/5. mirëpo edhe kjo rregullore është shumë e komplikua, ka procedura të gjata dhe nuk është shumë fleksibile.

Çështja të cilën e keni përmendur më parë , por që e kam përmendur edhe unë në një seancë kur ka qenë çështja e zhvillimit ekonomik, është çështja me mjetet nga fondi i privatizimit, mjetet që mbahen të bllokuara, të cilat nuk janë në qarkullim, mirëpo nga ana tjetër e njëjta shumë e mjeteve që është derdhur në atë fond janë mjetet që kanë dalë nga qarkullimi i varfër i paqesave në Kosovë. Gjuhën që sot po e përdor është shumë

kritike, mirëpo qëllimi im është çështja që duhet të ketë një transparencë më të madhe edhe me fjalë më të thjeshta kisha dashur që AKM-së t'i bëhet një auditim.

Pse t'i bëhet AKM-së një auditim, për arsye se politikat operacionale nuk kanë qenë në favor të ritjes së fondit të privatizimit, se me këto politika operacionale ju ka mundur që tërhiqja e ofertuesit të parë t'i mundësojë të marrë punë tek ofertuesi i dytë dhe të tretë dhe që kjo ka ndodhur në se 40% të rasteve dhe kjo e ka dëmtuar këtë fond rreth 40 milionë euro. Kjo është nën një, nuk kisha dashur të flas edhe për datën e kualifikuese që është 5 ditë para hapjes së ofertave që janë zakonisht duhet të jetë vetëm disa orë jo 5 ditë.

Një arsye tjetër është, që pse duhet të ketë auditim, është bërë edhe tjetërsimi i pronave me vetëm një ofertues, dhe ato për ato konzerciume që nuk janë të qëndrueshme aspak. Një arsye tjetër është që AKM-ja ka marrë vendim që të bëjë një administratorë të huaj për Trepçën, pse të bëhet një administratorë tani për Trepçën kur ka ardhur faza përfundimtare e tjetërsimit që duhet të tjetërsohet edhe kompleksi Trepça a do të jetë ky qëllim i falimentimit të 12 ndërmarrjeve të Trepçës, apo është ndonjë qëllim tjetër, vërtetë 19 fabrikave të Trepçës jo 12, pse nuk është bërë më herët.

Një arsye pse duhet të ketë auditim, se AKM-ja deri më tash nuk ka bërë transparente llogaritë e veta për ato ndërmarrje që i ka dhënë në komercializim, janë më se 50 ndërmarrje. Një çështje tjetër është, që AKM-ja nuk ka arritur t'i shlyejë borxhet të atyre ndërmarrjeve shoqërore që janë tjetërsuar dhe që kanë pas obligim ndaj administratës tatimore. Kjo shumë është gati 30 milion euro. Duhet të kihet parasysh që AKM-ja ka bërë deri më tani në fazën e momentit të likuidimit të tyre, duhet ta bëjë këtë bartje, dhe ajo që është për mua si kryetar i komisionit për buxhet dhe financa kryesore është, që deri më tani AKM-së, ia kemi ndarë 186 milion euro.

Për këto shuma unë kërkoj ta kemi një auditim. Për auditimin që është më se i nevojshëm, do ta kisha lutur Kryesinë e Kuvendit t'ia bëjë një kërkesë z. Petersen, si na e bëri ai neve për auditimin e Kuvendit, që t'i bëhet një auditim i plotë, një auditim detal AKM-së, në kuptimin e asaj që ne kemi informacione se çka po ndodh, çka ka ndodhur dhe se vetëm atëherë mund t'i japim vlerësimet tona për këtë proces që është njëri ndër proceset më të rëndësishme në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Osmani, fjalën e ka deputeti Gashi, të përgatitet për fjalë Mazllum Kumnova.

DEPUTETI FADIL GASHI – Ju faleminderit z. kryesues, z. Ryker, të nderuar ministra kolegë deputetë.

Unë kam një parashtrësë nga një grup qytetarësh të komunës së Klinës, të cilët kërkojnë rikthimin e pronave të uzurpuara apo të konfiskuara, pa drejtësisht nga ish-regjimet e ndryshme, por edhe pas Luftës së Parë Botërore.

Ish- pronarët e shpronësuar dhunshëm në periudhat e ndryshme kohore këtë shqetësim e kanë paraqitur edhe para Asamblesë komunale të datës 7 prill 2006 dhe kanë gjetur mbështetjen nga ana e këshilltarëve të Asambles. Ish -pronarët janë shqetësuar për shkak se procesi i privatizimit nga ana e AKM-së a i takon ata, dhe pronat e tyre. Ata kërkojnë nga Kuvendi i Kosovës që të iniciohet procedura për hartimin dhe nxjerrjen e ligjit përkatës, për kthimin e pronave ish pronarëve. Deri në nxjerrjen e ligjit të tillë ish-pronarët kërkojnë që të bëhet një zgjidhje me qëllim që ato prona të mos përfshihen në procesin e privatizimit dhe të evitohen mundësitë e konflikteve ndërjerëzore dhe pasojat e tjera me rastin e shitjes dhe privatizimit të tyre nga ana e AKM-së. Këto raste të cilat i prezantoj nga Klina nuk janë të lokalizuara vetëm në Klinë,por janë prezente në disa komuna të Kosovës. Ish- pronarët kërkojnë që padrejtësia historike të cilën e kanë përjetuar nga regjimet anti-popullore të përmirësohet nga ky kuvend i zgjidhur nga populli. Ata nuk kërkojnë asgjë më tepër, por vetëm që pa drejtësia e shkaktuar ndaj tyre, të zgjidhet sipas ligjit për shkak se disponojnë dokumente të mjaftueshme, që dëshmojnë se ata vetë dhe parardhësit e tyre ishin pronarë legjitimë. Duke u dal në ndihmë këtyre ish- pronarëve konsiderojmë që realizojmë një prej të drejtave dhe lirive themelore njerëzore- garantimi i pronës, e drejtë që është e rregulluar me të gjitha normat ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e familjeve të shpronësuara u kanë ofruar edhe regjistrin përkatës të rasteve me të dhënat e shkurtra relevante të kësaj çështjeje, i cili si i tillë nuk është përfundimtar. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Z. Kumnova e keni fjalën , të përgatitet deputeti Zef Morina.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA – Z. kryesues, ministra,

Ka qenë e qëlluar që ky Kuvend të debatojë edhe pse me vonës për çështjen e privatizimit më sa di unë për herë të parë. Duke konsideruar si çështje mjaft të rëndësishme për të tashmen dhe për të ardhmen e Kosovës. Si bëhet një bilanc i arritur në këtë veprimtari, me siguri se të gjithë do të jemi dakord se procesi ka qenë mjaft i ndërlikuar, i ngadalshëm pse jo edhe me një kosto të lartë për këtë buxhet tonin të varfër.

Mirëpo shqetësimet tona janë të arsyeshme kur dihet se privatizimin e shohim si mundësi reale të përshpejtimit të zhvillimit të ekonomik të Kosovës. Me siguri gjendjes së tanishme ekonomiko sociale i ka kontribuar edhe privatizimi i ngadalshëm, shenja inkurajuese kanë filluar që nga viti i kaluar me disa ndryshime që janë bërë me rregullore për të cilën ka dhënë pëlqim edhe Zyra e posaçme në OKB. Mirëpo edhe në fushën e transferim të kompetencave janë bërë gabime që po na kushtojnë shumë. Me një anë është anashkaluar Qeveria, janë bërë disa korrigjime me pjesëmarrje në bord ,të cilat veprime në esencë janë vetëm përpyetje për ruajtjen e kompetencave ekonomike nga ana e UNMIK-ut. Pa dyshim duhet të ilustrujë me një shembull. Duhet t'i kthehemi ekonomisë së Gjakovës. Më e mirë ka qenë në muajt e parë të pasluftës se si është katandisur sot. Rregulloret por edhe mos zbatim i tyre janë faktorë kryesorë që mbi 40 ndërmarrje sot nuk janë në funksion, unë nuk e shoh at ëndërr me syhapur se mund t'i

punësojë me këto kapacitete 25 mijë punëtorë sa i kishte dikur ekonomia e Gjakovës. Por zbatimi i një strategjie të privatizimit do të punësonte një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Në kohën e fundit janë privatizuar disa ndërmarrje kapaciteteve të kufizuara dhe vërehet një interesim i ministrit Dugolli për një zgjidhje të kësaj situatë. Mirëpo, deri më tani AKM-ja është sjell me pa përgjegjësi ndaj statusit të ndërmarrjeve aksionare të Gjakovës. Unë mendoj se nuk bën vetëm të debatojmë për çështjet e privatizimit vetëm për deshtime. Ky Kuvend duhet të dalë me përfundime të qarta për të orientuar dhe mbështetur, rekomandimet e Qeverisë dhe të kërkojmë respektimin e një dinamike të transferimit të kompetencave.

Lidhur me këtë ,nëse më lejoni,do t'i kisha dhënë disa propozime të cilat nuk janë dhënë në rekomandimet e Qeverisë. E para, banka duhet të inkurajojë që këtë proces të privatizimit ta mbështesin sidomos bizneset kosovare për blerje të aseteve të ndërmarrjeve të cilat kanë perspektivë, janë me interes kombëtar për ekonominë e vendit. Faza tjetër privatizimit e cila lidhet me korporatizimin e ndërmarrjeve publike, është edhe më e rëndësishme, prandaj këtu duhet të kemi kujdes të posaçëm, meqë Kosovës si një resurs të rëndësishëm për eksport dhe për krijimin e të ardhurave e ka KEK-un, PTK-në ,aerportin ndërsa strategjike e ka ekonominë e ujërave dhe hekurudhën, prandaj shitja e këtyre subjekteve e varfëron Kosovën në tërësi, nga burimet kryesore të të ardhurave dhe eksporti.

Ky proces duhet të mbështetet, meqë shpjegon dhe përcakton asetet dhe obligimet e shoqërive aksionare, të cilat do të dalin nga ky korporatizim, por Qeveria duhet të ketë kujdes të veçantë ku përcaktohet se kur duhet të jetë pronar i aksioneve të këtyre shoqërive, të cilat do të dalin nga ky proces. Në këtë drejtim Qeveria duhet të konsistojë që aksionarë, pronarë të këtyre aksioneve, duhet të jenë 20% të punëtorëve të cilët punojnë aktualisht dhe si është edhe përvoja e deritanishme dhe propozojmë 70% fondit për zhvillimi ekonomik të Kosovës. 17% fondit të pensioneve dhe 46 shtetit që janë aksione në shitje të lirë.

Ky sugjerim bazohet në faktin se procesi ka për qëllim përgatitjen e këtyre ndërmarrjeve për shitje diçka për Kosovën kjo nuk është e palejueshme, meqë Kosova si resurse të eksportit dhe sidomos të ardhurave, në të ardhmen do ta ketë PTK-në, KEK-un, Aeroportin dhe ndërmarrjet e tjera publike, prandaj e vetmja mundësi që të parandalojmë shitjen apo ta përkufizojmë atë në shitje të pjesëshme është duke mbajtur paketin kontrollues të aseteve, aksioneve përmes fondit për zhvillim dhe atij pensional ,që është 34% ose 1 e treta e aseteve të përgjithshme dhe kur ato i bashkojmë edhe 20% të aseteve të aksioneve të punëtorëve ne do t'i kemi gjithsej 54% të aseteve në duar të vendorëve, eventualisht të lira mbeten 46%.,që ne na mundëson të gjithë të jemi pronarë dominues, prandaj edhe vendimmarrës në qeverisje, ky nuk është një zbulim, kjo është përvojë e disa shteteve që kanë mbrojtur interesat kombëtare dhe kanë kaluar me sukses këtë proces. Po e mbyll me një thënie: Suksesi në jetë ka nevojë për optimizëm për të mbajtur shpresën dhe mjaft pesimizëm për ta motivuar shqetësimin që e kemi sot. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. deputetë Zef Morina.

DEPUTETI ZEF MORINA – Faleminderit z. kryesues, z. Ryker të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë.

Që nga themelimi i –AKM-së në korrik të vitit 2002,që në bazë të Rregullores 2002/12, kishte autorizime të pakufizuara, në administrimin e pasurisë ,gjegjësisht të pronës shtetërore dhe shoqërore në Kosovë. Që nga ajo kohë ekonomia kosovare pësoi rënie të vazhdueshme për shkak se edhe ato pak ndërmarrje shoqërore të cilat ishin në funksion të pjesshëm, filluan të humbin vullnetin për punë, sepse politika e AKM-së nuk ishte në favor ta zgjerimit të kapaciteteve, por kishte të bënte me privatizimin e tyre në gjendje sa më të mjerueshme. Qeveria e Kosovës që në fillim kishte rezerva në punën e kësaj agjencie që me të drejtë u quajt super qeveri.

Institucionet e Kosovës u privuan nga e drejta për të kontrolluar punën e kompanive profitabile publike,siç ishin PTK, Aeroporti hekurudha, hidrosistemet e shumë kompani të tjera publike, të cilat edhe përkundër problemeve që kishin mund të ndihmonin ekonominë kosovare, arsyeja ishte se pse kompetente ishte vetëm AKM-ja. Në fillim AKM-ja u zotua se sa n më parë dhe me transparencë do t'i privatizonte ndërmarrjet shoqërore,por fillimi nuk tregoi vullnet dhe gatishmëri, pasi udhëheqësit e bordit drejtues të AKM-së u vunë nën presionin e politikës së Beogradit,duke mbajtur të bllokuar procesin e privatizimit, as Qeveria dhe as PSSP-ja nuk arritën ta zhblokimin dhe ta vazhdimin e procesit të iniciuar nga ish- shefi i Shtyllës IV z. Lamzorf dhe ish-drejtoresha e AKM-së z. Marija Fuqi.

Me shumë se një vit e gjysmë privatizimi ishte pothuajse tërësisht i bllokuar, që për Kosovën ishte një humbje e madhe. U desh që Këshilli i Sigurimit të ndërhynte për të dhënë dritën e gjelbër për vazhdimin e privatizimit. Mendoj se qëllimi i ngadalësimit të privatizimit ishte që ndërmarrjet që edhe ashtu nuk ishin joshëse për investitorët të shkatërrroheshin dhe të arnotizoheshin sa më shumë. Është e pakuptueshme madje edhe e pa pranueshme që ndërmarrjeve shoqërore në Gjakovë të cilat në vitet 89 janë shndërruar në shoqëri aksionare të mos u jepej e drejta qoftë për të funksionuar si shoqëri aksionare apo të bëhej privatizimi i tyre. Këto ndërmarrje kishin një kohë rreth 25 mijë punëtorë, e tani ndërmarrjet janë buzë shkatërrimit dhe punëtorët të papunë në mëshirën e veprimit dhe të Qeverisë. Me të drejtë qytetarët e Gjakovës dhe të rrethinës janë të indinjuar në punën e Qeverisë dhe të AKM-së. Vlen të theksohet se me ardhjen e z. Ryker treni filloi të ecte më shpejtë. por prapë me pengesa dhe me një qëndrim pothuajse të ngadalësuar. AKM-ja që nga korriku i vitit 2002 më shumë ka frenuar, seç ka hapur rrugë në ngritjen e kapaciteteve në kompanitë të cilat ishin nën administrimin e tyre.

Ritmi i zhvillimit dhe zgjerimit të kompanive publike ishte shumë i ngadalshëm. Shembull duhet të merr hekurudhat e UNMIK-ut, të cilat pas marrjes në kompetencë nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, vërtet ato më shumë janë dëmtuar se që riparuan. Sipas të gjitha të dhënave vlen të theksohet që transferimi i kompetencës si e ceku edhe z. Ryker nuk është bërë për shkak se kështu Korniza Kushtetuese nuk e lejon dhe duhet pritur zgjidhja e statusit të Kosovës. Dëshiroj të them se kjo nuk qëndron, sepse pikërisht sipas Kornizës Kushtetuese UNMIK-u është detyruar që brenda kohës së administrimit

në Kosovë të bëjë transferimin e kompetencave. Kjo parashihet edhe në kreun V dhe në kreun VIII të kornizës kushtetuese.

Për transfer të kompetencave nuk është e nevojshme të bëhet ndryshimi i Kornizës Kushtetuese, por kjo mund të bëhet me një vendim të PSSP-së sepse këtë ia lejon edhe vetë Korniza Kushtetuese. Unë i kam dy pyetje, njëra është në lidhje me mjetet e privatizimit të cilat fatkeqësisht nuk janë brenda Kosovës, por janë jashtë dhe u tha që janë grumbulluar rreth 200 milion euro. A është bërë shpërndarja e 20% sipas Rregullores së AKM-së për punëtorët që është në vlerë rreth 40 milion euro dhe pyetja tjetër, ku është arsyeja e mostransferimit të kompetencave tek institucionet vendore, a është mosgatishmëria e AKM-së për t'i transferuar apo kapaciteti i pa mjaftueshëm i institucioneve vendore, gjegjësisht i Qeverisë së Kosovës dhe në fund kërkoj nga Qeveria dhe AKM-ja që duke u bazuar në vërejtje të cilat i dhanë deputetët, të ndryshojë politikat vepruese në dobi të ngritjes së zhvillimit ekonomik të vendit, sepse ky është standardi kryesor i një shteti. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. deputetë. Për fjalë është paraqitur z. Ryker, i cili dëshiron që disa pyetjeve të shtruara deri më tash, para se të shkojë në pauzë t'u përgjigjet.

SHEF I SHTYLLËS IV TË UNMIK-ut JOACHIM RUECKER – Ju faleminderit shumë. Z. kryesues, dhe deputetë, unë jam i sigurt se z. Dugolli dhe zëvendësi do të përgjigjet në disa pyetje. Mirë po kam kënaqësi që kam mundësi t'u përgjigjem disa pyetjeve që u shtruan këtu.

Të filloj duke thënë se një numër pyetjesh që u shtruan janë të trajtuara në fjalimin tim, ne duhet të sigurojmë që versioni i shkruar i fjalimit tim t'u shpërndahet juve në mënyrë që ju t'i gjeni përgjigjet aty për pyetjet që i keni shtruar dhe unë nuk do të hy në detaje për sa u përket pyetjeve që i kam trajtuar në fjalimin tim. Vetëm një çështje të rëndësishme që u shtrua këtu ishte se AKM-ja thatë, se nuk ndihet e përgjegjshme ndaj Kuvendit, ndaj Kosovës, ndaj institucioneve të Kosovës në përgjithësi.

Më lejoni të them se unë e mirëpres këtë mundësi për të debatuar këtu, për sa i përket UNMIK-ut dhe vetes sime, ne kemi mundur këtë debat ta mbajmë më herët. Unë jam i gatshëm t'i përgjigjem çdo pyetjeje, jo vetëm këtu edhe nëpër komisione, kudo që ju dëshironi që unë të jem i përgjegjshëm për punën që e bënë AKM-ja, gjithashtu më duhet të them se a është një përfshirje adekuate e institucioneve të Kosovës. Buxheti i AKM-së është po, pushteti i rezervuar është buxheti i rezervuar, mirëpo shkon ose kalon nëpër procedurat e rregullta buxhetore dhe natyrisht buxheti miratohet nga Kuvendi. Prandaj shumica e pyetjeve nuk duhet të shtrohen sepse ata vetëm janë përgjigjur, çka bënë AKM-ja me paratë, këto janë investime kapitale për KEK-un, dhe gjithashtu disa shpenzime operacionale, dhe ne jemi të gatshëm që të përgjigjemi në këtë pyetje jashtë çështjeve buxhetore.

Tri ministrat e Qeverisë janë të pranishëm në AKM, janë të pranishëm në organet vendim marrëse, prandaj mendoj se ekziston përgjegjësia dhe përgjegjshmëria në këtë proces, dhe

nëse ju mendoni që nuk është ashtu atëherë më lejoni që unë të përgjigjem në të gjitha pyetjet që ju i shtruat, juve t'ju sigurojë, pastaj u bënë edhe disa pohime si janë korrupsioni, konflikti i interesave, dhe çështjet e tjera. Mirëpo, unë nuk kam parë dëshmi apo arsye konkrete për këtë, fjalët që u thanë këtu pa esencë pa përmbajtje, një gjë që u përmend nga dy folës ishte se : afati i Alferonit për pagesë është shtyrë pa bazë ligjore, më lejoni të them se kjo nuk është e vërtetë pagesa, në realitet afati për pagesë nuk është shtyrë, mirëpo, vlerësimi i përbashkët i të dy palëve AKM-ja në një anë Alferoni në anën tjetër, kontrata është lidhur, dhe ky gjithmonë është e mundshme me marrëveshjen e dy palëve në fjalë d.m.th. ata janë pajtuar për ta shtyrë këtë.

Dy palët kanë paraparë që kontrata me të gjitha gjërat që ndërlidhen me të do të lidheshin deri në mes të qershorit po kështu nuk ndodhi prandaj të dy palët në mënyrë vullnetare AKM-ja dhe Alferoni e vazhduan d.m.th. afatin kur kontrata do të lidhet. Natyrisht pagesa u bë, prandaj nuk ka pasur asnjë shkelje të asnjë procedure.

Z. Alush Gashi i LDK-së tha, se ne duhet të debatojmë, natyrisht kjo bëhet me zgjidhjen e juaj dhe ne jemi të gatshëm që të marrim pjesë në këtë debat. Nuk është se AKM-ja ka zgjedhur një administratorë ndërkombëtar për Trepçën, por ankesat e kreditorëve për Trepçën kanë gjetur mënyrë përmes sistemit të gjykatave dhe ka qenë mënyra e vetme për t'i ndalur ato, dhe ne kemi nisur procedurën e insolvencës sipas procedurave të veçanta, dhe për këtë arsye ne këtë duhet ta diskutojmë, nuk ka qenë vendimi i AKM-së por s'ka pasur mënyrë tjetër për të ndalur kërkesat të cilat filluan që të godasin Trepçën.

Për sa i përket kërkesave të kreditorëve dhe detyrimet për disa ndërmarrje, nuk është legjislatori, dhe nuk është ekzekutivi, por është gjyqësia që do të vendos për këto kërkesa nëse ato janë valide apo jo, dhe nëse ka zgjidhje të përgjithshme për kërkesat e kreditorëve për kërkesa që kanë të bëjnë me vitet 90-ta atëherë sistemi i gjyqësisë do ti marr këto parasysht dhe to ti shqyrtojë. Ky është një rast i pastër i sundimit të së drejtës, dhe ne vërtetë duhet t'i dallojmë rolet e ndryshme të cilat duhet ti luajmë. Një sërë çështjesh kishin të bënin me ndërmarrjet publike.

Unë e kuptova se ky debat nuk është për AKM-në por për privatizimin dhe unë siç thashë ne nuk privatizojmë ndërmarrjet shoqërore d.m.th. termoelektranat kompanitë e huaja, mirëpo ne muajm ti diskutojmë këto ndërmarrje publike gjithashtu por për sa i përket përfitimeve të monopolit në PTK, po ka, ka përfitime të monopolit, dhe unë plotësisht pajtohem me ju. Duhet të ketë një konkurrencë për këtë arsye UNMIK-u fuqishëm ka sugjeruar që ne të kemi një provajder të dytë të telefonisë mobile, dhe tani procesi është në vazhdim e sipër për këtë. Unë gjithashtu dëgjova disa pyetje lidhur me procesin e privatizimit, disa strategji me të gjëra si është zhvillimi strategjik i Kosovës, plani për zhvillimin strategjik të Kosovës, gjithashtu një zgjerim të disa objektivave më të detajuara, e kështu me radhë. Kjo e tëra është e nevojshme dhe më vjen mirë që plani zhvillimor i Kosovës është duke u përpiluar, megjithatë do t'ju këshilloja që procesin e privatizimit të mos e shtrojmë si çështje urgjente, ose të ngutshme, sepse ne nuk jemi duke e shpikur rrotën, procesi i privatizimit është ashtu ose është i tillë nga i cili do të përfitojë ekonomia e Kosovës dhe për këtë arsye është menduar. Për sa i përket ndërmarrjeve publike nuk do të thosha gjë tjetër.

Z. Merxha, ju jeni më duket nga Prizreni, dhe ju e përmendët çështjen e Printeksit, Printeksi ndoshta është një shembull për një numër të ndërmarrjeve ku AKM-ja është në një pozitë shumë të vështirë, unë plotësisht e mbështesë atë që thatë ju, privatizimi i Printeksit, unë e di çka do të thotë për punëtorët, mirëpo kjo është ndërmarrje ku në bord është diskutuar nëse ka kushte për spinof special u arrit konkludimi me ndihmën e disa ekspertëve, se tregu ashtu si ka ekzistuar në të kaluarën ma nuk ekziston dhe ristrukturimi i kësaj ndërmarrje në tregjet e mëparshme ishte e pa mundshme mu për shkak të teknologjisë së demoduar dhe të vjetërsuar, dhe në rastet e tilla ne vendosim që spinofi special nuk është i mundur, dhe kjo ka pasoja të mëdha. Unë nuk po i shmangem pyetjes, unë po përpiqem që të përgjigjem, Printeksi ka qenë një rast shumë i vështirë dhe ka edhe raste të tjera të vështira ku ne duhet të marrim vendime të vështira ose të bëjmë zgjidhje të vështira.

Pyetja e z. Berishës lidhur me objektivat e AKM-së si janë arritur objektivat e AKM-së, mendoj se të gjitha këto përgjigjeje i gjeni në fjali me që do tua shpërndajmë në formë të shkruar. Gjakova unë e përmenda këtë, gjithashtu i dëgjova disa çështje të tjera që u shtruan spinof-in special kushtet nuk janë përcjellur duhet të jemi të qartë. AKM-ja nuk ka resurse që të bëjë një analizë makro apo mikroekonomike të efekteve të spinof-it. Ne natyrisht i kemi parasysh kushtet për këtë spinof-e speciale.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Ryker, unë e di që ka disa pyetje shtesë, ne e kemi kohën për drekë, mendoj që tani duhet ta marrim një orë pauzë, në ora 2 e 15 fillojmë seancën, për debat deri më tash janë paraqitur 20 veta thuajse edhe z. Ryker ju falënderojmë për pjesën e parë të përgjigjeve, është i mirë se ardhur pas drekës në seancë prapë. Ju faleminderit.

Për debat kemi kuorum të mjaftueshëm.

Sipas radhës për të diskutuar, fjalën e ka deputeti Hilmi Ahmeti

DEPUTETI HILMI AHMEMTI - I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, i nderuari Ministër.

Procesi i privatizimit në të drejtë vlerësohet i një rëndësie vitale për Kosovën dhe të ardhmen e saj.

Një nga synimet e privatizimit është mundësimi i shfrytëzimit të resurseve dhe të potencialeve që ka Kosova. Prandaj, si proces është me pritë me shpresë se do të ketë një zhvillim ekonomik më të mirë, më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm dhe se do të krijojë një perspektivë për të gjithë qytetarët e Kosovës e sidomos për rininë e saj. Rëndësia e privatizimit nuk është që të bëjë para të gatshme për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës përmes shitjes së ndërmarrjeve, por me rëndësi është nxitja e privatizimit dhe investimit, kapitalit të brendshëm dhe atij të huaj për të arritur zhvillim ekonomik në Kosovë, në mënyrë që të kemi një të ardhme ekonomike me një treg të gjerë dhe funksional. Për këtë arsye privatizimi është shumë më tepër se sa transferimi i titullarit të pronës, d.m.th. është proces që ndërmarrjet e Kosovës i shpine ne ekonomi tregu. Në

fillim ky proces pati një ngecje, më vonë u dinamizua. Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve, por nuk është shfrytëzuar mandati i AKM-së në kryerjen e aktiviteteve që ruajnë ose rrisin vlerën dhe ekzistencën komerciale të ndërmarrjeve. Ekziston përshtypja sikur AKM-ja është e interesuar më shumë për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore pa u pushuar biznesi. Spinofet speciale duhet përdoren në më shumë ndërmarrje që privatizohen në mënyrë që të mundësohet punësim më i madh i të rinjve. Numri i punëtorëve të mos jetë si një qels tepër i lartë, por të jetë një numër më i vogël për të hyrë në spinof special. Mendoj se AKM nuk arriti në masën e duhur të promovojë investimet e reja në industri, të krijojë biznese të reja, të krijojë mundësi të reja për punësim dhe zhvillim të sektorit privat me anë të investimeve ku investitorët do të gjenin fuqi punëtoresh të kualifikuar dhe të motivuar për punë. Me kompetencat të rezervuara dhe me buxhetin e kufizuar, Qeveria e Kosovës është jashtë mundësive të investimeve në riaktivizimin e disa ndërmarrjeve deri në privatizimin e tyre. Edhe pas 4 viteve të themelimit të AKM-së disa ndërmarrje as nuk u privatizuan as nuk u licencuan për prodhim. Mendoj, se minierat e plum-zingut të Trepçës është dashur të pajisen me leje për eksploitim nga bordi i pavarur i minierave dhe mineraleve sepse prodhimi provues ka qenë i suksesshëm. Një studim i arsyeshmërisë ekonomike të kompletuar nga personeli i Stan Tërgut në shkurt të vitit 2002, i cili merr parasysh të gjitha aspektet relevante, që kanë të bëjnë me minierën si kostoja operuese, kostoja direkte dhe profitabile janë mjaft të kompletuara. Studimi i fundit i arsyeshmërisë ekonomike është kompletuar në fund të vitit 2005 nga i gjithë stafi vendor dhe ndërkombëtar ku shumë çka ka ndryshuar lidhur me këto llogari sepse çmimet e metaleve janë rritur shumë dhe ka analiza të reja të promarrjes dhe përbërja komponentës së dobishme në xeherorë është mjaftë e lartë sidomos ajo e metalit, plumbit, zingut dhe argjentit. Dhënia e lejes për eksploitim deri në privatizim të Trepçës pa dyshim se do të ishte në interes në interes të rritjes të mirëqenies së minatorëve, rritjen e traditës së minatorit dhe do të ndihmonte buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe në ndërkohë do të përgatitej një strategji e mirë për privatizimin eventual të sajë, por gjithmonë duke marr parasysh rezervat e të gjitha kategorive që disponojnë minierat e Trepçës.

Unë falënderoj Qeverinë për punën e bërë dhe raportin e ofruar për procesin e privatizimit, gjithashtu përkrahu dhe kërkesat e saj për transferimin e kompetencave tjera të nevojshme në funksionimin normal të ekonomisë të Kosovës.
Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. Ahmeti, fjalën e ka Ibush Jonuzi, le të përgatitet Bajrush Xhemali

DEPUETI IBUSH JONUZI – Ju faleminderit z. kryesues, ministër i nderuar, deputetë të respektuar, zonja dhe zotrinjë

Privatizimi në Kosovë vlerësohet si një nga detyrat më të rëndësishme e lidhur ngushtë me rikëmbjen e ekonomisë së shkatërruar kosovare. Është vlerësim i përgjithshëm se për ringjalljen e kësaj ekonomie nevojitet një kapital serioz i cili është vështirë se do të sigurohet pa privatizimin e ndërmarrjeve ekonomike, shoqërore dhe publike në Kosovë. Një prej çështjeve kryesore të administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe të

institucioneve vendore është privatizimi duke qua shoqërinë në një ekonomi me treg të lirë. Në kuadër të privatizimit këto institucione kanë krijuar agjencionin kosovar të mirëbesimit e cila mbikëqyrë zbatimin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Procesi i privatizimit në Kosovë është vlerësuar mjaft i vështirë dhe mbetet si proces mjaft i komplikuar. Privatizimi është i lidhur ngushët me amzën sociale të shoqërisë prandaj, Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit dhe ne të gjithë duhet të kemi kujdes se në këtë proces fjalën vendimtare duhet ta ketë faktori vendor, i cili duhet të respektoj fuqishëm vullnetin e popullit dhe interesat e Qeverisë, sepse pasuria e Kosovës i takon Qeverisë dhe popullit të Kosovës.

Duke parë nevojën dhe domosdoshmërinë në realitetin e ri të krijuar, duhet bërë përpjekje kualitative që të shtyhet përpara strategjia e privatizimit në sfera të caktuara të industrisë apo në sfera të tjera. Këtu duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë pasurisë së patundshme dhe tokës bujqësore e cila duhet të ruhet si e tillë. Në një vizitë pune që e ka pas Komisioni parlamentar para disa dite në Gjakovë për çka ka qenë edhe ministri Dugolli, nuk kisha dashur me përsëritë atë që e thanë parafolësit, por shqetësimi i tyre është si u tha më herët. Ekspertët dhe drejtuesit vendor të ekonomisë kanë vërejtje për kompetenca që i ka Agjencioni i Kosovar i Mirëbesimit. Preandaj, mbështesim rekomandimet për privatizim të ofruar nga Qeveria e Kosovës, zbatimin e ligjeve, si Ligji për investime të huaja, Ligji për konfeksione, Ligji për shpronësime me interes publik që tani është në proces garanton që Kosova të bëhet një vend i sigurt ku mund të investohet dhe kreu për fund e kisha mbështetur kërkesën e kryetarit të Grupit parlamentar të LDK-së profesor Alushit kur e potencoi çështjen e Trepçës dhe njëherit dy here e potencoi z. Ryker që duhet t'i qaset një çështje shumë serioze problemit të Trepçës dhe unë si deputet e mbështes shqetësimin dhe qasjen serioze të atij problemi. Ju faleminderit!

KRYESUEI XHAVIT HALITI - faleminderit, z. Xhemajli e keni fjalën, le të përgatitet Genc Gorani

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit z. Kryesues, ministra, kolegë deputetë,

Privatizimi është nevojë e domosdoshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës në kushtet e ekonomisë të tregut dhe është dashur të ndodhë patjetër, por kjo formë e privatizimit është formë më e papërshtatshme dhe më e dëmshme që DHE është formë e imponuar pa të drejtë nga AKM me politika tejet të gabuara të saj, prandaj edhe rezultatet e privatizimit janë plotësisht zhgënjyese. AKM dhe përfaqësuesi special i saj që në fillim pat injoruar zërin e këtij parlamenti duke mos marr parasysh fare debatin për Rregulloren për privatizim, madje pa përfunduar atë ditë ky debat Përfaqësuesi special e nënshkroi këtë Rregullore. Në fakt, ne duhej të na lejohet të nxirrjm Ligjin e privatizimit nga ky Kuvend, ashtu që privatizimin ta bënim në bazë të rrethanave në Kosovë, pra ashtu siç do të gishte më së miri për ekonominë dhe qytetarin e Kosovës. Sidoqoftë mosdëgjimi i zërit të këtij Parlamenti për privatizimin në përgjithësi ka bërë që sot të ndihen pasoja katastrofave ekonomike e sociale nga procesi i gabuar i privatizimit. Në rend të parë, nga kjo politikë e dëmshme sot Kosova po rrezikohet si shtet i ardhshëm të jetë i vetmi shtet në Evropë pa pronë pasi AKM ka vendosur që cili

do resurs qoftë i çfarëdo rëndësie nacionale apo i çfarëdo karakteri strategjik ta privatizojë, e dihet se çdo shtet ruan diçka si pronë e tij që nuk e privatizon. Madje, ky Parlament ka pas nxjerr konkluzione së paku në lidhje me miniera që të mos privatizohen, por as ky zë nuk u dëgjua padyshimte kjo do të na kushtojë tepër shumë në të ardhmen.

Procesi i privatizimit kështu siç po zhvillohet edhe me të meta të shumta dhe tejet të dëmshme. Në këtë proces nuk respektohen as rregullat në fuqi, shkelen procedurat e shumta të tenderëve, ka konflikte të interesit në tenderim, kurdisje në blerje, mungesë transparencë etj. pra gara është jo ferr dhe e pandershme. Këtu ka shumë çka për t'u thënë, por unë për shkak të kohës do të ndalem vetëm në një segment të privatizimit. Privatizimin e Feroniklit i cili si i tillë është i dështuar për shkak të shkeljeve të shumta. Ja po i numëroj disa nga shkeljet në këtë proces tenderimi. Sipas pikës 4.1 të rregullave të tenderimit IMR që më vonë nuk di se si u shëndërua në ALFERON as që ka mundur të parakualifikohet për rundin e dytë të tenderimit të Feroniklit që nënkupton fuqinë aksionare mbi 50% të kompanisë ndërlidhëse në konzorcium me përvojë në xehetari gjë që asnjë pikë e tillë nuk është plotësuar dhe që te tre përfaqësuesit e konzorciumit kanë vetëm nga 33% të akckonit. Nën dy, në mënyrë të paligjshme, pa vendim të Bordit të AKM-së është shtyer tri here afati për hapjen e ofertave, ndërsa nuk është shtyer ky afat për para kualifikime të ofertuesëve të tjerë të mundshëm. Shtyrja për 8 muaj rresht e afatit për hapje të ofertave ka pasur për qëllim t'ia prishë konzorciumin me e Adeniklit me Fenimagun duke i mundësuar kalimin e këtij të fundit në konzorciumin me IMR dha si konkurrent njërin me tjetrin për të njëjtin tender që me këtë rast është bërë edhe një shkelje duke u thyer marrëveshjet në mes Fenimagut dhe Adeniklit për tender, prandaj sikur të ishte, qoftë edhe vetëm kjo shkelje do të duhej të anulohet tenderi. Nën tre, këto shtyrje për hapjen e ofertave janë bërë që të tri here pa vendim të Bordit dhe pa një njoftim me shkrim për të dhënë arsye se përse shtyhet afati i hapjes së ofertave. Këtë shtyrje e ka bërë z. Kirk Adams zëvendës drejtori i privatizimit sipas instruksioneve të drejtorit për privatizim z. Gjoni Gjonson tani këshilltar i ministrit Dugolli, i cili pastaj në gusht të vitit 2005 do të kërkojë punë në IMR Alferon që do të thotë se AKM dhe Ministria kanë hyrë në konflikt të interesit përmes z. Gjonson i cili me këtë rast ka shkelë detyrën zyrtare duke dhënë informata që do të duhet të ishin konfidenciale dhe kështu ka dëmtuar ofertuesit tjerë siç ishin Samsung, Nikoinvest, Fisin krub etj për këtë shkak, po të kishte shtet ligjor për shkeljen e tij në detyrë zyrtare z. Gjoni Gjonson do të përgjigjej penalisht para gjyqit për shkak të shkeljes së nenit 4.6 ku ka qenë i obliguar që t'i trajtojë si konfidenciale informatat që janë paraqitur në aplikacionin për regjistrim në librin e ofertuesëve. Z. Ryker tha se pak më parë nuk ka argumente. Besoj se e ka këtë letër këtu që e kam edhe unë e që është e z. Gjoni Gjonson, që është argument për t'u hetuar dhe nëse nuk e ka, mund t'ia japi edhe nuk e mendoj fare, është në anglisht. Nën 4, në të njëjtën formë ka dëmtuar konkurrencën e lirë dhe e ka shkelur Ligjin edhe z. Dugolli i cili dërgon një letër Bordit të AKM-së të datës 20 qershor 2005, ja edhe kjo letër këtu është dhe bënë presion të fuqishëm ku ndër të tjera shkruan: "Ofertuesi i parë duhet të diskualifikohet dhe ofertuesi i dytë më i lartë duhet të shpallet ofertues fitues në mbledhjen e ardhshme të Bordit të AKM-së të 29. qershorit 2005 dhe pastaj shton se ritenderimi duhet të evitohet. Nën katër, Adenikeli paditë z. Dugolli me kallëzim penal lëndë e cila tani gjendet në Prokurorinë e Qarkut për krime

të rënda me akuzë se z. Dugolli ka kërkuar mito prej 3 milion € dhe meqë ky nuk ia ka dhënë e ka eliminuar nga konkurrenca. Edhe këtë kallxim penal meqë mu ka ankua z. Dugolli dhe që nuk e kam, unë mund t'ia gjejë. Nën pesë, se ne duhet të flasim me fakte e jo veç kështu kuturu, nën pesë rregulla e tenderit sipas spinofit special pika 10.3 që parasheh të jenë së paku tri oferta të kualifikuara, nuk është respektuar dhe është një shkelje tjetër shumë e rëndë që nuk ka guxuar të ndodhë. Nën gjashtë, ALFERONI ishte 16 milion ma i lirë se ADENIKLI dhe si i vetëm në garë u shpall fitues pa konkurrent, në fakt ishte fituesi i paragjykuar dhe i privilegjuar.

Në raportimet e shumta të mediave nëpër botë paraqitën akuza të shumta për Alferoni për aktivitetet kriminale të larës të parave, korrupsion dhe lidhje afariste me krimin e organizuar ashtu si dhe për ballë ALFERONIT në gjykatat të ndryshme ndërkombëtare dhe Ministri Dugolli e z. Ryker në vend që të merren me hulumtimin e pasurisë së dyshimtë të Alferonit që ka qenë dashur të bëhet, këta u morën me përçarjen e punëtorëve dhe suspendimin e menaxhmentit duke ia lënë në dorë vjehrit të z. Dugollit Shaban Bujupit. Pa u bazuar në asnjë rregullore z. Ryker i është dhënë, z. Ryker në propozimin e z. Dugolli i është dhënë kompetenca që pa vendim të Bordit vendosmi nënshkrimin e kontratës dhe shtyrjen e afatit për pagesë të obligimit. Z. Ryker tha këtu se u bo mbi baza vullnetare, por u deshtë të shtrohej se në mënyrë vullnetare po, por në mënyrë të paligjshme, d.m.th. Për me skelë ligjin ashtu i bie kjo. Nën nëndë, ashtu siç e ndihmoi Alferonin t'i eliminojë konkurrentit e tij gjatë procesit të tenderimit Qeveria dhe AKM-ja tani po i bëjnë favore antiligjore për çështjen e pagesës për pesë muaj me radhë me shtyrje të njëpasnjëshme që është presedan për çështjen e privatizimit i shtyhet afati i pagesës pa ditur kush arsyet e vërteta dhe se gjëja po bëhet në emër të marrëveshjes për rrymë, e cila marrëveshje është bërë po thuaj se në legalitet të plotë mes KEK-ut dhe Alferonit nën presionin e fuqishëm z. Ryker. E gjithë kjo bëhet për çështjet të cilat nuk janë të parapara me kontratë. Është e padrejtë që t'i bëhet presion KEK-ut për të bërë kontratë dhe tepër e dëmshme. Me këtë rast është edhe një tendencë që Alferonit t'i jepet edhe një tender i pashpallur për rrymë dhe atë pa asnjë konkurrent kështu që KEK blen rrymë të shtrenjtë me tender dhe e shet rryme pa tender me çmim përgjysmë më të lirë.

Ky presion antiligjor mbi KEK-un u bë edhe pse për këtë sipas ligjit për energji sipas nesh tepër të qarta sepse Alferoni mundë t'i shitet rrymë nëse ka rrymë, por nëse nuk ka, atëherë t'i lihet në dispozicion rrjeti energjetik dhe sipas memorandumit të Athinës ka mundësi të furnizohet me rrymë tregu regional kudo që leverdisë. Këtë gjë nuk mund ta bëjë konsumatori i rëndomtë prandaj shteti në radhë të parë duhet ta furnizojë atë. Për Alferoni të cilit i është ndaluar në vendin e vet Kazakistan të merret me veprimtari minerale vërtetë duhet të jetë fatlum. Kur këtu në Kosovë të gjithë kujdesen për këtë dhe i krijojnë favore në mënyrë antiligjore si Qeveria ashtu edhe AKM-ja në veçanti e me përkushtim z. Gjoni Gjonson ish drejtor i privatizimit, pastaj ministri Dugolli mandej kryetari i Bordit të AKM-së dhe i Shtyllës IV z. Ryker që shkoi, ata të KEK-ut dhe kush jo. Tani Kryeministri i Kosovës z. Çeku se i kemi dy Çeka, me falni me heshtjen e tij ndaj krejt këtyre shkeljeve i krijon kushte Alferoni që këto shkelje të rezultojnë me nënshkrimin përfundimtar të kontratës dhe dua të them që në fillim se ka gabuar hapin. z. Kryeministër para se të niste punën e tij me anulimin e tenderit të telefonisë mobile, ka

qenë dashur ta anulojë tenderin e Feroniklit sepse shihet qartë se tenderimi i Feroniklit ka shkelje pakrahasushmisht ma shumë se sa ajo e telefonisë mobile, vetëm kështu do të jetë një shembull i mirë se nuk do të punojë me dy kute. Vetëm kështu do të tregonte se ka vendosur t'i pretë rrënjët e korrupsionit, vetëm kështu do të tregonte se ato që thonë çdo ditë për respektimin e ligjit nuk janë vetëm fjalë të thata, vetëm kështu do të tregonte se është kryeministri i Kosovës se jo mbrojtës i ministrave të partisë së tij të vogël në të cilën sa po është anëtarësuar. Për z. Kryeministër ka mundur të bëjë këtë, por duhet vendosmëri dhe guxim, përndryshe veprimet me standardet e dyfishta duke toleruar mos transparencën në shkeljen e ligjit nga ana e ministrave dhe përfaqësuesve tjerë në procesin e privatizimit jo që nuk i bënë nderë atij, por edhe dëmtojnë rëndë Kosovën.

Të nderuar deputetë për fund po shtojë se korrupsioni është fjala ma e shpesh që po përdoret. Nëse dikush nga organet kompetente është i interesuar ta zbulojë, po ju tregoj se ku është, korrupsioni është aty ku shkelet ligji e me tenderime të shumta janë shkelur ligje edhe rregulla dhe në veçanti në tenderimin e Feroniklit. Një auditim i pa anshëm nga një auditor do ta vërtetojë këtë çka po them, prandaj është më se i nevojshëm. Dhe të gjitha këto shkelje nuk janë bërë për të mirën e Kosovës, këto mund të bëhen thjeshtë për përfitime personale të personave të involvuar në këto shkelje dhe klaneve apo subjekteve të cilët ju takojnë ata persona. Kështu nuk mund t'i qojmë proceset përpara, pra as këtë të privatizimit. Çështja e Feroniklit nuk ka marrë fund me derdhjen e parave që nuk di nja një milion a dy, më duhet ende duhet t'i derdhë, por u tha që është përfunduar, nuk di si ka përfunduar. Implementimi i kontratës do të jetë një sfidë tjetër për tenderuesit. A do të shkrihet xehja në Drenas apo jo, ku, a do ta tregojë se do të shkojë në Kavadarë natyrisht masë tri viteve . 1000 punëtorë, natyrisht ata që nja 1000 gati mbesin pa punë ata do të jenë shumë të zhgënjyer që në fillim. Kush e ka at fat që me hy në punë, do të zhgënjehet pas dy viteve sepse të garantuar janë vetëm për dy vite.

KRYESUEI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. Xhemajli

Koha ka kaluar. Sipas radhës është deputeti Gorani, le te përgatitet zonja Myrvete Dreshaj

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryesues, kolegë të nderuar, kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj

Procesi i privatizimit në Kosovë përmban elementet më esenciale të sovranitetit, andaj sipas mendimit tim, është veçanërisht çështje e Kuvendit të Kosovës. Do të them se në këtë start të privatizimit si dhe të atij të ardhshëm një pjesë e madhe e pushtetit ra të Kosovës gjendet jashtë kontrollit të këtij Kuvendi apo të cilit do institucion vendor i dalur nga zgjedhjet.

Privatizimi i aseteve strategjike të Kosovës nuk mund të iniciohet në asnjë formë para realizimit të sovranitetit të Kosovës. Është e qarët se jemi duke shkuar së shpejti në një fazë kur pa realizim të mjaftueshëm të këtij sovraniteti do të jemi ndeshë me të gjitha

aspiratat dhe realizimin e shtetësisë tanë dhe funksionalitetit shtetëror. Koorporatizimi i ndërmarrjeve kapitale të Kosovës me transformimin e tyre në shoqëri aksionare, me pronësi 100% të aksioneve në AKM është një parapërgatitje të çpronësimit aktual të Kosovës, dhënia e pasurive të Kosovës blerësve të rastit gjegjësisht të paragjykuar. Dua t'i përgjigjen drejtpërsëdrejti një aludimit të z. Ryker në lidhje me atë se pronësia shtetërore na ndërmarrjet publike është karakteristike e vendeve komuniste, mendoj se me të vërtetë na e ka dhënë një leksion jashtëzakonisht të gabuar veçanërisht të nivelit jo i përgjigjet pozitës së tij nga se në shumicën e vendeve Evropiane të standardit më të lartë apriori kapitaliste si në Finlandë, Suedi, në Gjermani apo Francë, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve strategjike shtetin në to ka kapital jashtëzakonisht të madh dhe në shumtën e rasteve shteti është magjurar në kapitalin e tyre. Në Finlandë kapitalizmi i këtyre ndërmarrjeve arrin 90%, ndërkaq shteti ka, posedon mbi 60% të aksioneve në këto ndërmarrje. Për fund dua ta përkrahi çdo iniciativë të cilit do grup parlamentar, cilit do deputet për një auditim të mirëfilltë nga autoditori, ndoshta jo vetëm një, por disa auditor të pavarur ndaj AKM-së në veçanti të dy bordeve menagjues dhe atij mbikëqyrës po përsërisë edhe një here ndaj AKM-së në veçanti dhe atij një auditim nënshtrim i një auditimi urgjent, po ashtu në këtë auditim do të përkrahë çdo iniciativë që merr parasysh, faktikisht do t'i detyronte këta anëtarë të bordeve rreth AKM-së, ta deklarojnë pasurinë para hyrjes në këto borde dhe pasurinë aktuale.

Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit Gorani, fjalën e ka deputetja Dreshaj, le të përgatitet deputeti Brajshori

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ - I nderuari z. kryesues, të nderuar kabinet qeveritar, të nderuar kolegë deputetë

Po të shikohet objektivisht procesi i privatizimit për shoqërinë kosovare nuk paraqet polarizim të skajshëm të gjykimit apo ngërthim krejtësisht antagonist të individëve, partive politike dhe institucioneve të Kosovës. E gjithë shoqëria kosovare ka qëndrim posaçërisht të njëjtë dhe nuk dallon me njësinë matëse rreth kryerjes së këtij procesi i cili do të duhej të krijonte zhvillim ekonomik për Kosovën, treg të ri të punës, afarizëm të suksesshëm të ndërmarrjeve ekonomike etj. Në Kosovë në një mënyrë apo në një tjetër po funksionon një kontratë e pashkruar sociale dhe politike e cila në këtë periudhë po e mbanë stabilitetin e shoqërisë sonë, por a është vetëm kontrata e pashkruar politike dhe sociale ajo që po i përcjellë zhvillimet pozitive dhe ngecje të privatizimit, sigurisht që jo. Janë një varg procesesh dhe vendimesh të cilat mund të diskutohen këtu. Le ti shohim disa nga këto procese sa të suksesshme si veçanti jo komplementare me nevojën e përfundimit të këtij procesi brenda një afatit të arsyeshëm. Pas një varg mos marveshjesh që i kanë përshkruar ndërkombëtarët dhe vendorët në krye të AKM-së dhe pothuaj se një ngrirje të këtij procesi në vitin e fundit janë shënuar rezultate të dukshme në relaksim të marrëdhënieve në mes AKM-së dhe Zyrës së saj në Nju Jork, mes AKM-së dhe Qeverisë së Kosovës dhe si rrjedhojë përshpejtimin e këtij procesi. Si rezultat i këtij relaksimi janë bërë disa ndryshime në Rregulloren e AKM-së e cila bëri të mundur përshpejtimin e punëve në privatizimin dhe të atyre ndërmarrjeve që viteve të fundit kishin ndryshuar statusin e tyre shoqëror. Nëse ju referohemi të dhënave konkrete që

sjell raporti i Qeverisë, nuk mund të mos kalojmë pa dhënë rezultate të theksuara në këtë drejtim sidomos në numrin e konsiderueshëm të njërive të privatizuara dhe me fillimin e investimeve të kapitalit privat, e kjo dhe të shtimit të të punësuarve dhe zgjerimit të kapaciteteve prodhuese. Me këtë proces qytetarët e Kosovës prijnë me pjesëmarrje rreth 90% me çka ata po bëhen pronarë të ligjshëm të tyre, mirëpo e tërë kjo në nuk nënkupton edhe tejkalimin e të gjitha pengesave dhe anomalive të cilat vazhdojnë të pengojnë, ngadalësojnë dhe madje ta mbajë peng përfundimin me sukses dhe me kohë të këtij procesi. Fjalën e kemi për marrëdhëniet jo komplementare të strukturës së këtij institucioni. Ende nuk ka asnjë lëvizje të institucioneve ndërkombëtare në barazjen e disa prej kompetencave të AKM-së në institucionet vendore, përkundrazi ky projekt me rëndësi nacionale i cili priti të përfundonte në vitin 2005 i ka dhënë vetes afat të pakufizuar. Sa do privatizimi ka rëndësi thelbësore në jetën tonë shtetërore, ekonomike dhe shoqërore, vazhdimi i këtij mandati institucioni i cili nuk përfaqëson shumicën vendore të përbërësve të tij nuk arrin të zgjedhë ende suksesshëm një varg pengesash juridike, nuk ka bërë asnjë përpjekje për plotësimin e stafit të tij në aspektin profesional dhe madje nuk ka sjellë dhe nuk ka ende një projekt strategjik domethënës për ekonominë e Kosovës, ndërsa Zyra e saj për informim është plotësisht e mbyllur dhe jo transparente dhe me këtë nuk mendojmë se është interes dhe garancë për suksesin përfundimtar të këtij procesi. Me këtë rrjedhë pengë i madh i Kosovës mbetet ngrija e fondit të privatizimit. Në këtë kohë të kërkesave dhe nevojave të mëdha për problemet fundamentale të mbijetesës sociale dhe ekonomike të qytetarëve të këtij vendi, të mbash peng fondin më të rëndësishëm të Kosovës i cili duhej të hynte urgjentisht në procesin zhvillimor është e palejueshme dhe e paarsyeshme, madje as në emër të ndikimit të qarqeve ndërkombëtare a të statusit të pazgjidhur të Kosovës. Përgjegjësia e mosfunksionimit të këtij kapitali me rëndësi fundamentale shkon nga institucionet ndërkombëtare të drejtuesit e institucioneve vendore dhe nuk përjashton madje as organizatat sindikale, heshija dhe amulija e të cilave në këtë kohë po përplasen me vetë gjendjen e mjerë në të cilën gjendet ajo sot, ndërsa vështirë që do të mund të arsyetohet në emër të interesave të mëdha të politikës nacionale.

Nuk dua ta përfundojë këtë fjalë timen duke thënë sikur AKM-në ta udhëheqin individët dhe institucionet vendore, do të bërin çudira, por nuk mund të mos e theksojë faktin se nëse sot përgjegjësia për kryerjen me sukses të privatizimit i takon Qeverisë së Kosovës e kjo është edhe financuese e sajë, atëherë edhe menagjimi i këtij institucioni do të duhej t'i kalonte sa më parë Qeverisë vendore. AKM-ja sot është ndërtuar mbi koncepte të dyfishta dhe logjikisht të paqëndrueshme financimi vendor dhe menagjimi ndërkombëtar. Në rrethana të tashme do të kishte kuptim një mbikëqyrje apo konsultim ndërkombëtar, por jo edhe e kundërta sikur veprohet, përgjegjësia thonë matet me përgjegjësinë e cila të është dhënë që më parë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit! Z. Brajshori, le të përgatitet deputeti Jusuf Sutaj

DEPUETI BEXHET BRAJSHORI, Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar kryeministra, të nderuar kolegë deputetë – unë kam frigën se do të përsërisë parafolësit

pra kolegët e mi, sepse tema është e atillë dhe kërkoj falje që në fillim dhe diskutimin tim do ta përmbledh 5 ose 6 pika shkurtimisht.

E pra do të ishte konstatimi se mendoj se që në fillim procesit të privatizimit kemi bërë dy gabime në kuadër të politikave profesionale, e para ka qenë mosvlerësimi i vlerës së objekteve që do të privatizohen. Unë kuptoj ekonominë e tregut, por në rrethanat tona ka qenë e domosdoshme një vlerësim i përafërt me qëllim me pa se deri ku po ofrohen ofertat dhe e dyta, destinomi pas procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore e në këtë drejtim kemi çrregullime. Si rezultat i kësaj vijmë te pika e dytë efektet e privatizimit që mendoj se këtu duhet fokusohemi, çka solli procesi i privatizimit për këtë periudhë, natyrisht sepse efektet e privatizimit nuk mund të priten shpejt, për këtë periudhë çka, çka pritet në të vërtetë në të ardhmen e afërt, sa do të ndikojë në zvogëlimin e papunësisë në Kosovë, sa do të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike në përgjithësi në Kosovë, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, pra në ndërmarrjet private, sa do të kemi beneficione në buxhetin e përgjithshëm të vendit dhe çështje të këtilla. Mendoj se këtu duhet fokusuar akoma për të ardhur dhe për të caktuar hapa tjerë dhe çka duhet bërë, dhe hapat tjerë që duhet bërë, unë mendoj se i pari ndër të tjerët do të ishte nevoja e menjëhershme e çbllokimit të fondit privatizimit. Ne derisa kërkojmë investime nga jashtë, ne derisa kërkojmë ndihmën e donatorëve të jashtëm, ne derisa kërkojmë ndihmë në qoftë edhe të formave të ndryshme të financimeve mjetet tona mbeten të bllokuara. Një ç'bllokim i mjeteve të fondit të privatizimit dhe i fondeve tjera të cilat nuk përmendim në këtë rast, do të zbushte nevojën e financimeve në kuptim të ndihmave nga jashtë. Kosova përfundimisht duhet të shkëputet nga logjika e ndihma falas sepse edhe standardet të cilat i biseduam dje nuk mund të mbërrihet pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe ajo mund të bëhet vetëm me investime qoftë të jashtme qoftë të brendshme. Këto mjete që i kemi mund të na ndihmojnë në këtë drejtim shumë.

Pika e katërt do të ishte nevoja e bartjes së kompetencave. Pas zgjedhjes së statusit të statusit të vendit, nëse kjo nuk është bërë deri tash ose është bërë në formën e përgjysmuar ku anëtarët vendor tonët thjeshtë nuk mund të jenë vendim marrës në formën e prerë, për këtë arsye natyrisht se kemi edhe çështje të caktuara, të cilat nuk mund të mbërrin efektin e vet pra edhe procesin e privatizimit po edhe menagjimi i ndërmarrjeve publike në përgjithësi. Nëse kjo bartje e kompetencave bëhet në formën e plotë qoftë në variantin e parë, qoftë në variantin e dytë veç unë mendoj se duhet të jetë bartje e plotë e kompetencave me përgjegjësi të plotë te institucionet vendore. Ne do të përfundojmë një proces të privatizimit do të thoja me kohë, por do të kishim një menagjim ma të suksesshëm te ndërmarrjet publike të cilat deri me tani natyrisht se mungon. Mungon një qeverisje dhe një transparencë efektive te ndërmarrjet publike gjë që po shihet se ato ekzistojnë ose vetëm për vetveten e vet dhe nuk ekzistojnë për financimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Këtë dretim mendoj se është shumë e nevojshme të bëhet diçka shumë shpejtë. Nëse ndërmarrjet publike ato ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit me potencialin e vet që e kanë sigurisht se do të zvogëlohet edhe nevoja ndihmave nga jashtë dhe përfundimisht mendoj se është e nevojshme ndryshimi politika operacionale të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Ne

sfera të caktuara atë cilat do të ndihmonin në përshpejtimin e përfundimit të procesit të privatizimit dhe në arritjen e efekteve më të mira në këtë drejtim.
Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z.Brajshori

JUSUF SUTAJ – a është këtu - atëherë fjalën e ka z. Nekibe Kelmendi le të përgatitet deputeti Afrim Arzuallxhiu

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - ju faleminderit z. Kryesues, të nderuar deputetë dhe ju ministra – diskutimin tim të them të vërtetën e kam përgatitë dhe për fjalë jam lajmëruar ndoshta ndër të parat në mëngjes, mirëpo për një arsye më është dashur të shkëputem përkohësisht nga puna e Kuvendit për shkak të pjesëmarrjes në punë në komision tjetër. Kështu diskutimin e pas përgatitur derisa ishte prezent z. Ryker dhe pyetjet i kamë destinuar për te. Megjithatë unë do ta them mendimin tim që kamë lidhur me privatizimin dhe sigurisht z. Ministër si anëtar i Bordit do t'ia përcjellë z. Ryker dhe do ti kenë parasysh shqetësimet e mija.

Shqetësimi i par i imi është dhe mendoj se e ndajmë këtë shqetësim të gjithë. Përse të merremi ne me borxhet e Trepçës dhe përse AKM-ja nga mjetet e privatizimit t'i paguajë borxhet e Trepçës kreditorëve kur dihet mirëfilli se gjatë dhjetë viteve të okupimit Trepça e ka pasur të bllokuar konton e vet. Kjo ka qenë bërë qëllimisht. Tërë afarizmin dhe të gjithë transferin e mjeteve e ka bërë nëpërmjet të xhiro-llogarisë ose kontos bankare në Fagar dhe kjo është një fabrikë që ka qenë në Podujevë – fabrika Fagar nga aty i ka tërhequr të gjitha mjetet financiare i ka dërguar në Sërbi, kurse konton legale të Trepçës që e ka pasur në kontabilitetin shoqëror të atëhershëm ka qenë ajo gjithnjë e bllokuar prandaj kreditorët nuk kanë mund me i realizuar mjetet e tyre, kërkesat e tyre financiare karshi Trepçës. Le të hulumtohen ku shkuan gjitha ato mjete që u krijuan nga afarizmi dhe që u derdhen në Fagar, në mënyrë që mos ta paguajmë borxhin e huaj kjo është nën një. Nën dy, Kosova ka nevojë për një industri përpunuese pse mjetet nga privatizimi nuk përdoren për këtë qëllim, do të realizoheshin dy synime tona, do të zhvillohej ekonomia kosovare dhe do të përfitonim nga përpunimi i resurseve sidomos metaleve të çmueshme që i ka Kosova këtu e nuk do t'i shitshim si lëndë të parë me një çmim tejet të ulët. Tre, çështja e privatizimit në disa raste ka një prapavi tjetër të krijimit të fondit të tokës ndonëse në shfrytëzim 99 vjeçar për ta shfrytëzuar atë për industri bancore dhe për me ardhë ma shpejtë te paratë e gatshme. Kështu që, me këtë janë të motivuar disa pjesëmarrës në oferta për t'i privatizuar ndërmarrjet shoqërore nëpërmjet të AKM-së. Nën katër, përse lejohet që në rat të heqjes dorë të fituesit të tenderit të parit? Pse i kalohet automatikisht e drejta e blerjes apo e privatizimit ofertuesit që e ka dhënë çmimin e dytë dhe nuk bëhet ritenderimi. Këtu merren vesh ofertuesit mes veti, jepe ti çmimin maksimal ti e fiton, unë e jap një çmim, siç ka ndodhur me Farmendin p.sh. është shitur për 6 milion, ofertuesit të parë, ka heqë dorë ofertuesi i parë është shitur për 4 milion, ka heqë dorë edhe ai ofertues për me ardhë deri te një shumë shumë të vogël por për fat është prishur ajo shitblerja ai privatizim dhe duhet të përsëritet tenderi. Ndoshta pas këtyre makinacioneve meshefet i njëjti ofertues por me emra të tjerëve dhe pse nuk limitohet për një afat të caktuar

kohor, tjetërsimi i ndërmarrjes së blerë me anë të privatizimit sepse ndodhë që një ndërmarrje blihet sot me një çmim dhe e gjënë blerësin tjetër ia shet atij me një çmim tjetër shumë më të lartë dhe aty del fitimi. Nën katër, çka po ndodhë me ndërmarrjet që dhunshëm janë integruar me ndërmarrjet në Serbi siç ka qenë rasti i ndërmarrjes së gypave, ai në mënyrë të dhunshme, ajo ndërmarrje ndër të parat, në mënyrë të dhunshme është integruar me Smederevën dhe ashtu i ka humbur gjurma gjeneza e asaj ndërmarrjeje e sot nuk figuron si ndërmarrje në Kosovë. Nuk mund të privatizohet, në të vërtetë ajo ka ekzistuar dhe ka qenë ndërmarrje e Kosovës.

Tash do të kalojë te një çështje tjetër. Pas themelimit të AKM-së menjëherë një rregullore pasuese ka qenë themelimi i dhomës së veçantë e cila në njëfarë mënyre është dhomë speciale e AKM-së. Te kjo dhomë e veçantë e Gjykatës supreme të Kosovës e cila nuk ka të bëjë asgjë të përbashkët me Gjykatën Supreme të Kosovës sepse punon me Rregullore të veta, qytetarët e Kosovës të cilët i drejtohet për realizimin e të drejtave nga fusha e ndërmarrjeve ekonomike nuk kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e vet zyrtare. Të gjitha aktet duke filluar nga padia si akt inicial i kontestit e deri te dokumentet duhet t'i përkthejnë në gjuhën angleze, po na e kemi gjuhën zyrtare të garantuar me Kornizën Kushtetuese gjuhën shqipe edhe serbe, nëse donë me funksionu ajo Dhomë ajo duhet të ketë mjetet e veta për me gjyqtar ndërkombëtar që nuk e flasin gjuhën shqipe do ti ketë mjetet e veta t'i bëjë përkthimet dhe pastaj ato shpenzime t'ia hedhë palës e cila e ka humbur kontestin e jo me ta mohuar në start të drejtën që t'i drejtohesh asaj. Dhe për fund edhe unë mbështes rezervën që pati, që shprehu z. Xhemajli që t'i lënë diçka kapital shtetit dhe mos të privatizojnë ndërmarrjet që janë të rëndësisë së veçantë për ekonominë e shtetit ton të ardhshëm.

Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit e nderuar deputete. Unë kërkoj falje po në radhë keni qenë edhe më poshtë. Për shkak të respektit ta kam dhënë përpara fjalën. Sikur të kishit paraqitur edhe ma herët, me me lajmëruar se ke punë ose se je lodhë, nuk ka problem, nuk është bërë me qëllim dhe kërkoj falje. Fjalën e ka deputeti Arzuallxhiu, le të përgatitet për fjalë deputeti Halimi

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU - Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra prezentë, kolegë të nderuar. Po frikohem se edhe debati i sotëm për temën e privatizimit do të jetë i kotë sikurse edhe shumë debate të mëhershme këtu në seanca tematike sepse në fund të seancës nuk kemi përfundime, nuk kemi konkluzë konkrete. Mendoj se tek atëherë seanca tematike do të ketë kuptim edhe do të jenë më të efektshme. Mendoj se debatet e këtilla pa konkluzë janë vetëm debate sa për të thënë se është debatuar për një temë të caktuar. Sidoqoftë unë do ta shfrytëzoj të drejtën time për ta shprehur mendimet dhe brengat e mija për privatizimin. Privatizimi si proces siç u tha edhe nga parafolësit ka qenë i pa evitueshëm, mirëpo edhe i nevojshëm si proces i tranzicionit. Forma se si është duke u zhvilluar tek ne nuk është e qëlluar sepse nuk janë përfillur specifikat e ekonomisë kosovare prandaj edhe rezultatet dhe efektet nuk janë ashtu siç janë pritur. Mendoj se nuk janë shfrytëzuar sa duhet dhe si duhet përvojat e privatizimit në shtetet tjera në region edhe pse z. Ryker tha te kundërtën se janë shfrytëzuar përvojat.

Qëllimet parësore të privatizimit kanë qenë definimi i pronarit, faktikisht të pronës shoqërore i cili si pronë është e pa definuar e sidomos për ndërkombëtarët dhe përmes asaj të bëhet ringjallja e ekonomisë përmes një inxhekcioni të privatizimit dhe si rrjedhojë e kësaj do të kishim një punësim të një numrit të konsiderueshëm të punëtorëve gjegjësisht të bëhet zbutja e papunësisë. A janë arritur këto qëllime? Rezultatet e gjertanishme dëshmojnë të kundërtën. Nëse shtrohet pyetja se sa prej ndërmarrjeve të privatizuara deri më tani janë duke punuar – shumë pak prej tyre përgjigja është. A është rritur numri i të punësuarve në objektet e privatizuara jo, fatkeqësisht ka një rënie drastike. Fatkeqësisht shumica e objekteve prodhuese janë duke ndërruar destinimin e tyre dhe prej hapësirave prodhuese shndërrohen në depo të thjeshta apo në objektet banimi që në aspektin ekonomik paraqet një dështim dhe dëm të madh. Financiarisht Kosova edhe ashtu e varfër është varfëruar edhe për disa qindra milionë euro dhe vetëm 20% e atyre parave që do të duhej të shpërndahen punëtorëve do të mbetet në Kosovë, ndërsa 80% i parave nga privatizimi në vend që të jenë në qarkullim në Kosovë dhe të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit ,ato derdhen në banka evropiane me kamata 1 deri 2% derisa biznesi kosovar detyrohet që të financohet ndoshta nga po ato para por me kushte shumë më të vështira me kamata 10 deri 15% që janë kamata të fajdexhive e jo kamata bankare, dhe kështu detyrohet biznesi kosovar që të punojë faktikisht për këto banka.

Në Prizren nga objektet industriale të privatizuara të cilat dikur kanë punësuar 6 deri 7 mijë punëtorë. Me prodhimtari kanë vazhduar farmakosi me një përqindje të vogël të ulët ende jo në atë përqindje sa duhet të jetë. Fabrika e këpucëve "Komuna" si një depo e saj sipas gjitha gjasave do të shëndërrohet në një supermarket ku dod të punësohen diku rreth 200 punëtorë dhe një pjesë e prodhimit ka mundësi që përmes një pune ... me italianët të vazhdojë, ndërsa "Printeks"-i për të cilin disa fjalë i tha edhe z.Rykeri është një tragjedi në vete. Në këtë industri kanë punuar përpara rreth 2600 punëtorë, vetë fakti pak më par që tha z.Ryker se teknologjia në Printeks është e demoduar dëshmon atë se në AKM njerëzit të bëjnë vlerësime të tilla, nuk janë ekspertë. Unë personalisht në vitet 1982-1989 kamë qenë drejtor i investimeve në Printeks dhe e di shumë mirë se në çfarë gjendje është teknologjia e Printeksit dhe e di shumë mirë se në periudhën 1982-89 në Printeks janë investuar mbi 50 milion \$. Edhe në vitin 1989 para ardhjes së masave të dhunshme Kolegjiumi i ekspertëve të Printeksit kemi vensour të bëjmë paraprakisht një vlerësim të pasurisë së Printeksit edhe në dokumentet që i gjeta në shtëpi, gjeta vlerën që është vlerësuar Printeksi si në vitin 1989 se vlen diku rreth 247 miliokn marka, d.m.th. diku rreth 123 milion €. Momentalisht ka paisje në vlerë mbi 10 milion që janë ende në paketa, të paçelura, të pa montuara thjeshtë edhe nuk di kush ka informuar në këtë formë z. Rykerin se teknologjia në Printeks është e demodume. Nuk është problemi në vlerën e shitur 3 milion të Printeksit, nuk është problemi aty, mirëpo problemi me 2600 punëtorë që kanë punuar në atë ndërmarrje edhe mundësia që të punësohen edhe rreth 600 punëtorë në fabrikën e tre të tjerres e cila është ndërtuar, mirëpo paisjet nuk kanë mundur të montohen dhe situata është e tillë. Mendoj se privatizimi është dashur të bëhet së pari me disa kushte paraprake sidomos për objektet industriale për objektet që janë për prodhim. Kushti i parë është dashur të jetë vazhdimësia e prodhimit me mundësin e zgjerimit dhe ndryshimit të prodhimit, kushti

tjetër të jetë kushti i dytë numri minimal i punëtorëve që do të punësoheshin në një periudhë 6 mujore deri në 12 mujë dhe kushtet tjera janë të tepërta. Mendoj se duhet të insistohet shumë më gjatë në kërkesën për vazhdimësinë e prodhimit në objektet prodhuese. Çvarë vlere ka privatizimi i tillë kur objekti i prodhimit shndërrohet në depo apo në objekt për banim. Është investuar në teknologji, në pajisje, në ngritjen profesionale të kuadrove dhe menjëherë krejt këto bijnë në ujë dhe dikush që ka pak ma tepër para e blen objektin dhe e shëndërron destinimin e tij prej objektit të prodhimit në depo apo në objekt banimi.

Forma e tashme e privatizimit pa kurrfarë kushti pra kritere të caktuara, do të duhej të ishte forma e fundit e privatizimit në Kosovë. Privatizimi do të kishte zgjatur pak më shumë, mirëpo efektet do të ishin shumë më të mëdhaja. Fakti se shumë pak fabrika të privatizuara janë aktivizuar, më bëjnë të dyshojë mbi prejardhjen e parave nga të cilat janë blerë fabrikat, ndoshta jo të gjithë, por një pjesë e madhe e tyre, nga se njeriu i cili din me punë të fitojë të gjitha to para për të blerë fabrikën, do të duhej ta dinte edhe ta aktivizojë atë fabrikë.

Kështu kjo formë e privatizimit më të shpejtë sa për ta hequr qafesh këtë barë është duke sjellur dëme jashtëzakonisht të mëdha ekonomisë kosovare duke hapur edhe rrugë për malverzime me korupcione, anomali etj. Shumë anomali u cekën këtu, mirëpo unë dëshiroj ta ceku vetëm atë se u shitën 300 hektarë tokë për 30 mijë € ku faktikisht një ari tokë është shitur për 1 €. Mendoj se sidomos për privatizimin e tokave duhet të ketë një minimum në të cilin nuk duhet shkuar, por do të ishte më mirë që ato toka të barten në pronësi të kuvendeve komunale për shumë arsye.

Kërkesa e Aalferonit për çmim të beneficuar të rrymës pas privatizimit të Feronikelit është kërkesë me të cilën detyrohen konsumatorët të mjerë kosovar në këtë formë indirekte faktikisht ta financojnë ndal ngadalë patronat e Alferonit në blerjen e

Feronikelit me paratë nga dallimi në çmim të rrymës.

Dëshiroj të ceku, të them disa fjalë edhe për kushtet e kreditimit të privatizimit, mendoj se këto kushte janë shumë të pavolitshme. Kamatat prej 10 deri 15% në vit dhe afati i kthimit maksimum 5 vjet janë kushte jashtëzakonisht të vështira. Këto kushte gjithashtu kushtëzojnë dhe kufizojnë ofertat në privatizim. Kreditimi i privatizimit në regjion është shumë më i volitshëm me kamatat maksimale 5 deri 7% me afatet e kthimit 10, 15, 20 e në disa vende deri 30 vjet. Pse këto kushte nuk janë edhe në Kosovë? Këtë pyetje po e shtroj sepse kemi të bëjmë me bankat e njëjta po me kushte të ndryshme: Pse këto kushte nuk aprovohen edhe në Kosovë? Arsytimi se nuk ka siguri të mjaftueshme në Kosovë nuk mund të qëndroj, Kosova nuk hiq më pak e sigurtës se vendet në regjion. Prandaj, duhet të punohet urgjentisht në ndryshimin e kushteve të kreditimit për privatizim me mundësinë e derdhjes së mjeteve të grumbulluara nga privatizimi në ndonjë bankë në Kosovë me kusht që ato mjete të destinohen për kreditimin e privatizimit dhe të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit . z.- Arzuallxhiu, Fjalën e ka Ymer Halimi, z deputet urdhëroni. Le të përgatitet deputeti Ramdan Kelmendi.

DEPUTETI YMER HALIMI - Ju faleminderit kryesues, i nderuar ministër, të nderuar deputetë

KRYESUESI – mikrofonin e deputetit Nazim Jashari, ju lutem.

DEPUTETI NAZIM JASHARI - z. Kryesues mua më vjen keq që po ndërhyjë kështu, por çështja është pak ma parimore. Mund t'ju them lirisht se në momentin kur ka marë fjalën folësit e parë në këtë Kuvend, njerëzit që përfaqësojnë grupet parlamentare ka qenë e pamundur me shtypë butonin pra nuk ka qenë e mundshme me aktivizua kërkesën për fjalë. Që në momentin e parë që është liru kërkesa për fjalë, unë e kam shtyp tastin edhe po më intereson a është faji te teknika apo ku është faji? Në rast se shkohet një grup parlamentar flet grupi i LDK-së ka dy tre folsa më shumë se është grup i madh, flet grupi i PDK-së, flet Grupi i Aleancës do të ishte dashur të vij te ORA, rendi. Unë nuk e di çfarë rendi po përfilllet në këtë seancë, në rast se flet tash folësi i Aleancës kalohet në një grup tjetër, unë nuk di tash çka po ndodhë. Mu më vjen keq shumë

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputetë në qoftë se jeni lodhur kërkojmë pauzë Unë po e shohë se çka janë bëjnë vetëm nuk është rendi i deputetëve , asnjëherë nuk e bëjmë sipas bankave, por sipas fuqisë politike dhe sipas radhës ne përpiqemi ta respektojmë në maksimum secilin grup parlamentar ,sipas radhës i jepet fjala. Nuk ka ndonjë qëllim ndaj askujt. Ju lutem u krye. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi.

DEPUTETI YMER HALIMI – Po ia filloj me matematikë, nëse ka mundësi, ju lutem nëse ka mundësi, më sa duket kjo seancë është e ashtuquajtur seancë post festum .Në qoftë se e dini matematikën thuhet se e dimë matematikën, kemi rezultatin $2/3$ plus $1/3$, $2/3$ është kryer deri sot. Sot mund të bisedohet për $1/3$. Atëherë cili është prioriteti i një Qeverie në rastet e tilla, kur e merr postin e vet. Suksesi i një qeverie matet në shkallën më të madhe nga suksesi i zbatimit të politikave ekonomike që gjenerojnë të mira materiale për mirëqenien e qytetarëve , ku zhvillimi ekonomik është dertiminues për stabilitet politik dhe për shkallë të lartë pavarësimi. Së dyti, legjimiteti dhe suksesi në Qeveri në transicion maten nga mënyra se si do të kryhen reformat ekonomike. Qeveria aktuale ka qasje të drejtë,por kur kërkon të privatizohet si një formë e veprimt, por AKM-ja në privatizim sa duket është një element diskutabil , sepse struktura e saj ligjore mund të jetë diskutabile edhe nesër. Ndonjë kuvend tjetër ka qëndrim ndoshta më të rreptë se ne. Është faktor, është fakt notar se ekonomia e Kosovës duhet t'u nënshtrohet ligjeve të transformimit dhe Kosova të jetë e hapur për ekonominë e tregut të lirë, por kjo ekonomi tash për tash nuk është konkurrenente në tregun e hapur. Diçka që është digresion nga kjo pikë e rendit të ditës në këtë çast nuk kisha dashur ta lënë anash, është se prodhimi vendor has në vështirësi shtesë , se lënda e parë që importohet gjatë gjithë kohës doganohet 10% përveç rasteve të veçanta,

ndërsa prodhimet e gatshme , meqë importohen nga vendet fqinje të të njëjtës përmbajtje ,doganohen 0%, kjo e zvogëlon mundësinë e punësimeve të reja.

AKM-ja si titullar i pronës shoqërore që u bë , pritej të jepte një menaxhim të mirë subjekteve ekonomike, fatkeqësisht kjo vazhdoi me një mënyrë të keqe menaxhimi dhe shumë ndërmarrje, mund të themi , janë shpërbërë. Kjo është e qartë ,sepse të tjerët nuk duhet të jenë më të vëmendshëm për dike sa për vetveten. Diçka është për të veçuar se kjo si të jetë një prije e qëllimshme që ndërmarrjeve t'u ulet vlera për rastin e privatizimit dhe humbës të jenë vetëm arka e shtetit dhe punëtorët. Kjo është shqetësuese, veçmas te sistemet e mëdha siç janë KEK-u dhe Trepça ,më gjithë ministri i Energjetikës dhe i Minicrave reagoi arsyeshëm, pa marrë parasysh se këtu dikush po ndërlidhë edhe efekte politike. Kjo është shumë hipotetike që në Kuvend , gjithësesi, duhet të sqarohet. Së dyti, ose deputetë të nderuar më rahat, te privatizimi në Kosovë janë dy faza, një ndalim të plotë polemizues dhe tash një liberalizim të skajshëm. Privatizimi kushtëzohet në çdo shtet ishte bërë nga agjencitë e privatizimit dhe kontrollin e tyre e ka bërë kuvendi i atyre shteteve. AKM-ja , qe tani e merr këtë privatizim në duart e veta, ne as që i kemi ndihmuar e as që e kemi kontrolluar. Privatizimi ka shkallë të lartë rreziku për blerësit dhe për institucionet qeveritare, prandaj ka nevojë për kuadër të mirë ligjor dhe institucionet duhet të ngritin shkallën e përgjegjësisë. Te privatizimi ka ndërhyrje interesi shtetëror e privat , mendësitë lihen për lëshime apo dikush të thotë edhe korrupsion. Në privatizim Qeveria është e detyruar ta mbrojë interesin e qytetarëve të vet dhe për këtë duhet ngritur shqetësim në shumë raste që janë esenciale për veprimin ndaj AKM-së. Këtë duhet ta bëjë edhe Kuvendi, p.sh. në qoftë se dikush në ofertë jep çmim më të lartë për blerje, por ka ndërmend ta mbyll ndërmarrjen duke zëvendësuar atë me veprimtari importi,a duhet AKM-ja ta pranojë ofertën më të lartë? Kam lexuar literaturë dhe është e saktë Qeveria ka obligim të nxisë konkurrencën në treg dhe duhet të ndërhyrë që të përjashtojë blerësin e tij dhe ta ruaj procesin e prodhimit, por edhe punëtorët. Kështu është në shtetet e lindjes dhe të perëndimit. Qeveria është dashur të vlerësonte këtë. Unë besoj se ka pasur vend për veprime të tilla. Shembull te këtyre shndërrimeve të ndërmarrjeve prodhuese në importuese apo restorante apo toka bujqësore në troje veç në seancën e djeshme u shqyrtuan shumë. AKM-ja nuk ka shqetësim për këto raste sa duhet, nuk është shqetësim numri krahasues në mes të punëtorëve që kanë ngelur pa punë dhe atyre që tani janë punësuar nga këto privatizime. Sa përgjegjësi kërkohet nga Qeveria po aq duhet të kërkohet nga Kuvendi, sepse nuk kemi ngritur shqetësim më parë, andaj që në fillim Kuvendi i Kosovës ,kompetencë e pa kompetencë është dashur ta ngriste shqetësimin që sot të kemi dilema se Ligji i privatizimit a i përgjigjet praktikës së privatizimit në mënyrë të duhur. AKM-ja për punën e vet në privatizim po edhe në menaxhimin e subjekteve ekonomike, por edhe nga arka e varfër e shtetit të jep transparencë të plotë. Është demokratike të përgjigjesh para këtij Kuvendi. Njerëzit vendorë në Bord sa e njohin këtë proces , si të tillë dhe sipas cilit kriter dikush është aty brenda. Sa është legjitim privatizimi i tokave që Mbretëria e ish-Jugosllavisë dhe më vonë ajo komuniste i kanë konfiskuar nga populli , pa kompensim. Në privatizim a ka pastrim të parave? Cili është efekti i privatizimit, e kjo dinamikë dhe mënyra e privatizimit, a janë në shkallën e arsyeshmërisë? Cili është kaucioni i garancisë për investime në punësimet e premtuara? Cili është përcaktimi dytësor i parasë së privatizimit që rri në arka? Borxhin

e pagave të punëtorëve kur do ta paguajë AKM-ja, atyre që janë dëmtuar deri tash? Ju lutem sa është e drejtë të veprohet në këtë mënyrë me pronën e shtetit kaq lirshëm dhe pa dhënë kurrfarë përgjegjësie deri sot në këtë Kuvend? A do të kemi pronë shteti në të ardhmen, apo do të jemi jashtë saj?. AKM-ja me funksionin e vet te derisotshëm në këtë segment del se është shtet në shtet dhe ngecje e sistemit të Toshiba's (kuti e zezë), aty nuk dihet ç' bëhet brenda, por shihen vetëm efekte dalëse. Dhe ky është privatizimi i dy të tretave të ndërmarrjeve në pronësi. Është një sukses numerik, por nuk dimë se çfarë është brenda kësaj nga struktura e vetë esenciale. Mbështes mendimin se në AKM duhet të ketë kontroll dhe të gjitha segmentet e saj të kontrollohen shtruar. Të jemi të kujdesshëm se përgjegjësinë që na takon, të mos e kërkojmë gjetiu, por te vetja dhe ne së pari si Kuvend. Sado nostalgjik që do të jemi, dashur e pa dashur privatizimi po kryhet ose të themi në fazën e fundit po kryhet. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. Halimi, deputeti Nazaim Jashari në listë është i parafundit, meqenëse është i shënuar sipas radhës së grupit, e keni fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryesues me respekt, nuk është çështja se kemi ndonjë ankesë speciale, çështja është te respektohet njëfarë rendi në mes grupeve parlamentare, se mund të flas edhe i fundit, nuk ka problem, por mes grupeve të respektohet njëfarë rendi, dihet grupi më i madh, grupi tjetër e grupi tjetër. Është e vërtetë se nuk shkojnë ato simultan prej grupi në grup, por shkojnë më shumë kandidatë prej LDK-je, më shumë prej PDK-je, një shkon prej Aleance , një shkon ngaj ORA. Nuk e di 4 kanë folur deri tash të Aleancës, tanët, veç dy, këtë e di . E tani më thuani se nuk kam të drejtë, unë po e pranoj se nuk kam të drejtë, për t' u paraqitur, jam paraqitur me kohë.

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar z. kryesues, ministra.

Tema që po e diskutojmë sot është një temë e cila mua më krijon shije të mirë. Pasi që jemi pak këtu, po ju tregoj që është hera e parë në këtë Kuvend që nuk e ndiej veten jashtë grupit parlamentar me Alush Gashin, me Nekibe Kelmendin me Naser Osmanin që nuk është këtu, me Bajrush Xhemajlin, me Afrim Arzuallxhiun, me Mazllum Kumnovën, pra unë jam me të gjithë ju në një grup parlamentar.

Është hera e parë që ndodh kjo kështu. Pse është kështu? Është se çështja është e tillë, pra është një çështje që na preokupon të gjithëve njësoj. Kur po them për ne të gjithë andej, por do të ishte dashur që edhe këta këndej të jenë me ne andej. A është kjo kështu a nuk është nuk po dua të paragjykoj. Duhet të jetë gjithsesi Pse duhet të jetë, sepse ne jemi këtu në emër të disa zgjedhësve që na e kanë dhënë një mandat dhe ne përpiqemi që atë mandat që e kemi marrë prej atyre zgjedhësve ta reflektojmë në mënyrë më të mirë të mundshme të të gjitha grupet parlamentare, se interesa të tjera nuk kemi. Këta në Qeveri mund të kenë edhe interesa tjera, nuk do të ishte dashur, por mund të kenë, por në rast se interesi i tyre nuk është identik me interesin e shumicës sonë, ne do të duhet të ndërmarrim diçka se nuk është në rregull kjo punë. Prandaj, e kam një sugjerim para se ta vazhdoj fjalën që dua të them, me një vërejtje konkrete dhe shumë praktike për procesin e privatizimit ,por i z. Alush Gashit, është i z. Naser Osmanit,

është i z. Barjrush Xhemajli që të kërkohet prej këtij Kuvendi nëpërmjet një dokumenti të shkruar se do të duhej të jetë një rezolutë ose diçka tjetër e ngjashme në auditim në AKM. Alushi, në emër të Grupit, pra në këtë aspekt jam shumë i interesuar që nga ky debat të dalë një dokument i cili do ta obligonte Qeverinë e Kosovës se në z. Ryker e kemi vështirë të komunikojmë se po na duhet përkthyesi edhe ashtu ai mandatin nuk e merr nga këta qytetarë dhe nuk ndien për këta qytetarë, por duhet të ndiejnë këta që i kemi deleguar ne. Pra këta duhet ta kenë ndjeshmërinë e nevojshme që t'i paraqesin interesat e këtij Parlamenti dhe interesat e qytetarëve atje ku e përfaqësojnë këtë Parlament dhe ata qytetarë. Pra në këtë aspekt kam propozim shumë konkret që shefat e grupeve parlamentare të takohen edhe ta formulojnë një tekst, me të cilin do të kërkohet një auditim në AKM, sepse në AKM nuk ka transparencë, nuk ka transparencë as sa i përket mënyrës se si merren vendimet, nuk ka transparencë as sa i përket mënyrës se si caktohen kriteret e vlerësimit të tenderuesve. E kam një shembull këtu eklatant këtu, dua t'ju tregoj, por e kam një ankesë të një ndërmarrjeje private nga Gjilani, e cila është ndërmarrje e përzier kosovare-hungareze e dy themeluesve: z. Mehmeti dhe z. Balind me nga 50% të aksioneve, të cilët kanë konkurruar për blerjen e Kombinatit të Dhanit. Ju kujtohet ai kombinati që këtu njëherë prodhonte cigare "Bozhur" edhe e kanë angazhuar një avokat Morina nga Gjakova për t'i përfaqësuar interesat e kësaj ndërmarrjeje në kontestin me AKM-në lidhur me procesin e privatizimit. Privatizimi i Industrisë së Dhanit që tash quhet IDXH TABAKO për të cilën është shpallur tenderi në rundin e dhjetë, besoj që ministrat këtu të pranishëm janë të njoftuar për rastin, është shpallur tenderi më 15.02.2006 edhe fituesi i përkohshëm. Tenderi ka qenë me spinof special për t'ju tërhequr vërejtjen. Fituese e përkohshëm u shpall gojarisht firma ose kandidati me shifrën T85. Në qoftë se ndiqen procedurat e mënyrës si është marrë vendimi për këtë tender dua t'ju them se përveç një informate gojore pala e cila e konsideron veten të dëmtuar, pra "Ballkania," ndërmarrje e përzier kosovare-hungareze e konsideron vetin të dëmtuar për shkak të kriterëve që janë zbatuar gjatë vlerësimit të ofertave. Sipas informacioneve që i kam nga zotërinjtë e ndërmarrjes thuhet që informata për fituesin e ofertës nuk është publikuar ende në internet, pra përderisa të gjitha të tjerat janë publikuar, kjo ende nuk është publikuar, por është thënë vetëm gojarisht se për 1% ndërmarrja ose shifra me numrin T18 ka përparësi ndaj shifrës T85, që është ndërmarrja e dëmtuar në këtë rast, që pretendon se është e dëmtuar. E dua t'ju them sot kanë qenë kriteret që sipas kësaj ankese vi në pah shumë mirë. Kanë qenë tri kriteret themelore: kriteri për vlerësim, ka qenë çmimi më i pari me 50% të poenëve, 25% kanë pasur investimet e parashikuara në këtë ndërmarrje për të ardhmen dhe 25% ka qenë numri i punëtorëve që do të punësohen. Sipas çmimit të ofruar ndërmarrja Ballkania, që pretendon që është e dëmtuar e ka vlerën për një 800 mijë € më të madhe se sa vlera e ofertuesit që e ka fituar tenderin, pra përderisa ndërmarrja që pretendon që është e dëmtuar e ka ofertën 2 milion e 219 mijë €, ndërmarrja T18 që e ka fituar tenderin e ka 1 milion e 400 mijë € kjo sa u përket pareve në dorë që duhet të paguhet për ta marrë të drejtën e pronësisë. Sa i përket investimeve ndërmarrja T18 që e ka fituar tenderin, është në përparësi me ndërmarrjen që konsiderohet se është e dëmtuar, sepse kjo ka ofruar 5 milion 999 mijë €, kurse ajo ka ofruar 4 milion e 650 mijë €, kurse sa i përket të punësuarve ndërmarrja T18 i ka paraparë 799 persona që t'i punësojë, kurse ndërmarrja që pretendon se është e dëmtuar ka paraparë më pak punëtorë, i ka paraparë 324. Pra në

dy pozicione ndërmarrja që është shpallur fitimtare gojarisht është më e mirë, kurse në një pozicion që tërheq 50% të poenave është fitimtare për në pozicionin themelor kur numërohen parat, është fitimtare ndërmarrja që pretendon se është e dëmtuar. Tash vijmë te një moment këtu, i cili flet për mënyrën e vendimmarrjes në AKM, për transparencën, për rregullsinë, ose të kundërtën e rregullsisë. Në qoftë se Kombinati i Duhanit i Gjilanit ndoshta aktualisht i ka 205 punëtorë, pra nuk ka punëtorë ka njerëz që marrin ndonjë bursë se rroga nuk marrin. Në kohën më të mirë të mundshme ka punuar me kapacitet të plotë kur cigaret Bozhur janë pirë në krejt Kosovën i ka pasur 405 punëtorë, kurse në masat e dhunshme të Millosheviqit kur e ka mbushur Millosheviqi me punëtorë ma së shumti që ka ka mbërri deri 600 punëtorë.

Ky ofruesi T18 i ka ofruar 800 punëtorë në kohën e sotme kur e dimë saktë se teknologjia është avancuar aq shumë sa që edhe ata 324 punëtorë që i ka paraparë ofertuesi që ka humbë është vështirë që të mund të mbahen në punë për shkak se është teknologji e automatizuar. Nuk dua të flas më tutje, besoj se të gjithë jeni pak a shumë të njohuar me aspektet e problemeve që kanë të gjitha ndërmarrjet në botë lidhur me tepricën e fuqisë punëtore, për shkak të automatizimit të procesit. E tash, lind pyetja në cilën bazë është marrë vendimi, pra ankesa është e drejtuar ndaj z. Kirk Adams i cili e përmendi edhe dikush këtu edhe në mënyrë qarkore u është dërguar z. Ryker, z. Dik, z. Ahmet Shala dhe z. Paul Qisar apo si lexohet ky emër nuk e di, ndoshta Qishar e sidoqoftë dua që ta tërheq vërejtjen edhe një herë tek aspekti i privatizimit. Po privatizohet prona jonë, prona e Kosovës dhe ne të gjithë në këtë aspekt jemi në një parti në partinë e Kosovës ose do të duhej të ishim dhe në rast se ministrat nuk ose ministri Dugolli ma konkretisht i cili e mori fjalën dhe u përpoq që ta mbrojë këtë proces me fanatizëm që nuk e quaj normale ta mbrojë me fanatizëm këtë proces që ky proces që ky proces le shumë për t'u dëshiruar, pra edhe ky do të ishte me ne edhe ta bëjmë presionin bashkërisht te AKM-ja, e cila udhëhiqet dhe dirigjohet nga z. Ryker dhe Shtylla IV e UNMIK-ut. Besoj se ishte dashur edhe ashtu deputë është edhe do të duhej bashkërisht ta bënim presionin që ky proces në rend të parë të jetë më i rregullt, të jetë më transparent dhe që, duke iu bashkangjitur vërejtjeve të disa kolegëve këtu, të kemi kujdes, sepse në këtë proces nuk është vetëm një zgjidhje e çastit, nuk është vetëm një zgjidhje e momentit aktual, por është zgjidhje edhe e të ardhmes të tonë, fëmijëve tanë. Në qoftë se ne vetë duhet ta marrim në mostër ku përmenden këtu vlerat e pronave pa dashur që gjatë procesit të shpronësimit të banorëve të fshatit Hade një metër tokë djerrinë, djerrinë, jo klasa e tetë, por klasa pa klasë është konsiderua 3,25 cent një metër katror dhe në qoftë se në atë proces të shëmtimit, nuk kam asgjë kundër. Është çështja se njerëzit nuk e humbin aty pronën, por e humbin edhe shpirtin se po zhvendosen prej vendlindjes, dua të them se ajo është më e keqe, mirëpo me i krahasuam mekanikisht 3.25 l metër katror djerrinë me 1€ ari diku ku është shitur në Drenicë, unë për vete nuk e di se çka i thonë kësaj puna, a i thonë shitje a i thonë falje, nëse i thajnë falje atëherë së paku e dimë se ja kemi falur dikujt edhe presim prej tij se a do të falë a të shumëfishojnë, rritë e jo t'i tjetërsojnë e t'i shndërrojnë në diçka krejt tjetër, diçka që nuk presim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju falënderit z. deputet. Për fjalë është paraqitur Sala Berisha- Shala, le të përgatitet deputeti Enver Muhaxheri

DEPUTETJA SALA BEREISHA -SHALA – I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë

Në Kosovën e shkatërruar nga lufta privatizimi është një nga nevojat fundamentale sa i përket zhvillimit të ekonomisë së tregut. E përçolla me vëmendje raportin e z. Ryket dhe z. Dugolli, përfaqësues të AKM-së po ashtu i përçolla me vëmendje kolegët e mi deputetë. Me këtë rast nuk do të dëshiroja ta përsëris fjalën e askujt edhe pse ndoshta do të dalë diçka e tillë ngase shumë shqetësime i kemi të njëjta në lidhje me këtë çështje. Procesi i privatizimit në Kosovë është tema më e përfolur pro et contra si në mes të komuniteteve të biznesit, ekspertëve vendorë të ekonomisë deri te qytetarët e thjeshtë.

Them të drejtën në një masë të madhe ka shqetësime e zhgënjime në këtë drejtim, para së gjithash ndër qytetarët, duke pasur parasysh arsyet e tyre, siç janë: papunësia e madhe, gjendja ekonomike dhe sociale tejet e rëndë etj.

Të nderuar kolegë deputetë, unë nuk do të flas sot për procesin e privatizimit në prizmin politizuar, nuk do të flas as për privatizimin e privatizuar nga ana e një pjese të ndërkombëtarëve dhe vendorëve që janë në Bordin e AKM-së, nuk do të flas as për zhytjen e thellë të ndërmarrjeve në krizë financiare si pasojë e këtyre parregullsive që u cekën më lart dhe si pasojë e politikave operacionale të AKM-së, nuk do të flas as për legjitimitimin e praktikave të tërheqjes së ofertuesve kryesorë nga blerja e ndërmarrjeve shoqërore në sajë të marrëveshjeve të fshehta, kurdisjeve e tjera, siç ndodhi p.sh. me Feroniklin, mandej me dy hotelet e mëdha, siç janë Grandi dhe Iliria, rastin këtu që vjen erë korrupsioni. Nuk do të flas as për shumë gjëra që u thanë e nuk u thanë këto nga parafolësit, mendoj se secila nga këto janë tema në vete. Këtu para së gjithash jam për t'i përcjellë shqetësimet e qytetarëve të Drenicës me rastin e fenomenit privatizim i Feronikelit. Të kuptohemi drejt, secili ka të drejtë të pëceptojë prolemin në mënyrën e vet. Odisejada dhe privatizimi i Feroniklit para së gjithash për qytetarët e varfër të Drenicës ishte një lojë me nervat e tyre, ishte një lojë me shpresën e tyre për t'i dhënë fund gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale. Pyetja ime njëkohësisht edhe e tyre është: Kur do të marrë fund kjo lojë? Mosbesimi ndaj kompanisë Alferon është në kulmin e vet. Këtë e di edhe Alferoni e dinë edhe zyrtarët e AKM-së edhe Qeveria. Këtë mosbesim e kanë mbjellë AKM-ja dhe Qeveria për dyshimet e bazuara gjatë procesit të tenderimit dhe më pastaj deri te nënshkrimi, deri te pagesa e Alferonit që u bë kohëve të fundit dhe pastaj nuk dihet kur do të ndalen apetitet ose kërkesat për privilegje të Alferonit, Nuk e dimë se çfarë më tutje do të na paraqet ai derisa të fillojë me punë Feronikli apo nuk do të fillojë asnjëherë. Këtu mund të na japin ndoshta një përgjigje të paragjykuar përfaqësuesit e AKM-së. Këtu nga të gjithë kolegët .U fol për shumë parregullsi që mos t'i përmendi, mos t'i përsërisë u folë për jo transparencë, joefikasitet që u adresua nga parafolësit nga disa parafolës në drejtim të AKM-së si superqeveri. Të gjitha këto në asnjë mënyrë nuk e amnestojnë Qeverinë duke pasur parasysh që në Bordin e AKM-së janë edhe përfaqësuesit e saj. Shfajsimi se e drejta e rezervuar në këtë fushë ua pamundëson veprimin është vetëm një justifikim i njerëzve me psikologji robi, dhe në të kundërtën ata d.m.th. ministrat nuk do të duhet të pranoin të qëndrojnë në atë Bord vetëm si dekor. Në këtë drejtim pyes: Çka bëri Qeveria më së

paku çka bëri Qeveria për zgjidhjen e problemeve sociale apo për kthimin e mjeteve nga fondi i privatizimit? Çka bëri Qeveria që së paku procesi i privatizimit të jetë më transparent? Pse bëhet diskriminim ndaj biznesit vendor në këtë proces. Sa për ilustrim po e përmend që janë me qasje dhe kanë qasje me dy kute. Derisa ndaj Alferonit tregohet zemërgjerësi e pakufishme, u shtye gjashtë herë afati i pagesës, ndërsa privatizuesve vendorë edhe pse bëjnë pagesë u shtyhet nënshkrimi i kontratave. Merrni me mend pasojat ekonomike e tjera që nuk dua ta elaboroj në këtë rast. E kam një pyetje: për Qeverinë A i është dhënë Alferonit, duke pasur parasysh situatën energjetike në Kosovë, statusi i konsumatorit të privilegjuar në baza ligjore nga një grup ekspertësh apo nga një klan politikanësh? Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit zonja Berisha. Për fjalë është paraqitur Ymer Muhaxheri, fjalën e keni z. deputet, le të përgatitet deputet Berat Luzha

DEPUTETI YMER MUHAXHERI - Kuvend i nderuar, z. kryesues

Asociacioni i konceptit të AKM-së është shqetësues për faktin se është zbatuar në një ekonomi të lodhur, pak të zhvilluar në krahasim me vendet tjera të Jugosllavisë me një ekonomi e cila e ka përjetuar luftën, një pjesë e saj ka mbetur pa fabrika, pa industrinë. Ajo ka pasur fat që me këtë proces të privatizimit është shndëruar në market, hipermarkete, supermarkete dhe është për t'u vajtuar se klasa sunduese politike atëherë kur është imponuar ky koncept destruktiv diçka suigjeriris për Kosovën nuk ka pasur sens me reaguari aq ma tepër, e ka kultivuar një teori të shpresës se me procesin e privatizimit do të hapet një perspektivë e prosperitetit shoqëror, se do të hapen vendet e punës. E kuptueshme është se transicioni i ka këto probleme me u shndërrua prej një sistemi të ekonomisë së planifikuar me kohë, raporti ndaj pronës është kolektiv me një ekonomi të tregut ku konkurrenca është ligj i vleftës. Këto janë vështirësi të veçanta edhe pse në këtë proces ka pasur edhe vlerësime, por jo edhe në ato shtete ku me sukses të madh i kanë përdorë ato dy metoda e mjerisht ajo përvojë e cila nuk është marrë si bazë për ndërtimin e përmbajtjes e këtij koncepti këtu. Për shembull Çekia e ka bërë këtë transicion në atë mënyrë që gjithë ai kapital i sajuar prej shitjes është ndarë në tri pjesë: një pjesë e klasës punëtore, një pjesë ka shkuar në fondin e pensioneve e fondi tjetër si pasuri e komunës. Por ajo tjetra ma e suksesshme e Gjermanisë Lindore, ku prona shoqërore është dhënë, por me kushte që të investohet dhe me kusht tjetër që të rritet numri i punëtorëve. Fati i zi na ka përcjell ne që ky koncept është zbatuar dhe i kemi ato implikimet, implikimet e saja shumë kohë kemi me i përjetua. Ne i gëzohemi mbarimit të këtij vitit kur presim me u shpallë një fitore e madhe e shoqërisë kosovare-pavarësia. Por sa here që të kujtohet koncepti i AKM-së, atëherë ta errëson, shqetëson, nuk di t'i gëzohem asaj fitoreje, sepse këto implikime kanë me na përcjellë. Merrni me mend një absurditet prej 2002 kur është themeluar, është imponuar ky koncept i AKM-së deri me këtë vit - 5 vjet janë dhënë 300 milion prej buxhetit të Kosovës, e privatizimi i atyre 450 fabrikave llogaritet 400 deri 500 milion. Në popull barra s'e paguan qiranë. Qe çfarë fati kemi ne në këso rastesh. Kaq ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Luzha, le të përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha

DEPUTETI BERAT LUZHA— Edhe unë u ndjeva pak i diskriminuar me fjalën, mendoj që ka qenë dashur shumë më herët, por do të ishte mirë që të bëhen disa kritere.

Të nderuar kolegë deputetë, jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e privatizimit si një proces i domosdoshëm ekonomik dhe shoqëror. Mirëpo, në opinionin tonë po krijohet bindja se përmes privatizimit po shitet çdo gjë. Po shitet edhe vetë Kosova. Dihet se Agjencia e Privatizimit i quajtur shkurt AKM është në kompetencat e UNMIK-ut, por ne si vendorë kemi këmbëngulur që disa objekte t'i takonin sektorit publik apo shtetëror dhe që kanë vlerë dhe rëndësi kombëtare të mos privatizohen. AKM-ja ka një qasje të gabuar, kur tenton t'i privatizojë apo po i privatizon ta zëmë objektin e ish- hotelit Union, Pallatin e Shtypit dhe disa objekte të tjera kulturore, shoqërore etj. Procesin e privatizimit deri tash e ka dëmtuar dhe do ta dëmtojë edhe më shumë sektorin e pyjeve, ndarja dhe cilësimi i ekonomive pyjore si ndërmarrje shoqërore me tendencë të privatizimit të tyre, ka shkaktuar kaos të vërtetë në pylltari dhe si pasojë edhe shkatërrim masiv të pyjeve. Privatizimi i ekonomive pyjore do t'i kushtojë 144.000 € në vit Buxhetit të Kosovës, vetëm për pagesën e qirave të Agjencisë të Pyjeve dhe miliona të tjerë për ndërtimin e objekteve të reja për ndërtimin e zyrave të agjencisë, duke mos llogaritur pasojat e shkatërrimit të pyjeve. ekonomitë pyjore do të duhej të transformohen e jo të privatizoheshin. Agjencia e privatizimit e UNMIK-ut nuk duhet t'i privatizojë, pos ekonomive pyjore, as stacionet e veterinars, as stacionet e autobusëve, as stacionarët e banjave tona të njohura, Banjën e Pejës dhe të Killokotit, as Lotarinë e Kosovës. Shitja e tyre do t'i dëmtonte rëndë interesat e Kosovës, për të pasur ndërmarrje publike dhe shtetërore ashtu siç ka në të gjitha vendet e botës. Sipas analogjisë nëse mund të shiten stacionarët e banjave tona të njohura atëherë lirisht mund të shiten edhe spitalet. Nëse mund të shiten stacionet veterinarë pse të mos shiten edhe qendrat e mjekësisë familjare. Të gjitha fabrikat dhe objektet e tjera prodhuese do të duhej të privatizoheshin me spinof special, në të kundërtën pronarët e rinj të tyre mund tua ndërrojnë destinimin dhe ne do të mbetemi edhe pa ato pak fabrika që i kemi pasur në të kaluarën, kurse mundësitë për punësim do të zvogëloheshin dukshëm. Gjithashtu problem të veçantë paraqet privatizimi i tokave bujqësore, sepse shumica prej tyre kanë pronarë të vërtetë, kurse blerësit eventual më shumë janë të interesuar t'ia ndërrojnë destinimin që ata t'i parcelizojnë dhe pastaj t'i shesin me çmime të shumëfishuara. Stafi vendor në bordin e kësaj agjencie duke përfshirë dy tre ministrat e Qeverisë së Kosovës nuk duhet t'ia bëjnë temenanë siç ja kanë bërë deri tash akteve të shitjes pa kritere që po i bën AKM-ja ata janë me AKM për ta mbrojtur interesin e Kosovës dhe jo të bëhen servilë të zyrtarëve të AKM-së. A ka korrupsion në AKM, kjo agjenci e formuar para 4 viteve nga UNMIK-u që financohet me parat e taksapaguesve vendorë merr afro 70 milion euro në vit, por asnjëherë nuk u paraqet raport financiar institucioneve të Kosovës, madje asaj asnjëherë deri më tash nuk i është bërë auditim apo revizion nga revizioni i përgjithshëm, asnjëherë nuk janë bërë transparente parat qindra mijëra euro që kjo agjenci i ka marrë nga buxheti i Kosovës në emër të Kombinatit Trepça, në emër të KEK-ut, në emër të Aeroportit etj. Kurse siç e dimë Trepça ndodhet para likuidimit, KEK-u edhe pas 7 viteve prodhon terri, Aeroporti ndodhet në këmbë të qelqta. Asnjëherë deri më tash nuk është zbardhur deri në fund çështja e fondit të krijuar nga shitja e ndërmarrjeve, nuk dihet saktë ku janë ato para,

pse nuk përdoren, për çka janë të destinuara, ku qëndrojnë, prandaj transparenca në AKM dhe auditivi i saj janë më se të domosdoshme. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputetja Hoxha kurse le të përgatitet Bislim Hoti.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë. Privatizimi është njëra nga nevojat thelbësore për zhvillimin e ekonomisë së tregut, prandaj privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike kanë ndikim qenësor në këtë fushë. Ndërmarrjet më të mëdha të Kosovës, siç janë ndërmarrjet publike si KEK-u, PTK-ja Aeroporti, Hekurudhat janë privatizuar dhe janë nën autoritetin e AKM-së. Ne mendojmë se është me interes të shtrohet pyetja këtu se mbi çfarë baze ligjore AKM-ja bëri korporatizimin e këtyre ndërmarrjeve publike, në cilën rregullore të UNMIK-ut është mbështetur ajo, apo në cilin ligj të miratuar në Kuvendin e Kosovës. Duhet të shtrohet pyetja se çka është interes kombëtar i Kosovës, a janë këto Aeroporti, hekurudhat, PTK-ja minierat, ujërat etj. Unë mendoj se po. Në raportin lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, i cili na është shpërndarë të gjithë deputetëve, ministri Dugolli është shprehur se AKM-ja ,BE-ja dhe UNMIK-u nuk kanë siguruar asnjë strategji apo propozimi për privatizimin e pronave të vlefshme të ndërmarrjeve publike është përfshirë ndër të tjera edhe shërbimi i Aeroportit të Prishtinës, shërbimet e telefonisë mobile, sektori i telekomunikacionit etj. Të nderuar deputet dëshiroj t’jua përkujtoj se Aeroporti i Prishtinës në prill të vitit 2004 ka kaluar nën kontrollin civil dhe që të licencohet në të do të duhej të bëheshin disa renovime dhe me këtë rast është hartuar një masterplan për periudhën 2005 – 2025. Mirëpo sipas të dhënave duhet se Banka Botërore do të bëjë investime në vlerë prej 40 milion euro për renovimin e Aeroportit dhe me këtë rast të mos veprohet sipas planit master. Banka Botërore e ka vlerësuar Aeroportin e Prishtinës në vlerë prej 65 milion euro, çka është nën çdo kriter. Ne mendojmë se do të duhej që anëtarët në bordet mbikëqyrëse dhe bordet menaxhuese të kërkojnë të zbatohet plani master. Mendoj se sa i përket Aeroportit të Prishtinës mund të privatizohen vetëm shërbimi i fluturimit dhe shërbimet me pasagjerë, ndërsa nuk bën të privatizohet infrastruktura, siç janë: Kontrolli i fluturimit, pistat, pyrgu, pajisjet navigative etj. Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2005 që bën fjalë për progres të Kosovës, thuhet se sektori i hekurudhave ka nevojë për investime të konsiderueshme dhe se rivitalizimi i saj është në fazë kritike. Sa ju përket hekurudhave mendojmë se edhe atje nuk bën të privatizohet infrastruktura, ajo mund të shfrytëzohet, ndërsa Qeveria e Kosovës duhet të menaxhojë dhe administrojë atë.

Është me interes të diskutohet edhe për çështjen e telefonisë mobile, tash dy vite ne dhe qytetarët e Kosovës jemi të preokupuar për fatin e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe për dëmet që po ia shkakton me këto vonesa ekonomisë së Kosovës. Pyetjet tona me këtë rast i drejtohen ministrit të Posttelekomunikacionit z. Ahmeti edhe pse ai nuk është këtu.

1. A është menduar se sa dëme po i shkaktohen ekonomisë sonë, me përzgjedhjen dhe me anulimin e ofertuesit të dytë të telefonisë mobile,

2. Si mund të shpjegohet fakti që një kryeministër e shpall ofertuesin e dytë të telefonisë mobile, ndërsa tjetri që erdhi pas tij urdhëron që ai vendim të anulohet,
3. Si po u lejohet edhe më tej të operojnë lirshëm operatorë të pa licencuar dhe të përdorin hapësirën kosovare për përfitime të mëdha, pa asnjë detyrim ndaj vendit ku ata veprojnë, duke pasur parasysh faktin se ata nuk derdhin edhe asnjë cent të vetëm në buxhetin e Kosovës.

Në Ligjin për telekomunikacion neni 6 pika 2 thuhet: "Se bordi i ART-së përbëhet nga 5 anëtarë", pyetja ime për ministrin Ahmeti është Pse ky bord funksionon vetëm me 4 anëtarë.

Dëshiroj të ndalem edhe te çështja e privatizimit të ndërmarrjes Ballkan të Suharekës e tash Therandë. e cila u privatizua me spinof special. Me këtë rast dëshiroj të shpreh shqetësimet e qytetarëve të Therandës në lidhje me privatizimin e kësaj ndërmarrjeje, dëshiroj t'i numëroj disa mangësi dhe shkelje të procedurave në lidhje me këtë privatizim:

1. Privatizimi i ndërmarrjes Ballkan është bërë në kundërshtim me Rregulloren e AKM-së për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, sepse ndërmarrja i është shitur ofertuesit të vetëm të paraqitur në tender, kurse me rregullore duhet të jenë më shumë se 3 ofertues.
2. AKM-ja si menaxhuese e ndërmarrjeve shoqërore ka bërë privatizimin e ndërmarrjes sipas dëshirës së pjesës më të madhe të punëtorëve.
3. Ndërmarrja Ballkan është shitur me çmim shumë të ulët dhe atë vetëm për 1 milion e 400.000 euro.
4. Numri i të zënëve me punë është shumë i vogël, të papunë dhe pa përkujdesje sociale do të mbeten më shumë se 1000 punëtorë. Sipas kontratës, blerësi ka për obligim të punësojë vetëm 375 punëtorë dhe të investojë 6 milion euro. Deri më tash pronari i ri nuk i ka përmbushur asnjë nga këto obligime.

AKM-ja dhe Ballkani nuk kanë përmbushur asnjë obligim ndaj punëtorëve, punëtorët nuk kanë marrë 20% nga privatizimi, 2 paga dhe 5.300 euro për të cilat ata posedojnë vendimet.

Në lidhje me privatizimin e Ballkanit ministri i Tregtisë dhe i Industrisë z. Dugolli, para strukturave komunale të Therandës pat thënë se kemi pasur fat se Ballkanin e privatizua me një firmë nga Turqia, pronari i së cilës është profesor Universiteti. Z. Dugolli dëshirojmë t'i sjellim vetëm këto fakte. Kur firma turke Yzebamp është themeluar në vitet 77 – 80 Ballkani ka pasur 2.000 të zënë me punë, ka pasur kuadër të specializuar edhe magjistër dhe doktor shkence, ka pasur qarkullim vjetor 80 milion dollarë amerikan, gamë të gjerë të prodhimit dhe kapacitete të mëdha prodhuese. Po ashtu Ballkani me prodhimet cilësore pushtoi tregjet e Evropës, Amerikës dhe më gjerë. Privatizimin e Ballkanit e karakterizojnë këto dobësi: Zvogëlimi i të të zënëve me punë, krahasuar para procesit të privatizimit, rritja e qarkullimit, nuk ka investime. Firma nga e cila është privatizuar ndërmarrja është nën nivelin tekniko- teknologjik, të cilën dikur e ka

pasur Ballkani, prandaj nuk mund të pritet asgjë e mirë në aspektin ekonomik, përveç humbjes së ish- tregjeve dhe dështimit të plotë të privatizimi. Pronari i ri gati nuk ka kryer asnjë detyrim ndaj Qeverisë në formë të pagesave dhe taksave dhe tatimeve ndaj saj. AKM-ja ka qenë e obliguar të bëjë auditivin e ndërmarrjes, mirëpo ajo këtë nuk e ka bërë deri më tash, prandaj duke i pasur parasysh të gjithë këta tregues punëtorët e fabrikës Ballkan më 1 qershor 2005 i kanë adresuar një letër bordit të AKM-së me kërkesë që ta anulojë shitjen e Ballkanit dhe kërkuar që ky të riternderohet, Ata kërkuar që bordi i AKM-së të marrë në konsideratë kërkesat e 1.500 punëtorëve dhe të ketë parasysh perspektivën e ndërmarrjes dhe të ardhmen e punëtorëve të mbetur të pa punë dhe pa përkujdesje sociale dhe të 15.000 anëtarëve të familjeve të tyre.

Me veti i kemi nënshkrimet e punëtorëve të ndërmarrjes Ballkan. Duke i pasur parasysh të gjitha këto fakte mendojmë se për shkak të shkeljeve të procedurave të tenderimit ,si dhe për faktin se pronari i ri nuk ka përmbushur detyrimet që ka sipas kontratës së nënshkruar, atëherë kërkojmë auditivin e kësaj ndërmarrjeje dhe më pas të ritenderohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Bislim Hoti, kurse le të përgatitet deputetja Teuta Sahatçiu.

DEPUTETI BISLIM HOTI – Faleminderit z. kryesuese. Edhe pas gabimit që bëtë prapë përshëndetje për ju, sepse para folësve të mi 5 orë përpara e kamë kërkuar fjalën. Diskutimet tona nuk e di sa do ta kenë vlerën kur po e shoh se të gjithë jemi të lodhur dhe nuk di se sa do të zënë vend. Fillimisht përshëndes raportin për procesin e privatizimit në Kosovë të hartuar dhe të menduar nga Qeveria e Kosovës, por asesi nuk e mbështes vonesën e këtij raporti dhe mangësitë që mund t'i gjejmë në këtë raport. Privatizimi jo i shpejtë, jo kualitativ ka sjellë huti tek qytetarët e Kosovës dhe nuk premtion ardhmëri të qëndrueshme në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 si kompetencë të rezervuara, AKM-ja jo vetëm që është bërë superqeveri e Kosovës, por edhe zot shtëpie, edhe pse mendohet se në bordin e AKM-së ka vendorë ,unë nuk pajtohem. Por edhe pse mendohet që në bord ka emra shqiptarë, për mua janë të huaj, andaj mendojmë se ka ardhur ora e fundit, nuk e kam fjalën për Orën e Veton Surroit, por akrepat e këtij momenti tregojnë se shpirtin e privatizimit duhet ta ushqejmë me frymën tonë. Kjo frymë e deritashme e AKM-së në krye me zotin Roker Qeverinë e Kosovës e bëri të paralizuar, ndërsa Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë me në krye z. Dugollin e bëri kukull në privatizim. Privatizimi në Kosovë për AKM-në ishte fitimprurës, ndërsa për qytetarët e Kosovës diskriminues. Privatizimi i deritashëm në vend që të zvogëlojë papunësinë ai e bëri të kundërtën, ndërmarrjet e shitura nga AKM-ja bëjnë papërgjegjësi, pa strategji. Shitet një ndërmarrje ndërtimore ku kishte qindra punëtorë, blerësi këtë ndërmarrje e kthen në përpunimin e çokolatave apo makaronave apo çipiripave dhe punëtorët e profesionalizuar në ndërtimtari mbesin pa punë ,sepse ata nuk janë profesional për të prodhuar makarona apo çokolata, njashtu bënë edhe me toka të shitura ku blerësit më pas i shesin për troje. Ka edhe shumë të tjera që janë bërë dhe po bëhen nga ana e agjencisë që them më mirë të mos kishte agjenci fare

Gjakova dikur ishte shembulli më i mirë i Kosovës për këtë fushë, tani të gjithë jemi dëshmitarë të vërtetë se Gjakova ka mbetur Gjakova ka mbetur shenja më e keqe në Kosovë në këtë drejtim. AKM-ja për mua është tani një shoqëri e konsumuar, nuk kishte strategji të qartë në privatizim edhe për komunitete. Ndërmarrjet e mëparshme shoqërore, ndërtimore, shërbime e komunikacion, mirëmbajtje, bujqësore, prodhim kishin mjaftë të punësuar edhe pjesëtarë të komuniteteve, më pas me privatizim ata ngelin pa punësim. Andaj janë më se të domosdoshëm ndryshimi dhe pushimi i AKM-së, këtë e themi për arsye se siç thotë populli i di Meta punët e veta për këtë çështje e më së miri e dimë ne, më së miri duhet ta dinte Qeveria e Kosovës, e cila do ta nxirrte një ligj të miratuar në këtë Kuvend ku do të përcaktoheshin qartë mekanizmat në privatizim gjithmonë duke i respektuar edhe sindikatat e pavarura. Qeveria e Kosovës duhet t'i ketë parasysh formalitetet në procesin e privatizimit, ku duhet ta nxjerrë një ligj i cili favorizon punësim në privatizim për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke iu falënderuar mbesim me shpresë se zëri ynë do ta vetëdijësojë Qeverinë e Kosovës që këtë përgjegjësi ta marrë mbi vete. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka Teuta Sahatiçiu, kurse le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETJA TEUTA SAHATIÇIU - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputet. Si inxhinierë me profesion çdoherë mundohem me gjet lidhshmëri matematikore, lidhshmëri teknike në mes ngjarjeve. Edhe sot në këtë rast u mundova me gjetë lidhshmërinë a thua me cilën logjikë është duke u vazhduar me parafolësit. Një herë mendova se është logjika e forcës në Parlament, pastaj mendova se ndoshta është logjika e alfabetit e unë shkoj pak më prapa, pastaj u mundova me gjetë në teknikë dhe po më duket që në teknik e gjeta. E gjeta se në fakultet kur kemi mësuar për procesorë kanë ekzistuar disa regjistra dhe në regjistra ajo informatë që ka hyrë e para në ato regjistra ka dalë fundit, por unë mendoj se është problemi teknik dhe duke pasur parasysh që sistemi ynë nuk e ka mirëmbajtjen teknike, do të kisha propozuar që ta marrim një kompani vendore e jo të Shkupit, jo të jashtme, e cila do ta mirëmbajë këtë që të mos kemi probleme të natyrave të ndryshme teknike dhe të koncentrohemi vetëm në punë.

Së pari desha t'i përsërisja të gjithë duke pasur parasysh edhe ministrin e Tregtisë, i cili për këtë debat e përgatiti edhe dokumentin në mënyrë që debati me qenë më konstruktiv dhe më i frytshëm. Përveç gjërave të tjera në këtë dokument më ra në sy fjalia, për ndërmarrjet shoqërore të Gjakovës dhe aty thuhet: "Këto ndryshime më vonë do të lejojnë privatizimin e atyre ndërmarrjeve shoqërore të cilat kinse ishin transformuar në kompani të bashkuara aksionare". Vërtet më bëri shumë përshtypje kjo fjala "kinse". Nëse themi kinse atëherë ne po prejudiojmë statusin e tyre, ne po prejudiojmë mënyrën se si është bërë. Unë mendoj që Ministria e ka për detyrë që t'i zbatojë ligjet e jo t'i interpretoj në mënyra të ndryshme, kinse është ajo, kinse është kjo. Janë ligjet, janë rregulloret zbatohet atë, mos prejudio, mos thuaj kinse ashtu e kinse kështu. Për privatizim, privatizimi është një proces i domosdoshëm me të cilën ndërmarrjet nga një gjendje e pronësisë kalojnë në gjendjen tjetër pronësie. Në ato ndërmarrje që funksionojnë pa e penguar punën e ndërmarrjeve. Qëllimi i privatizimit është xitja e

zhvillimit ekonomik, është rritja e punësimit dhe me këtë rritja e mirëqenies sociale. Me fjalën privatizim ne tentojmë ta krijojmë sektorin e fortë privat dhe si proces i tillë meriton respekt dhe përkrahje. Të flasim tash për rezultatet e privatizimit. Përmes këtij privatizimi fondi i mjeteve për privatizim është jashtë qarkullimit, të cilën shumica prej deputetëve, shumica prej folësve e përmendën dhe do të duhet që me të vërtetë të kemi kujdes që ky fond të mos ndikojë në zhvillimin e shteteve të zhvilluara me parat e kosovarëve, por të ndikojë në zhvillimin e kosovarëve me parat e cila ajo është ndërtuar dhe është grumbulluar. Me këtë mënyrë të privatizimit, përveç zhvillimit të mëtejshëm ne rrezikojmë edhe likuiditetin e bankave. Ato ndërmarrje kosovare të cilat kanë marrë kredi për të blerë këto kompani prej qarkullimit e kanë tërhequr një sasi të parave, kjo sasi e parave nuk ekziston më në qarkullim me këtë rast rrezikohet zhvillimi i mëtejshëm i këtyre kompanive, njësoj rrezikohet edhe likuiditeti i bankave. Pra pamundësohen edhe investimet e mëtejme nga blerësit. Besimi i investitorëve të jashtëm përmes privatizimit, ne tentojmë që t'i tërheqim investitorët e jashtëm këtu, shtrohet pyetja: Besimi i investitorëve të jashtëm në kushtet e Kosovës kur mungon besimi i AKM-së në këto kushte, duke pasur parasysh që AKM-ja vetë nuk beson në kushtet e Kosovës dhe i qet paret jashtë, si mundemi ne të presim prej investitorëve të huaj që të vijnë dhe t'i investojnë parat këtu. Ky trend i rritjes së papunësisë dhe i stagnimit të zhvillimit ekonomik, punëtorët të cilët përmes spinofit special marrin ato 20%, ata punëtorë nuk janë më punëtorë, ata punëtorë janë të papunët e ardhshëm të cilët do ta rëndojnë edhe më tepër punësimin në Kosovë. Tjetër që u tha shumë herë mosdhënia e përgjegjësisë. AKM-ja përgjegjësinë e ka t'i merë mjetet nga buxheti i Kosovës, ndërsa përgjegjësi tjetër nuk ka. Prandaj fuqishëm i mbështes të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët të cilët e kërkojnë auditivin e AKM-së, duke pasur parasysh që dje folëm për standardet, për standardin e parë dhe të dytë, funksionimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit, mendoj që kjo plotësisht përputhet me këtë mekanizëm për të cilin folëm.

Për AKM-në në disa ndërmarrje ka qenë e shpejtë, bile tepër e shpejtë siç u pa edhe prej diskutimeve të tjera, ndërsa për disa ndërmarrje të tjera e veçanërisht për Gjakovën ajo ka qenë shumë e ngadalshme, shumë e ngathtë dhe kjo frikë e marrjes së përgjegjësisë në të vërtetë është përgjegjësi, dikush duhet të japë përgjegjësi pse këto ndërmarrje të Gjakovës deri më sot kanë ngelur të paprivatizuara, të cilat nuk kanë hyrë në rendin e privatizimit.

Unë mendoj që me këtë lloj të qasjes të AKM-së, AKM-ja e ka humb kontaktin me realitetin, e ka humbur kontaktin me qëllimin e vet për të cilin është krijuar, e ka humbur kontaktin me punëtorët dhe me shoqërinë, sepse me shkrimin e shumë të raporteve dhe me numër të madh të imellave si duket ka mbetur shumë brenda në zyre dhe nuk po del jashtë me e pa efektin se çka po ndodh në realitet dhe cila është dobia e Kosovës prej këtyre aksioneve të AKM-së.

Shumë herë dëgjuam edhe për mosrespektimin e kushteve të cilat AKM-ja i ka vendosur dhe në raste të shumta këto kushte të cilat vet i ka vendos nuk janë respektuar por janë zgjedhur të tjerët të cilët nuk i kanë plotësuar ato kushte.

Gjithashtu edhe për mekanizmin, me të cilin do të kontrollohen ato investime, të cilat blerësit ofertuesit i kanë marrë përsipër që të investojnë në të ardhmen, të rrisin numrin e punëtorëve dhe që ta zhvillojnë më tutje punën të cilën e kanë marrë. Tash do të koncentrohemi pak në Gjakovë, për qytetin i cili ka qenë i harruar prej AKM-së dhe në të cilin më në fund të fundit AKM-ja nisi të vinte. Dy ditë para seancës ministri Dugolli e pa të arsyeshme të vinte, me siguri pengesë ka pasur se me çfarë veture, me ardhë, me mercedesë apo me BMW apo me çka tjetër të vinte deri në Gjakovë. Sigurisht ajo është arsyeja që është vonuar deri tash, apo ndoshta fatmirësisht PDK-ja që e filloi këtë debat dhe debati u bë katalizator për përshpejtimin e disa proceseve. Pasi jam nga Gjakova ku ekzistojnë 48 shoqëri aksionare, ju lutem që në pika atë shkurtra t'ju njoftoj për gjendjen e tyre. Këto ndërmarrje janë transformuar në shoqëri aksionare me ligjin jo diskriminues të kohës së Ante Markoviqit për kapitalin shoqëror, Fletorja Zyrtare RSFJ77/88, 40/89 etj. Prandaj do të lidheshim me ministrin Bujar Dugollin, i cili tha Z. kryetar shumicës i është zgjatur koha dhe pasi jam në rend aty kah fundi, shpresoj se edhe mua do të më zgjatet koha. Me të njetin ligj janë privatizuar edhe fabrikat e tjera në ish- Jugosllavi dhe ministri Dugolli duhet ta dijë se Ante Markoviqi nuk ka qenë në kohën e Millosheviqit dhe aty ka pak dallime në vite. Këto shoqëri aksionare mbesin të paregjistruara nga Ministria e Tregtisë dhe të paregjistruara ato nuk mund të ushtrojnë aktivitet të plotë ekonomik. Nuk kanë mundësi qasje në kredi, import, eksport, nuk mund të aplikojnë në tender, të kenë konton e vet në bankë etj. Janë të obliguar të bëjnë kontrata deri në tre muaj, firma që mund të bëjnë kontrata vetëm deri në 3 muaj dhe të bëjnë pagesa simbolike prej disa mijëra eurosh. Këto me një fjalë tepër të butë janë nënçmuese nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe e Industrisë dhe të AKM-së, të mos them keqdashëse dhe të papërgjegjshme, por në të njëjtën kohë këto ndërmarrje nuk pengohen të paguajnë tatime, p.sh Gorenje Elektromotori e ka planin e biznesit dhe garancinë nga Sllovenia për fillimin e punës dhe prej shtatorit e ka komplet dokumentacionin e gatshëm në AKM dhe prej shtatorit e deri sot ajo nuk ka arritur të hyjë në rend për shqyrtim, por nuk ka mundësi të operojë sikur agjenci aksionare tjera, pasi që nuk mund të regjistrohen. A thua kush ka aq guxim që në këtë papunësi të madhe, në këtë stagnim enorm ekonomik të pengojë dike të punojë. Pikërisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe AKM-ja, si Shtylla e Katërt të cilat janë kompetente të stimulojnë zhvillimin ekonomik dhe për çudi kryeministri Dugolli u kujtua 2 ditë para seancës kur do të flitet për privatizim dhe erdhni me propozimin e regjistrimit do si do nën të ndryshme. Do të ishte më mirë që ministri të mos zbulon kategori të reja të bizneseve të ndryshme dhe të mos interpretojë në mënyrë arbitrare ligjet që janë në fuqi, por t'i respektojë ligjin dhe rregulloret, pikërisht urdhëresën administrative 2002/22, neni 42 duke u bazuar në Rregulloren 2001/6 për shoqëritë tregtare e cila thotë: "Një ish- ndërmarrje shoqërore, e cila është transformuar në kohë në shoqëri aksionare ose në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar para se të hyjë kjo urdhëresë administrative që njihet si e tillë nga një gjykatë kompetente në Kosovë, do të regjistrohet si shoqëri aksionare ose si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas procedurave të përcaktuara me nenin 41 të kësaj urdhërese administrative të nënshkruar prej Mihajl Shtajnerit".

Gjithashtu edhe vendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, pasi jemi duke folur për sundimin e ligjit nr. 159/2005 e dt. 28.09.2005 me të cilin obligohet e paditura - Ministria për Tregti dhe Industrisë, Agjencia për regjistrimin e bizneseve ta regjistrojë

shoqërinë aksionare Ereniku në afat prej 10 ditësh. Pro pranimit të statusit të shoqërive aksionare janë: Ligji jodiskriminues, rregullorja 2002/22 dhe vendimi i gjykatës për regjistrim dhe vërtetimit të statusit dhe studimi nga Instituti Ekonomik në Prishtinë për statusin juridik, ekonomik të shoqërive aksionare në Gjakovë. Pas të gjitha këtyre fjalëve po kujtohem a thua cili ka qenë qëllimi, pse këto shoqëri aksionare nuk janë regjistruar dhe nuk u është dhënë mundësia të punojnë me që rast zhvillimi ekonomik ka ngec, me që rast punësimi është zvogëluar, me ç' rast sundimi i ligjit ka pasur ngecje. Nuk mund të mendoj diçka tjetër përveç një vendimi arbitrar të mos them vendimi politik, i cili u ka kundërshtuar të gjitha këtyre argumenteve.

Rekomandim: Më erdhi mirë që Grupi i AAK-së dhe kolegja ime Xhylnaze Sylaj ndërmorën një aksion për formulimin e një rezolute me rekomandime nga kjo seancë. Rekomandimet do të ishin prej anës sonë:

1. Të regjistrohen si shoqëri aksionare, sipas urdhëresës administratiave të cekur më parë, nenin 42. Gjithashtu kjo kërkesë është e mbështetur nga vendimi i Gjykatës të cilën e ceka më lartë dhe të cilën kush dëshiron mund ta ketë kopjen dhe të regjistrohet.
2. Të formohet fondi i privatizimit, kurse fondi i privatizuar të transferohet në banka vendore dhe ta ndihmojë zhvillimin tonë e jo zhvillimin e Holandës, Gjermanisë etj se ato nuk kanë nevojë të zhvillohen me parat tona, të një vendi shumë të varfër.
3. Të krijohet fondi për pensione, se të gjitha këto ndërtesa nuk i kemi ndërtuar ne, nuk janë ndërtuar në 99-ntën, nuk janë ndërtuar në 2006, ato janë ndërtuar moti, janë ndërtuar prej këtyre punëtorëve që sot janë pensionuar, që nuk kanë pension. Dhe
4. Të krijohet fondi për zhvillim, i cili do të gjenerojë zhvillimin e bizneseve vendore.

Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi, kurse le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi .

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj. Është krejt normale që në çdo vend në transicion debati për privatizim të jetë kryekëput politik Natyrisht që në këtë debat kanë qenë të përjashtuar qytetarët e Kosovës, ngase ata nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojnë se çka duhet të bëjë shteti i tyre për qytetarët dhe çka duhet të mbetet në duar të shtetit dhe çka në duart e tyre. E kuptoj se Kosova do të fillojë të zhvillohet ekonomikisht vetëm atëherë kur qytetarët e saj do ta kenë preokupim të vetëm zhvillimin e tyre ekonomik. E di që sot nuk është preokupim i tyre i vetëm, por me siguri që shumë shpejt edhe do të jetë. Unë besoj që qasja në ekonominë e Kosovës, pasi që është edhe ministri i ekonomisë këtu nga një ekonomi që momentalisht po bazohet që e quajnë ekonomistët ekonomi të kërkesës, duhet të shndërrohet në një ekonomi të tregut të lirë dhe mbi konceptin e ekonomisë së prodhimit. Unë do t'i përmend disa treziqe që barten me privatizim të cilat kanë ndikim direkt në politikën e Kosovës edhe në të ardhmen. E para ka të bëjë me pastrimin e

parave. Nuk është problem vetëm pastrimi i parave që mund të bëhet në Kosovë, problem është që ata janë ofertues seriozë apo mund t'i quajmë më të fortit në këtë rast dhe kur e dimë të gjithë që me privatizim mund të ketë ndikim në reformimin e ekonomisë nacionale dhe në krijimin e planeve nacionale, atëherë do të na dalë që këta blerës, për mendimin tim, jo legjitimë dhe organizatat e tilla jolegale do të jenë po i quaj reformues dhe hartues të planeve dhe strategjive nacionale. Njëkohësisht fuqia ekonomike bartet nga Qeveria dhe tregu i lirë te këto organizata. Elementi i dytë apo problemi i dytë është privatizimi i turbullt që e quajmë ekonomistët që mund të themi me të drejtë- privatizimi i shpejtë. Askush nuk është kundër privatizimit dhe atij që të bëhet sa më shpejtë, por në këtë proces duhet të jemi të kujdesshëm ndaj atyre që janë të kujdesshëm që si t'i përfitojnë rentat e tyre dhe duhet të dimë se në shpejtësi mund të jenë edhe specialistë të vërtetë për këtë, andaj do ta mbështetja auditimin që do të bëhet në procesin e privatizimit. Një element në veçanti që është për strukturën politike në Kosovë është me siguri i ndikuar nga mendimi i Marks Verberit në veprën e tij "Kapitalizmi politik". Ai konstaton me të drejtë se ndikimi i politikës është në zhvillimin ekonomik, por këtu kemi të bëjmë me diçka tjetër, bëhet luftë për ndikimin politik dhe përfitimi në kuptimin në ndikimin e tyre në privatizim. Nëse i marrim përvojat e këqija si mund t'i kemi ato në Rusi, Ukrainë apo dikund tjetër, ndërmarrësit e rinj nuk kanë shumë të përbashkët me ndërmarrësin afarist, por më shumë janë ndërmarrës politikë. Në botën moderne e dimë që ekonomia e ka apo e determinon politikën, në Kosovë ende politika e determinon ekonominë, sidomos atë të zezën, por mendoj se shumë shpejt do të ndikojë ekonomia edhe në Kosovë që të ketë kontroll mbi politikën.

Një element i veçantë në privatizim mendoj që ka qenë vonesa e privatizimit dhe me siguri kushtet e privatizimit dhe se ne kemi bërë sot që një pjesë e fuqisë ekonomike të popullatës, në vend që të orientohet nga prodhimet e reja, nga prodhimtaria që mund të jetë konkurrencte në vend dhe më gjerë ,ata janë orientuar kryesisht në prodhimet që kanë qenë më parë, pra më shumë janë orientuar të investojnë në objektet apo fabrikat që kanë qenë po e quaj të prodhuara apo të krijuara në vitet e 70-ta dhe më pak në ato të teknologjive moderne.

Elementi i fundit që do të përmend sot është rreziku apo gabimi që po e bën Qeveria, e cila me siguri se do të ketë pasoja në të ardhmen, dua t'ia tërheq vërejtjen edhe AKM-së lidhur me privatizimin e pronave të kontestuara apo pronave private. Ne e dimë që në vendet komuniste ka pasur eksproprijim të pronave të ndryshme, në veçanti në Kosovë ndoshta ka qenë më shumë apo më specifike se në vendet e tjera, por nuk është bërë asnjë hap për kthimin e këtyre pronave dhe në këtë drejtim me këtë lloj të privatizimit me siguri ne duhet të kemi parasysh se po krijojmë raporte të tensionuara në mes të pronarit të ri dhe pronarit të vjetër dhe një barrë e cila do të mbetet për Qeverinë në të ardhmen. Me siguri që privatizimi duhet të jetë një proces që do të ndikojë jo vetëm në shitjen, mund ta quajmë kështu të objekteve ekzistuese, por gjithsesi në ndryshimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, kurse le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, zotërinj qeveritarë dhe deputetë. Debati për privatizimin zhvillohet edhe në vendet më të zhvilluara të Evropës, madje shpeshherë bëhet edhe debat shumë i nxehtë, bëhen mijëra shkrime e libra për çështjen se çka duhet privatizuar e çka jo. A duhet të ekzistojë edhe prona publike pranë pronës private etj. Kurse në Kosovë ky debat po bëhet në Kuvend, por me një vonesë të madhe dhe pa përfshirjen e shoqërisë civile dhe të specialistëve të fushave të ndryshme që do të jepnin kontributin e tyre në çështjen e procesit të privatizimit. Këtu u dëgjuan kritika të ashpra në drejtim të procesit të privatizimit, madje si duket nga këto kritika sapo doli nga salla edhe ministri Dugolli, i cili është i përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces dhe është njëri prej më të entuziazmuarëve dhe më të zellshmeve në këtë proces. Grupi i LDK-së kërkoi një auditim të tërësishëm të procesit të privatizimit. Unë do ta saktësoja pak më ndryshe, unë do të kërkoja një kontroll dhe një hetim të përgjithshëm të procesit të privatizimit dhe pjesë e këtij kontrolli dhe këtij hetimi do të duhej të ishte edhe Kuvendi i Kosovës dhe veçmas opozita, nëse duam të kemi një kontroll dhe një hetim korrekt dhe të paanshëm. Është përshtypje e përgjithshme dhe jo vetëm sot jona këtu që nga ky privatizim do të dalë një oligarki e fuqishme financiare, e cila do të përpiket në të ardhmen që të monopolizojë të gjithë jetën politike ekonomike dhe shoqërore të vendit. Këtu nga shumë deputetë u dëgjua se buxheti i Kosovës deri më tash ka ndarë 300 milion, dikush tha 200 milion, kurse kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa tha 186 milion euro për AKM-në, kurse nga shitja që është bërë deri më tash e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, janë inkasuar rreth 154 milion e 441 euro, na del se në Kosovë faktikisht nuk po ndodh privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërore me qëllim që të ringjallet ekonomia siç po thuhet, por po ndodh përvetësimi dhe thënë më shkurt uzurpimi i pasurisë kombëtare të Kosovës, e cila është pasuri edhe e çdo qytetari të Kosovës dhe ky uzurpim po paguhet nga buxheti i Kosovës me qindra miliona euro. Unë mendoj që disa prona, disa ndërmarrje publike siç është rasti konkret i Banjës së Klllokotit, nga kolektivi i të cilit edhe kam kërkesë të veçantë, ky kolektiv u është drejtuar edhe kryetarit të Kuvendit me sa e di unë, Qeverisë, AKM-së, kryetarit të Kosovës me kërkesë që Banja e Klllokotit të mos privatizohet, por t'i jepet statusi i një instituti publik, rehabilitues dhe shëndetësor dhe të kalojë në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Unë mendoj se përveç kësaj duhet të kihet parasysh, me gjithë se jemi të vonuar në këtë çështje, tashmë shumëçka ka ikur, por duhet të kemi kujdes dhe është shqetësim edhe i komunave që edhe toka publike komunale të kursehet nga privatizimi ose t'u lihet një sipërfaqe e caktuar komunave që mund ta shfrytëzojnë për nevojat e tyre publike për ndërtim shkollash, spitalesh dhe objektesh tjera për nevoja publike. Ka ndodhur, siç është rasti në Vushtrri të privatizohet edhe sheshi i qytetit, ky është me të vërtetë një absurd i llojit të vet, diçka që nuk ndodh në vendet e tjera normale, por me që ne jemi kështu një vend jonormal, ndodhin edhe gjëra, siç po ndodhin jo normale. Ju faleminderit.

KRYETARI – Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, kurse le të përgatitet Xhevdet Neziraj.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Ju faleminderit z. kryetar dhe mirë bëtë që erdhët sepse intervenimet e z. Xhavit për kohëzgjatjen e diskutimit dhe të flitet për radhë nuk kishin të sosur. Të nderuar kolegë deputetë meqë shumë segmente u thanë këtu që ishin të ngjashme me ato që do të thosha unë, tani do të fokusohem vetëm në dy segmente.

Procesi i privatizimit në Kosovë po vazhdon, pavarësisht pakënaqësitë dhe herë herë aty- këtu pakënaqësitë në të gjithë po e mbështesim këtë proces, çdo ngadalësim i procesit të privatizimit vonon realizimin e programit për privatizim. Me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, me investimet ndërkombëtare në Kosovë, mundësohet zhvillimi ekonomik i Kosovës, gjithashtu avancohet edhe punësimi i shumë njerëzve. Papunësia është më e theksuara në Kosovë në rajon e më gjerë, gjendja e skajshme e papunësisë shkakton edhe probleme sociale dhe pakënaqësi. Të respektuar deputetë, procesi i privatizimit deri më tani në komunën e Rahovecit po ecën të thuash mirë, janë privatizuar një numër i madh i ndërmarrjeve shoqërore si: Ndërmarrja shoqërore Termosistemi, ndërmarrja shoqërore Sillosi në Xerxë, ndërmarrja shoqërore 18 Nëntori ish -fabrika e plasmanit dhe këto ditë u privatizue ndërmarrja bujqësore industriale Rahoveci në Rahovec. Deri para privatizimit ka qenë një lloj agonie, sepse ky lloj i ndërmarrjeve shoqërore kanë qenë të çdokujt dhe askujt, tani është me rëndësi se dihet pronari i këtyre ndërmarrjeve shoqërore dhe më mban shpresa se këto ndërmarrje shoqërore të privatizuara do të rimëkëmben në të mirë të popullatë shumë punëtore të Rahovecit me rrethinë. Shembull konkret për të mirë do të veçoja ndërmarrjen e privatizuar Sillos në Zerze, ku menjëherë janë bërë investime kapitale në ngritjen e mullirit bashkëkohorë me kapacitet 630 tonë brenda 24 orëve dhe janë punësuar një numër i konsiderueshëm punëtorësh. Është shumë me rëndësi edhe privatizimi i NBI-së ose Ndërmarrjes Bujqësore Industriale e Rahoveci në Rahovec, që u bë këto ditë e të cilën lirisht mund ta quajmë gjigantin e Dukagjinit për prodhimin dhe përpunimin e rrushit dhe të verës, bile nuk e teprojmë fare nëse Bodrumin e verës në Rahovec e quajmë Trepçë të Dukagjinit apo thesari i saj, është mjaft e rëndësishme që këtë gjigant e ka blerë biznesmeni shqiptaro amerikan Hary Bajraktari me kompaninë vendore Fruti. Kemi besim dhe dëshirë se ky afarist i njohur do t'ua kthejë besimin bujqve të veshëm të kësaj treve, po ashtu besojmë se vera e Rahovecit në veçanti e vera e Kosovës në përgjithësi e njohur për vlerë do të kalojë bllokadat dhe do të plasohet edhe në tregun evropian dhe në shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu me investimet kapitale të cilat janë mbi 5 milion euro do të rritet interesimi të vreshtarët në sektorin privat për mbjelljen dhe kultivimin e hardhisë së rrushit edhe më tej, ku do të bëhet edhe punësimi i punëtorëve të rinj dhe do të zgjidhet problemi i punëtorëve që ishin të punësuar më parë dhe kanë mbetur pezull, ngase si duket nuk po zbatohet drejt obligimi ndaj tyre, pra është vullneti për t'u marrë me këtë kulturë që është mjaft fitimprurëse, megjithëatë ka edhe pakënaqësi të ish pronarët dhe pronat e tyre që dikur u janë marrë, ku nuk mungojnë kritikrat destinuar AKM-së, për vonesë të procesit dhe parregullsi të tjera . Gjithashtu pozita e punëtorëve të vjetër dhe atyre që pranohen mbetet për t'u parë në të ardhmen. Ju faleminderit.

KRYETARI – Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, kurse le të përgatitet për fjalë Hajredin Hyseni.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ - I respektuar kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Unë do të bëj përpjekje të jem i shkurtër dhe të mos i përsëris disa gjëra që u përsëritën këtu, Vetëm do të them që ish ndërmarrjet e ish sistemit socialit kanë humbur tregun dhe e dinë ekonomistët mirë se çka do të thotë me e humb tregun, duhet edhe firmat shumë të njohura në botë kur e humbin tregun e kanë shumë vështirë që të kthehen në treg e le këto që nuk kanë punuar qe 20 e sa vjet, prandaj edhe ndërmarrjet e

Pejës edhe të Gjakovës mund të përshëndeten dhe duhet të bëjnë plane të reja të biznesit që të mund ta përfitojnë tregun. Do të them që ndërmarrjeve të e tregut ish- socialist nuk u janë bërë investime qe 25 vite, kemi amortizim të makinerisë edhe amortizim fizik, por edhe amortizim moral, të cilat duhet të largohen nga ato ndërmarrje. Mirëpo do të veçoj këto se çka do të mund të bëjë Qeveria me qëllim të privatizimit më të mirë. Nëse ka mundësi që ndërmarrjet të mos shiten në bazë të çmimit të cilin jep pronari, por në bazë të planit që një pronar do ta dorëzonte për investime dhe të përcjellë dinamikën e investimeve, por edhe ai pronar që do të ofronte se do të punëson një numër më të madh të punëtorëve dhe në këtë formë më mirë është të falet një ndërmarrje, por të ketë investime edhe ato investime të mos bëhen mbas 10 viteve, por të bëhen sot, prandaj këtu është e tërë ajo politika e cila duhet të bëhet në privatizimin e ndërmarrjeve.

Do të isha ndalur edhe te privatizimi i ndërmarrjeve publike, siç janë posta, KEK-i në të gjitha vendet perëndimore, por edhe në Gjermani, prej nga vjen z. Ryker, shumë ndërmarrje nuk janë të shpronësuar ashtu siç po mendojnë ta shpronësojnë Kosovën, edhe Kosova duhet të ketë pronë mbi disa ndërmarrje. Unë do ta marrë shembullin e Kroacisë ku posta dhe telekomi 50% janë të shtetit 40% janë të aksionarëve, ndërsa 9% e kanë zgjedhur problemin e invalidëve të luftës, prandaj edhe ne mund të veprojmë në këtë formë dhe në këtë mënyrë dhe të arrihet një shkallë më e lartë e punësimit, përndryshe akuzat kundër Qeverinë janë të pabaza. Ne ishim ata deputetë edhe në legjislacionin e parë të cilët nuk arritëm ta ndryshonim Rregulloren e AKM-së dhe z. Shtajner na pruni këtu, atëherë pse t'i akuzojmë vetëm dy ministra, duhet të akuzohemi të gjithë, por kjo është kompetencë e UNMIK-ut të cilën nuk ke mund ta ndryshosh. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, kurse le të përgatitet deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Z. kryetar, ministra të pranishëm të nderuar deputetë, privatizimi është një proces i cili është i domosdoshëm për funksionimin e demokracive, sepse ai decentralizon ekonominë e centralizuar duke hapur mundësi për zhvillimin ekonomik dhe investime dhe një hap i tillë në Kosovë duhet të përshëndetet, sepse kjo është nevojë për funksionimin e ekonomisë së tregut të lirë. Në vendet e tranzicionit ku hën pjesë edhe Kosova një proces i tillë ka pasur mangësitë që e kanë përcjell, e një ndër pengesat kryesore në Kosovë ka qenë se nuk ka funksionuar shteti ligjor, pra nuk janë zbatuar rregullat e parapara duke u përdorur ato me standardet e dyfishta, varësisht se si e kanë vlerësuar udhëheqësit e privatizimit të cilët do të duhej të ishin zbatues të ligjit e jo ligji vetë. Për këtë praktikë të tyre jemi dëshmitarë se ata zgjasin afatet e përmbushjes së një ofertuesi jashtë rregullave të parapara me Rregulloren për privatizim. Një faktor tjetër i cili po dëmton këtë proces në Kosovë është edhe ndërrimi i destinacionit që po u bëhet ndërmarrjeve prodhuese me rastin e privatizimit, ku për pasojë dhjetëra hektarë shndërrohen në tokë për ndërtim, në vend që të privatizohen me spinof special që do të duhej ta ruante destinacionin e prodhimit e jo të krijojë një anarki. Ata që më së shumti në këtë proces po dalin humbës janë punëtorët të cilët thuajse nuk fitojnë asgjë nga shitja e ndërmarrjeve, sepse të hollat nga shitja e ndërmarrjeve përfundojnë në banka dikund jashtë për të cilat qytetarët nuk dinë se ku mbahen dhe si shfrytëzohet ato para. Të marrim një shembull, tjegullorja në Besianë 19 qershori është

privatizuar në rundin e tretë të privatizimit dhe 136 punëtorë kanë mbetur pa i marr 22 paga edhe pse këshilli i punëtorëve, zyra rajonale e AKM-së, sindikata kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për t'i paguar këto paga. Dihet se në këtë proces interesi i punëtorëve nuk është fare i mbrojtur, përfaqësuesi i sindikatës në AKM më shumë është një dekor se një zë që vërtet do të mund t'i mbronte interesat e punëtorëve. Dihet sot në Kosovë se me procesin e privatizimit po bëhet biznes në mes konkurrentëve dhe kjo le për të dyshuar se edhe bordi i AKM-së dhe Qeveria bëhen shpesh menaxherë i këtyre bizneseve. Nuk janë raste të rralla kur ofertuesi i parë me ofertuesin e dytë janë shumë larg në ofertat e tyre dhe zakonisht tërheqja e të parëve le një mjegull të madhe për AKM-në dhe Qeverinë ,sepse ndërmarrjet në këto raste thuhetse falen.

Edhe unë mendoj si shumë deputetë se disa resurse me interes nacional siç janë minierat nuk duhet të privatizohen. Për zotin Ryker kisha një pyetje, në çfarë shkalle janë të privatizuara minierat në Gjermani prej nga vjen z. Ryker dhe më intereson pse ata nuk i kanë privatizuar. Askush në Kosovë nuk është kundër privatizimit, por privatizimi duhet ekskluzivisht t'u nënshtrohet rregullave të parapara dhe duhet kuptuar se zhvillimi ekonomik i Kosovës do të varet jo vetëm nga shpejtësia, por edhe nga cilësia e tij. Nuk i pengojnë investimet e huaja në Kosovë ata që kritikojnë parregullsitë në procesin e privatizimit ,siç pretendohet shpesh nga Qeveria. Investimet në Kosovë i pengojnë pikërisht ata që e udhëheqin këtë privatizim dhe me veprimet e tyre krijojnë mosbesim edhe te ata që dëshirojnë të konkurrojnë, por edhe te vet qytetarët. Andaj Qeveria dhe AKM-ja duhet ta rishikojnë vetëvehten sa i përket investimeve të huaja në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI SABIT RRHMANI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë mendova të tërhiqem prej fjalës pasi që z. Dugolli nuk ishte këtu, por e thirrën melaqet dhe erdhi. Z. ministër unë do të përqendrohem më shumë në formë të pyetjes, meqë mendoj se deputetët i kanë përfshirë ato kryesore, kështu që do të kem pyetje konkrete e jo debat. Duke marrë parasysh që deri në vitin 1999 një pjesë e komunitetit ashkanlinj absolutisht nuk ka qenë të punësuar në ndërmarrje publike apo shoqërore, një pjesë më e madhe e tyre në vitin 1990, kur shumica shqiptare i kanë lëshuar vendet e tyre të punës, pjesa më e madhe e komunitetit ashkanlinj ju kanë bashkangjitur dhe e kanë lëshuar punën. Duke marrë parasysh që disa ndërmarrje qysh tash janë privatizuar dhe 20% u takojnë punëtorëve unë dëshiroj t'ju njoftoj z. ministër që një pjesë e madhe e pjesëtarëve të komunitetit ashkanlinj që kanë qenë të punësuar deri në vitin 1990 dhe e kanë lëshuar punën në vitin 1990 u është mohuar e drejta e participimit në atë 20%, nuk di cila është arsyeja. Kemi rastin konkret në komunën e Ferizajt në Kombinatin e drurit "Tefik Çanga "ku nga një numër prej 87 punëtorësh të cilët kanë qenë të punësuar deri në vitin 1990, 24 prej tyre u është mohuar e drejta që të participojnë në 20% edhe ata kanë qenë punëtorë deri në vitin 1990 edhe pas vitit 1990 nuk kanë punuar.

Një shembull tjetër konkrete është në Prishtinë, një ndërmarrje që është marrë me mirëmbajtjen e rrugëve nuk di si është quajtur ajo deri në vitin 1990, 96 punëtorë të komunitetit ashkanlinj kanë punuar në atë ndërmarrje 78 prej tyre në vitin 1990 së bashku

me shqiptarët e kanë lëshuar punën, 49 prej këtyre 78 kanë qenë me përvojë të punës mbi 18 vjet edhe sot edhe në kohën e pasluftës kur janë paraqitur në vendet e tyre të punës absolutisht as që u lejuar të hyjnë në ndërtesë ku kanë punuar ata e le më të participojnë në atë 20%. Unë dëshiroj t'i di vetëm disa kritere, a i përcakton AKM-ja kriteret e shpërndarjes të këtij 20% apo vetë ndërmarrjet që e kanë marrë atë 20% që t'u ndajë punëtorëve, a është kriter i AKM apo është kriter i ndërmarrjeve që kujt t'i teket ta marrë atë 20% apo ju takon të gjithëve që kanë punuar, nuk po flas për ata që kanë punuar deri në vitin 1999, ndoshta edhe s'e kanë merituar se kanë punuar me një sistem krejt tjetër, por ata që kanë punuar deri në vitin 1990 një pjesë e madhe e tyre pse nuk kanë të drejtë dhe pse u mohohet e drejta të participojnë në 20%.

Disa ndërmarrje të cilat e kanë vazhduar veprimtarinë edhe pas kohës së luftës, pse u mohohet e drejta punëtorëve të komunitetit ashkanlinj të cilët e kanë lëshuar punën në vitin 1990 tash të kthehen në vendet e tyre të punës, apo disa prej tyre që kanë qenë edhe në vendet më përgjegjëse nëpër organizata të tyre të punës u është ndërruar vendi i punës, tash i kanë qitur rojtat apo diçka të thjeshtë. Një rast konkret e kemi në Auto-reмонт të Ferizajt, 4 punëtorë që kanë punuar prej vitit 1972 deri në vitin 1990 janë larguar prej punës së bashku me shqiptarët. Në vitin 1999 prapë janë kthyer në vendet e tyre të punës, kurse në vitin 2001 vetëm këta 4 punëtorë largohen pa asnjë arsye nga vendet e tyre të punës, vetëm u jepet një vendim se më nuk mund të punojnë këtu dhe asgjë më tepër, pse është marrë ai vendim.

Dhe pyetja që ka të bëjë me bordin e AKM-së z. ministër ju thatë që në bordin e AKM-së janë 3 ministra, njëri prej tyre ju thatë që duhet të jetë serb, pse pa tjetër serb, mua po më intereson pse patjetër serb a vetëm aty ku ka para serbët marrin pjesë, pse nuk marrin në institucione, pse nuk marrin pjesë në Kuvend, kurse në bordin e AKM-së po, a ka mundësi me qenë ai boshnjak apo turk, apo diçka tjetër, por nëse e ka bojkotuar pjesëmarrjen e vet në bordin e AKM-së, nuk besoj që ka, ndoshta edhe është ai ministër nuk e di, por nëse nuk është a është zëvendësuar me ndonjë ministër tjetër apo jo prej pakicave të tjera. Ju faleminderit.

KRYETËARI – Ju faleminderit. Pasi që debati është kryer rreth kësaj pike, konstatoj se Kuvendi miraton raportin e rekomandimit të Qeverisë lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve. fjalën e ka ministri Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLI – Faleminderit kryetar. Më lejoni që në emër të Qeverisë së Kosovës ta falënderoj Kuvendin e Kosovës për një debat konstruktiv dhe të frytshëm për këtë çështje që është shumë e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Më lejoni të konstatoj që edhe ne si Qeveri, si institucione i mbështesim kërkesat e grupeve në rend të parë kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, të AAK-së dhe partive që e mbështetën të bëhet një auditim i pavarur në AKM- duke përfshirë nga data kur është themeluar kjo agjenci e deri në ditët e sotme. Unë në fillim e thashë që në bazë të infrastrukturës ligjore që punon kjo agjenci dhe dy ministra që janë aktivë në bord nuk do të thotë se arrijnë ta kontrollojnë tërë punën e menaxhmentit të AKM-së, i cili është totalisht i ndërtuar shumë më parë, kur ne nuk kemi qenë atëherë dhe Qeveria e Kosovës nuk ka qasje në menaxhmentin ekzekutiv të AKM-së, këtu duhet

t'ua bëjë me dije të gjithëve, por e di që shumë e dinë, por po bëjnë sulme dhe akuza vetëm pse dëshirojnë ta sulmojnë Qeverinë. Dëshiroj t'i bashkangjitem kërkesës që statusi i Trepçës duhet të konsiderohet si i veçantë dhe duhet edhe institucionet e Kosovës dhe institucionet e larta si Parlamenti me komisionet e veta dhe grupet parlamentare ta japin kontributin e vet për çështjen e Trepçës si një objekt, si një ndërmarrje e veçantë me interesa të rëndësishme për vendin. Dëshiroj t'u bashkangjitem edhe qëndrimeve të Z. Ryker se ndaj kërkesave që i pat Grupi Parlamentar i PDK-së se është bërë shkelja e rregullores me rastin e privatizimit të Feronikelit dhe duhet t'i hedh poshtë ato akuza që u bënë në adresë dhe posaçërisht në adresë timen dhe të Qeverisë së Kosovës, sepse janë akuza pa baza, akuza tendencioze me qëllim për t'i njollosur personat e caktuar dhe akuza që janë dirigjuar nga shefat, nuk po them parapolitika, siç u tha dje, por nga shefat dhe për keqardhje pse nuk vijnë me deklarua vetë këtu se kemi edhe për ta shumë çka për të thënë, por pasi nuk janë këtu po e lëmë dhe nuk po i themi sot.

Sa u përket interesave, ne nuk kemi interesa personale në këtë proces dhe anëtarët e bordit që janë nga Qeveria e Kosovës nuk paguhën për punën që e bëjnë në bordin e AKM-së, duhet t'i hedh poshtë ato vlerësime që i ka dhënë një gazetë opozitare se gjoja anëtarët e bordit në AKM- nga Qeveria marrin mëditje nga 1000 euro që ka qenë një absurd i veçantë. Është kërkuar që të kompensohen shpenzimet qoftë në udhëtime, por nuk ka ndodhur edhe pse ne humbim shumë kohë dh na marrin shumë pjesë të kohës së punës nëpër ministri për të qenë aktivë dhe për ta përcjell këtë proces që është shumë i rëndësishëm.

Dëshiroj të them se AKM-ja dhe bordi i AKM-së as nuk ndikojnë në krijimin e konzerciumeve në spinofe speciale as nuk ndikojnë për prishjen e tyre, prandaj të gjitha ato që u thanë janë të pa baza dhe nuk kanë kurrfarë vlere. Dua t'i përgjigjem pyetjes apo komentit që e dha z. Surroi, i cili tha se në raportin që e dha Qeveria nuk është bërë analizë e cilësisë së procesit, unë këtu jam thirr dhe jam autorizuar të bëjë një raport dhe mendoj që e kam bërë një raport si Qeveri, duke i përmendur sukseset në të cilat edhe ne jemi të kënaqur dhe duke i përmendur shqetësimet që i ka Qeveria e Kosovës dhe nuk jemi ftuar për të bërë analiza në Kuvend dhe mendoj se për analiza janë tribunat, tryezat se kushdo që të na ftoj duhet ta japim kontributin tonë. U tha se nuk ka pasur rezultate në punësim. Unë i kam dhënë disa shifra të spinof-et speciale dhe mendoj se me siguri nuk i paska lexuar, por dua t'i përsëris se vetëm me spinof-e speciale janë të garantuara 6.306 vende të punës pa i llogaritur spinof-et e rregullta për 230 ndërmarrje, që duhet një analizë e veçantë të bëhet dhe të shkohet të intervistohet se sa i kanë punësuar ata, por nuk ka dyshim që nuk ka sukses, d.m.th ka sukses të madh.

U tha nga z. Surroi se asetet strategjike duhet të lihen e të mos të privatizohen e mori shembull Feronikelin, këtu dua t'u përgjigjem edhe z. Surroi dhe zotërinjve nga PDK që ishte 2 korriku 2004, kur në një mbledhje të përbashkët z. Lanzdorf dhe z. Jakupi në atë kohë e përcaktuan për ta privatizuar Feronikelin, d.m.th nuk ishte ky bord, nuk ishte kjo Qeveri dhe 3 herë radhazi është shtyrë privatizimi vetëm gjatë vitit 2004 për këtë gjigant ekonomik, prandaj detyrën kur e kemi marrë në mbledhjen e partë të bordit vetëm çështja e privatizimi ka qenë e hapur dhe nuk kemi pasur ndikim as në hartimin e politikave operacionale të spinof-it special, por as në masat e tjera që pretendohen nga ata që nuk ju

kanë realizuar qëllimet ndoshta. Ngrirja e parasë publike sidomos të fondit të privatizimit, ne e folëm dhe u fol nga shumë deputetë këtu që është një preokupim, një brengë e jona dhe mendoj se është e padrejtë që ajo mbahet e ngrirë, por duhet edhe ju me rekomandime edhe me ato që i kemi paraqitur ne edhe me diskutime këtu që ta shtyjme këtë proces përpara që të zhbllokohet, nuk mund Qeveria vetë e as dy anëtar të bordit që jemi ne nga Qeveria aktivënë bord të AKM-së, nuk mund këtë fond ta zhbllokojmë u tha nga z. Ryker se është çështje që ndërlidhet me statusin dhe mendojmë që mund të bëhen hapa dhe të zhbllokohet të paktën një pjesë për t'i'u dhënë në shërbim bankave.

Marrja me qira e objekteve për organet qeveritare, kjo ka ndodhur është marrë me qira, Qeveria nuk ka pasur mundësi t'i heq ndërmarrjet nga regjistri i AKM-së dhe për t'i bërë pronë të veten apo për të ndërruar statusin e tyre. Ne jemi përpjekur për disa objekte siç është përmendur edhe Hoteli Union, ne e kemi ngritur këtë çështje edhe në atë kohë kryeministri i Kosumi i ka shkruar bordit dhe e kemi diskutuar, e vetmja mundësi ka qenë që komuna të jetë pronare, të kompensoj ta marrë atë objekt, përndryshe dhënia apo ndërrimi i titullarit pa proces të privatizimit konsiderohet si veprim i paligjshëm dhe nuk është përfillur dhe bjen ndesh me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe nuk kemi pasur sukses në këtë drejtim. Mendoj që korporatizimi është proces i duhur që ka ndodhur, është një hap para privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, d.m.th vlerës apo aseteve specifike të ndërmarrjeve publike që u përmendën nga deputetja e PDK-së që edhe ne mendojmë që disa asete të ndërmarrjeve publike mund të privatizohen se do të gjenerojnë të hyra më të mira edhe për buxhetin edhe shërbime më të mira dhe ky është një hap që do të qojë andej, por korporatizimi bazohet në nivelin e qeverisjes të korporatave të niveleve perëndimore, është marrë modeli gjerman, por në kombinim edhe me atë angloamerikan. U tha nga z. Merxha që po humbin vendet e punës, ne e marrim gjendjen ekzistuese që është pas lirim të Kosovës, ne nuk flasim për ekonominë socialiste në kohën e regjimeve komuniste, atëherë kur kanë qenë ndërmarrjet e tilla. Ne e kemi një gjendje si e kemi tani. Mbi 98% të ndërmarrjeve shoqërore janë pasive dhe janë duke u shkatërruar, ndoshta 2% apo 3% janë disa ndërmarrje që mundohen t'i nxjerrin shpenzimet apo pagesat për një numër të kufizuar të punëtorëve, por ajo ekonomi është e vdekur dhe nuk mund të ngjallet, mund të ngjallet me privatizim dhe krijimin e perspektivave të reja dhe nga ky proces as ne nuk mund të ikim. Deputetja Hadrëgjonaq tha që bëhet shpëlarja e parasë në këto procese, ne kemi marrë garanci nga UNMIK-u, policia e UNMIK-ut, Shtylla e Parë e cila i bën hetimet në bashkëpunim me Interpolin për pasuritë e kompanive „qoftë ndërkombëtare që konkurrojnë, qoftë vendore dhe ne e kemi atë mekanizëm për momentin që bën kontrollet financiare dhe nuk kemi tjetër mekanizëm dhe si të tillë kur na vjen dokumenti me shkrim që është e pastër kompania ne e kemi atë mekanizëm dhe i besojmë atij mekanizmi deri sa të kemi një mekanizëm tjetër. Prandaj nuk është konsideruar ndonjë element i tillë që dikush ka marrë pjesë në privatizim apo me para të pista ka blerë diçka, prandaj kontrollet financiare të ndërmarrjeve zgjatën dhe është shpesh zgjatje e panevojshme.

Privatizimi i ndërmarrjeve bujqësore, ne e mbështesim privatizimin dhe u tha edhe të kooperativave, ndërsa pengesa dhe degradimi apo devalvimi i tokës bujqësore duhet të kyçen dhe të aktivizohen edhe mekanizma të tjerë siç janë komuna, për të mos lejuar që toka bujqësore të shndërrohet në një tokë për qëllime tjera. Në rast se ka sanksione të duhura, unë mendoj që do të pengohet ai, sepse toka bujqësore duhet të ruhet si tokë

bujqësore dhe ky është qëndrim i Qeverisë që ne e mbështesim. U dëgjua këtu se janë ndryshuar kushtet pas privatizimit me spinof-e speciale. Në rast se privatizimi me spinof special ka ndodhur dhe është nënshkruar kontrata, pronari është i obliguar ta respektojë atë kontratë dhe nuk mundet ta ndryshoj. Ekzistojnë mënyrat e kontrollimit nga AKM-ja, por në të ardhmen edhe nga Qeveria që të shikohet në përpikëri se si e ka zbatuar kontratën. Në rast se investitori nuk ju ka përmbajtur mund të iniciohet procedura e prishjes së kontratës dhe përfaqësuesi special e ka atë të drejtë me ligj që ta shfuqizojë atë kontratë dhe ta prishë atë privatizim, duke i marrë të gjitha përgjegjësitë jo Përfaqësuesi Special dhe institucionet e Kosovës, por vetë ai i cili nuk e ka zbatuar, prandaj janë masa që mund të merren.

Kompanitë e Gjakovës që u folën edhe nga deputetja e LDK-së, por edhe nga deputetja e Orës, e cila mendoj se e pati më shumë për fushatë politike dhe nuk është prezent tash për t'i dëgjuar opinionet tona. Në mandatin e kaluar kush ka qenë deputet e din se ky Kuvend ka bërë një rezolutë me të cilën i ka hedhur poshtë të gjitha ligjet që janë marrë pas suspendimit ose marrjes me dhunë të autonomisë së Kosovës. Nëse ky Kuvend mendon që ka ligje jo diskriminuese atëherë urdhëroni pajtohuni me atë dhe ne do t'i zbatojmë ato ose bëni ndonjë vendim që ligjet pas marrjes së autonomisë të Kosovës nuk kanë qenë diskriminuese, ne pajtohemi. Ne kemi bërë hapa të duhura për ndërmarrje të Gjakovës dhe ne e kemi thyer statuskuon që ka mbretëruar prej kur është themeluar AKM-ja. Ne i kemi shkruar që nuk e tolerojmë atë gjendje me ndërmarrjet e Gjakovës dhe e kemi thyer atë gjendje dhe i kemi 7 ndërmarrje të privatizuara. Ne kemi thënë se do t'i japim interes privatizimit dhe kemi filluar me privatizim, ne kemi thënë se do t'i shikojmë rastet kur privatizimi është kryer 100%, transferimi i pronës dhe në rast se auditorët e AKM-së vërtetojnë në bazë të dokumentacioneve se një ndërmarrje qoftë Gorenjeelektromotori që është privatizuar 100%, është ndërruar dhe nuk ka pasur diskriminim dhe ka pasur vlerat e pagesave të gjitha në rregull. Unë mendoj se bordi do të marrë vendim në favor të kësaj, por në rast se nuk ka argumente, dokumente që ka ndodhur ashtu ne nuk jemi kompetent, por janë kompetent organet profesionale dhe gjykatat që vlerësojnë që ai transformim i pronës është bërë në bazë ligjore, prandaj ne nuk kemi si bord me shqyrtuar statusin, por janë ekipet e ekspertëve dhe gjykata pran Odës Speciale që e bënë këtë. Janë edhe disa çështje, unë thashë edhe për statusin e Trepçës që e tha z. Kelmendi, ne do të punojmë bashkërisht me Kuvendin për këtë çështje dhe kryeministri i ka ngritur shqetësimet sa i përket kësaj çështjeje dhe ne kemi marrë vendim dhe i kemi kërkuar Përfaqësuesit Special që Trepça të mbrohet nga paditë apo nga pretendimet që ka pasur borxhe, Përfaqësuesi Special e ka bërë një gjë të tillë deri më tash dhe ne u kemi thënë që institucionet e Kosovës nuk pranojnë se Trepça ka borxhe apo është transferuar apo është bërë shoqëri aksionare sepse ka qenë në administrimin e dhunshëm dhe ato borxhet i ka shkaktuar Serbia dhe jo Trepça dhe jo organet legjitime të Kosovës. Sa i përket statusit të privilegjuar ajo është çështje që rregullohet në Ministrinë e Energjetikës dhe Minierave dhe status të privilegjuar për furnizim me energji elektrike do të kenë shumë kompani prodhuese të industrisë prodhuese, por nuk do të kenë dallime sa i përket çështjeve që t'u bëhet tolerime në atë mënyrë që të dëmtohet buxheti i Kosovës apo afarizmi i KEK-ut, ky është vendim i Qeverisë edhe në rastin me Alferonin edhe me rastin e kontratave të tjera që Qeveria e Kosovës nuk lejon dëmtimin e buxhetit duke u-shpallur status të privilegjuar dhe Qeveria nuk lejon që të dëmtohet afarizmi i KEK-ut me rastin e

nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve komerciale, ky është vendim qeveritar dhe në bazë të këtij vendimi ka vepruar edhe Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Tek industria e duhanit ne i kemi ngritur këto shqetësime që i tha deputeti nga Ora edhe ne kemi kërkuar sqarime në bazë të ankesave që i kanë bërë zyrtarët nga ofertuesi i dytë faktikisht, edhe neve na duket nonsens 790 punëtorë një ndërmarrje që faktikisht duhet t'i rritë apo t'i trefishoj kapacitetet dhe jemi shprehur skeptik se a ka paraqitur ai investitor një plan investiv të veçantë ku do t'i krijojë të gjitha ato vende të punës, por nuk mund të themi nëse ka plan biznesi të saktë që nuk i donë të hapen 790 vende të punës dhe është një çështje e ndjeshme, menaxhmenti na ka thënë që dallon një poen, rregullat janë rregulla, politikat janë politika operacionale, ne kemi kërkuar sqarime është thënë që kompania që ka dhënë më shumë vende të punës dhe investime dallohet për një poen me kompaninë që ka dhënë më shumë në çmim kesh dhe kjo çështje është pjesë e punës në menaxhmentin e AKM-së. Unë besoj që ata do ta zgjedhin këtë. U tha që është bërë lojë me Drenicën, unë mendoj që shumë nga disa zotërinj këtu që janë nga Partia Demokratike dhe është e vërtetë që kanë bërë lojë me Drenicën, por faktikisht këtë lojë nuk kanë arritur ta fitojnë, sepse popullata nuk i ka përkrahur dhe nuk i ka dëgjuar, se ka qenë në dëm të interesit të tyre dhe jam i lumtur unë që kjo Qeveri dhe Bashkësia Ndërkombëtare që u arrit të hapen 1000 vende të punës në Drenicë, prandaj ju z. të nderuar me ato fushatat tuaja personale, individuale, me ato akuza denigruese e shpifëse merruni prapë në këtë proces, por nuk do t'ia arrini sepse ne kemi mbështetje ligjore, kemi vepruar në bazë të ligjit dhe jemi të sinqertë dhe transparentë, pra do të shihet puna e kujt ka qenë më e ndershme dhe më e mirë. Jemi të gatshëm për këtë t'ju përgjigjemi, por është fat që popullata nuk ju ka përgjigjur ftesës suaj në këto lojëra.

Sa i përket privatizimit të Ballkanit. Ai është një investitor i huaj, është duke bërë operim biznesi ashtu siç e ka marrë me kontratën e spinof-it special dhe mendojmë se do t'i përmbushë kushtet që i ka për obligim sipas kontratës. E kam vizituar dhe ai është duke bërë progres, është duke ju përmbajtur numrit të të punësuarve sipas afateve që i ka marrë, është duke kryer një afarizëm, është duke eksportuar, prandaj kjo është çështje që do të vazhdojë dhe ne do ta përcjellim në vazhdimësi, madje edhe në rast se dështon do t'i ndërpresë punët dhe do të themi se ka dështuar, por nuk ka shenja të dështimit as Ballkani, as Llamkosi dhe shumë ndërmarrje që janë privatizuar me spinof special kanë afarizëm të suksesshëm.

Zoti Rrahmani u shpreh për çështjen e 20% të punëtorëve të pakicave. Unë kur thashë në fillim që është një e padrejtë që po bëhet që përmes Odës së Veçantë përcaktohet statusi i punëtorëve, kjo është diçka shumë e komplikuar, le që nuk ka rezultate, por edhe po bën dëmtrimin e punëtorëve. Ato miliona që po mbesin në llogari të AKM-së nuk janë bartur as në xhirologari të BSPK-së, që të paktën të rritet kamata dhe të përfitojnë punëtorët më shumë. Kjo ka qenë kërkesë jona. Unë mendoj që kategorizimi duhet të bëhet që ata që kanë punuar deri në vitet e 90, ata që kanë punuar pas çlirimit të Kosovës, d.m.th këto dy kategori, nuk mendoj që ata që kanë punuar në masa të dhunshme dhe i kanë marrë menaxhimet të përfitojnë nga kjo, por sido që të jetë kjo është çështje që listat duhet të hartohen nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura. Për momentin duhet të dërgohen në Gjykatën e Veçantë në rast se e heqim këtë politikë operacionale ne do të jemi të lumtur

që do të mund t'i miratojmë di bord se kush mund ta fitojë të drejtën e 20% dhe . Mendoj që këtu nuk duhet të bëjmë dallime pa marrë parasysh se a kanë qenë serbë apo egjiptas, ashkalinj apo romë, shqiptarë, por a kanë qenë mbi 3 vjet në punë gjatë këtyre periudhave, duhet ta fitojnë të drejtën që të kenë pjesë në 20%. Unë kam parë edhe disa raste specifike që ndërmarrjet që janë privatizuar, aty ku kanë pasur minoritete nuk i kanë larguar, shembull ke fabrikën e Ujit të Kllokotit, Ajo vazhdon t'i mbajë 20 serbë në punë që kanë qenë, nuk e ka larguar asnjë.

Më lejoni që t'i mbështes ato vlerësime pozitive dhe qëllimmira që na janë dhënë ne. Unë mendoj se ne nga Kuvendi presim përkrahje qoftë me rekomandime, qoftë në çështje tjera që u ngritën këtu që t'i shtojnë përpara, u tha që është pjesë e rezervuar, por ne nuk mund të heshtim edhe pse është pjesë e rezervuar ,sepse bëhet fjalë për pasurinë e Kosovës, bëhet fjalë për ndërmarrjet e Kosovës, bëhet fjalë për qytetarët e Kosovës. Pa marrë parasysh që është pjesë e rezervuar ne mendojmë që ka ardhur koha të mendohet transferi i këtyre kompetencave dhe ne jemi të gatshëm me ndihmën e Kuvendit që ta zotërojmë edhe këtë transfero të kompetencave në fushën e privatizimit. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit ministër. Përfaqësuesi i propozuesit tëka të drejtë ta marrë fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI – Z. kryetar, para se të marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar do t'i replikoj z. ministër Dugolli lidhur me atë se kush po i dilka zot popullit të Drenicës, Qeveria me Bujar Dugollin, apo ishte vetë populli i Drenicës që i doli zotë vetvetes dhe jo vetëm vetvetes. Dua të them se përkrahja e popullit të Drenicës rreth privatizimit të Feronikelit është treguar me vetë aktivitetin që e ka bërë ai popull dhe punëtorët e Feronikelit. Të jemi të bindur se as sot dhe asnjëherë nuk do të pajtohemi dhe s'jam pajtuar me mënyrën se si është privatizuar dhe mënyrën se si ka shkuar Feronikeli, dua të shtoj këtë se z. Dugolli bashkë me z. Ryker edhe një ditë do të na i privatizojnë edhe varrezat dhe nuk do të kemi ku të futemi në varre dhe kjo i ngjan taman sikur atyre reformave agrare dhe kolonizuese 3 apo 4 sa kanë qenë në kohën e Serbisë, kur të gjithë ne ishim bërë çipçi në tokën tonë dhe po të vazhdohet ky proces me këtë politikë të privatizimit atëherë vërtet populli i Kosovës do të jetë çipçi në tokën e vetë dhe një ditë se çka do të mund të na privatizojnë. Desha të shtoj edhe këtë se z. Dugolli bashkë me emisarët e vet me çanta të mbushura me para shëtisin nëpër Drenicë, duke u përpjekur që të blejnë njerëz me ndikim që të pajtohen me mënyrën se si është privatizuar Feronikeli.

KRYETARI – Ju faleminderit, diskutimet kanë marrë fund ju lutem, të mos hapim prapë proces të diskutimeve ju lutem.

DEPUTETI XHAVIT HALITI- Mendoj që e kam fjalën posaçërisht për Grupin Parlamentar të PDK-së, kemi pasur 7 orë gati debat, është kryer debati nuk mund të bëhet replikë pas fjalës së përfaqësuesit të grupit parlamentar dhe përfaqësuesi i grupit parlamentar e ka pasur mundësinë, unë po them që ta fillojmë një rrugë të mbarë, mos ta rifillojmë debatin, sepse replikë pas replike i marrim edhe dy orë, me rregullore s'keni të drejtë.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - I respektuari kryetari i Kuvendit, i nderuari kryeministër, kolege deputetë pjesëmarrës në seancë, LPK e ka përkrahur procesin e privatizimit dhe ka qene kundër çdo shtyerje dhe bllokimi të tij.

I bashkangjitemi pjesës së vërejtjeve që janë duke u bërë për privatizimin dhe nuk dëshiroj që t'i përsëris ato. Unë dua të kundërshtoj për mënyrën dhe kushtet e privatizimit dhe të trajtimit të minierave në Kosovë. Kjo rrugë bën që Kosova të mos ketë pse t'u gëzohet pasurive të veta natyrore nga të cilat po krijohen kushtet që vendi ynë të fitojë me së paku.

Shifrat flasin se vlera e ndërmarrjeve të shitura me buxhetin që ka ndarë Kuvendi i Kosovës për AKM-në është afërsisht e njëjtë. Kosova nuk ka qasje në paratë e grumbulluara nga privatizimi. Pos humbjeve buxheti i Kosovës deri më tash asgjë nuk ka fituar nga privatizimi.

Qëndrojmë në propozimin që AKM e financuar nga Qeveria të drejtohet dhe kontrollohet nga Qeveria dhe Kuvendi.

U bashkangjitem rekomandimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë që AKM të kalojë në kompetenca të Qeverisë, gjithashtu edhe kërkesës për auditim të AKM-së dhe propozimeve të tjera konstruktive që u dhanë këtu..

Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI – Z. Xhemajli është kryer debati, do të vazhdojmë sonte me pikën e 3 të rendit të ditës apo ta lëmë për një ditë tjetër, pyes përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për fjalë është paraqitur profesor Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë mendoj që sot nuk duhet të vazhdohet me pikën tjetër, po të vazhdojmë ditën tjetër kur ju të vendosni, Kryesia, apo kryesuesi kur të vendos. Ju faleminderit.

KRYETARI – Seanca vazhdon punën me 27 prill, pika e 3 e rendit të ditës do të vazhdohet më 27 prill 2006.